

KLSH ANALIZA VJETORE 2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KLSH ANALIZA VJETORE **2017**

Tiranë, 2018

Titulli:

KLSH ANALIZA VJETORE 2017

Redaktoi: Armanda BEGAJ

Realizoi në kompjuter: Armanda BEGAJ

Seria: botime KLSH 04/2018/88

ISBN: 978-9928-159-69-4

Shtypur në Shtypshkronjën: MORAVA

Tiranë, 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
HYRJE	7
PËRSHËNDETJE	11
<ul style="list-style-type: none"> • Fjala përshëndetëse e Presidentit të Republikës, SH.T.Z. Ilir META 11 • Përmbledhje ekzekutive e performancës së KLSH-së, për vitin 2017 15 Fjala e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar LESKAJ • Fjala përshëndetëse e Rektorit të Universitetit “Aleksandër MOISIU” Durrës, znj. Kseanela SOTIROFSKI 35 • Fjala përshëndetëse e Sekretarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, Prof. Dr. Anastas ANGJELI 37 • Fjala përshëndetëse e Auditorit të Përgjithshëm të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, z. Besnik OSMANI 40 • Fjala përshëndetëse e Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë, z. Naser ADEMI 43 	
REFORMA INSTITUCIONALE DHE PERFORMANCA E VEPRIMTARISË AUDITUESE TË KLSH-së, PËR VITIN 2017	45
<ul style="list-style-type: none"> • PROGRESI DREJT MODERNIZIMIT INSTITUCIONAL PËRGJATË VITIT 2017 45 Nga znj. Luljeta NANO, Sekretar i Përgjithshëm • DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE 69 Nga znj. Lindita LATI, Drejtor i Përgjithshëm • DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE 93 Nga znj. Manjola NAÇO, Drejtor i Përgjithshëm • DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE INVESTIMEVE TË HUAJA 105 Nga znj. Yllka PULASHI, Drejtor Departamenti 	

- **DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHETIT** 113
Nga z. Azmi STRINGA, Drejtor Departamenti
- **DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETIVE DHE MJEDISIT** 123
Nga z. Bajram LAMAJ, Drejtor Departamenti
- **MBI AUDITIMET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT** 146
Nga z. Kozma KONDAKÇIU, Drejtor Drejtorie
- **DEPARTAMENTI JURIDIK, KONTROLLIT TË ZBATIMIT TË STANDARDEVE** 151
Nga z. Ermal YZEIRAJ, Drejtor Departamenti
- **TRANSPARENCA E AKTIVITETIT TË KLSH-së SI NJË NGA TREGUESIT KRYESORË TË MODERNIZIMIT TË INSTITUCIONIT DHE TË RRRITJES SË BESIMIT TË QYTETARËVE NË PUNËN E TIJ** 161
Nga znj. Irena ISLAMI, Drejtor Drejtorie

MBI AUDITIMET E PERFORMANCËS TË REALIZUARA GJATË VITIT 2017 193

- **PUNA AUDITUESE E DEPARTAMENTIT TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS** 193
Nga z. Rinald MUÇA, Drejtor Departamenti
- 1. **Mbi auditimin me temë: CILËSIA E AJRIT** 197
Aulent GURI, Artur HASANBELLIU dhe Xhuljeta ÇELAJ
- 2. **Mbi auditimin me temë: EFEKTIVITETI I POLITIKAVE PËR ZHVILLIMIN STRATEGJIK TË TURIZMIT** 205
Miranda BERDO dhe Klejvis KULE
- 3. **Mbi auditimin me temë: EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AGJENCINË E ZHVILLIMIT BUJQËSOR DHE RURAL** 209
Gjovalin PREÇI dhe Klejvis KULE
- 4. **Mbi auditimin me temë: PERFORMANCA E MINISTRISË SË ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË NË ZHVILLIMIN E SPORTIT** 214
Dorel BALLIU dhe Kris ANASTASI
- 5. **Mbi auditimin me temë: UNIFIKIMI I PIKAVE DOGANORE TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS** 218
Sali AGAJ dhe Redi AMETLLARI

FOKUSI STRATEGJIK I KLSH-së – QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT PËR PERIUHDHËN 2018 – 2022 223

Nga z. Bujar LESKAJ, Kryetar i KLSH-së

LEKSIONE TË HAPURA TË ZHVILLUARA ME STUDENTËT E UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS	254
<ul style="list-style-type: none"> • VEPRIMTARIA E AUDITIMIT TË JASHTËM NË SEKTORIN PUBLIK, KONTROLLI I LARTË I SHTETIT, KUADRI KUSHTETUES DHE LIGJOR 254 Nga znj. Luljeta NANO, Sekretar i Përgjithshëm • AUDITIMI KOMBËTAR DHE RESPEKTIMI I TIJ NË KUADËR TË STANDARDIZIMIT TË NJË KONCEPTI EUROPIAN MIRËQEVERISJEJE DHE TË MIRËADMINISTRIMIT TË ASETVE NË INTERES TË PUBLIKUT 265 Nga z. Bajram LAMAJ, Drejtor Departamenti • AUDITIMI I SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INSTITUCIONEVE PUBLIKE 272 Nga znj. Yllka PULASHI, Drejtor Departamenti • HYRJE NË AUDITIM 276 Nga znj. Aulona JANI, Kryeaudituese 	
KONTRIBUTET E AUDITUESVE TË KLSH-së, TË CILËT KANË MBYLLUR KARRIERËN E TYRE PROFESIONALE GJATË VITIT 2017	281
PASQYRIMI NË MEDIAN VIZIVE, TË SHKRUAR DHE ELEKTRONIKE I ANALIZËS VJETORE TË KLSH-së PËR 2017, 15 SHKURT 2018	287

HYRJE

Analiza e përgjithshme e aktivitetit të KLSH-së për vitin 2017 u zhvillua pas analizave të Departamenteve dhe Drejtorive të KLSH-së, në të cilat morën pjesë përveç audituesve të Departamenteve respektive edhe auditues nga Departamente të tjera auditimi me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe të praktikave më të mira të punës në auditim. Analizat u kryen gjatë muajit janar 2018 në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe në to morën pjesë gjithashtu përfaqësues të mediave, të shoqërisë civile dhe të botës akademike.

Pas kësaj faze të parë, në datat 15-16 shkurt 2018, në mjediset e Universitetit “Aleksandër MOISIU”, në Durrës, Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvilloi analizën vjetore të punës për institucionin për vitin 2017.

Në ditën e parë të analizës morën pjesë Presidenti i Republikës, Shkëlqesia e Tij z. Ilir META, Sekretari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, Akademik Anastas ANGJELI, Audituesi i Përgjithshëm i Kosovës, z. Besnik OSMANI dhe Zëvendës Audituesi i Përgjithshëm i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, z. Naser ADEMI, Rektorja e Universitetit “Aleksandër MOISIU”, zj. Kseanela SOTIROFSKI si dhe shumë përfaqësues nga profesori, ekspertë të shoqërisë civile, analistë dhe studentë të fakulteteve të Universitetit.

Në fjalën e tij, Presidenti META dha vlerësimin për performancën e deritanishme të KLSH-së, duke cilësuar se *“...dua të shpreh kënaqësinë për angazhimin dhe përkushtimin në rritje të këtij institucioni të rëndësishëm, të këtij institucioni suprem të auditit në vendin tonë, pasi mirëmenaxhimi i financave publike si dhe ndërtimi i proceseve dhe sistemeve që rritin eficiencën dhe eliminojnë hapësirat për abuzim duke rritur transparencën dhe llogaridhënien, janë sfidat me të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit, përballlet në përditshmërinë e punës së tij.*

Performanca e qëndrueshme dhe në rritje e këtij institucioni gjatë viteve të fundit ka ardhur si rezultat i reformimit dhe modernizimit të praktikave audituese konform standardeve ndërkombëtare të auditimit duke ndikuar drejtpërdrejt edhe në forcimin e mirëqeverisjes së institucioneve publike në vend.”

Në përshëndetjen e tij, Sekretari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, Akademik Anastas ANGJELI vlerësoi punën e bërë në vitet e KLSH 2018

fundit nga KLSH për rritjen e kapaciteteve të tij profesionale dhe theksoi se ka një praktikë të mirë bashkëpunimi mes Kuvendit dhe KLSH-së, e cila kulmoi në miratimin e ligjit të ri organik të institucionit në nëntor 2014, në përputhje me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t.

Në fjalën e tij, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar LESKAJ cilësoi se “Aktiviteti i KLSH-së gjatë vitit 2017 është motivuar dhe udhëhequr nga drejtimi themelor i Kongresit të XXII-të të INTOSAI-t¹: *Auditimi publik në shërbim të qytetarit*» dhe nga drejtimi tjetër themelor i Kongresit të X-të të EUROSAT-t², “*Si mund të ndihmojnë SAI-et në rikthimin e besimit të qytetarëve tek qeverisja publike?*”. Jemi përpjekur t’i realizojmë këto dy orientime themelore duke i parë si detyra/sfida tona kryesore, duke punuar për (1) modernizimin e institucionit nga këndvështrimi i aftësive audituese dhe (2) duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes publike, nëpërmjet forcimit të llogaridhënies dhe transparencës e thellimit të luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit financiar.

Më tej, z. LESKAJ vijoi “...KLSH ka përmbushur detyrën dhe mandatin e tij kushtetues, duke realizuar 156 auditime nga 154 të planifikuara, nga të cilat 25 janë auditime përputhshmërie, 14 janë auditime financiare, 15 janë auditime performance, 92 janë auditime rregullshmërie, 5 janë auditime të TI dhe 5 janë auditime tematike”.

Kryetari i KLSH-së theksoi që viti 2017 ishte viti i fundit i zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së për vitet 2013-2017. Objektivat strategjike të institucionit kanë ecur paralel me objektivat e Planeve Strategjike 2011-2016 të INTOSAI-t dhe 2011-2017 të EUROSAT-t. Monitorimi i zbatimit të kësaj Strategjie ka sjellë bilancin e pesë viteve 2013-2017 të konsolidimit të reformës institucionale në KLSH dhe krijimit të një modeli institucional që afron me modelet më të përparuara të SAI-ve Europiane.

Kryetari i KLSH prezantoi gjithashtu Planin Strategjik 2018-2022 të zhvillimit të KLSH. Analiza vjetore e KLSH vijoi gjatë ditës së parë me prezantime nga ekspertë, akademikë dhe nga përfaqësues të shoqërisë civile mbi performancën dhe rezultatet e llojeve të ndryshme të auditimit, zhvillimin e partneriteteve dhe përsosjen e metodologjive të auditimit.

¹ Kongresi INCOSAI i XXII-të, Abu d’Habi i Emirateve të Bashkuara Arabe, dhjetor 2016.

² Kongresi i X-të i EUROSAT-t, Stamboll, maj 2017

Në datën 16 shkurt, analiza e institucionit vijoi në Ambientet e KLSH-së dhe gjithashtu u zhvilluan leksione në ambientet e Universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit.

Në ambientet e KLSH-së, analiza e ditës së dytë filloi me workshop-in e Departamentit të Auditimit të Performancës. Një përzgjedhje e tillë vjen në një kohë të konsolidimit të këtij departamenti, të themeluar në 2012, auditimet e të cilit jo vetëm përbëjnë një indikator të modernizimit të KLSH-së por reflektojnë edhe objektivin institucional për të qenë sa më pranë qytetarëve, në përmirësimin e shërbimeve publike.

Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës, z. Rinald Muça u shpreh se viti 2017 qe viti i përfundimit të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2013-2017, ku zhvillimet profesionale dhe rritja e kapaciteteve audituese përmbushën Objektivin e Tretë Strategjik, përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës. Auditimet e performancës janë rritur ndjeshëm në numër (20% më shumë se një vit më parë), mbulueshmëri institucionesh dhe cilësi, duke trajtuar tema të ndjeshme për problematikën tonë sociale dhe ekonomike, si Matura 2016, Siguria Ushqimore, Efektiviteti i Masave të ndërmarra nga Organet Tatimore në mbledhjen e Detyrimeve të Prapambetura, Procedurat e Prokurimit, etj.

Më pas, **Prof.Dr. Skënder OSMANI** paraqiti përpara audituesve të KLSH-së leksionin *“Performanca, Auditimi, Optimizimi dhe Mirëqeverisja”*.

Prof.Osmani cilësoi se zhvillimi ekonomik i vendit është i lidhur përgjithësisht me performancën shoqërore, burimet njerëzore e natyrore, kërkimin e arsimit, dijet dhe teknologjinë, projektet dhe reformat e politikën, strategjinë dhe institucionet, auditimin dhe kontrollin, programimin dhe simulimin, modelimin dhe optimizimin, sigurinë dhe riskun, etj.

Analiza e ditës së dytë u mbyll me workshop-in dedikuar Auditimeve të IT. Zoti Kozma KONDAKÇIU, Drejtor i Drejtorisë së Auditimit të IT, bëri një pasqyrë të auditimeve të realizuara gjatë vitit 2017.

Paralelisht me këto zhvillime, **në ditën e dytë të analizës**, një grup drejtuesish të KLSH-së, znj. Luljeta NANO, Sekretare e Përgjithshme, z. Bajram LAMAJ, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, znj. Yllka PULASHI, Drejtore e Departamentit të Auditimeve IT dhe Investimeve të Huaja dhe znj. Aulona JANI, Kryeaudituese në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit, gjatë paradites së datës 16 shkurt, **zhvilluan leksione të hapura me studentët e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.**

Pas leksioneve, studentët dhe pedagogët u përfshinë në diskutime dhe shprehën interesin dhe njëkohësisht shqetësimin e tyre mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve të KLSH-së duke pyetur se çfarë masash merr institucioni për rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së tyre.

Znj. Pulashi vuri theksin në faktin që KLSH është institucion rekomandues dhe në këtë këndvështrim ne duhet të vijojmë të “shkruajmë” rekomandimet tona, të cilat edhe pse nuk gjejnë zbatim sot, mbeten aty, të shkruara dhe janë gjurmë që flasin vetë për mangësi në sistemet e menaxhimit të financave publike, por flasin vetë gjithashtu për punën tonë në drejtim të përmirësimit të këtyre mangësive.

Nën këtë optikë, paneli i njohu studentët me web-in e KLSH-së, i cili përditësohet në mënyrë të vazhdueshme me gjithë aktivitetet e institucionit si edhe me publikimet e vendimeve dhe raporteve të auditimit dhe u sugjerua të përdoret nga studentët si një burim i besueshëm informacioni edhe në përgatitjen e temave për punimet e tyre shkencore.

Me këto leksione u mbyll edhe dita e dytë e Analizës Vjetore të KLSH-së për vitin 2017.

Irena ISLAMI

Armanda BEGAJ

Drejtorja e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Kontrolli i Lartë i Shtetit

FJALA PËRSHËNETËSE E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, SH. T. Z. ILIR META



I nderuar zoti LESKAJ,
e nderuara znj. SOTIROFSKI,
i nderuar profesor ANGJELI,
të nderuar të ftuar dhe pjesëmarrës!

Do të duhet të flisja ndryshe pasi dëgjova këtë problematikë kaq të thelluar dhe të përgjithësuar nga z. LESKAJ, megjithatë do të kemi raste të tjera dhe dua të shpreh kënaqësinë për angazhimin dhe përkushtimin në rritje të këtij institucioni të rëndësishëm, të këtij institucioni suprem të auditit në vendin tonë, pasi mirmenaxhimi i financave publike si dhe ndërtimi i proceseve dhe sistemeve që rritin eficiencën dhe eliminojnë hapësirat për abuzim duke rritur transparencën dhe llogaridhënien, janë sfidat me të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit, përballet në përditshmërinë e punës së tij.



Performanca e qëndrueshme dhe në rritje e këtij institucioni gjatë viteve të fundit ka ardhur si rezultat i reformimit dhe modernizimit të praktikave audituese konform standardeve ndërkombëtare të auditimit duke ndikuar drejtpërdrejt edhe në forcimin e mirëqeverisjes së institucioneve publike në vend.

Shtyllat kryesore mbi të cilat besoj se do të vazhdohet të bazohet veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë pavarësia dhe profesionalizmi.

Do të doja të ndalesha në disa momente, që i konsideroj si tejet të rëndësishme për rolin dhe vazhdimësinë e punës suaj.

Së pari, kompleksiteti i proceseve të globalizimit, o na përball të gjithëve me sfida të reja, deri diku të panjohura, për tejkalimin e të cilave kërkohet qasje si proaktive ashtu dhe inovatore.

Intensiteti i një sërë problematikash me karakter jo vetëm kombëtar siç janë çështjet e emigrimit, sigurisë kombëtare, ndryshimeve klimatike po vjen gjithmonë e në rritje, ndaj dhe qasja e kërkuar duhet të jetë reflektuese.

Kontrolli i Lartë i Shtetit nëpërmjet vlerësimit të performancës së vendimmarrjeve në këto fusha sensitive, duhet të kontribuojë drejtpërdrejtë në evidentimin dhe jetësimin e praktikave më të mira, duke garantuar përmbushjen e objektivave strategjike kombëtare.

Së dyti, në një kohë kur besueshmëria tek institucionet publike është në nivele jo fort inkurajuese, ruajtja e integritetit dhe legjitimitetit moral për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit mbetet një sfidë e rëndësishme.

Ju duhet të drejtoni nëpërmjet shembullit tuaj, duke përcjellë tek publiku, si dhe tek institucionet e tjera perceptimin e paanësisë, profesionalizmit dhe integritetit, duke qenë pararojë e reformimit të proceseve, që garantojnë transparencë dhe maksimizojnë interesin publik.

Së treti, në radhë, por jo për nga rëndësia, një moment që lidhet drejtpërdrejt me misionin tuaj, është domosdoshmëria dhe nevoja që ekziston për të rikthyer besimin tek institucionet publike dhe vendimmarrja e tyre.

Ky besim është barometri më i mirë për performancën e këtyre institucioneve si dhe tregues i përafrimit të standardeve të aplikuara në menaxhim me ato të vendeve të Bashkimit Europian ku duam të anëtarësohemi.



Gjithashtu, një moment tjetër i rëndësishëm për të ruajtur një shërbim të besueshëm, është përmirësimi i vazhdueshëm i trupës audituese. Është e vërtetë që trupa audituese certifikohet si e tillë, pas një programi trajnimi dhe testimi profesional, por ky trajnim duhet të jetë i vazhdueshëm dhe t'u përgjigjet kërkesave të kohës.

Edhe statistikak që paraqiti sot z. LESKAJ për sa i takon rritjes së periudhës dhe cilësisë së trajnimit të KLSH-së janë një tregues i rritjes dhe i kualifikimit të vazhdueshëm të kësaj trupe, një proces i domosdoshëm që besoj se do të vazhdojë më tej në të ardhmen.

Sepse legjislacioni dhe aktet nënligjore janë njëkohësisht të ndryshueshme, dhe normalisht që interpretimi mbi zbatimin e tyre bëhet i vështirë, pasi audituesit do t'i duhet t'i referohet veprimit apo shkeljes dhe bazës ligjore që ka rregulluar një marrëdhënie të caktuar në një kohë të caktuar.

Kjo kërkon njohuri të thelluara në fushën ku kryhet auditimi, dhe nëse kjo nuk realizohet do të kemi përcaktime të gabuara të konkluzioneve audituese dhe rekomandime të paazhornuara për përmirësimin e performancës.

Prandaj zhvillimet e kohës kërkojnë që njohuritë e secilit të jenë në përmirësim të vazhduar, dhe kjo do të jetë sfidë e përhershme për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit që unë dëshiroj të shpreh besimin dhe mbështetjen time se ju do ta përballoni me sukses!

Ndaj pa u zgjatur më tej, pasi mendoj se konkluzionet e z. LESKAJ ishin mjaft thelbësore, po kështu edhe Profesor ANGJELI, edhe në emër të Kuvendit, jam i bindur se do të japë ide edhe më konkrete, pasi bashkëpunimi i Kuvendit me Kontrollin e Lartë të Shtetit është shumë i rëndësishëm, dua t'ju falënderoj jo vetëm për ftesën për të marrë pjesë në këtë veprimtari të këtij Institucioni shumë të rëndësishëm, por njëkohësisht t'ju falënderoj edhe për vendin, për auditorin që keni zgjedhur, për këtë universitet të ri, ende, i Durrësit, por që mban emër të madh! Dhe t'ju uroj gjithashtu të gjithë pedagogëve, trupës akademike, studentëve suksese në rritjen e mëtejshme të këtij universiteti, jo vetëm sasiore, por edhe cilësore!

Të gjithë duhet të jemi më të vëmendshëm ndaj universiteteve! Duhet të jemi edhe më mbështetës, pasi problemet e arsimit të lartë nuk u takojnë vetëm universitete, qeverisë apo institucioneve, por i takojnë të gjithë shoqërisë. Dhe ne e dimë se arsimit të lartë ndeshet ende me sfida mjaft të vështira. Njëkohësisht edhe me vështirësi dhe sfida për zbatimin e ligjit të arsimit të lartë, por jam i bindur që të gjitha këto zgjidhen përmes një reflektimi vetëm pozitiv nga të gjithë aktorët, larg çdo komunikimi arrogant, i cili nuk na ndihmon për t'i konsoliduar reformat dhe për të përmirësuar impaktin e tyre në shoqëri, aq më tepër të rinjtë dhe tek fëmijët tanë.

Kështu që edhe njëherë sukses edhe Universitetit “Aleksandër MOISIU” dhe dua të shpreh bindjen time që respektimi i autonomisë universitare dhe lirive akademike është një standard i rëndësishëm për demokracinë e një vendi që dëshiron të jetë anëtar i barabartë me gjithë vendet e tjera në Bashkimin Europian.

Dhe me këtë rast falënderoj Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit që bashkëpunon me universitetet, sepse këtu shikoj edhe mjaft pedagogë të mi të Fakultetit të Ekonomisë me mjaft përvojë në fushën e financave publike!

Faleminderit dhe suksese!

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E PERFORMANCËS SË KLSH-së, PËR VITIN 2017

Fjala e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar LESKAJ

I nderuar Shkëlqesia Juaj Zoti President i Republikës,
e nderuara Rektore e Universitetit “Aleksandër MOSIU”, znj. SOTIROFSKI,
i nderuar z. OSMANI,
i nderuar z. ADEMI,
i nderuar profesor ANGJELI,
të nderuar, përfaqësues të botës akademike, profesoratit dhe shoqërisë civile,
të nderuar kolegë auditues!



Aktiviteti i KLSH-së gjatë vitit 2017 është motivuar dhe udhëhequr nga drejtimi themelor “Auditimi publik në shërbim të qytetarit” i Kongresit INCOSAI i XXII-të i INTOSAI-t³ dhe nga kryetema “Si mund të ndihmojnë SAI-et në rikthimin e besimit të qytetarëve tek qeverisja publike?” e Kongresit të X-të të EUROSAI-t⁴.

Jemi përpjekur t’i realizojmë këto dy orientime themelore duke i pare si detyra/sfida tona kryesore, mbi bazën e mesazhit kuptimplotë të Kongresit INCOSAI i XXII: “Të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri”, duke punuar për modernizimin e institucionit nga

këndvështrimi i aftësive audituese dhe duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes publike, forcimit të llogaridhënies dhe transparencës e thellimit të luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit financiar.

KLSH vjen sot në këtë analizë vjetore të përgjithshme pas kryerjes së analizave në secilin prej departamenteve të auditimit. Kemi përmbledhur gjetjet, sugjerimet dhe

³ Kongresi INCOSAI i XXII-të, Abu d’Habi i Emirateve të Bashkuara Arabe, dhjetor 2016.

⁴ Kongresi i X-të i EUROSAI-t, Stamboll, maj 2017

vërejtjet ndaj punës dhe qasjes sonë nga ana e ekspertëve të shoqërisë civile të pranishëm në analizat e departamenteve, të cilët i falenderojmë për pjesëmarrjen dhe kontributin. Si institucion suprem auditimi i Republikës, duke u përpjekur të jemi shërbëtarë dhe mbrojtës të interesave të qytetarëve shqiptarë, besojmë fort në punën në sistem, ku përfshihen 1) Presidenti dhe Kuvendi, 2) Qeveria, 3) Opozita, 4) Institucionet e Pavarura dhe 5) Shoqëria Civile dhe Mediat, për përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

Me lejonin që në emër të të gjithë audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit të veçojmë ndihmesën dhe kontributin e dhënë në mbështetje të rolit dhe veprimtarisë së KLSH nga Shkëlqesia e Tij z. Ilir META, më parë në rolin e Kryetarit të Kuvendit dhe sot si President i Republikës. Prania e Tij në këtë analizë është një tregues domethënës i vlerësimit që institucioni i Presidentit të Republikës, i përfaqësuar më parë nga të dy ish Presidentët z. Bamir TOPI dhe z. Bujar NISHANI, ka ndaj misionit të institucionit kushtetues të KLSH dhe i mbështetjes së pakursyer të Tij, të sotme dhe në të ardhmen për institucionin.

Falenderojmë dhe vlerësojmë lart Kuvendin e Shqipërisë, Kryetarin e tij, Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, në veçanti Kryetarin e Komisionit z. Erjon BRAÇE dhe Sekretarin, Akademik Anastas ANGJELI, për mirëkuptimin dhe mbështetjen e gjerë që na kanë dhënë si KLSH.

I. TREGUESIT E PERFORMANCËS 2017

Viti 2017, është viti i tretë i matjes së performancës së institucionit sipas strukturës së standardizuar të Kuadrit të Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, matje që synon të vlerësojë objektivisht kontributin e SAI-t në menaxhimin financiar publik, në qeverisjen e mirë dhe llogaridhënien, si dhe në përpjekjet për të luftuar korrupsionin.

Matjet objektive të performancës në formën e treguesve e bëjnë atë të përshtatshme dhe për krahasimin e performancës së aktivitetit të SAI-t në mënyrë dinamike me veten gjatë kohës, apo me SAI-et simotra, duke krijuar kështu një sistem të unifikuar vlerash e standardesh, sikurse e shpreh edhe motoja e INTOSAI-t “Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë”.



I.1. Auditimet

KLSH ka përmbushur detyrën dhe mandatin e tij kushtetues, duke realizuar 156 auditime nga 154 të planifikuara, nga të cilat:

- 25 janë auditime përputhshmërie;
- 14 janë auditime financiare;
- 15 janë auditime performance;
- 92 janë auditime rregullshmërie;
- 5 janë auditime IT;
- 5 janë auditime tematike.

Shpërndarja e llojeve të auditimeve pasqyron zhvillimin dhe modernizimin e institucionit, duke shfrytëzuar maksimalisht burimet njerëzore. Pavarësisht kapaciteteve të limituara, KLSH ka arritur të mbulojë me auditim të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore, të shpenzimit apo gjenerimit të fondeve publike, duke u përqendruar me auditime performance, financiare, të përputhshmërisë dhe të teknologjisë së informacionit në institucionet e shpenzimeve dhe të ardhurave më të mëdha, ose të një rëndësie parësore për ekonominë dhe shërbimet publike të vendit.

I.2. Dëmi ekonomik

Pyetja “A janë bërë gjatë vitit 2017 strukturat qeverisëse më të përgjegjshme në menaxhimin e fondeve shtetërore?”, e cila qëndron në themel të rikthimit dhe rritjes së besimit të qytetarit ndaj qeverisjes, merr një përgjigje jo pozitive, duke parë nivelin e dëmeve dhe shpenzimeve jo-efektive apo me efekte negative në Buxhetin e Shtetit. Nga auditimet e vitit 2017, KLSH ka zbuluar:

1. Dëm ekonomik, parregullsi dhe shkelje financiare (në të ardhurat publike dhe shpenzimet e kryera) në nivelin e 11.5 miliard lekë, ose 85.8 milionë euro, duke kërkuar shpërbimin e dëmit, pra arkëtimin e këtyre parave në Buxhetin e Shtetit në masën 99 përqind të tyre.
2. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, si në të ardhura dhe në shpenzime, në vlerën prej 99.05 miliard lekë, ose rreth 740 milionë euro. Në total janë konstatuar shkelje në shumën 110.5 miliard lekë, ose afërsisht 826 milionë euro.

I.3. Dobishmëria

Treguesi i dobishmërisë, efektivitetit të institucionit, një tregues qendror i Kuadrit të Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, i përdorur gjerësisht nga SAI-t moderne europiane dhe nga GAO amerikane, është 31.9 lekë për KLSH-në për vitin e kaluar. Pra, për çdo një lek të shpenzuar nga Buxheti për institucionin, institucioni ka zbuluar dhe kërkuar për t’u zhdëmtuar në Buxhetin e Shtetit 31.9 lekë. Në krahasim me periudhën dhjetëvjeçare 2002-2011 (me një mesatare 21.1 lekë), efektiviteti i institucionit për periudhën gjashtëvjeçare 2012-2017 është rritur mbi pesë herë (108.7 lekë).

I.4. Llojet e Auditimeve

Auditimet e performancës janë rritur ndjeshëm në numër (20 përqind më shumë se një vit më parë), mbulueshmëri institucionesh dhe cilësi, duke trajtuar tema të ndjeshme për problematikën tonë sociale dhe ekonomike, si Matura 2016, Siguria Ushqimore, Efektiviteti i Politikave për Zhvillimin Strategjik të Turizmit, Efektiviteti i Masave të ndërmarra nga Organet Tatimore në mbledhjen e Detyrimeve të Prapambetura, Procedurat e Prokurimit Publik, Unifikimi i Pikave Doganore me Kosovën, Kostimi i Shërbimeve Spitalore, etj.

Auditimet financiare janë dyfishuar në numër, krahasuar me vitin 2016, duke punuar me përkushtim për dhënien e opinionit për hartimin e pasqyrave financiare. Po ecim drejt certifikimit të pasqyrave financiare për institucionet e audituara. Këto

auditime po përballen me sfidën e implementimit të modeleve të reja të auditimit, bazuar në vlerësimin e riskut sipas një metodologjie të re dhe në përputhje me standardet e INTOSAI-t.

Me sugjerim të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të BE-së, DG-Budget, po përpiqemi të shkëputemi nga auditimet tradicionale të përzierjes së ligjshmërisë me rregullshmërinë e veprimtarisë së institucionit të audituar, duke synuar metodologji bazuar në praktikat më të mira të komunitetit INTOSAI. Për këtë, kemi veçuar Auditimet e Përputhshmërisë nga ato të rregullshmërisë ligjore, duke u përqendruar në ndërhyrjet në sistemin e funksionimit të njësive të audituara, me qëllim përmirësimin rrënjësor të punës dhe rezultateve të tyre, dhe jo konstatimin e të njëjtave shkelje ligjore që përsëriten në kohë, me propozimin thjesht të masave administrative dhe disiplinore të rradhës.

I.5. Rekomandimet dhe masat e propozuara. Zbatueshmëria

Në cilësinë e institucionit shërbëstar të qytetarit dhe si agjent kryesor i Kuvendit për të garantuar mirëqeverisjen, gjatë vitit 2017 kemi dhënë 91 rekomandime "Propozime për ndryshim legjislativ", 2082 rekomandime të natyrës "Masa Organizative", 1007 "Masa Disiplinore" dhe në po atë nivel "Masa administrative" në kompetencë të institucioneve përgjegjëse. Megjithatë numri i këtyre rekomandimeve është i konsoliduar, niveli i zbatimit, pavarësisht se kemi tentuar të ndjekim një politikë nxitëse për implementimin e tyre, mbetet i ulët. Masat organizative të pranuar janë në nivelin 53%. Shifrat e masave të zbatuara janë në proces dhe shkojnë në nivelet 50-60%. Ndër masat disiplinore, nivelin më të ulët të zbatueshmërisë e kanë propozimet e KLSH për largimin nga puna të drejtuesve të lartë. Një situatë e tillë ushqen drejtpërdrejt antikulturën e pandëshkueshmërisë, prandaj dhe i rekomandojmë Qeverisë të konsiderojë me përparësi largimin nga detyra të nëpunësve të lartë të konstatuar nga KLSH në abuzim flagrant me asetet dhe fondet publike. Largimi i disa prej tyre vetëm për arsye politike dhe mosmarrja e masave ndaj të tjerëve ndikon tek prokurorët në mos procedimin më tej të dosjeve të sjella nga KLSH. Inkurajojmë dhe mbështesim Prokurorinë e Përgjithshme të rihapë dosjet e kallëzimeve të KLSH, si një hap që do të ndihmonte dukshëm në rivendosjen e kulturës së ndëshkueshmërisë në administratën tonë shtetërore.

I.5. Kallëzimet penale

KLSH, në këto gjashtë vite 2012-2017, e ka orientuar aktivitetin auditues drejt sfidave të mirëqeverisjes publike, duke synuar të fitojë besimin e qytetarit përmes një roli aktiv në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës, si dhe në thellimin e

luftës ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes. Edhe pse standardet e INTOSAI-t, të cilat institucioni po i zbaton tashmë gjerësisht në punën e tij, nënvizojnë rolin këshillues dhe rekomandues të institucioneve supreme të auditimit në drejtim të parandalimit të sjelljeve korruptive dhe abuzimeve me fondet publike, mjedisi në të cilin operojmë si dhe nivelet e larta të korrupsionit në çdo qelizë të qeverisjes së vendit kanë imponuar një qëndrim të balancuar ndërmjet rolit parandalues me rolin ndëshkues të institucionit. Numri i kallëzimeve penale gjatë kësaj periudhe 6-vjeçare ka qenë tregues i punës sonë, duke realizuar 266 kallëzime penale apo indicie për 847 nëpunës të lartë, të mesëm dhe të ulët të administratës shtetërore, ose me një ritëm një kallëzim në javë apo një kallëzim afërsisht çdo tre auditime, ose dy herë më shumë se në periudhën 7-vjeçare 2005-2011. Për vitin 2017, kallëzimet penale të institucionit kanë qenë 47, për drejtues kryesisht të rangut të mesëm dhe të lartë të administratës shtetërore.

Besojmë se këto kallëzime, si dhe në tërësi dosjet e auditimeve të realizuara nga KLSH, do të jenë indicie dhe materiale të vlefshme për institucionet e reja të reformës në drejtësi, të cilat do të fillojnë së shpejti nga funksionimi për thellimin e luftës kundër korrupsionit.

II. GJETJET DHE REKOMANDIMET KRYESORE 2017

Nga auditimet e kryera në vitin 2017, kemi identifikuar disa çështje thelbësore mbi qëndrueshmërinë e financave publike, të cilat, duke qenë se vijojnë ndër vite, në mendimin tonë kërkojnë një vëmendje të shtuar të Kuvendit dhe Qeverisë.

II.1. Ligji “Për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik”

KLSH për disa vite radhazi i ka adresuar në mënyrë të përsëritur, që nga viti 2013, Kuvendit, Qeverisë dhe të gjitha instancave të larta shtetërore rekomandimin për hartimin e Ligjit “Mbi përgjegjësinë materiale të nëpunësit publik” në të cilin do të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e kryerjes së detyrave zyrtare.

Mungesa e theksuar e përgjegjshmërisë financiare në vend është evidentuar dhe theksuar edhe nga Progres Raportet e Bashkimit Europian të viteve të fundit. Jemi të sigurt se me hapat për realizimin e plotë të reformës në drejtësi, kjo përgjegjësi do të shtohet, pasi reforma duhet të vijojë edhe në këtë drejtim. Gjykojmë se ka ardhur koha që Kuvendi, Komisioni për Ekonominë dhe Financat në bashkëpunim

me Qeverinë, të marrë nismën për hartimin e këtij ligji kyç në rritjen e përgjegjësisë, llogaridhënies dhe në disiplinimin e vendimmarrësve dhe menaxherëve kryesorë të financave tona publike.

Ligji do të japë në formë të plotë dhe të njëjësuar mënyrat dhe dokumentimin e dëmeve që nëpunësi publik u shkakton fondeve dhe aseteve publike, vlerësimin e dëmit, mënyrat dhe kriteret e vlerësimit, etj. Objekt i ligjit do të jetë caktimi i shpërblimit të dëmit, sipas pjesëmarrjes dhe rolit të nëpunësit publik në shkaktimin e dëmit. Ai do të sigurojë gjithashtu një proces të qartë e transparent të shpërblimit të dëmit ndaj interesat publike, duke vendosur edhe një balancë mes mundësive reale të punonjësit zhdëmtues dhe duke ruajtur minimumin jetik. Ligji do të sanksionojë përgjegjësinë materiale të titullarëve të subjekteve publike për vendimmarrjet e gabuara në dëm të interesave publike, duke përcaktuar edhe kriteret se kur përgjegjësia materiale shndërrohet në përgjegjësi penale.

II.2. Kredibiliteti i procesit të buxhetimit

Gjate auditimit “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2016”, kemi konstatuar se vijohet me praktikata e programimeve jo realiste të buxhetit, sëmundje kjo e qeverive shqiptare në këto vite. Programimi i të ardhurave mbetet pika më e dobët dhe që ndikon edhe në ndryshimin e shpenzimeve. Kjo praktikë, ku kuadri makroekonomik dhe fiskal i përshtatet ndryshimeve të nevojshme buxhetore të momentit po vijon prej vitesh. Ajo reflekton mungesën e boshtit, pra të kuadrit makroekonomik dhe fiskal si mjet strategjik dhe pikë reference për Programimin Buxhetor Afatmesëm dhe atij vjetor, çka është thelbësore për kredibilitetin e buxhetit. Kjo mangësi gjenerohet edhe nga mungesa e Këshillit Fiskal, një organi të pavarur të rekomanduar për disa vite radhazi nga KLSH, i cili do të përfshihej në studimin dhe përpilimin e parashikimeve makroekonomike të sakta, të besueshme dhe të pacënueshme, duke rritur cilësinë e planit buxhetor afatmesëm dhe vjetor, si dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë me rregullat fiskale aq të nevojshme për të siguruar stabilitet fiskal.

Kemi konstatuar se të ardhurat totale të programuara në 2016 janë ulur me 5.5%, krahasuar me fazën e parë të Programimit të Buxhetit Afatmesëm 2016-2018, ndërsa shpenzimet e programuara për vitin 2016 janë ulur me 6.3%, krahasuar me fazën e parë të PBA. Kemi rekomanduar respektimin e realizimit të të ardhurave buxhetore sipas planifikimit të bërë, duke mundësuar edhe një planifikim të mirë të shpenzimeve buxhetore, i cili do të luante një rol kyç në përmirësimin e shërbimeve publike, rritjen e investimeve dhe nxitjen ekonomike. Në këtë mënyrë konsolidimi

fiskal do të arrihej përmes rritjes së të ardhurave dhe jo përmes frenimit të shpenzimeve publike.

Institucioni ka theksuar se përmbushja e synimeve strategjike kërkon një angazhim gjithëpërfshirës dhe nuk është përgjegjësi vetëm e Ministrisë dhe e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilët koordinojnë këtë proces. Të gjitha institucionet e tjera të linjës, duke përfshirë edhe KLSH, duhet të ndihemi përgjegjës për respektimin e objektivave dhe treguesve të Programimit të Buxhetit Afatmesëm. Ndryshimet me akte normative, sidomos me ato që bëhen gjatë muajit dhjetor, shkaktojnë mungesën e kredibilitetit të buxhetit dhe kërkojnë një adresim shumë më të kujdesshëm dhe më koherent për të mos lejuar përdorimin në vijimësi të tyre.

Gjykojmë se është parësore për financat tona publike ndërgjegjësimi, krahas Ministrisë së Financave, edhe i institucioneve të tjera të Qeverisjes qendrore, i ministrive të linjës, etj., për rëndësinë e një plani buxhetor realist dhe në mbështetje të objektivave strategjike të vendosur, i cili do të kontribuonte konkretisht edhe në uljen e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Duke përcjellë shqetësimin e ngritur edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar lidhur me peshën e detyrimeve të tanishme dhe të ardhshme të Buxhetit të Shtetit nga zbatimi i partneriteve publik-privat të kontraktuara dhe të propozuara në të ardhmen, kemi rekomanduar draftimin e Hartës së Risqeve për financat publike.

II.3. Borxhi publik dhe risqet nga borxhi i jashtëm

Duke vlerësuar punën e bërë dhe rezultatet pozitive të arritura, sidomos në ndryshimin e trendit të borxhit publik nga rritës në rënës, vërejmë se në dy vitet e fundit nivelet e borxhit publik kundrejt Prodhimit të Brendshëm Bruto (73% në vitin 2005 dhe 72.4% në 2016-ën) nuk tentojnë drejt parametrave të synuar në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, pra drejt përmbushjes së objektivave strategjike të vendosur. Gjykojmë se treguesit e përdorur për menaxhimin e borxhit publik nuk përmbushin kërkesat e standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, në lidhje me vlerësimin e qëndrueshmërisë, kostos së borxhit dhe menaxhimit të tij me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë. Mungesa e zbrërthimit të strategjive afatmesme të menaxhimit të borxhit publik në plane konkrete veprimi dhe strategji alternative ia bën të pamundur Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë diversifikimin dhe zbutjen e risqeve, për të arritur në një menaxhim eficient të borxhit publik.

Kemi kërkuar vëmendje të shtuar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me menaxhimin e borxhit publik dhe angazhimin maksimal që të përmbushen

objektivat e vendosura për ta ulur borxhin publik nën 60% të PBB-së brenda një periudhe afatmesme.

II.4. Programim dhe realizim i kujdesshëm i investimeve publike dhe vëmendje ndaj stokut të detyrimeve të prapambetura

Nga auditimet e realizuara, konstatojmë se ka një menaxhim jo të kujdesshëm të fondeve që programohen për investime, dhe që më pas realizohen gjatë vitit. Është lehtësisht e verifikueshme që si në programim dhe në realizim ka një spostim të investimeve në tremujorin e fundit, duke arritur pikun në muajin dhjetor. Rreth 34% e investimeve me financim të brendshëm (ose 14,7 miliard lekë) janë realizuar gjatë muajit Dhjetor. Ndërsa shpenzimet kapitale me financim të huaj (kredi dhe grante), janë realizuar në masën 72%. Gjithashtu konstatojmë përdorimin e buxhetit të vitit 2016 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që shkojnë edhe deri në vitin 2011, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura. Si pasojë e përdorimit të fondeve të këtij viti në shlyerjen e investimeve të periudhave të mëparshme, në fund të 2016, nga auditimi rezulton se janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në shumën 1,8 miliard lekë.

II.5. Prokurimi publik dhe inefficiencia e tij

1. Po të analizojmë strukturën e dëmit të konstatuar nga auditimet gjatë vitit 2017, konstatojmë se grupi i dytë i shkeljeve dhe dëmeve më të mëdha konstatohet përsëri në fushën e prokurimeve publike. Ndryshimet ligjore dhe ndërhyrjet në aktet rregullative kanë plotësuar kuadrin rregullativ të prokurimit publik në Shqipëri, por konstatohet se prokurimi publik nuk garanton konkurrencë të drejtë dhe nuk impakton zhvillimin ekonomik përmes injektimit të fondeve drejt një game të gjerë operatorësh. Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara, janë shpallur fitues 1140 operatorë ekonomikë për 5067 procedura prokurimi në total. Janë kryer teste të përqendritimit dhe nga analiza e bazës së të dhënave në lidhje me prokurimet e fituara evidentohet që gjatë vitit 2016, 50% e vlerës totale të prokuruar është përfituar nga 57 operatorë ekonomikë ose 5% e totalit të operatorëve të cilët kanë fituar 14.7% prokurime nga totali i atyre të zhvilluara. Pra konstatohet një përqendrim i prokurimeve në një numër të kufizuar operatorësh, fakt që ndikon drejtpërdrejt në tregun e produkteve dhe në konkurrencën e lirë.

2. Por nuk ka vetëm përqendrim të fondeve drejt një numri të kufizuar operatorësh ekonomikë. Konstatohet se 10% të numrit total të prokurimeve zhvillohen nga 10 autoritete kontraktore të cilat përdorën 41% të fondeve të prokuruar për vitin 2016. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka vlerën më të lartë të

fondeve të prokuruar në nivelin 11.5 miliard lekë, pasuar nga DPP (Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara në Ministrinë e Punëve të Brendshme) me 4.1 miliard lekë, Bashkia Tiranë me 3.7 miliard lekë dhe KESH 3.7 miliard lekë.

Akordimi i fondeve për OSHEE, KESH sh.a. dhe OST tregon një përqendrim të investimeve në sektorin e energjetikës. Ministria e Punëve të Brendshme, si institucioni i autorizuar për kryerjen blerjeve të përqendruara për mallra dhe shërbime me natyrë homogjene për të gjitha institucionet e tjera publike, ka prokuruar 4,1 miliard lekë të cilat përbëjnë 4% të fondit total të prokuruar për vitin 2016, fakt që tregon se një strukturë e tillë nuk po arrin të marre rolin e një superstrukture që do të garantonte përmes kapaciteteve profesionale, efektivitetin e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve për nevoja të sektorit publik.

3. Kemi vërejtur se ka një nivel të lartë procedurash në të cilat diferenca midis fondit limit dhe ofertës fituese është në nivele minimale, pra drejt 0, me një numër pothuaj të njëjtë me procedurat që kanë një efektivitet nga 5% deri në 20%. Në numër të lartë janë procedurat që kanë diferenca të lartë të ofertës fituese dhe fondit limit, pra mbi 20%, fakt që ngre pikëpyetje si për saktësinë e llogaritjes së fondit limit ashtu edhe për uljen e ofertave në nivele që vënë në rrezik realizimin e shërbimeve, investimeve apo sigurimin e mallrave në cilësinë e duhur.

4. Nga auditimi i disa procedurave të prokurimit, në seancën publike të hapjes së ofertave në sistemin e prokurimit elektronik në Drejtorinë e Përgjithshme të Prokurimeve, kemi konstatuar se operatorët nuk publikojnë ofertën ekonomike ose dokumentacionin ligjor/teknik të kërkuar. Për rrjedhojë sigurohet konkurrenca numerike në fazën publike të hapjes së ofertave, por jo konkurrenca në përzgjedhjen e ofertës. Kjo mënyrë konkurrimi i hap rrugën për kualifikim dhe shpall fitues operatorin e mbetur në garë (pa u futur në proces konkurrimi) si e vetmja alternativë, duke lënë shteg për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë, fenomen për të cilin Autoriteti Kontraktues duhet të sinjalizojë Autoritetin e Konkurrencës, si organ kompetent i hetimit të sjelljes anti konkurruese të operatorëve ekonomikë. Për pasojë, mos-publikimi nga operatorët ekonomikë i ofertës ekonomike apo i dokumentacionit të tenderit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike mund të kufizojë konkurrencën e drejtë dhe efektive, duke mos nxitur dhe inkurajuar biznesin e vogël dhe të mesëm.

5. Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është autoriteti më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj. Nga auditimi i vendimeve të KPP me zgjedhje

rastësore, rezultoi se KPP në përgjithësi gjatë shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë, megjithëse është shprehur për shqyrtimin e tyre në themel, në fakt është shprehur vetëm pjesërisht për objektin e ankesës së operatorëve ekonomikë, duke krijuar premisa për vendimmarrje jo të sakta, të cilat kanë cenuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë fitues të kontratave publike, shpeshherë e shoqëruar me dëm ekonomik.

Nga auditimi i dosjeve mbi ankimet e operatorëve ekonomikë të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kemi vërejtur se nuk është krijuar arkivi elektronik për të gjithë dokumentacionin për çdo ankimim, në përputhje me rregullat mbi arkivat. Kemi rekomanduar krijimin e arkivit elektronik të dosjeve për çdo ankimim, me qëllim sigurimin e transparencës në procesin e administrimit të dosjeve.

II.6. Vëmendje e shtuar në trajtimin e borxhit tatimor dhe doganor

Nga auditimi i zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kemi konstatuar nivelin shqetësues të borxhit tatimor. Pesha e këtij borxhi si përqindje ndaj PBB-së, nga 8.5% e PBB-së në fund të 2015 arriti në 11.7% e PBB-së në fund të 2016-ës. Në vlerën e borxhit prej 147 miliardë lekë (rreth 1.1 miliardë euro), janë shtuar detyrime përgjatë vitit 2016 në shumën 76,6 miliardë lekë, ndërkohë që numri i subjekteve borxhlinj ka pësuar një rritje alarmante nga 6,408 subjekte në vitin 2015 në 63,366 subjekte në fund të vitit 2016. Në stokun e borxhit tatimor, disa nga debitorët më të mëdhenj janë edhe ente publike. Në fund të vitit 2016, subjektet me borxh më të madh se 5 milionë lekë (2,067 subjekte ose 1.4% e numrit total të subjekteve) zënë 77% të stokut të borxhit. Përveç rritjes së Borxhit Tatimor dhe Doganor në vlerë nominale me 41.1% në krahasim me një vit më parë, rezulton se rritja e detyrimeve ndaj tatimeve dhe doganave (borxhi tatimor dhe doganor) si dhe e skemës së sigurimeve shoqërore për vitin 2016 është në vlerë 51,2 miliardë lekë ose 383 milionë euro dhe përbën mungesë direkte të ardhurash për Buxhetin e Shtetit. Kemi rekomanduar që të shtohet vëmendja në lidhje me trajtimin me efektivitet të masave për mbledhjen e këtyre detyrimeve tatimore dhe doganore, si dhe një politikë më e kujdesshme në shpalljen dhe realizimin e amnistive fiskale, të cilat nxisin krijimin e borxheve tatimore.

II.7. Mbi shitjen e pronës shtetërore dhe aksioneve të zotëruara nga shteti

Nga auditimi në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, kemi konstatuar se procesi i administrimit të pronës publike vazhdon jetë i fragmentarizuar në shumë institucione, çka krijon mundësinë e shpërndarjes së përgjegjësisë dhe rrit rrezikun

e keqpërdorimit të pronës publike. Mungesa e inventarizimit të pronës publike vijon prej me shume se 20 vite të jetë një nga problemet kryesore e cila krijon efekte në konfirmimet e titujve të pronësisë nga institucionet publike që kanë për detyrë dhënien e vërtetësisë mbi këto tituj. Kjo është evidentuar edhe si një nga shkaqet për ekzistencën e rreth 600 konflikteve gjyqësore në proces vetëm në Ministrinë e Financave si rrjedhojë e procedurave të privatizimit ndër vite. Vlera e shmangieve me efekte negative financiare të identifikuar nga auditimi ishte 338 milion lekë, si pasojë e vendimmarrjeve të gabuara dhe zgjatjes së procedurës së tjetërsimit të pronës publike duke u bazuar në vlerësime të kryera vite më parë dhe që nuk reflektonin vlerën në momentin e shitjes. Me qëllim miradministrimit të pronës publike, KLSH ka kërkuar, ndër të tjera, kryerjen e një analize më të hollësishme për shitjen e pronave publike, krijimin e kartelave të veçanta, dhe zgjidhjen e problemit për kompensimin e ish pronarëve.

II.8. Raportimi financiar në sektorin publik

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të shtetit synojnë të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të shtetit. Konstatohet se, edhe për vitin 2016, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, nuk janë pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit. Mungesa disavjeçare e pasqyrave të konsoliduara të shtetit në gjykim tonë ndikon jo vetëm në nivelin e transparencës, por është e lidhur ngushtë me analizën e treguesve makroekonomik. Konstatohet se nuk ka një bazë të qartë rregullative mbi të cilën realizohet Raportimi Financiar, fakt që krijon hapësira për mangësi të theksuara në mbajtjen e kontabilitetit dhe në raportimin financiar nga njësitë që duhet të raportojnë mbi bazë të standardeve të kontabilitetit publik. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk disponon listën e plotë të të gjithë institucioneve buxhetore dhe jo buxhetore, bilanci i të cilave është pjesë e Pasqyrave të Konsoliduara të Shtetit. Në janar 2018, KLSH ka filluar një auditim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me procesin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare, me qëllim monitorimin e këtij procesi në kushtet e ristrukturimit institucional dhe rritjen e ndërgjegjësimit nga strukturat përgjegjëse. Kemi kërkuar që Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në mbështetje të strategjisë së financave publike, të publikojë menjëherë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS, si baza kryesore metodologjike mbi të cilën do të ndërtohet kontabiliteti publik në Shqipëri në të ardhmen e afërt.

II.9. Vështirësi në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin nga institucionet publike

Ligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë publike të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, me qëllim përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë. KLSH ka konstatuar se në praktikë ka një lexim të ndryshëm nga entet publike, të fushës së zbatimi të këtij ligji duke synuar mos përfshirjen në kuadrin rregullues që sanksionon ky ligj. Tipike është sjellja e shoqërive aksionere me kapital shtetëror apo institucioneve të pavarura në krijimin e administrimit e fondeve, pavarësisht të qenit te tyre si ente publike. Për këtë kemi kërkuar që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa me qëllim zbatimin e plotë të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, duke përfshirë sipas karakteristikave specifike të tyre shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse, si dhe duhet të shprehet në kuadër ligjor për zbatimin nga institucionet e pavarura të cilat krijojnë apo shpenzojnë fonde publike.

II.10. Auditimi i njësive të vetëqeverisjes vendore

Si KLSH kemi vërejtur parregullsi që kanë sjellë mos evidentim të drejtë të inventarit të aseteve të këtyre njësive, mos evidentim të saktë të të drejtave të këtyre njësive lidhur me detyrimet apo borxhin e bizneseve ndaj njësive të qeverisjes vendore. Gjykojmë se mosvlerësimi sa duhet i kësaj problematike mund të çojë në një “faliment” të këtyre administratave apo rritje të huave në nivel lokal.

Nga auditimet e realizuara gjatë vitit 2017 në njësitë e vetëqeverisjes vendore, KLSH ka konstatuar se administrimi i taksave dhe të ardhurave të veta reflekton mangësi të mëdha, për të cilat, KLSH ka rekomanduar vëmendje të shtuar për përmirësim të treguesve financiarë të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në shumë njësi konstatohen nivele të larta të borxhit tatimor, pasaktësi të vlerës reale në mungesë të transferimit të të drejtave nga ish komunitat në Bashki, për të cilat kemi kërkuar një strategji sektoriale për vënien nën kontroll të niveleve të borxhit dhe uljen e tij përmes konsolidimit fiskal në nivel bashkie.

Nga auditimi i realizuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore, kemi konstatuar se megjithëse reforma territoriale ka qenë e domosdoshme, për të cilën KLSH ka

rekomanduar kryerjen dhe përshpejtimin e saj që në vitin 2012, përveç impakteve pozitive që ka dhënë në drejtim të përqendrimit dhe menaxhimit më të mirë të të ardhurave, rritjes së volumit të investimeve, në opinionin tonë, edhe në vitin e dytë të zbatimit të saj, nuk janë arritur pritshmëritë e duhura në lidhje me rritjen dhe cilësinë e shërbimeve ndaj komunitetit, rritjen e të ardhurave financiare, etj.

Sensitiv është borxhi i konsiderueshëm i krijuar ndaj subjekteve private, nëpërmjet krijimit të detyrimeve për fatura të palikujduara ndër vite, për arsye të kryerjes së punimeve apo shërbimeve, pa u siguruar më parë fondet e nevojshme për realizimin e tyre. Në bilancet e Bashkive rezultojnë mjaft detyrime të krijuara nga viti 2012 e përpara, por prej tyre nuk ka një analizë të borxhit të krijuar në çdo vit nga pamjaftueshmëria e aftësisë paguese, faktorët që kanë ndikuar në krijimin e kësaj vështirësie financiare, etj.

Kemi rekomanduar një monitorim në vijimësi të krijimit të detyrimeve të prapambetura si dhe formulimin e një strategjie të qartë të trajtimit të borxhit në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Nga auditimet e ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore (32 ish bashki dhe 120 ish komuna), kemi vërejtur se nuk ka një transferim të saktë të listës së debitorëve gjatë procesit të transferimit të kompetencave nga komunat drejt Bashkive. Problemi i borxhit tatimor edhe për njësitë e vetëqeverisjes është sensitiv. Vetëm në auditimet e vitit 2017, detyrimet e paarkëtuara ndër vite janë llogaritur në masën rreth 2,6 miliard lekë.

KLSH ka konstatuar mungesë vizioni në lidhje me pronat dhe keqadministrim të tyre, që nis me mungesën e inventarëve të pronave në dispozicion, duke rekomanduar masa organizative për përmirësimin e situatës.

Bashkimi i ish komunave në Bashkitë e mëdha ka sjellë edhe një problem të mprehtë në lidhje me dhënien me qera të sipërfaqeve të konsiderueshme të tokave bujqësore, të pandara nga ish komunat, me afate kohore shume të gjata nga 30 deri 99 vjet, ndërkohë një pjesë e tyre i kanë dhënë me qera pa i patur ato në pronësi, pasi nuk u janë transferuar pronat. Por edhe në rastet kur pronat u janë transferuar Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore, dhënia me qera e tyre është bërë në mungesën e plotë të dokumentacionit dhe mjaft prej tyre nuk janë të noterizuara. Kjo problematikë në një të ardhme jo të largët mund të krijojë një problem social, pasi investimet janë kryer në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ligjor për t'i garantuar ato.

Konstatohet po ashtu se Bashkitë nga ana praktike e kanë të pamundur kontrollin e territorit. Në disa Njësi të Vetëqeverisjes Vendore mungon edhe personeli i specializuar për këtë qëllim. Mungesën e administrimit të territorit e dëshmojnë dëmtimet e mëdha të pyjeve dhe kullotave nga njerëzit, pa përmendur këtu edhe dëmtime të mëdha të pyjeve dhe kullotave nga rënia e zjarreve, etj.

- Duke patur parasysh peshën që mban Buxheti i Shtetit dhe problematikat e konstatuara në auditimet e 5 viteve të fundit tek Shoqëritë e Ujësjellës-Kanalizimeve, si niveli i lartë i humbjeve të ujit në rrjet, mungesa e një angazhimi serioz nga Këshillat Mbikëqyrës, mos ushtrimi i kompetencave nga Pushteti Vendor (Kryetari i Bashkisë dhe Këshillat Bashkiake) për mbarëvajtjen e këtyre shoqërive, detyrimet e larta për energji elektrike që shumë shoqëri i detyrohen OSHEE, etj., kemi audituar 9 shoqëri të tilla për vitin 2017.

Nga auditimet e kryera ka rezultuar gjithsej dëm ekonomik në vlerën 180,6 milionë lekë dhe shpenzime dhe të ardhura jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, në vlerën 18,4 miliard lekë.

II.11. Auditimi i zyrave të regjistrimit të pronave dhe agjensive të legalizimit

Gjatë vitit 2017, kemi audituar 19 subjekte të lidhura me regjistrimin e pronave dhe procesin e legalizimeve, nga këto 7 auditime në ZVRPP dhe 6 auditime në strukturat e ALUIZNI-t.

A. Nga auditimet e realizuara në zyrat e regjistrimit, është konstatuar një dëm ekonomik i matshëm në vlerën 254,1 milionë lekë dhe të ardhura të munguara në vlerën 68,9 milionë lekë. Theksojmë që krahas dëmit ekonomik të matshëm në këto institucione ekziston edhe një dëm ekonomik i fshehur dhe i pamatshëm, shumë herë më i lartë se i pari, i cili lidhet me një zinxhir të stërzgatur pasojash sociale, mjedisore, ligjore dhe njerëzore, të shkaktuara si pasojë e paligjshmërive të kryera ndër vite me pronat nga ana e punonjësve dhe drejtuesve të ZVRPP-ve, të cilat së bashku me problematikën e proceseve gjyqësore, përbëjnë dhe burimin kryesor të faturave të papërbalueshme që shteti shqiptar, duhet të paguajë tashmë dhe në vijim si pasojë e vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

B. Nga auditimi i realizuar përgjatë vitit 2017, në zyrat e ALUIZNI-it, kemi konstatuar se problematikat mbeten të njëjta me ato të periudhës 2012-2016.

Nga 40 auditime të zhvilluara në gjashtë vitet e fundit në zyrat e ALUIZNI dhe në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në 36 (90 përqind) prej

tyre kemi depozituar kallëzime penale për 196 punonjës të këtyre institucioneve të nivelit ish-drejtues, përgjegjës sektori dhe specialistë. Vërejmë me shqetësim se nuk është vepruar për rregullimin e mangësive dhe korrigjimin e shmangieve, për të përmirësuar gjendjen.

III. 2017-VITI I PËRFUNDIMIT ME SUKSES TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT 2013-2017

Viti 2017 përfaqësoi vitin e fundit të zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2013-2017, e rishikuar. Objektivat strategjike të institucionit kanë ecur paralel me objektivat e Planeve Strategjike 2011-2016 të INTOSAI-t dhe 2011-2017 të EUROSAI-t, dy organizatat e komunitetit të institucioneve supreme publike të auditimit në Europë dhe botë. Monitorimi i zbatimit të kësaj Strategjie ka sjellë bilancin e pesë viteve 2013-2017 të konsolidimit të reformës institucionale në KLSH dhe krijimit të një modeli institucional që afron me modelet më të përparuara të institucioneve supreme të auditimit në Europë. Bazuar në nivelin e treguesve të Kornizës së Matjes së Performancës së një Institucioni Suprem Auditimi, dokument i miratuar si standard ISSAI në Kongresin e fundit të INTOSAI-t, objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit 2013-2017 janë realizuar në masën 85%. Në këta 6 vite (duke shtuar edhe vitin 2012), institucioni, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit dhe partneritetet me institucionet simotra të zhvilluara evropiane, ka arritur të përgatisë një trupë audituesish, të mirëtrajnuar dhe të motivuar, e cila zbaton me kompetencë dhe rigorozitet profesional standardet ndërkombëtare të auditimit suprem, ISSAI-t.

Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2013-2017, e rishikuar, Objektivi i Parë Strategjik ishte zhvillimi i kapaciteteve institucionale të KLSH nëpërmjet amendimit dhe përsosjes të bazës rregullatorë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira evropiane. Sot KLSH ka një ligj organik bashkëkohor dhe tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të vitit 2014, me ndihmën e ekspertizës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Bashkimit Europian. Janë miratuar dhe janë në funksionim një kuadër i brendshëm rregullator administrativ e organizativ, së bashku me Manualët dhe udhëzuesit specifikë në funksion të adoptimit të Standardeve ISSAI, si Manuali i Auditimit Financiar, Manuali i Auditimit të Performancës, i rishikuar, Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, që të gjithë këta manuale së bashku me

Udhëzuesit e tyre, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Borxhit Publik, Udhëzuesi i Auditimit Mjedisor, Metodika e Kontrollit të Cilësisë dhe Sigurimit të Cilësisë në Auditim, Draft-Manuali i Auditimit të Prokurimeve Publike, etj.

Qasja e institucionit në përmbushje të Objektivit të Dytë Strategjik, rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit, u udhëhoq nga parimet dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare, duke e bazuar zhvillimin metodologjik dhe profesional i burimeve njerëzore në dy shtylla kryesore: (1) krijimin e një profili të lartë profesional të audituesit publik; (2) sigurimin e kryerjes së veprimtarisë audituese, në përputhje të plotë me standardet e auditimit të jashtëm publik si dhe praktikrat e mira të fushës të konkretizuara në manualet e auditimit, rregullore të procedurave të auditimit, përmirësimin e raportimit dhe transparencës si dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit auditues. Në fund të vitit 2017, audituesit e KLSH kishin një mesatare prej 28,5 dite trajnimi/auditues duke arritur kështu dhe nivelin më të lartë të këtij treguesi përgjatë gjithë zhvillimit të këtij institucioni ndër vite, ose 14 here me shume se viti 2011 me 2,1 ditë mesatare trajnimi/auditues. Trajnimet mbuluan fusha të tilla si Standardet Ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t, Manualet e Auditimit dhe udhëzuesit specifikë të qasjes audituese dhe teknikave të auditimit, çështje të kuadrit rregullator dhe legjislativ të përgjithshëm në nivel kombëtar dhe institucional të lidhura drejtpërsëdrejti me veprimtarinë audituese, si dhe të tjera që kanë impakt në punën e KLSH, çështje specifike të auditimit në konferenca, workshop-e dhe vizita studimore në SAI-t homologe si praktika më të mira ndërkombëtare të fushës, etj.

Puna për rritjen e trajnimeve dhe marrjen e eksperiencës drejtpërsëdrejti në auditim nga ekspertë të SAI-ve simotra u thellua me nisjen e Projektit të Binjakëzimit me fondet e Bashkimit European IPA 2013, me SAI-t e Polonisë (NIK) dhe të Kroacisë si partnere, në mars të vitit 2016. Vetëm gjatë vitit 2017 u organizuan nga ekspertë polakë, kroatë dhe holandezë, 37 misione pranë audituesve të KLSH, duke dhënë 80 rekomandime.

Zhvillimet profesionale dhe rritja e kapaciteteve audituese mbështetën fuqimisht angazhimet të ndërmarra nën Objektivin e Tretë Strategjik, përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës. Me miratimin e Ligjit 154/2014, KLSH u mandatua për të realizuar auditime performance në mënyrë eksplicite dhe specifike, me akses të pakufizuar, si në subjekte, ashtu edhe në informacion, sikurse dhe me të drejtën për të raportuar në Kuvend me auditime individuale performance. Për vitin 2017, numri i auditimeve të performancës u rrit me 20% në krahasim me vetëm një vit më parë, duke arritur në 15 auditime, trend që do të

vijojë të mbahet edhe në të ardhmen, duke e kthyer këtë lloj auditimi në boshtin e përpjekjeve tona për përmirësimin e funksionimit të administratës shtetërore dhe rritjen e besimit të qytetarit tek kjo administratë, në ndjekje të modeleve të institucioneve homologe europiane dhe më gjerë.

Me Objektivin e Katërt Strategjik, KLSH provoi të kalonte drejt një zhvillimi ambicioz, atë të auditimeve në sistemet e teknologjisë së informacionit, ndërkohë që baza e njohurive dhe e teknologjisë së trashëguar nga viti 2011 ishte praktikisht e papërfillshme ose zero. Në Ligjin nr. 154/2014, institucioni u mandatua për të realizuar auditime të teknologjisë së informacionit si një lloj i veçantë i auditimi, nëpërmjet të cilit, KLSH mbledh dhe vlerëson provat, për të përcaktuar nëse një sistem kompjuterik mbron asetet, ruan integritetin e të dhënave, lejon që synimet e subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive, duke përdorur burimet në mënyrë eficiente. Nën këtë objektiv, është krijuar Drejtoria e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe janë realizuar auditimet e para të këtij lloji, ndërkohë që është punuar për të miratuar kuadrin e plotë rregullativ mbi të cilin realizohen auditime të tilla mjaft komplekse. Numri i auditimeve TI është modest, por me një trend rritës nga viti në vit, fakt që tregon se edhe në këtë lloj auditimi konsolidimi i punës audituese është i kënaqshëm.

Në përmbushje të Objektivit të Pestë Strategjik, institucioni ka rritur kontributin për qeverisjen e mirë, duke synuar rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit. Si KLSH gjykojmë se propaganda nuk është transparencë, përkundrazi. Ajo paraqitet si armiku më i egër dhe më i rrezikshëm i transparencës dhe llogaridhënies, për shkak se kërkon të hiqet si këto dy të fundit. Korrupsioni ndjek formulën e studiuesit të mirënjohur ndërkombëtar, Robert Klitgaard: $K = M + S - P$, ku “K” është korrupsioni, “M” monopoli, “S” sasia që mund të përfitohet nga korrupsioni (e quajtur ndryshe fuqia diskrecionale e korrupsionit, liria e veprimit të tij) dhe “P” është përgjegjshmëria, llogaridhënia, të cilën ne si institucione supreme auditimi, si SAI e konsiderojmë të pandashme nga transparenca.

Sot, SAI-t, jo vetëm në Europë, por në të gjithë botën, janë thirrur në testin e kohës për të dëshmuar se kanë aftësinë të rrisin besimin qytetar në qeverisjen publike, duke bere transparente, te dukshme dhe te kuptueshme per te gjithë, rezultatet dhe performancen e saj, nëpërmjet auditimeve të tyre gjithnjë e më cilësore, të guximshme dhe parandaluese ndaj risqeve për keqmenaxhim, menaxhim të papërgjegjshëm dhe abuzim me paranë publike. Aktiviteti ynë si KLSH në këtë drejtim, merr rëndësi ne kushtet e procesit të integritetit të vendit tonë, pas

miratimit kohët e fundit të Strategjisë së Bashkimit Europian për Ballkanin Perëndimor, ku qartësisht shpaloset perspektiva e integritimit në BE për Shqipërinë, në rast të suksesit në kryerjen dhe thellimin e reformës në drejtësi.

Reforma në drejtësi është e lidhur ngushtësisht me përpjekjet për ndërgjegjësimin dhe mbajtjen në mënyrë konstante përgjegjës te nëpunësit e Shtetit, lidhur me detyrimin e mbrojtjes dhe ruajtjes së parasë dhe aseteve publike, duke patur për mision shërbimin më efektiv ndaj qytetarit, në një linjë me orientimet dhe mesazhet qendrore të Kongreseve të fundit INTOSAI dhe EUROSAI të komunitetit të institucioneve supreme të auditimit. Si institucion i mandatur nga Kushtetuta, KLSH kërkon sinergji bashkëpunimi mes të gjithë veprimtarëve të tjerë përgjegjës për të garantuar realizimin e objektivit strategjik të reformës në drejtësi.

Nën Objektivin e Gjashtë Strategjik, KLSH ka integruar elementë modernë të komunikimit dhe ka miratuar Strategjinë e Komunikimit 2017-2019, duke synuar të përçojë zërin e qytetarit dhe të publikut nëpërmjet auditimeve dhe raportimeve për gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Strategjia e komunikimit thekson marrëdhëniet e KLSH me publikun dhe Kuvendin, duke përfshirë edhe partnerë të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në vitin 2016, Kuvendi miratoi Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015, duke vlerësuar progresin e arritur nga institucioni në përafrimin e punës së tij audituese me standardet ndërkombëtare të fushës.

Për vitin 2017, institucioni ka qenë i pranishëm 6.7 herë më shumë me informacione dhe mesazhe në median e shkruar dhe ka gjashtëfishuar praninë e tij në mediat audiovizive, krahasuar me vitin 2010, duke kontribuar në median e shkruar të vendit me artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike. Një vlerë e shtuar e KLSH-së në gjashtë vitet e fundit (2012-2017) në fushën e komunikimit dhe të transparencës me publikun është kolana e botimeve të tij, e cila ka arritur në fund të vitit 2017 në 83 tituj, nga vetëm 12 botime modeste të periudhës 1992-2011. Gjatë vitit 2017, institucioni përgatiti dhe botoi 16 libra mbi standardet dhe udhëzimet e auditimit, manualët, raportet e performancës, 3 edicionet vjetore të Revistës shkencore “Auditimi Publik”, etj. Do të vijojmë të pasurojmë kolanën e botimeve të tij edhe për këtë vit, gjatë të cilit kemi parashikuar të botohen 17 tituj, duke arritur në 100 tituj Kolana e Botimeve KLSH për periudhën 2012-2018.

Komunikimi gjatë vitit 2017, përmes mjeteve të teknologjisë së informacionit ka arritur të përmbushë objektivat e Strategjisë së tij të Zhvillimit 2013-2017. 98% e vendimeve të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për gjetjet dhe

rekomandimet nga auditimet sot publikohen në faqen në internet të institucionit në kohë pothuajse reale. Raportet më të rëndësishme të auditimit i janë dërguar dhe komunikuar Kuvendit, duke synuar një ndërveprim aktiv me Ligjvënësin.

xxx

Ky vit që sapo ka filluar do të jetë viti i parë i zbatimit të Strategjisë së re të Zhvillimit të KLSH 2018-2022. Strategjia i përgjigjet kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të INTOSAI-t (ISSAI-ve) dhe është mbështetur në udhëzuesit metodologjikë të publikuar për këtë qëllim nga organizatat ndërkombëtare profesionale dhe Nisma për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI). Planet Strategjike të INTOSAI-t 2017-2022 dhe EUROSAI-t 2018-2023, të miratuara në Kongreset përkatëse cituar më sipër, kanë shërbyer si udhërrëfyes në hartimin e kësaj Strategjie të institucionit për pesë vitet e ardhshme.

Nëpërmjet Vizionit në përmbushje të Misionit të tij në këtë Strategji, KLSH synon t'u përgjigjet sfidave dhe kërkesave të kohës, duke u aftësuar t'u qëndrojë dhe përshtatet ndryshimeve në mjedisin rrethues, me të cilat ballafaqohet sektori publik. Institucioni synon të investojë në ekspertizën e nevojshme dhe të domosdoshme në fusha të tilla si zhvillimet dixhitale, qëndrueshmëria e financave publike, efektiviteti dhe eficientia e menaxhimit të programeve qeveritare, kryesisht në atë të partneritetit publik-privat, etj.

KLSH aspiron që nëpërmjet auditimeve të tij të sjellë vlerë të shtuar në shërbimin ndaj qytetarit, Kuvendit dhe subjekteve publike që auditon. Kjo nënkupton sigurimin e aftësive më të mira profesionale dhe njohurive mbi standardet ndërkombëtare të fushës për të gjithë trupën audituese dhe personelin ndihmues në KLSH, nëpërmjet partneriteteve dhe punës së përbashkët, duke zbatuar një nga parimet e ISAI 12, që të udhëheqë nëpërmjet shembullit.

Ju faleminderit!

**FJALA PËRSHËNDETËSE E REKTORIT TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”,
DURRËS, ZNJ. KSEANELA SOTIROFSKI**

Shkëlqesia Juaj Zoti President i Republikës,
i nderuar Kryetar i KLSH-së, z. Bujar LESKAJ,
i nderuar Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, z. OSMANI,
i nderuar Zëvendës Auditori i Përgjithshëm i
Maqedonisë, z. ADEMI,
të ftuar të nderit,



Më lejoni që në emrin tim dhe të kolegëve të Universitetit
“Aleksandër MOISIU”, Durrës, t’ju uroj mirëseardhjen në
programin e analizës vjetore të KLSH-së.

Ju jemi mirënjohës për ardhjen tuaj këtu. Ne e shohim këtë si një mundësi për të
ndërtuar ura bashkëpunimi mes Universitetit, Institucionit të Presidentit të
Republikës dhe KLSH-së. Mendoj se ky bashkëpunim i nisur do të vijojë për t’u
kthyer në një shërbim të dobishëm për institucionet tona, veçmasi për UAMD-në.

Përse e them këtë? Sepse ne jemi Universiteti më i ri publik në vend. Por po e le
mënjatë modestinë, jemi edhe më energjiku. Kemi një staf akademik dhe
administrativ me ambicie të shëndoshë, ku kemi gërshetuar më së miri “emrat e
shquar” të botës akademike më të rinj të diplomuar shkëlqyer brenda e jashtë
vendit.

Ne ofrojmë risi në botën akademike shqiptare duke qenë i vetmi universitet me
programe studimi profesionale 2 vjeçare që i drejtojmë të rinjtë drejt këtij tregu,
për të cilin vendi ynë ka kërkesë dhe nevojë të madhe.

Po ashtu, tjetër risi jona është Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën, ku
studimi dhe praktika shkojnë paralelisht me njëra tjetrën, dhe ku studentët në fund
të studimeve të tyre e kanë të garantuar tregun e punës.

Ne jemi Universiteti i Durrësit, dhe më lejoni t’ju them një fakt që pak e njohin.
Burime arkivore në Dubrovnik, Kroaci ofrojnë të dhëna për të parin universitet në

Ballkan, që ishte “Studium generale” – Universiteti i Durrësit, në vitet '80, të shekullit XIV, themeluar nga dominikanët durrsakë.



Pra Durrësi ka qenë i pari Universitet në Gadishullin Ilirik, ndaj sot ne kemi si mision të rëndësishëm tonin ndërkombëtarizimin. Jemi pjesë e projekteve rajonale e ndërkombëtare. Synojmë të bëjmë akoma më mirë duke u bërë udhë lidhëse mes arsimit të lartë shqiptar dhe atij përtej Adriatikut. Dhe përtej dallgëve të para kemi nisur të lundrojmë me sukses në det të hapur.

Për të gjitha këto që përmenda ne jemi të ndërgjegjshëm që do të kemi nevojë për mbështetje. Mbështetje të cilën e kërkoj nga Ju z. President, nga Ju z. LESKAJ, nga ju të ftuar të tjerë të nderit. Ne si UAMD, bashkë me institucionet tuaja, mund të japim kontribut në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës dhe në luftën kundër korrupsionit e konsolidimit të shtetit ligjor.

Duke mos dashur t'ju marr më shumë kohë të çmuar, në fund të fjalës sime dua të shpreh falenderimet e mia për z. LESKAJ për bashkëpunimin e tij të ngushtë me profesionistë të botës akademike dhe shoqërisë civile. Të gjitha këto kanë ndikim në përmirësimin e menaxhimit financiar publik në vend. z. LESKAJ përgëzime gjithashtu për konferencat e suksesshme që keni organizuar për mirëmenaxhimin e financave dhe forcimin e kapaciteteve të audituesve.

Ju faleminderit edhe njëherë për ardhjen në UAMD dhe ju uroj një analizë të frytshme.

FJALA PËRSHËNDETËSE E SEKRETARIT TË KOMISIONIT TË EKONOMISË DHE FINANCAVE NË KUVENDIN E SHQIPËRISË, PROF. DR. ANASTAS ANGJELI

I nderuar Shkëlqesia Juaj Zoti President i Republikës,
i nderuar z. LESKAJ,
e nderuara znj. SOTIROFSKI,
të nderuar miq të ftuar dhe pjesëmarrës!

Duke ju uruar punime të mbara dhe suksese në këtë analizë një vjeçare të institucionit tuaj, më lejoni t'ju shpreh vullnetin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, për bashkëpunimin që ka patur dhe do të ketë në të ardhmen me këtë institucion të rëndësishëm e të pavarur.

Pa dyshim që pas fjalës së Kryetarit, z. LESKAJ, është e qartë që ky institucion vjen sot në këtë analizë njëvjeçare, duke shpalosur

aspektet shumëdimensionale të punës së tij, që dëshmojnë për shndërrimin e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në një institucion bashkëkohor të mbikëqyrjes dhe veçanërisht të auditimit të fondeve publike, për një menaxhim më të mirë të financave publike, për një qeverisje më të mirë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka arritur të realizojë objektivat e tij strategjik. Unë do të identifikoj ato shkrurtimisht në aspektin e kuadrit ligjor dhe të metodologjisë bashkëkohore, që ai ka përdorur dhe përdorur në këto pesë vitet e fundit.

Së pari, sot KLSH ka një kuadër të ri ligjor. KLSH zbaton një ligj organik bashkëkohor, tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të vitit 2014, me ndihmën e ekspertizës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Bashkimit Europian. Kjo ka bërë të mundur që aktet nën ligjore, si dhe ato rregullatore të veprimtarisë së KLSH-së, të çojnë në rritjen e dobisë së auditimit. Treguesi i dobishmërisë, efektivitetit të KLSH-së, një tregues qendror i Kuadrit të Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të



Auditimit, i përdorur gjerësisht nga SAI-t moderne europiane dhe nga GAO amerikane, për vitin 2017 është 31.9 lekë. Në krahasim me periudhën dhjetëvjeçare 2002-2011 (me një mesatare 21.1 lekë), efektiviteti i institucionit për periudhën gjashtëvjeçare 2012-2017 është rritur mbi pesë herë (108.7 lekë).

KLSH, si institucion suprem auditimi ka kaluar nga auditimet klasike në ato më moderne dhe bashkëkohore. Zhvillimet profesionale dhe rritja e kapaciteteve audituese mbështetën fuqimisht angazhimet të ndërmarra nën Objektivin e Tretë Strategjik, përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës. Me miratimin e Ligjit 154/2014, KLSH u mandatua për të realizuar auditime performance në mënyrë eksplicite dhe specifike, me akses të pakufizuar, si në subjekte, ashtu edhe në informacion, sikurse dhe me të drejtën për të raportuar në Kuvend me auditime individuale performance. Për vitin 2017, numri i auditimeve të performancës u rrit me 20% në krahasim me vetëm një vit më parë.

Sistemi i Zhvillimit Profesional reflekton efektivitetin e politikave të rritjes së kapaciteteve profesionale të KLSH në vite, për të cilat treguesit e performancës përfaqësohen në nivele rreth 14 herë më të larta, nga 2,1 ditë mesatare trajnimi/auditues në vitin 2011, në fund të vitit 2017 stafi auditues ka një mesatare prej 28,5 ditë trajnimi/auditues duke arritur kështu dhe nivelin më të lartë të këtij treguesi përgjatë gjithë zhvillimit të këtij institucioni ndër vite.

Tregues të tjerë të performancës së trajnimeve konfirmojnë se ndër vite struktura e trajnimeve ka ndryshuar në përputhje me kërkesat e vetë stafit për zhvillim, si dhe kërkesave të standardeve të profesionit për të siguruar që puna audituese të kryhet në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, ISSAI.

Së dyti, kuadri metodologjik i KLSH që prej vitit 2012 është plotësuar dhe përditësuar duke reflektuar me korrektesë ndryshimet më të fundit në fushën ndërkombëtare, dhe gjatë vitit 2017 një seri dokumente metodologjike u zhvilluan për të kompletuar këtë kuadër. Nuk mund të lë pa përmendur ndër botimet e shumta të këtij institucioni:

- Metodologjinë e Auditimit të Performancës.
- Metodologjinë e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë.
- Metodologjinë e auditimit IT.
- Përdorimi i IT Tools/ instrumenteve të TI-së në auditim dhe praktikën e punës së KLSH.

Megjithëse zhvillimet e arritura në krijimin e një sistemi të konsoliduar trajnimi, sfida e KLSH në fushën e zhvillimit të kapaciteteve është Zhvillimi i Sistemit të Zhvillimit Profesional, i cili do të përfshijë Certifikimin dhe Zhvillimin e Vijueshëm të Detyrueshëm Profesional. Politikat e zhvillimit profesional duhet të nxisin vetëveprimin në mënyrë të tillë që trajnimi të mos shikohet vetëm si detyrim për t'u përmbushur, por si një proces i fitimit të dijeve që shton vlerë për vetë audituesin dhe në përgjithësi për institucionin.

Arritjet e deritanishme të objektivit për më shumë se 25 ditë trajnimi/auditues në një vit mbetet një eksperiencë pozitive që duhet mbajtur dhe përmirësuar në drejtim të përmbajtjes dhe cilësisë.

Padyshim që për mua është kënaqësi të konstatoj këndvështrimin e ri që KLSH ka sjellë për bashkëpunimin me organet e drejtësisë, në kuadër edhe të reformës në drejtësi, duke rritur gjithnjë rolin e tij në luftën ndaj shpërdorimit, mashtrimit, abuzimit me financat publike, akteve korruptive, shkeljeve të ligjit, për një përdorim efikas të fondeve publike, të kontributeve të taksapaguesve shqiptar dhe mirëqeverisjes së vendit, dhe natyrisht në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Duke ju uruar sukses në veprimtarinë tuaj kaq të dobishme, ju falenderoj për vëmendjen.

FJALA PËRSHËNDETËSE E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT TË KOSOVË, Z. BESNIK OSMANI



I nderuar Kryetar LESKAJ,
i nderuar Profesor ANGJELI,
i nderuar z. ADEMI,
të nderuar profesorë dhe auditues!

Është një kënaqësi e veçantë të marrë pjesë në Analizën Vjetore të Institucionit tuaj, ku ju me krenari natyrisht shpalosni rezultatet e punës tuaj.

Nëse institucionet e tjera të vendit, do të kishin mundësi që të merrnin kapacitetet dhe aftësinë profesionale që kanë Institucionet Supreme të Auditimit ndërkombëtare dhe të vendeve tona, sigurisht do të mund të kishim një qeveri më moderne, më të përgjegjshme në lidhje me interesat e qytetarëve.

Bashkëpunimi ynë me Kontrollin e Lartë të Shtetit është bërë pjesë e kalendarit të institucionit. Konstatoj me kënaqësi që programi i aktiviteteve në kuadër të bashkëpunimit është realizuar, duke përfshirë vizitat studimore, pjesëmarrjen në auditimet paralele, siç e përmendi dhe Kryetari LESKAJ, Nuk mund të lë pa përmendur përkrahja që Kontrolli i Lartë i Shtetit po i jep Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës për njohjen ndërkombëtare si institucion suprem auditimi, për aderimin në EUROSAI dhe INTOSAI.

Auditimi paralel i performancës me temë “Unifikimi i pikave doganore të Shqipërisë dhe Kosovës”, iniciativë e zotit LESKAJ, qe një risi në bashkëpunimin e frytshëm me institucione të rëndësishme të Kosovës si, Zyra Kombëtare e Auditimit, Ministria e Financave, Doganat dhe Odën Ekonomike të Kosovës. Nga operimi i plotë i doganës kosovare në Portin e Durrësit, përveç se bizneset do të përfitonin një ulje të kostos aktuale me rreth 2 milion euro në vit, do të kishim dhe një barrierë të mirë në luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit. Sigurisht që për zbatimin e rekomandimeve shumë të vlefshme të këtij auditimi do të duhet përfshirje serioze dhe vendimmarrje e qeverive të të dy vendeve tonë.

Vlerësimi nga Auditori i Përgjithshëm të Kosovës z. Besnik Osmani



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT / NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

Të nderuar,

Jam i lumtur të nënvizoj që bashkëpunimi midis auditorëve të Shqipërisë dhe Kosovës është një shembull i shkëlqyeshëm i bashkëpunimit dhe ngritjes së kapaciteteve. Zbatimi i projekteve të përbashkëta sidomos në auditimet e performancës apo organizimi i aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të edukimit profesional të vazhdueshëm paraqesin shembullin konkret të unifikimit të aktiviteteve audituese.

Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit gëzon një respekt të veçantë në mesin e familjes së Institucioneve Supreme të Auditimit në Evropë dhe më gjerë. Duke qenë kështu, neve na është dhënë mundësia e promovimit edhe të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës në rrugën e integritimit ndërkombëtar.

Gjatë bashkëpunimit, kam gjetur përkushtimin e thellë që KLSH e ka vendosur me prioritet, dhe që është shumë e dobishme për t'i siguruar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe publikut shqiptar, që veprimtaria ekonomike e institucioneve publike dhe personave tjerë juridik shtetërorë, sikurse edhe përdorimi dhe mbrojtja e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal është duke ndodhur në pajtueshmëri të plotë ligjore dhe fondet janë përdorur për qëllimet e synuara.

Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe mbajtja e forcimi i integritetit dhe kredibilitetit të institucioneve tona mbetet një sfidë e vazhdueshme. U jam shumë mirënjohës Kryetarit Leskaj dhe personelit të KLSH-së për të punuar bashkërisht në arritjen e këtyre objektivave.

Me respekt,

Besnik Osmani
Auditor i Përgjithshëm i Kosovës



Puna e audituese padyshim që është shumë fisnike, por dhe shumë sfiduese. Jo shumë njerëz na duan, si në Tiranë edhe në Prishtinë, për faktin e të qenit kritikë në përdorimin e fondeve publike.

Zbatimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe kontabilitetit kërkon përkrahje të vazhdueshme. Siç u shpreh shumë qartë dhe Kryetari LESKAJ, ne si dy institucione supreme auditimi nuk na duhet të bëjmë tjetër zbatojmë këto standarde të që kanë gjetur zbatim në institucionet më moderne të auditimit kudo në botë.

Për të arritur objektivat na duhet të forcojmë më tepër kapacitetet tona të brendshme përkundër përpjekjeve dhe rezultateve, që kemi patur së bashku. Gjithashtu na duhet të thellojmë bashkëpunimin me partnerët vendas dhe ndërkombëtar, sidomos atë rajonal, duke qenë pjesëmarrës aktiv në rrjetin ndërkombëtar të institucioneve supreme të auditimit. Siç e përmendi dhe Presidenti META ne duhet të përcjellim trendin e globalizimit në punën tonë.

Nuk po zgjatem më shumë. Ju mirëpres në Kosovë, në dy ditët në vijim për të festuar së bashku 10 vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, por gjithashtu ju mirëpres edhe në tetor, për festimin e 15 vjetorit të themelimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës.

Dëshiroj suksese në punën tuaj. Ju faleminderit!

FJALA PËRSHËNDETËSE E ZËVENDËS AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË ZYRËS SHTETËRORE TË AUDITIMIT TË MAQEDONISË , Z. NASER ADEMI

I nderuar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar LESKAJ,

të nderuar zonja dhe zotëri, të dashur miq!

Është një nder dhe kënaqësi të jem këtu përsëri midis jush në Republikën e Shqipërisë, dhe në emër të Entit për revizion shtetëror të Republikës së Maqedonisë të cilin e përfaqësoj, JU uroj një punë të suksesshme.



Ne vlerësojmë shumë punën KLSH e posaçërisht punën e Kryetarit të KLSH z. Bujar LESKAJ, i cili me vendosmërinë dhe përkushtimin e tij mendoj se ka udhëhequr KLSH si Institucion Suprem të Auditimit në hartën e institucioneve më të vlerësuara nga kolegët e regjionit dhe më gjerë.

Kemi përcjellë punën tuaj si Institucion Suprem të Auditimit dhe kemi qenë shumë herë të ftuar të marrim pjesë në evenimentet e KLSH, ku me të vërtetë jeni të vetmit në regjion që organizoni Konferenca Shkencore.

Ekzekutimi i auditimit shtetëror, i cili përfshin ekzaminim e dokumenteve, transaksionet financiare të cilat paraqesin të ardhura dhe shpenzime publike, vlerësimin mbi përdorimin e fondeve në aspekt të ekonomizimit, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe vlerësim të përdorimit të fondeve të taksapaguesve dhe qytetarëve përfaqëson prioritetin kryesor të çdo Institucioni Suprem të Auditimit, gjithashtu edhe të Institucionit Suprem të Auditimit, të cilin ne e përfaqësojmë.

Aktivitetet tona dhe aktivitetet e ndërmarra nga subjektet që kanë qenë të audituara mundësojnë forcimin e sistemit të financave publike, rritjen dhe e promovimin e transparencës, llogaridhënies, disiplinës fiskale dhe efektivitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike.

Këto aktivitete do të lehtësojnë shumë procesin e aderimit të vendeve tona në familjen e vendeve të Bashkimit Europian.

Përvetësimi i njohurive të reja në fushën e auditimit shtetëror, shkëmbimin e praktikave të mira mes Institucioneve Supreme të Auditimit dhe mësimi nga njëri-tjetri, mbi të gjitha të Institucioneve Supreme të Auditimit në rajon paraqesin nevojën për thellimin e bashkëpunimit tonë të themeluar për të cilën shprehim mirënjohje të thellë.

Falenderime të ndjera për Kryetarin z. Bujar LESKAJ për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm mes dy institucioneve duke theksuar se një praktikë e tillë duhet t'u shërbejë si shembull i mekanizmave të tjerë institucionalë të dy vendeve tona.

Faleminderit!

REFORMA INSTITUCIONALE DHE PERFORMANCA E VEPRIMTARISË AUDITUESE TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT, PËR VITIN 2017

PROGRESI DREJT MODERNIZIMIT INSTITUCIONAL PËRGJATË VITIT 2017

Nga znj. Luljeta NANO, Sekretar i Përgjithshëm

KLSH gjatë vitit 2017 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale në funksion të një zhvillimi të qëndrueshëm drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmëritë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.



1. MENAXHIMI I NDRYSHIMIT NË FUNKSION TË PËRMBUSHJES SË OBJEKTIVAVE STRATEGJIK

1.1. *Strategjia për menaxhim dhe zhvillim 2013-2017 e ripunuar*

Viti 2017 ishte viti i fundit i implementimit të Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 e rishikuar. Menaxhimi i ndryshimit në KLSH është kryer nëpërmjet sigurimit të vijueshmërisë së implementimit të objektivave të kësaj, duke vijuar me përmbushjen e objektivave prioritare të modernizimit institucional.

Mund të konfirmohet që objektivat strategjike të Strategjisë së Zhvillimit Institucional kanë qenë në fokus të veprimtarisë menaxheriale institucionale dhe promotor i zhvillimit dhe progresit institucional gjatë gjithë vitit 2017.

Menaxhimi i ndryshimit dhe zhvillimit institucional është realizuar duke konsideruar implementimin e objektivave strategjike si një proces dinamik, duke proceduar me rivlerësimin, përditësimin, përshtatur dhe zgjeruar dimensionet objektivave strategjike.

Njëherazi është proceduar me sigurimin e monitorimit të planit strategjik si një proces, i cili mundëson përditësimin e objektivave duke i shtuar vlerë strategjisë për zhvillim institucional.

Rezultatet e monitorimit: KLSH ka kryer në vijimësi dhe në nivel periodik vjetor monitorimin e strategjisë së zhvillimit institucional duke prodhuar Raportet vjetore të monitorimit të Strategjisë dhe për vitin analizues ky raport është miratuar me Vendimin nr . 148 datë 11.10.2017 dhe publikuar në Web-in e KLSH-së.

Në përfundim të këtij procesi monitorimi mund të konfirmohet që menaxhimi strategjik institucional është udhëhequr drejt normave dhe parimeve ndërkombëtare të auditimit të jashtëm publik si dhe në konvergjencë të plotë me Strategjinë e Zhvillimit të EUROSAT-t dhe të INTOSAT-t, duke përmbushur në këtë mënyrë pritshmëritë, gjatë gjithë periudhës së implementimit të strategjisë.

Raportet e monitorimit kanë shërbyer edhe si një instrument informimi dhe transparence për palët e interesit, si publiku, Kuvendi e Komisioni European, dhe të gjitha organizmat ndërkombëtar, të cilëve u mundësohet në këtë mënyrë vlerësimi i progresit të zhvillimit Institucional.

1.2. Strategjia e Implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI

Gjatë vitit 2017 KLSH vijoi me përmbushjen e objektivave të Strategjisë Implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit duke u angazhuar plotësisht në zbatimin e standardeve profesionale në ushtrimin e funksionit auditues në një linjë me qasjen e INTOSAT-t dhe EUROSAT-t duke e konsideruar kete proces si një prej sfidave me dinamike me të cilat përballen të gjithë SAT-t në nivel global që është “Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI”.

Plani i Zhvillimit Strategjik të INTOSAT-t për periudhën 2017-2022 përcakton si objektivi parësor zhvillimin e Standardeve Profesionale dhe konkretisht: “INTOSAT do të vijojë të promovojë Institucione të pavarura, të zhvilluara, multidisiplinore dhe do të inkurajojë mirëqeverisjen nëpërmjet: Mbështetjes për gjenerimin dhe ruajtjen e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI si dhe kontribuimin për zhvillimin dhe miratimin e standardeve profesionale efektive⁵.

Në Kongresin e X i EUROSAT-t, Maj 2017 theksohet që: “EUROSAT rekomandon përmirësimin e zbatimit të ISSAI-ve dhe nëse është e mundur reflektimin e ISSAI-ve

⁵ INTOSAT Strategic Plan 2017-2022. Goal 1 “Professional standards”.

në progresin e SAI-ve”⁶.

Procesi i implementimit të ISSAI-ve, sikurse edhe në vitet e kaluara është bazuar në këto objektiva:

- Implementimin e ISSAI-ve, në përputhje me mandatin e KLSH-së.
- Vlerësimin e performancës së auditimeve kundrejt ISSAI-ve.
- Përdorimin e ISSAI-ve, si kuadër referues në veprimtarinë audituese.

Në këtë këndvështrim i gjithë procesi i zbatimit të ISSAI-ve është kryer nëpërmjet rishqyrtimeve dhe riformulimeve të metodologjive të auditimit të KLSH, proceseve dhe procedurave si dhe të gjithë faktorëve të tjerë institucionale që ndikojnë sigurimin e përputhshmërisë së veprimtarisë audituese me standardet profesionale.

Procesi i implementimit të standardeve ISSAI është dinamik dhe në funksion të vetë zhvillimit të tij. Kjo duket qartë dhe nga niveli më i lartë i përmbushjes të objektivave të Strategjisë shprehur në matricën e implementimit, pjesë e Raporteve të Monitorimit të kësaj strategjie.

Raportet e monitorimit të Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve, përfshi dhe Raportin e monitorimit të vitit 2017 dëshmojnë për një ndjekje zbatim rigoroz të përmbushjes së objektivave por jo vetëm, ato janë dëshmi e përpjekjeve institucionale për të progresuar drejt implementimit të plotë të Standardeve ISSAI.

1.2.1. *Statusi aktual dhe perspektivat e implementimit të ISSAI-ve (4 nivelet)*

Nga një analizë e implementimit të kuadrit të ISSAI-ve referuar shtresëzimit të tyre sipas niveleve të njohura dhe të pranura ndërkombëtarisht mund konfirmohet që:

Niveli 1, (ISSAI 1), Deklarata e Limës. Ky standard fundamental përbën dokumentin bazik dhe përfaqëson “Kushtetutën” e Institucioneve Supreme të Auditimit, në të cilin sanksionohen parimet themelore të krijimit dhe funksionimit efektiv të Institucioneve Supreme të Auditimit. Konstatohet se KLSH ka implementuar tërësisht kërkesat e këtij Standardi.

Niveli 2, (ISSAI 10-99) përmban parakushtet e nevojshme për funksionimin e përshtatshëm dhe profesional të SAI-t. Nëpërmjet Ligjit ri Organik të KLSH-së dhe veprimtarisë menaxheriale institucionale, KLSH ka mundësuar zbatimin në praktikë të kërkesave të parimeve themelore të sigurimit të pavarësisë, transparencës, llogaridhënies, etikës dhe kontrollit të cilësisë.

⁶ Konkluzione dhe rekomandime. Kongresi i X i EUROSAT-t, 23-25 Maj 2017, Stamboll, Turqi. KLSH 2018

Konstatohet se KLSH ka implementuar kërkesat e ISSAI 10 (Deklarata e Meksikës), ISSAI 20 Pavarësia e SAI dhe kërkesat e ISSAI 30 Kodi Etik i INTOSAI-t . Përsa i përket ISSAI 40 “Kontrolli dhe Sigurimi i cilësisë” KLSH është ka reflektuar kërkesat e këtij Standardi në dokumentin e Politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si dhe ka reflektuar në Rregulloren e Brendshme të Procedurave të Auditimit kërkesat e ISSAI 40. Gjatë vitit 2017 nën ekspertizën e kolegëve të SAI-t Polak u përgatitën dhe dokumentet e politikave të menaxhimit të cilësisë, si dhe listat kontrolluese.

Statusi i implementimit të nivelit 1 dhe të nivelit 2 të ISSAI-ve (ISSAI 10 e ISSAI 11” është konfirmuar dhe nga misioni i Peer-Review “Mbi pavarësinë e KLSH-së”, kryer nga Gjykata Austriake e Auditimit në bashkëpunim me Gjykatën e Llogarive të Moldavisë. sipas të cilit:

“Kushtetuta dhe Ligji për KLSH-në mbulojnë të gjitha Parimet e Deklaratës mbi Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit. Zbatimi de fakto i dispozitave të këtij kuadri është i përcaktuar shumë mirë”⁷.

Sa më sipër, KLSH gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale dhe asaj audituese do të avancojë me implementimin e kërkesave të nivelit 1 dhe 2 të ISSAI-ve në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë audituese.

Niveli 3, përmban parimet fundamentale të auditimit dhe japin një platformë konceptuale për auditimin Auditimin Financiar, Auditimin e Performancës dhe Auditimin e Përputhshmërisë duke siguruar dhe konsistencën me kuadrin e ISSAI-ve. Përsa i përket Nivelit 3 të KLSH ka implementuar parimet bazë të auditimit, si në Auditimin Financiar, Përputhshmërisë dhe atë të Performancës. KLSH në këtë aspekt do të progresojë duke konsideruar dhe Rekomandimet e adresuara nga Kongresi i X i EUROSAI-t, sipas të cilit: “Duke marrë parasysh se mandatet e auditimit janë të ndryshme, EUROSAI konkludon se ISSAI-të ofrojnë një kornizë të përbashkët veçanërisht për auditimin financiar dhe rekomandon, që ISSAI-të të harmonizohen me kornizat ligjore kombëtare të SAI-ve”⁸.

Bazuar dhe ne rekomandimet e SIGMA-s në lidhje me vijimin e përmirësimit të Manualeve të Auditimit të Përputhshmërisë dhe Auditimit Financiar, KLSH do të reflektojë kërkesat e Standardeve të nivelit 3, ISSAI 200 dhe 400 në këto dokumente

⁷ Raporti Përfundimtar i Peer Review. Vlerësim i pavarësisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit Shqiptar nga kolegët e institucioneve homologe Gjykata Austriake e Audituesve në bashkëpunim me Gjykatën e Llogarive të Moldavisë.

⁸ Konkluzione dhe rekomandime. Kongresi i X i EUROSAI-t, 23-25 Maj 2017, Stamboll, Turqi.

duke reflektuar në to dhe kërkesat e ISSAI-ve të nivelit 4 të Standardeve duke i pasuruar me udhërrëfyesit specifik të fushës së auditimit.

Niveli 4 i standardeve përfaqëson nivelin kryesor në referim të praktikës auditimit bazuar në ISSAI dhe përmban kërkesat për udhëzimin e auditimit në praktikë në trajtën e udhëzimeve operacionale, që mund të përdoren gjatë veprimtarisë audituese. ISSAI (1000-4999) përfshin setin e kërkesave të rekomanduara që duhet të përmbushin audituesit gjatë kryerjes së auditimit financiar, të performancës dhe të përputhshmërisë⁹.

Referuar perspektivës së zhvillimit në drejtim të zbatimit të ISSAI-ve, KLSH do të vijojë me zgjerimin e kuadrit rregullativ standardizues, duke hartuar manuale specifike të detajuara për fusha dhe drejtime të caktuara bazuar në Udhërrëfyesit e Pergjithshëm të Auditimit për Auditimin Financiar të Përputhshmërisë dhe të Performancës si dhe në Udhërrëfyesit për objekte auditimi specifike.

Krahas sa më sipër, në fokus të zhvillimeve strategjike në drejtim të implementimit të Standardeve ISSAI do të jenë dhe Udhërrëfyesit të INTOSAI-t për mirëqeverisjen INTOSAI GOV.

Progresi i bërë deri tani në hartimin dhe krijimin e kuadrit metodologjik, Manualeve të Auditimit sipas llojit dhe Udhëzuesve specifikë mbi bazën e ISSAI-ve përkatës do të vijojë të theksohet dhe çohet më tej në periudhën e ardhme. Në filozofinë e zbatimit të standardeve ndërkombëtare KLSH konsideron që të fokusojë burimet dhe kapacitetet institucionale në funksion të implementimit të suksesshëm të ISSAI-ve.

1.3. Kryerja e auditimeve pilot në funksion të përmirësimit të manualeve të auditimit dhe implementimit të Standardeve të fushës – ISSAI

KLSH në një linjë me rekomandimin e adresuar nga BE, që “KLSH të rrisë numrin e auditimeve pilot financiarë/të përputhshmërisë/rregullshmërisë, në përputhje me manualët e përditësuar dhe standardet e auditimit të INTOSAI-t” (Progres Raporti 2016 për Shqipërinë, faqe 85), si objektivi për vitin 2017 përcaktoi rritjen në mënyrë progresive me rreth 40% pilotimin e auditimeve të përputhshmërisë dhe e shprehur në terma konkrete numri i auditimeve të përputhshmërisë do të rritej nga 10 auditime përputhshmërie që kreu në vitin 2016 në 14 auditime.

Për vitin 2017 objektivi ishte kryerja e 10 auditimeve financiare. Në fakt ky objektivi u tejkalua, duke kryer 14 auditime financiare.

⁹ www.ISSAI.org&www.IDI.org ISSAI Implementation handbook Financial, Compliance, Performance Audit.

Krahas sa më sipër, në kuadrin e implementimit të projektit IPA 2013 po vijohet me procesin e pilotimit të disa auditimeve, proces ky i cili do të shoqërohet edhe me përmirësimin final të manualeve të auditimit.

KLSH në vitin 2018 do të vijojë me rritjen e numrit të auditimeve pilot në një linjë me kërkesat e Standardeve ISSAI në kryerjen e auditimeve të përputhshmërisë dhe ato financiare.

1.4. Implementimi një Sistemi Efektiv të Menaxhimit të Riskut. Strategjia për Menaxhimin e Riskut

KLSH gjatë vitit 2017 vijoi me implementimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, konsideruar si një prej një prej dokumenteve bazë dhe boshti i sistemit të menaxhimit të riskut .

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në KLSH është hartuar mbështetur në ISSAI 9130 “Udhëzues për Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik- Informacion i zgjeruar për Menaxhimin e Riskut Institucional” dhe në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

KLSH e ka konsideruar menaxhimin e riskut si pjesë të kulturës menaxheriale organizative, të integruar në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës, duke synuar identifikimin zvogëlimin dhe vlerësimin e riskut për çdo veprimtari që kryen institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Menaxhimi i Riskut gjatë vitit 2017, është realizuar si një proces që i është bashkëngjitur arritjes së objektivave të synuara në përputhje edhe me rekomandimet për zhvillim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për KLSH-në, të Tetorit 2016.

Në veçanti rekomandimi i rezolutës që: “KLSH gjatë periudhës në vijim të zbatojë Strategjinë e Menaxhimit të Kontrollit të Riskut me qëllim identifikimin, analizimin dhe monitorimin e risqeve kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e KLSH në funksion të minimizimit të ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive gjatë veprimtarisë audituese”¹⁰, ka qënë në fokus të menaxhimit të risqeve në të gjithë komponentët përberës të tij i lidhur ngushtësisht me elementet e riskut të Strategjisë për Zhvillim; me risqet menaxheriale, risqet institucionale, risqet e lidhura me veprimtarinë audituese. Zbërthimi në këto komponentë i riskut ka plotësuar kuadrin e menaxhimit të riskut institucional në të gjithë dimensionet e funksionimit të institucionit gjatë veprimtarisë të vitit 2017. Në përfundim

¹⁰ Rezoluta e Kuvendit adresuar KLSH, datë 20 Tetor 2016 “Rekomandimet, pika 7”.

theksojmë që KLSH ka kryer gjatë vitit 2017 dhe procesin e monitorimit të implementimit të Strategjisë së Riskut duke rezultuar me një raport monitorimi, i cili është publikuar dhe në web-in e KLSH-së duke i mundësuar të gjitha palëve të interesit ofrimin e informacionit në funksion të progresit të bërë në këtë drejtim.

1.5. Konsolidimi i efektivitetit të sistemit të etikës dhe integritetit

Në fokus të veprimtarisë menaxheriale institucionale sikurse në periudhat e kaluara ka qenë dhe është sigurimi i qëndrueshmërisë së zhvillimit dhe rritjes së efektivitetit të sistemit të etikës dhe integritetit institucional, nëpërmjet zbatimit të kornizës rregullative të KLSH-së dhe praktikave më të mirat të komunitetit të INTOSAI.

KLSH ka implementuar modelin e sugjeruar nga OECD në lidhje me implementimin e një sistemi efektiv të etikës dhe integritetit duke u fokusuar në tre shtylla kryesore:

1. Hartimi dhe konsolidimi i kuadrit rregullator mbi etikën dhe integritetin;
2. Menaxhimi i etikës dhe integritetit;
3. Ushtrimi i funksioneve mbikëqyrëse dhe kontrolluese për zbatimin e kodit të etikës dhe kuadrit rregullator institucional të etikës dhe integritetit.

Aktualisht, forcimi i sistemit të etikës dhe integritetit është ndër prioritetet e menaxhimit institucional dhe si anëtar i grupit Task Force për Auditimin dhe Etikën, ka ngritur tashmë strukturën e tij etike, Sektorin e Etikës dhe Integritetit, ka Kodin e tij të Etikës dhe në reflektim edhe të praktikave më të mira të institucioneve më të përparuara analoge ka ngritur edhe Komisionin e Etikës.

Gjatë vitit 2017 KLSH u bë pjesë e Grupit të projektit të EUROSAI “Mbi rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në përhapjen e kulturës etike në sektorin publik”, i cili udhëhiqet nga SAI Hungarez.

Në funksion të konsolidimit të kuadrit rregullator KLSH gjatë vitit 2017 publikoi dhe kreu trajnime të dedikuara të “ISSAI 30 – Kodi Etikës”, miratuar në Kongresin e INTOSAI-t, në Dhjetor 2016 ,si dhe Udhërrëfyesit:

- Auditimi i etikës në organizatat e sektorit publik dhe
- Si të implementojmë ISSAI 30;

Kodi i Etikës së KLSH-së, Rregulloret e veprimtarisë audituese apo të organizimit administrativ, Udhërrëfyesit e lançuar nga EUROSAI, të cilët janë përkthyer dhe botuar nga KLSH, si dhe të gjitha aktet e tjera të kornizës rregullative të KLSH-së

përdorin këtë taktikë menaxheriale për të dizenuar e zbatuar një politikë adekuate integriteti, duke rritur ndërkohë ndërgjegjësimin e stafit auditues në këtë drejtim.

Me Urdhrin e Kryetarit nr. 26 datë 27.01.2017 “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, është ngritur struktura përgjegjëse, e cila përbëhet nga tre anëtarë, konform përcaktimit të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Në nëntor të vitit 2017 njësia përgjegjëse ka kryer aktivitetin e prezantimit të Udhërrëfyesit “Për Sinjalizimin dhe sinjalizuesit në Shqipëri” me stafin e KLSH.

Me Urdhrin nr. 219, datë 31.12.2017 Kryetari i KLSH ka miratuar Rregulloren e brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes nga hakmarrja në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Në përmbushje të detyrimeve të Ligjit nr. 60/2016, datë 02.06.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” njësia përgjegjëse ka raportuar në ILDKPKI mbi aktivitetin e saj gjatë vitit 2017.

Në periudhën në vijim, KLSH synon:

- Monitorimin në vijimësi të risqeve dhe maturitetit të sisteme të integritetit, etikës dhe disiplinës institucionale;
- Përgatitja e Raporteve të Monitorimit nga Sektori i Etikës dhe Integritetit mbi inspektimet e kryera;
- Monitorimi nga ekspertët e jashtëm dhe bashkëpunimi me agjencitë e tjera dhe OJF antikorrupsion;
- Pjesëmarrje aktive në Grupet dhe projektet e EUROSAT-t referuar çështjeve të etikës dhe integritetit.

2. ZHVILLIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE TË INSTITUCIONIT


Meqenëse Institucionet Supreme të Auditimit konsiderohen si modeli ideal në aspektin e menaxhimit institucional, prishmëria në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore në KLSH është mjaft e lartë dhe është në fokus të qeverisjes së brendshme institucionale. Në këtë këndvështrim menaxhimi i burimeve njerëzore në KLSH është konsideruar si parakusht dhe jetik për funksionimin e institucionit në mënyrë efektive dhe të eficiente.

Bazuar në kërkesat e ISSAI 40, në të cilin përcaktohet që “Politikat e burimeve njerëzore përfshijnë (ndër të tjera): rekrutimin, zhvillimin profesional dhe promovimin”, KLSH për vitin 2017 e orientoi implementimin e politikave drejt procedurave transparente të rekrutimit, promovimit dhe sigurimit të kompetencës profesionale, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Qëllimi i KLSH-së është që të përmirësojë vazhdimisht performancën e tij, kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet një stafi i cili është i motivuar, është i mirë menaxhuar, si dhe që shpërblehet në mënyrë të drejtë.

Për vitin 2017, me anë të Vendimit nr. 4, datë 27.01.2017 të Kryetarit të KLSH, “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH”, i ndryshuar është miratuar struktura organike me një total prej 181 punonjësish. Nga viti 2011 dhe 2012, vite në të cilat struktura ka pasur një numër total prej 156 punonjësish, dinamika e shtimit të numrit të punonjësve ka rezultuar 5 punonjës çdo vit, duke arritur në 181 punonjës për vitin 2017.

Në total numri i stafit Kryeauditues dhe atij Auditues në vitin 2017 është 130 punonjës (nga 128 punonjës në vitin 2016, nga 125 në vitin 2015, 119 në vitin 2014, 113 në vitin 2013, 110 punonjës në 2012 dhe 2011), që zë rreth 73.8% të numrit total të punonjësve.




Siç shikohet qartë edhe nga grafiku struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë në favor të stafit auditues.

Klasifikuar sipas arsimimit, në strukturën organike për vitin 2017, punonjësit me arsim të lartë zënë 168 punonjës ose në masën rreth 95.4 % kundrejt numrit total

të punonjësve në vitin 2017, krahasuar me 141 punonjës ose 90% që rezultonin në vitin 2011.

Të ndarë sipas profilit të diplomimit, grafiki i klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë për vitet 2011-2017 paraqitet:



Me qëllim përmirësimin e performancës së tyre si dhe për të fituar njohuri, aftësitë dhe teknika të reja, një pjesë e punonjësve kanë përfunduar studimet në degë të dyta apo në certifikata të ndryshme, të cilat bëjnë të mundur që ato ti përdorin aftësitë e tyre, në mënyrë efektive në situata të reja dhe përkatësisht:

- 2 punonjës (Drejtore të Përgjithshme) kanë titullin “Profesor” dhe “Profesor i Asc.”;
- 5 punonjës kanë titullin “Doktor i shkencave”;
- 16 (9%) punonjës kanë një diplomë të dytë nga të cilët 12 në Drejtësi, 3 në Financë dhe 1 të tjera;
- 2 punonjës ka Diplomë Ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA) dhe 2 punonjës ka Certifikatë Ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA&CPA);
- 5 punonjës kanë certifikatën Kontabël i Miratuar dhe 2 punonjës ka certifikatën Ekspert Kontabël;
- 19 punonjës kanë certifikatën e Audituesit të Brendshëm;

- 12 punonjës kanë certifikatën e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme.
- 9 punonjës kanë certifikata të trajnimeve të zhvilluara on-line nga IDI (Iniciativa për zhvillim e INTOSAI-t).

Mbi proceset e rekrutimit dhe përzgjedhjes dhe pranimit të stafit

Rekrutimi dhe përzgjedhja është pika e nisjes për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe KLSH ashtu sikurse më parë, ka bazuar politikat e rekrutimit në tre parimet bazë që janë: i) Vlerësimi i profesionalizmit, ii) transparencës dhe iii) konkurrimi i hapur dhe mundësia e pjesëmarrjes për të gjithë të interesuarit. Politikat e rekrutimit të punonjësve janë aplikuar në një linjë me Strategjinë e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, me qëllim që KLSH të sigurojë stafin e duhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e duhur për të plotësuar nevojat korrente dhe të perspektivës.

Gjatë vitit 2017 janë ndjekur të gjitha procedurat sipas rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi nëpunësit civil, për rekrutimin e 22 punonjësve, nga 24 punonjës që janë rekrutuar në vitin 2016, nga 27 punonjës që janë rekrutuar në vitin 2015, nga 25 punonjës që janë rekrutuar në vitin 2014, 21 punonjës që janë rekrutuar në vitin 2013 apo nga 25 të rekrutuar në vitin 2012.

Politikat e ngritjes në detyrë dhe nxitjes së karrierës

Qëllimi i politikës së ngritjes në detyrë në KLSH është të sigurojë përdorimin e potencialit të punonjësve për një realizim më të mirë të kuadrit rregullator institucional. Kjo politikë është gërshetuar me politikat për motivimin dhe zhvillimin profesional. Çdo punonjës i KLSH-së ka të drejtën e ngritjes në detyrë dhe dëshmi për këtë është çdo anëtar i stafit të KLSH-së. Nisur nga standardet ndërkombëtare, ku një institucion suprem auditimi duhet të ruajë dhe të zhvillojë trupën profesionale në funksion të qëllimit të krijimit të mundësive për promovimin dhe për integrimin e stafit të ri, gjatë vitit 2017 janë zhvilluar 5 testime dhe është miratuar ngritje në kategori për 22 auditues, ndërsa gjatë vitit 2016 janë zhvilluar 5 testime dhe është miratuar ngritje në kategori për 16 auditues, gjatë vitit 2015 janë zhvilluar 6 testime dhe është miratuar ngritje në kategori për 27 auditues, gjatë vitit 2014 janë zhvilluar 6 testime dhe janë realizuar 20 ndryshime në kategori, gjatë vitit 2013 janë zhvilluar 3 testime dhe janë realizuar 23 ndryshime në kategori, duke ju dhënë në këtë mënyrë mundësinë zhvillimit të karrierave profesionale brenda institucionit, nëpërmjet konkurrimit.

Krahas sa më sipër është proceduar edhe me 3 raste të uljes në kategori të punonjësve.


Treguesit moshor dhe gjinor të stafit të KLSH-së

Tregues të tjerë, po aq të rëndësishëm për burimet njerëzore janë moshja e punonjësve të institucionit dhe raporti femra/meshkuj gjatë viteve 2011-2017 përkatësisht si më poshtë:


Moshja mesatare në KLSH në fund të vitit 2017 është 41.5 vjeç, nga 50 vjeç në 2011.



- Rezultojnë 35 punonjës nën moshën 30 vjeç, nga moshja 31-50 vjeç janë 75 punonjës, ndërsa mbi moshën 51 vjeç janë 66 punonjës.
- Vjetërsia në institucion është 7.4 vjet, nga 9 vjet në vitin 2016, nga 7.2 vjet në vitin 2015, nga 8 vjet në vitin 2014, 8.2 vjet për person që ka qenë në vitin 2013, 5.5 në vitin 2012, 9.1 në vitin 2011.



Raporti femra/meshkuj 39.7% me 60.2% në vitin 2017, nga 33.5% me 66.5% në vitin 2011.



Rezultojnë të punësuar në Institucion 70 punonjëse femra, 9 prej të cilave në pozicione drejtuese (Sekretare e Përgjithshme, Drejtore e Përgjithshme, Drejtore Departamenti, Drejtore Drejtorie, Kryeaudituese, Përgjegjëse Sektori), 15 punonjëse femra në Departamente, Drejtori dhe Sektorë mbështetës e ndihmës dhe 46 punonjëse femra në pozicione audituese.

Mbi ndryshimet dhe zhvillimet e Strukturës Organizative

Ndryshimet e Strukturës organizative kanë synuar që të adaptohet një strukturë organizative fleksibël dhe që reflekton kërkesat e “COSO model”, kundrejt pesë komponentëve për të siguruar sisteme efektive të kontrollit të brendshëm duke formuar në këtë mënyrë një sistem të integruar që reagon në mënyrë dinamike ndaj ndryshimit të kushteve eventuale.

Për vitin 2017, me anë të Vendimit nr. 4, datë 27.01.2017 të Kryetarit të KLSH, “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH”, i ndryshuar u hartua struktura e re e KLSH-së.

Ndryshimet strukturore gjatë vitit 2017 u kryen bazuar edhe në rekomandimet e adresuara nga ekspertet e huaj përgjatë procesit të implementimit të projektit IPA aktivitetit “Shqyrtimi i strukturës aktuale”.

Me vendimin e Kryetarit nr. 7 datë 10.02.2017 u krijua Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit, boshti kryesor i veprimtarisë të të cilit është

hartimi dhe zhvillimi i politikave të auditimit, strategjive të zhvillimit, monitorimit të tyre zhvillimit të metodologjive manualeve, si dhe mbështetja e departamenteve të auditimit

Në funksion të arritjes së pritshmërive për modernizimin institucional gjatë vitit 2017 vijoi konsolidimi i funksionimit të Departamentit të Performancës i krijuar që në fillim të vitit 2012, Departamentit Juridik dhe i Zbatimit të Standardeve, në funksion të forcimit të komponentit të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë konform kërkesave të ISSAI 40 “Sigurimi i cilësisë”. Po kështu gjatë vitit 2017 vijoi konsolidimi i Drejtorisë e së Auditimit të Teknologjisë dhe Informacionit.

3. ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE METODOLOGJIK INSTITUCIONAL

Zhvillimi i kapaciteteve dhe analiza e veprimtarisë trajnuese për vitin 2017 dhe rezultateve të saj konfirmoi se KLSH ka ndërtuar sistem efektiv trajnimi dhe zhvillimi profesional.

Objektivat e KLSH për zhvillim profesional u përvijuan në Programin Vjetor të Trajnimit për vitin 2017, duke synuar sigurimin e trajnimeve për stafin në si një qasje e qëndrueshme, e aftë ti mundësojë stafit ruajtjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive dhe dijeve dhe zhvillimin e karrierës.

Sistemi i Zhvillimit Profesional ne KLSH reflekton efektivitetin e politikave të rritjes së kapaciteteve profesionale të KLSH në vite, për të cilat treguesit e performancës përfaqësohen në nivele rreth 14 herë më të larta, nga 2,1 ditë mesatare trajnimi/auditues në vitin 2011 , në fund të vitit 2017 stafi auditues ka një mesatare prej 28,5 ditë trajnimi/auditues duke arritur kështu dhe nivelin më të lartë të këtij treguesi përgjatë gjithë zhvillimit të këtij institucioni ndër vite. Grafikisht ecuria e trajnimeve në vite paraqitet:



Tregues të tjerë të performancës së trajnimeve konfirmojnë se ndër vite struktura e trajnimeve ka ndryshuar në përputhje me kërkesat e vetë stafit për zhvillim, si dhe është orientuar drejt zhvillimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI.

- rreth 39% e trajnimeve u orientuan në fushën e metodologjisë audituese;
- 35% e trajnimeve trajtuan çështje të kuadrit rregullator dhe legjislativ të përgjithshëm, në nivel kombëtar dhe institucional;
- trajnime të tjera përfshinë çështje specifike të auditimit në konferenca, workshop-e dhe vizita studimore në SAI-t homologe, si praktika më të mira ndërkombëtare të fushës.

Për të maksimizuar cilësinë dhe vlerën e fitimit të njohurive në procesin e trajnimit KLSH është mbështetur ndjeshëm në diversifikimin e burimeve të informacionit.

Në një masë të rëndësishme gjatë vitit 2017, KLSH u mbështet nga veprimtari trajnimi nga ekspertët e Projektit të Binjakëzimit IPA 2013, kryesisht ekspertë të NIK i Polonisë, SAI i Kroacisë, Gjykatës së Auditimit të Holandës, brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet workshop-eve dhe vizitave studimore. Ofruesit e trajnimeve në vite janë ekspertët brenda KLSH-së, ekspertë të jashtëm në vend, ekspertë të jashtëm nga partnerët strategjikë të institucionit.

Korniza metodologjike në Kontrollin e Lartë të Shtetit është shtylla vertebrore e politikave të drejtimit të institucionit.

KLSH në ngritjen e kuadrit metodologjik ka synuar të kombinojë elementin teorik, pra zhvillimet dhe kërkesat e standardeve me elementin praktik, pra sigurinë se si këto kërkesa të mund të zbatohen në praktikë dhe ti shërbejnë në punë audituesit.

Standardet e përkthyer dhe të botuara në vite nga KLSH formojnë një kuadër domethënës, të cilat gjatë vitit 2017 u pasuruan më tej me përkthimin dhe botimin e grupit të Standardeve ISSAI dhe Udhërrëfyesve të miratuara në Kongresin e INTOSAI-t në Dhjetor 2016 dhe Udhërrëfyesit në Kongresin e EUROSAT-t Maj 2017 duke arritur në publikimin e 20 Standardeve ISSAI, që përfshin të katër nivelet e shtresëzimit hierarkik të tyre, që nga Deklarata e Limës deri në Udhëzuesit e nivelit 4 të fushave specifike të auditimit.

Manualet e Auditimit, sipas llojeve, në KLSH përmbajnë udhëzime të posaçme për të kryer auditimet në linjë me standardet e duhura dhe me cilësinë që kërkohet.

Në fund të vitit 2017, KLSH prezantohet me 4 manuale të auditimit dhe që përfshijnë Manuali e Auditimit të Performancës, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Manualin e Auditimit të TI-së.

Udhëzues dhe urdhra specifike që mbulojnë çështje më teknike janë përgatitur dhe zbatuar në vazhdimësi, duke mbështetur aktivitetin e gjithë trupës audituese. Janë në proces shqyrtimi përfundimtar Manuali i Auditimit kundër Mashtrimit dhe Korrupsionit dhe Manuali i Auditimit të Prokurimeve.

4. BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL: KOMUNIKIMI DHE MENAXHIMI I PARTNERITETIT

Ky aspekt i menaxhimit institucional është në përputhje të plotë dhe bazohet në standardet profesionale të auditimit publik suprem, ISSAI-t, dhe përkatësisht në Deklaratën e Limës (ISSAI 1), në Standardin ISSAI 20 “Parimet e Transparencës dhe të Përgjegjshmërisë”, si dhe në ISSAI-n 12 “Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit – Të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”.

4.1. Mbi hartimin dhe implementimin e Strategjisë së Komunikimit të KLSH-së 2017-2019

KLSH në kuadrin e implementimit të Projektit IPA në Korrik 2017 hartoi dokumentin e Strategjisë së Komunikimit të KLSH-së dhe e ka implementuar atë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017.

Objektivat strategjikë të KLSH u orientuan drejt nevojave, kërkesave dhe sfidave të institucionit në komunikimin me publikun dhe palët e tjera të interesit, por edhe në bazë të burimeve aktuale njerëzore dhe financiare dhe mundësisë së kufizuar të rritjes së tyre për periudhën e realizimit të Strategjisë:

Objektivi Nr. 1: Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni.

Objektivi Nr. 2: Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut.

Objektivi Nr. 3: Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinioni publik rezultatet dhe dobitë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit.

Objektivi Nr. 4: Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rumbullakëta.

Objektivi Nr. 5: Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në dhënien e opinionit, në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive.

4.2. Komunikimi me median


Gjatë viteve 2012-2017, institucioni në përmbushje të objektivit për rritjen e transparencës është zhvilluar në disa dimensione.

Kështu, krahas rritjes së kanaleve të komunikimit me publikun, përmirësoi përmbajtjen dhe cilësinë e mesazheve në njoftimet e tij për shtyp. Njoftimet për shtyp kanë qenë dhe janë përcjellësi kryesor i mesazheve publike të institucionit.

Gjatë vitit 2017, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat për shtyp me një numër prej 840 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike.

Në fund të vitit 2017, KLSH ka qenë e pranishme me rreth 100 kronika më shumë se vitin e kaluar (numri është rritur nga 550 në 642 kronika).

Institucioni ka konsideruar median e shkruar dhe audio-vizive, si partnerin kryesor ndër palët e interesit.




Në këtë drejtim ka ndikuar dukshëm edhe prezenca e audituesve të KLSH-së në median e shkruar, shkrimet e të cilëve i janë paraqitur të përmbledhura publikut në 9 volume (periudha 2013-2017), të cilët janë botime të kolanës së KLSH-së.

Gjatë vitit 2017, KLSH ka qenë prezente pothuajse në të gjitha gazetat me 125 shkrime, të shkruara nga auditues të KLSH-së. Gjatë pesë viteve, 2013-2017 audituesit e KLSH kanë botuar 521 artikuj.



Trajtimi i Letrave nga Qytetarët

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2017 ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit. Në këto raste KLSH i ka orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet ti drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre. Gjatë 2017, KLSH ka trajtuar 623 letra dhe ankesa, nga të cilat 246 jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Nga 377 ankesa në kompetencë të KLSH, 204 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 173 janë në proces verifikimi.



Muaji i Hapur në KLSH

Me qëllim njohjen më të plotë dhe të drejtpërdrejtë të veprimtarisë së Institucionit nga qytetarët, si edhe në kuadër të transparencës dhe njohjes së ndërsjellë të punës mes Departamenteve të auditimit në institucion, KLSH në zbatim të Strategjisë së Komunikimit 2017-2019 dhe të eksperiencës së javës së hapur, të organizuar në nëntor 2016, organizoi Muajin e Hapur për qytetarët, në datat 7 Nëntor- 11 Dhjetor 2017.

Gjatë kësaj periudhe, qytetarët patën mundësinë të vizitojnë mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të njihen me historikun dhe arritjet e institucionit në 92 vitet e ekzistencës së tij nëpërmjet mini-muzeut të KLSH-së, të takohen me punonjës, auditues dhe ekspertë të ndryshëm të institucionit, duke marrë të gjithë informacionin që kanë kërkuar dhe duke adresuar pyetje të ndryshme me interes për ta. Stafi i përgatitur i KLSH-së ishte në dispozicion të qytetarëve gjatë gjithë kësaj periudhe.


Gjatë muajit të hapur janë zhvilluar 49 aktivitete të ndryshme si takime mes Departamenteve të ndryshme të auditimit me qëllim shkëmbimin e eksperiencave; takime me gazetarë; prezantime të botimeve të KLSH-së nga Auditues të rinj; pjesëmarrje në Panairin e librit 2017; prezantimi i Rregullores së Re të KLSH; prezantimi i kolanës së botimeve të KLSH-së në dy panaire; takime dhe leksione me akademikë, profesorë, filozofë të fushave të ndryshme; prezantim i Draft-Strategjisë së zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018-2022; leksione nga kolegë të SAI-ve partnere, prezantimi i buxhetit faktik për vitin 2016; promovime librash që kanë interes për KLSH; aktivitete kulturore, promovimi i pjesëmarrjes së KLSH-së në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, në dy vitet e fundit me qëllim shkëmbimin e eksperiencave; pjesëmarrje në Kongresin dhe ekspozitën rajonale “Zgjidhja e mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe të gazta”, etj.

Po kështu në këtë kuadër u zhvilluan aktivitete në bashkëpunim me shoqërinë civile ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të stafeve akademike. Të gjitha aktivitetet janë ndjekur me vëmendje dhe interes nga auditues, gazetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, studentë, etj.

Publikimet e KLSH-së gjatë vitit 2017

KLSH vjen në gjashtë vitet e fundit 2012-2017 me një kolanë botimesh prej 83 titujsh. Kolana e botimeve, e cila pasurohet nga viti në vit, pasqyron çdo kronikë të reformave që ka nisur KLSH dhe nëpërmjet tyre, ne rrisim transparencën dhe llogaridhënien tonë si institucion, duke rritur njëkohësisht edhe besimin e KLSH 2018

qytetarëve ndaj punës sonë.



Gjatë vitit 2017, 67 botimeve të viteve 2012-2016, iu shtuan 16 botimet e 2017-s.

Revista Shkencore “Auditimi Publik”, arriti në numrin 17 të saj dhe është tregues i përkushtimit dhe vlerave të institucionit që vijon të botojë çdo 4 muaj një numër të kësaj Reviste.

Me qëllim promovimin e botimeve të KLSH-së, institucioni mori pjesë për të pestin vit radhazi në Panairin e Librit, në të cilin u paraqit me 77 botime përkundrejt 17 botimeve të vitit 2013, kur mori pjesë për herë të parë modestisht në këtë panair.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në vitin 2017, për herë të dytë në Panairin Ndërkombëtar të Klik Expo Group, që u organizua në Tiranë në datat 23-26 nëntor.

Kontrolli i Lartë i Shtetit u paraqit në këtë panair me kolanën e plotë të botimeve të tij për periudhën 2012- 2017.

Gjithashtu KLSH mori pjesë dhe në Kongresin Shkencor Ndërkombëtar “Menaxhimi dhe trajtimi i integruar i mbetjeve në gjendje të lëngët, të ngurtë dhe të gaztë” në datat 24-25 nëntor.

Në gjashtë vitet e fundit, KLSH ka lidhur 50 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 27 me OJF, 15 me institucione homologe dhe të tjerat me institucione shtetërore dhe Universitete Publike.

Bashkëpunime me profesoratin e Universiteteve dhe me Organizatat e Profesionistëve të fushës ka përvijuar edhe përgjatë vitit 2017, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e tyre për Revistën Shkencore të KLSH-së, Konferencat Shkencore të KLSH-së, trajnimet, rekrutimet e stafit, etj.

Konferenca e V-të Shkencore e KLSH-së

Konferenca e V-të u zhvillua në datat 11 -13 tetor 2017, në Tiranë dhe u realizua si një bashkëpunim mes Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Gjykatës Turke të Llogarive dhe Fondacionit të Kontabilitetit për Bashkëpunim Akademik të Turqisë.

Konferenca e këtij viti kishte si temë kryesore “Të Auditosh për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim” dhe në të morën pjesë rreth 160 të ftuar. Në këtë konferencë kishte përfaqësues nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Kontrolli i Lartë i shtetit, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Unioni i Dhomave të Audituesve dhe Kontabilistëve të Licencuar të Turqisë, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve, Universiteti i Lodz-it, Këshilli i Kontabilistëve të Shqipërisë, studentë, auditues, etj.

Bashkëpunimi me SAI-et partnere dhe institucione të tjera ndërkombëtare

Gjatë vitit 2017 kanë marrë pjesë në aktivitetet jashtë vendit 146 auditues ose 675 ditë/njerëz në total, thënë ndryshe pothuajse të gjithë audituesit e KLSH-së kanë qenë të paktën një herë jashtë vendit. Viti 2017 ka ruajtur trendin e suksesshëm të pjesëmarrjes së audituesve në aktivitete të ndryshme trajnuese të ofruara nga SAI-t homologe dhe institucione të tjera ndërkombëtare.

Përgjatë vitit 2017 janë zhvilluar 57 aktivitete, të tilla si Kongrese, Konferenca, Takime, seminare, trajnime, (këto të fundit edhe në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-et homologe) dhe Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënive e Jashtë ka qenë e përfshirë edhe në organizimin e 2 aktiviteteve të kryera në bashkëpunim me Institucionet Homologe dhe institucione të tjera të huaja.

Veçojmë vizitat dhe pjesëmarrjen e Kryetarit të KLSH në aktivitetet e mëposhtme, të cilat kanë pasur rëndësi të veçantë në vendosjen e partneriteteve strategjike të bashkëpunimit të KLSH-së, ndër këto aktivitete përmendim:

- pjesëmarrjen në Ceremoninë e 40 vjetorit të Deklaratës së Limës;
- pjesëmarrjen në Kongresin i X-të i EUROSAT në Stamboll;
- pjesëmarrjen në Mëngjesin e Lutjeve të Kryetarit;
- Vizita në SAI-n e Qipros;
- Vizita në SAI e Polonisë;

- Pjesëmarrjen në Konferencën e 9-të Vjetore të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës;
- Pjesëmarrjen në Simpoziumin e INTOSAI-t në Vjenë;
- Pjesëmarrjen në 40 vjetorin e krijimit të Gjykatës Europiane të Auditimit dhe në takimin e Komitetit të Kontaktit në Luksemburg;
- Pjesëmarrjen në 10 vjetorin e krijimit të SAI-t të Serbisë.

Aktiviteti i organizuar nga KLSH në bashkëpunim me SAI-e homologe dhe institucione të tjera:

KLSH gjatë vitit 2017 ka vërtetuar se ka kapacitete për të organizuar edhe aktivitete ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim tryezën e rrumbullakët mbi "Rolin e SAI-ve në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit". Kjo tryezë e rrumbullakët e zhvilluar në datat 14-16 qershor 2017 u bashkë-organizua me SIGMA-n. Aktiviteti, në të cilin morën pjesë përfaqësues nga Gjykata Europiane e Audituesve (ECA), nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) të Suedisë dhe Çekisë, nga SAI-t e rajonit, Kosova, Bosnje-Hercegovina, Turqia, Mali i Zi dhe Serbia, përcolli mesazhin e rëndësishëm se Institucionet Supreme të Auditimit janë një ndër veprimtarët kryesorë në luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Internshipi i ECA-s dhe fellowship i GAO-s

Në vitin 2017, dy auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë qenë pjesë e strukturave të ECA-s për një periudhë 5 mujore, duke përfituar nga programet e intershipit të këtij institucioni, për të kontribuar pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA-s. Internshipi është konsideruar një mjet shumë i rëndësishëm për të ofruar njohuri mbi auditimin e fondeve të BE-së, për audituesit e SAI-ve të vendeve që aspirojnë të bëhen anëtare të BE-së. Në total janë 12 auditues të KLSH-së që kanë fituar internship-et tek ECA, përfshirë dy audituese që do të fillojnë internshipin në mars 2018.

Po aq produktive për KLSH-në ka rezultuar edhe bashkëpunimi me GAO-n e SHBA-së ku gjatë vitit 2017 dy auditues të KLSH-së morën pjesë në një fellowship 4 mujor pranë kësaj zyre ndërsa gjatë 2018 dy auditues do të ndjekin këtë fellowship. Fellowshipi është hartuar për të forcuar kapacitetet e SAI-ve e për të rritur llogaridhënien dhe mirëqeverisjen.

5. IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT TË BINJAKËZIMIT GJATË VITIT 2017

Projekti i binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”, i cili nisi të implementohej në KLSH në mars të vitit 2016 ka vijuar të zbatohet në mënyrë të suksesshme edhe gjatë vitit 2017. Projekti është i ndarë në tre komponentë:

- Përmirësimi i kornizës ligjore për auditimin;
- Zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve të raportimit;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i impaktit të rezultateve të auditimit.

Gjatë këtij viti janë kryer 37 misione nga të cilat 2 i përkasin komponenti të parë, 24 misione i përkasin komponentit të dytë dhe 11 misione që i përkasin implementimit të komponentit të tretë.

Pas zhvillimit të suksesshëm të misioneve, në të cilat ekspertët polakë, kroatë dhe holandezë kanë bashkëpunuar ngushtë me drejtues dhe auditues të KLSH-së, u draftuan disa dokumente që kanë të bëjnë me veprimtarinë audituese, të cilat do të jenë objekt i rishqyrtimit përshtatjes dhe me pas i miratimit në funksion të implementimit të tyre.

Në përfundim të 37 misioneve ekspertët kanë dhënë mbi 80 rekomandime.

Lidhur me rekomandimet e dhëna nga ekspertët polakë, kroatë dhe holandezë me Vendimin e Kryetarit nr. 83, dt. 30.06.2017 është miratuar Plani i Veprimit i Zbatimit të Rekomandimeve të projektit IPA, për periudhën mars 2016-shkurt 2017, duke përcaktuar strukturat përgjegjëse dhe afatet për implementimin e rekomandimeve.

Strukturat respektive të përcaktuara në këtë plan veprimi janë në proces zbatimi të rekomandimeve të adresuara nga ekspertët polakë.

Në kuadër të projektit janë zhvilluar 6 misione trajnuese me një total prej 21 ditësh trajnim, të cilat lidhen me të gjitha etapat në të cilat kalojnë auditimet financiare dhe të përputhshmërisë, trajnime për krijimin e hepldesk-ut, të moduleve të auditimit IT për audituesit dhe çështjet e komunikimit.

Gjithashtu gjatë këtij viti janë zhvilluar dhe 2 vizita studimore, në të cilat audituesit e KLSH kishin mundësi të përfitonin eksperiencë nga koleget polakë dhe kroatë për çështjet e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, në vizita studimore 5 ditore, në të cilat kanë marrë pjesë 31 drejtues dhe auditues të KLSH-së.

Në misionet e zhvilluara në periudhën janar-dhjetor 2017 kanë marrë pjesë 98 drejtues dhe auditues të KLSH-së me përkatësisht 893 ditë/njerëz ose mesatarisht me një përfshirje individuale prej 9 ditësh.

Projekti i binjakëzimit është monitoruar nga strukturat e Komisionit Europian, në përfundim të të cilit projekti u vlerësua pozitivisht, duke vlerësuar relevancën e produkteve të projektit, në funksion të ngritjes së kapaciteteve institucionale të KLSH dhe forcimin e auditimit të jashtëm publik në Shqipëri.

6. MBI VLERESIMIN E VEPRIMTARISE SE MENAXHIMIT INSTITUCIONAL PËR VITIN 2017 NËPËRMJET INSTRUMENTIT TE KORNIZËS SË MATJES SË PERFORMANCËS (KMP)

KLSH në vijimësi ka synuar konsolidimin e një qeverisje efektive institucionale, nëpërmjet aplikimit dhe përdorimit të instrumenteve menaxheriale sikurse është instrumenti vetëvlerësues Korniza e Matjes së Performancës së SAI (PMF) e miratuar në Kongresin e Abu-Dhabi në Dhjetor të vitit 2016.

KONKLUZION:

Për vitin 2017 vlerësimi sipas Kornizës së Matjes së Performancës (PMF Instrument) të fushave që kanë të bëjnë me Menaxhimin Institucional, si:

- i) Qeverisja e brendshme dhe Etika;
- ii) Zhvillimi nëpërmjet planifikimit strategjik;
- iii) Burimet Njerezore e Trajnimi;
- iv) Komunikimi dhe menaxhimi me palet e treta;
- v) Menaxhimi financiar administrativ mbështës,

rezulton i realizuar në nivele maksimale apo të kënaqshme (nivelet 3-4), duke përbushur në këtë mënyrë indikatorët dhe kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, në fushat respektive.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE

Nga znj. Lindita LATI, Drejtor i Përgjithshëm



Departamenti i Institucioneve Qendore, si pjesë përbërëse e strukturës së KLSH-së, ka realizuar veprimtarinë për vitin 2017 në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullativ të institucionit, standardet ndërkombëtare të auditimit, manualët e auditimit financiarë dhe të përputhshmërisë, e Kodin e Etikës me përgjegjshmëri, transparencë dhe integritet profesional dhe personal.


Veprimtaria përgjatë edhe 2017 ka qenë gjithëpërfshirëse dhe në disa dimensioneve duke

kontribuar si pjesë organike e strukturore, në matricën dimensionale të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.


▪ VEPRIMTARIA AUDITUESE

Për vitin 2017 kanë përfunduar dhe janë evaduar:

- **26** auditime kundrejt 25 të planifikuara, nga të cilat: 8 auditime janë kryer për rregullshmërie (përfshirë rregullshmërinë financiare) të aktivitetit ekonomik e financiar të subjekteve,
 - **9** auditime janë kryer për përputhshmërinë,
 - **6** auditimi kanë qenë financiarë (*me opinion për pasqyrat financiare*) dhe
 - janë kryer **3** auditime tematike.



Nga aktiviteti auditues, gjatë vitit 2017 janë adresuar gjithsej **593** rekomandime, struktura tipologjike e të cilave është paraqitur edhe në grafikun:



Masa zhdëmtimi janë rekomanduar në vlerën 1.4 miliard lekë (1,407,190 mijë lekë), nga e cila pa mundësi arkëtimi janë në vlerën 1 miliard lekë (1,094, 509 mijë lekë).

Janë kryer 3 kallëzime penale për 12 persona dhe 2 indicie adresuar institucioneve ligjzbatuese.


Dëmi ekonomik

Nga auditimet e realizuara gjatë vitit 2017, vetëm për Institucionet Qendrore niveli i *dëmit ekonomik*, në formën e të ardhurave të munguara apo shpenzimeve, të cilat janë kryer në kushtet e parregullsisve ligjore, duke shkaktuar inefficiencë në përdorimin e parasë së taksapagesve, llogaritet në masën **1,407,190 mijë lekë**. Nga e cila është kërkuar arkëtimi për **312,681 mijë lekë**.

Struktura e dëmit ekonomik paraqitet:

- në fushën e prokurimeve publike në vlerën 762,803 mijë lekë (54%), nga të cilat vlera prej 513,180 mijë lekë janë në zbatimin e kontratave (është kërkuar rikuperimi për vlerën 452,803 mijë lekë),
- vlera e të ardhurave të munguara është 128,464 mijë lekë, kryesisht nga mos administrimi i pronave të dhëna me qira, koncesione, PPP, dhe inefficenca në arkëtimin e gjobave,
- në fushën e pagave në vlerën 54,172 mijë lekë,
- shpenzimet operative në vlerën 8,957 mijë lekë, dhe

- 452,794 mijë lekë, janë shpenzimet e tjera të realizuara në kushte të parregullsive ligjore.



Në auditimet e kryera dhe të evaduar, në disa subjekte janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me disiplinën financiare dhe buxhetore për shpenzimin pa efektivitet në vlerën totale **22,985,881 mijë lekë**, ku **19,734,800** mijë lekë ose 86% e zënë shpenzimet pa efektivitet të konstatuara në AKBN në fushën e hidrokarbureve për vitet 2014, 2015.

Prokurimet publike

Në auditimet e realizuara për vitin 2017 konstatohet se, në 13 subjekte janë realizuar **402** procedura prokurimi me fondin e përlogaritur në vlerën **2,816 milion lekë**, nga të cilat janë audituar procedura prokurimi në vlerën 2,013 milion lekë, ose 71% e vlerës gjithsej të prokuruar. Janë konstatuar shkelje procedura prokurimi me vlerën 1,956 milionë lekë ose në 97% të vlerës së procedurave të audituara, rezultat që tregon se fondet janë shpenzuar jo në përputhje të plotë me kërkesat ligjore.

Shkeljet ligjore, gjithsej **550**, të cilat çojnë jo vetëm në deformim të konkurrencës së operatorëve në treg por njëkohësisht nuk garantojnë vlerë për fondet e shpenzuara, janë në drejtimet e mëposhtme:

a. Në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit janë konstatuar **415** shkelje ose 75%:

- Në mos argumentimin e vlerës së përlogaritur të kontratave 135 shkelje;
- Në zbatim të përgjegjësive të autoritetit kontraktor 46 shkelje;
- Në përcaktimin e kriterëve të përgjithshme 34 shkelje;

- Në përcaktimin e kriterëve të veçanta 98 shkelje;
- Në përcaktimin specifikimeve teknike 102 shkelje.

b. Në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimeve janë konstatuar **66** shkelje ose 12%:

- Në plotësimin e kriterëve të kualifikimit 26 shkelje;
- Në skualifikimet e ofertuesve 13 shkelje;
- Në hapjen e shqyrtimin e ofertave 11 shkelje;
- Në ofertat anomalisht të ulta 3 shkelje;
- Në lidhjen e akt marrëveshjeve bashkëpunimi 1 shkelje;
- Në respektimin e afateve kohore në zbatimin e procedurave dhe ankesave **12** shkelje;

c. Në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve, arkivimi dosjes, **69** shkelje ose 13%:

- Zbatimi dhe lidhja e kontratës 18 shkelje;
- Akt marrje dorëzim 13 shkelje;
- Në kryerje punimesh 10 shkelje;
- Inventarizimi i dosjes 28 shkelje.

Shkeljet në prokurime



Konkluzioni i misioneve audituese në zbatim të standardeve me opinion

Për periudhën janar-dhjetor 2017 janë evaduar **6 auditime financiare**, ku janë dhënë opinionet për pasqyrat financiare, në zbatim të standardeve të auditimit financiar ISSAI 1700, ISSAI 1200, për të cilat kemi dhënë opinione *të pakualifikuar*. Ndër problematikat e konstatuara nga auditimi i pasqyrave financiare përmendim ato që lidhen me:

- mos zbatimin e parimit të kontabilitetit rrjedhës;
- moskryerjen e inventarizimit periodik dhe mos rakordimit të vlerës fizike me atë kontabël;
- mungesat e vazhdueshme në relacionet shpjegues të zërave materiale në kundërshtim me kërkesat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 1 “*Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare*” dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS 1, paragrafi 128;
- mos llogaritja e saktë e amortizimit e cila mbart risk potencial që mund të shfaqet në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktivitetit, apo të nevojave të tjera si psh ato për riparim, etj.

Për sa më sipër edhe pse nuk paraqesin gabime materiale kemi kërkuar marrjen e masave për sistemin, në funksion të paraqitjes së një pamjeje të drejtë të zërave në pasqyrat financiare dhe risqeve që këto zëra mund të mbartin në procesin e vendimmarrjes.

Në zbatim të standardeve të auditimit të përputhshmërisë ISSAI 4100, 4200 kemi dhënë: **9 opinione përputhshmërie** nga të cilat 4 opinione *të pakualifikuar*; si dhe 5 opinione *të kualifikuar*.

Problematika të konstatuara përgjatë auditimeve të përputhshmërisë përmendim: devijime materiale në ndryshime programimi nga faza në fazë e kostos për njësi pa një justifikim të arsyeshëm;

- procedura prokurimi të realizuara jo në përputhje të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik, që cenon realizimin e qëllimit të rritjes së ekonomicitetit dhe transparencës në përdorimin e fondeve publike;
- mos koordinimi institucional dhe mosadministrimi i dokumentacionit të plotë (në rastin e MZHETTS dhe strukturat e saj vartëse) ka sjellë moskryerjen në mënyrën

e duhur të monitorimit, raportimit dhe marrjes së masave me qëllim përmirësimin e gjendjes për koncesionet e dhëna ndër vite;

- rishpërndarje fondesh të pa argumentuara duke mos pasur analiza specifike të detajimit;
- mungesa të gjurmëve për llogaritjen e fondit limit, ndryshimi nga loti në lot dhe pse objekti i tenderimit është i njëjtë, etj.

çështje të cilat në përfundim rrisin sigurinë e arsyeshme të audituesit publik që informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë në disa raste nuk është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi duke nxitur kështu nevojën për dhënien e rekomandimeve të vazhdueshme nga ana jonë, në secilën prej fushave të sipërpërmendura.

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në periudhën e 3-mujorit të fundit të vitit 2016 dhe 6 - mujin e parë të vitit 2017

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë vitit 2016 dhe 2017, rezultoi se në **7** subjekte të audituar, janë rekomanduar gjithsej **256** masa, nga të cilat janë pranuar **254** masa - **2** masa nuk janë pranuar.

Konstatuam se nga **254** masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht **94** prej tyre ose 37%, pjesërisht **9** masa ose 4%, dhe konsiderohen në proces zbatimi **88** masa ose 35%, dhe pa zbatuar **63** masa, të cilat përfaqësojnë 25%.

Në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja "j", të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", të **7** subjektet e audituara kanë kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara.

Gjithashtu konstatohet se, 5 (pesë) subjekte nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujin në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", konkretisht: (Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore).

Ndërhyrjet me impakt nga auditimet e vitit 2017

Misioni i funksionimit të departamentit të institucioneve qendrore, si pjesë përbërëse e institucionit suprem të auditimit në Shqipëri, është që bazuar në ekspertizën profesionale të audituesve të identifikojë nivelin e përgjegjshmërisë së ekzekutivit për përdorimin e fondeve publike, të informojë qytetarin dhe Kuvendin mbi qeverisjen e fondeve publike si dhe të kontribuojë në përmirësimin e situatës për një mirë qeverisje të parasë së taksapaguesve me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet. Në vijim paraqiten gjetjet kryesore me impakt të identifikuara dhe të adresuara institucioneve qendrore, sipas grupimeve sektoriale.

1 Në sektorin e investimeve publike në institucionet qendrore

- Në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), është identifikuar krijimi **i detyrimeve të prapambetura**, të cilat nuk janë shoqëruar me një analizë të shkaqeve të pagesave të vonuara. Pra, nuk është respektuar disiplina buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake dhe rritjen e eficiencës së shpenzimeve nga ana e titullarëve, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues. Për këtë arsye, i është rekomanduar Ministrisë së Financave, e cila monitoron detyrimet financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë, të kërkojë nga MTI dhe institucionet e vartësisë një analizë të shkaqeve të pagesave të vonuara, të përcaktojë përgjegjësinë dhe vendosë masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nuk ka përditësuar çdo vit, **analizat teknike të çmimeve**, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me qëllim që kjo e fundit të verë në dispozicion çmimet e "investiguara", në bazë të kërkesës së bërë nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, brenda afateve të përcaktuara ligjorë, duke përdorur gjithë masat shtrënguese që parashikon ligji, me qëllim jo vetëm sigurimin cilësor të *"çmimeve mesatarë ..."* por edhe brenda afateve kohorë ligjorë për vitin 2017.

- Në praktikën e Autoritetit Rrugor Shqiptar, në vazhdimësi, konstatohet se nisen punime për vepra, rrugë të reja, në **mungesë** të plotë të **fondeve** për realizimin/përfundimin e tyre. ARRSH ka lidhur kontrata dhe ka kryer/pranuar kolaudimin e punimeve, për disa nga zërat e punimeve të parashikuara në preventivin përfundimtar të objektit, ndërkohë që veprat/rrugët, nuk janë përfunduar. Në mungesë të fondeve për përfundimin e punimeve, **objektet e "kolauduara", por të pa përfunduara**, braktisen duke shkaktuar dëme ekonomike

të parikuperueshme në zërat e punimeve për shtresat rrugore, duke rriskuar njëkohësisht sigurinë rrugore.

Autoriteti Rrugor Shqiptar në vërtetimet që lëshon për operatorët ekonomikë nuk saktëson nëse në momentin e lëshimit të tyre zbatohet kushti i plotësimit të punimeve në masën 70 për qind, në përputhje me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

2. Në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale

Ministria e Shëndetësisë, programimin e nevojave për medikamente për trajtim spitalor nuk e shoqëronte me Bilancin Material të çdo qendre spitalore. Procesi i programimit të nevojave për vitin pasardhës nga ky institucion detyrimisht duhet të hartohet bazuar në "*Bilancin Material*", i cili duhet të përgatitet nga njësitë vartëse, ku evidentohet gjendja e medikamenteve, të klasifikuara sipas medikamenteve gjendje, të papërdorura apo që u afron data e kadencës. Qëllimi është njohja e gjendjes dhe marrja e masave për rishpërndarjen e medikamenteve për përdorim në spitale të tjera.

Në Ministrinë e Shëndetësisë pagesat e situacioneve pjesore, nuk shoqërohen me librezat masash pjesore, dhe nuk kryen matje dhe verifikime faktike pjesore, që të vërtetojnë përputhjen e volumeve faktike të kryera në objekt me ato të situacionuara.

3. Në sektorin e hidrokarbureve, industrisë dhe energjisë

- **Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore** është ent publik që financohet nga buxheti i shtetit dhe projekte të tjera, por konstatojmë se kjo agjenci është jashtë kontrollit buxhetor pasi nuk kryen veprime përmes llogarive të thesarit të shtetit, si dhe nuk dorëzon pasqyrat financiare sipas rregullave të enteve publike në thesar. Faktikisht ajo vijon të funksionojë si një shoqëri tregtare me kapital shtetëror. Në këto kushte, fondet e përdorura nga AKBN, janë bërë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*". Vendosja e këtij institucionin nën regjimin buxhetor do të sigurojë edhe një nivel të shtuar kontrolli mbi mënyrën e sigurimit të të ardhurave për funksionimin e institucionit.

Konstatohet se në Ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "*Për taksat kombëtare*" nuk ka referencë për mbulimin e humbjeve të mbartuara fiskale, ndërkohë që mungon ose më saktë nuk shprehet nëse gjejnë zbatim kërkesat e Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", siç është shprehur për referencën ligjore të taksës

kombëtare (për rentën minerale). Për këtë Komisioni i Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, të vlerësojnë nevojën për plotësim apo amendim të Ligjit “Mbi sistemin fiskal në sektorin e Hidrokarbureve”, me aspektet e munguara, kryesisht saktësimin e faktit që kostot hidrokarbure mbarten për efekte të ndarjes së prodhimit, ndërsa fitimi fiskal është rezultati financiar pozitiv në një vit fiskal.

AKBN në kundërshtim me këtë kërkesë të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur gjoba duke mos iu referuar tremujorit përkatës nga data e lëshimit të lejes nga QKL (sot QKB) por duke iu referuar tremujorëve të ndarë sipas vitit kalendarik në zbatim të Urdhrave të Ministrit nr. 201, datë 20.6.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet” dhe nr. 202, datë 20.6.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve ndërtimore”. Është kërkuar të bëhet përshtatja e urdhrave të ministrit me ligjin në fuqi.

- **Ministria e Energjisë dhe Industrisë** në të gjitha rastet e procedurave të konkurrimit për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, është bërë në tejkalim të afatit të përcaktuar me VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kritereve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, ku cilësohet: “Afati maksimal i vlerësimit të ofertave është 30 ditë nga data e publikimit të ftesës për ofertë dhe mund të shtyhet për raste të veçanta, të argumentuara jo më shumë se 10 ditë”. Nga KLSH është kërkuar përmirësimi i ligjor.

Të gjitha ndërmarrjet dhe shoqëritë që MEI ka në administrim, pronësi ose jo, që kanë ushtruar veprimtari në industrinë jo ushqimore rezultojnë me humbje të akumuluar dhe prej vitesh nuk ushtrojnë aktivitet tregtar. Ministria e Energjisë dhe Industrisë duhet të marri iniciativën për përgatitjen dhe hartimin e akteve ligjore e nën ligjore me qëllim, përshpejtimin e procedurave të likuidimit, mbylljes apo të privatizimit, të gjithë ndërmarrjeve dhe shoqërive që janë pa aktivitet prodhimi.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë me cilësinë e Autoritetit Kontraktor në disa raste, përpara lidhjes së kontratës së koncesionit me operatorët ekonomik fitues, nuk ka kërkuar dokumentin e pagesës së tarifës, për Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), e cila kryen shërbimin e asistimit të autoriteteve

kontraktore, gjatë përgatitjes, vlerësimit dhe negocimit të koncesioneve, partneriteteve publike private. MEI duhet të përgatisë e dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimin për organizimin e funksionimin e ATRAKO-s.

Sipas VKM nr. 822, datë 07.10.2015, ndërtimi i hidrocentraleve, me kapacitet deri në 2 MW bëhet me miratim të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë por nuk përcaktohet nëse, MEI duhet të krijojë, një regjistër “Data Base”, ku të evidentohen dhe të hidhen të gjitha ekstremet e aplikimit, mos mbajtja e këtij regjistri, lejon dhe krijon hapësira për refuzime të pa arsyeshme të aplikantëve të paraqitur të parët në kohë, si dhe e bënë jo transparente procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve. Nga ana jonë është rekomanduar hartimi i një regjistër “Data Base” ku të evidentohen dhe të hidhen të gjitha të dhënat e përditësuara, deri në përfundimin e ndërtimit dhe futjes në punë të hidrocentraleve nën 2 MW.

Në disa procedura janë konstatuar shkelje të rregullave të Prokurimit Publik si në procedurën “Rehabilitimi i zonës të ish Metalurgjikut Elbasan”, nuk ka informacion për argumentimin e punimeve që parashikohen të kryhen për këto objekte, si: nuk ka studim paraprak, detyrë projektimi apo preventiv paraprak punimesh. Në DT janë vendosur dhe kërkuar disa kritere të veçanta haptas diskriminuese të cilat nuk kanë lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës që do prokurohet, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe, kanë penguar dhe kufizuar ndjeshëm konkurrencën e kësaj procedure.

Gjatë zbatimit të punimeve për rehabilitimin i zonës industriale të “Kombinatit Energjetik” me vlerë kontrate 49,257,650 lekë, është vepruar në kundërshtim me rregullat e Prokurimit Publik dhe rregullat e Kontrollit dhe Disiplinimit të Punimeve të Ndërtimit sepse, preventivi i punimeve ka ndryshuar ndjeshëm në ulje dhe rritje të volumeve pa ndryshuar çmimet e ofertës dhe vlerën e kontratës dhe pa shtuar zëra të rinj në preventiv.

4. Në sektorin e arsimit, kërkimin shkencor dhe kulturës

Nga ana e strukturave të AMA janë kryer kontrole/inspektime për zbatimin e ligjit nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të ligjit dhe janë vendosur sanksione për rastet e shkeljeve. Subjektet të cilat janë ndëshkuar për shkeljet e konstatuara nga grupet e inspektimit kanë ushtruar të drejtën e ankimimit për sanksionin e vendosur. Në përfundim të procesit të ankimimit AMA është shprehur për shfuqizimin e sanksionit me gjobë në masën 63.9% të numrit të përgjithshëm të sanksioneve të aplikuara dhe në masën 60.4% të vlerës totale të gjobave të vendosura. Gjatë auditimi u vërejt gjithashtu se në rregulloren e AMA-s nuk kritere

të cilat të përcaktonin mënyrën dhe arsyet e faljes së gjobave të vëna ndaj shkelësve të Ligjit 97/2013. AMA të marrë masat të menjëhershme për të ndryshuar Rregulloren e Autoritetit të Mediave Audioviziveduke parashikuar mënyrën dhe kriteret që bëjnë të mundur shfuqizimin e sanksioneve (gjobave) të vëna ndaj subjekteve shkelës të ligjit të mediave audiovizive.

Në **Universitetin Politeknik Tiranë** u konstatuan mangësi në plotësimin e kuadrit ligjor, pas daljes së Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, pasi ndonëse kanë kaluar mbi 2 vjet nga miratimi i këtij ligji Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, nuk kanë hartuar dhe miratuar një pjesë të rëndësishme të akteve nënligjore (VKM dhe Udhëzime) si derivate të ligjit të mësipërm, duke krijuar një ngërç në funksionimin e institucionit, në aspektin organizativ.

Është kërkuar nga Ministria Arsimit Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim dhe koordinim me Universitet Publike, në mënyrë të përsheptuar, të marrin masa për shfuqizimin e akteve nënligjore, të cilat kanë buruar nga ligji i mëparshëm, të hartojnë dhe miratojnë kornizën ligjore të cilat, bëjnë të mundur garantimin dhe funksionimin e Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH”*, në përmbushje të qëllimit të tij, të lirisë akademike dhe autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë.

Në **Ministrinë e Arsimit** sistemet e kontrollit të brendshëm janë pjesërisht efektive, kjo në drejtim të sigurimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të pagesave që lidhen me lëvizjen në llogaritë respektive, në vendosjen e kriterëve kualifikues sa i takon përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, në procedura prokurimi të cilat përbëjnë diskriminim mes kontraktorëve/furnitorëve; mungesa në dosjet e prokurimit të dokumentacionit ligjor e teknik, duke mos vërtetuar sipas standardeve cilësinë e punimeve dhe materialeve të përdorura.

Autoriteti Kontraktor ka përdorur kriterë që nuk mundësojnë rritjen e pjesëmarrësve në konkurrim dhe eficiencës në mirë përdorimin e fondeve publike pasi kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, duke cënuar parimin e mosdiskriminimit, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar dhe VKM nr. 914 ,datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

5. Prokurimet publike të përqendruara

- Nga auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Prokurimeve, i disa procedurave të prokurimit, në seancën publike të hapjes së ofertave në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) konstatohet se, **operatorët nuk publikojnë ofertën ekonomike** ose dokumentacionin ligjor/teknik të kërkuar. Për rrjedhojë sigurohet konkurrenca numerike në fazën publike të hapjes së ofertave, por jo konkurrenca në përzgjedhjen e ofertës. Kjo mënyrë konkurrimi i hap rrugën për kualifikim dhe shpall fitues, operatorin e mbetur në garë (*pa u futur në proces konkurrimi*) si e vetmja alternativë, duke lënë shteg për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë, fenomen për të cilin AK (OQB) duhet të sinjalizojë Autoritetin e Konkurrencës si organ kompetent i hetimit të sjelljes anti konkurruese të operatorëve ekonomikë. Për pasojë, mos publikimi nga operatorët ekonomikë të ofertës ekonomike apo i dokumentacionit të tenderit në SPE, mund të kufizojnë konkurrencën e drejtë dhe efektive, duke mos nxitur dhe inkurajuar biznesin e vogël dhe të mesëm.

Për këtë është rekomanduar ti kërkuar Agjencisë së Prokurimit Publik, përmirësime duke i paraqitur Këshillit të Ministrave propozime për rregullat e prokurimit publik, për përmirësime në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" me ndryshime, neni 73.

- Gjithashtu ka rezultuar se disa Autoritete Kontraktore (AK), i kanë paraqitur me vonesë të dhënat teknike, sasiore dhe fondin përkatës në tejkalim të afatit të përcaktuar në VKM nr. 28, datë 14.01.2015, pika 3 (*brenda datës 31 janar*). Vonesat kanë shkaktuar vështirësi në zhvillimin e procedurave dhe realizimin e tyre në kohën e duhur. Për të shmangur vonesat e shkaktuara është kërkuar përmirësimi ligjor i VKM nr. 28, datë 14.01.2015.

- Nga auditimi mbi llogaritjen e fondit limit konstatohet se nga DPP nuk ka asnjë gjurmë që tregon se është bërë verifikimi mbi angazhimin e fondeve buxhetore në dispozicion të AK-ve sipas përcaktimeve të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" me ndryshime, Kapitulli "*Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike*", pika 140 dhe 142, minimumi të kërkojë nga AK-të shkresat zyrtare të çeljes së fondeve.

- Shkresat e dërguara nga Autoritet Kontraktore për fondin limit në dispozicion të tyre në shumicën e rasteve nuk kanë bashkangjitur dokumentet për llogaritjen e tij dhe për pasojë nuk ka dhe gjurmë të verifikimit të këtyre fondeve nga ana e DPP.

- DPP, nuk disponon një regjistër të të dhënave, i cili duhet të përmbajë të dhënat mbi fondin limit sipas loteve, fondin limit të prokuruar, operatorin ekonomik fitues etj. në mënyrë që të publikohet në faqen zyrtare të APP-së për të mundësuar transparencën dhe verifikimin e tyre, mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe fondeve në dispozicion.
- Nga auditimi i DT për procedurën *“Shërbim cateringu”* ka rezultuar se në disa raste nga OQB, nuk janë përfshirë disa kërkesa të rëndësishme të paraqitura nga AK, si: nuk ka të përcaktuar si klauzolë dokumentet (*kontratën e qirasë mes operatorit ekonomik fitues dhe AK*) që duhet të paraqesë operatori ekonomik në rastet kur Autoriteti Kontraktor kërkon që gatimi, përgatitja, shpërndarja dhe servirja e ushqimeve do të bëhet detyrimisht në ambientet (kuzhinën/mensën e repartit) e tij të cilat janë detyruese. Vendosja e një kriteri të tillë është e detyrueshme pasi lidhet me kërkesat e paraqitura nga Autoritet Kontraktore, sidomos nga reparte ushtarake; për personelin e kuzhinës dhe konkretisht për punonjësit me profesione: kuzhinier, mercolog/kimist/teknolog, ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, nuk është kërkuar që të paraqesin librezën shëndetësore nga Inspektorati Sanitar Shtetëror.

6. Në sektorin e prokurimeve publike

- Nga auditimi në **Agjencinë e Prokurimit Publik** është evidentuar fakti se autoritet kontraktore, gjatë realizimit të procedurave me *“Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”*, kanë kryer procedura *“fiktive”*, duke ju referuar afateve kohore të kryerjes së tyre, apo plotësimit të dokumenteve të tenderit. Gjithashtu, referuar dhe faktit që edhe për procedurat me *“Negocim pa shpallje paraprake”* në rastet e nevojave ekstreme, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 55, germës “c”, përcaktohet se: *“...Në rast emergjence, autoriteti kontraktor do të marrë njëkohësisht të gjitha masat për kryerjen e procedurave normale të prokurimit”*, lind nevoja e përcaktimit të kufijve minimalë të domosdoshëm për realizimin e këtyre procedurave.
- Procesi i negocimit në LPP trajtohet vetëm për *“Procedurën negocim me shpallje paraprake të njoftimit”*, neni 32, pika 3, 4 dhe 5, ndërsa në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”*, pika 7 trajtohet negocimi për të dy rastet e negocimit të parashikuara në nenin 32 dhe 33 të LPP-së. Në nenin 33 *“Procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit”* të bëhet ndryshimi ku të përcaktohet, nëse autoritetet kontraktore, duhet të negociojnë ofertat e paraqitura apo çmimin e kontratës për rastet e parashikuara në këtë nen, apo jo.

- Nga auditimi është evidentuar që APP, nuk ka asnjë informacion mbi zbatimin e masave administrative, apo disiplinore të vendosura dhe propozuara prej saj. Administrimi i të dhënave mbi nivelin e zbatueshmërisë së vendimeve të saj është një indikator i matshëm rreth efektivitetit të vendimmarrjeve dhe për këtë është kërkuar shtimi i përgjegjësisë së AK duke e detyruar për të dërguar informacionin e nevojshëm mbi zbatimin e masave administrative e disiplinore duke kërkuar ndryshime në nenin 72.

- Nga auditimi është evidentuar se, në nenin 49 pika 1, janë përjashtuar nga kërkesa për paraqitjen e sigurimit të ofertës, procedurat e prokurimit me vlera nën kufirin e lartë monetare, gjë e cila nën gjykimin e KLSH-së, ndikon në tërheqjen e ofertuesve pas klasifikimit të ofertave, duke favorizuar ofertues të caktuar e duke çuar deri në dështimin e procedurave. Është rekomanduar ndryshimin në nenin 49 "*Sigurimi i ofertës*".

Për konstatimet e mësipërme janë rekomanduar ndryshimet e mundshme ligjore në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", në nenet 33, 43, 49, 72.

- Nga auditimi ka rezultuar se në nenin 56 "*Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar*", janë përcaktuar kufizimet e titullarit të AK, të cilat duhet të vinë në harmoni me përcaktimet e bëra në nenin 68 "*Raporti përmbledhës*" ku përcaktohet vetëm detyrimin e KVO-së për dërgim për miratim të raportit përmbledhës dhe nuk shprehet për detyrim të Titullarit të autoritetit kontraktor për pranimit të tij tërësisht, pjesërisht, apo kundërshtim; në nenin 58 "*Komisioni i vlerësimit të ofertave*" nuk shprehet nëse ky vendim është i ndryshueshëm nga titullari i autoritetit kontraktor apo jo. Është rekomanduar ndryshimi në nenin 56 "*Titullari i Autoritetit Kontraktor ose zyrtari i autorizuar*".

- Në nenin 74 "*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*", pikën 3, referenca ligjore nuk është e saktë. Neni 45 "*Kriteret e skualifikimit të kandidatëve ose ofertuesve*" LPP-së, shprehet për rastet e s'kualifikimit të operatorëve ekonomikë nga procedura e prokurimit, ndërsa përse ju përket kriterëve kualifikuese, ato janë të përcaktuara në nenin 46 të LPP-së. Është rekomanduar ndryshimi në nenin 74.

- Nga auditimi është evidentuar se referimi në çmimet e tregut, si një nga mënyrat e përcaktimit të vlerës limit të kontratës, nuk është i përcaktuar qartë në nenin 59, pika 2. Në VKM, duhet të shprehet qartë nëse merret për bazë oferta më vlerën më të ulët, apo vlera mesatare e ofertave të paraqitura. Meqenëse përdorimi i mesatares neutralizon edhe ekstremitetet (+/-), si dhe për faktin që vlera limit e

kontratës përbën nivelin më të lartë të lejuar, gjykojmë se përdorimi i mesatares së ofertave të paraqitura është më i drejtë. Gjithashtu, për të arritur në një vlerë limit të kontratës, sa më reale gjykojmë se është e nevojshme që autoritet kontraktore të mbështeten në dy ose më shumë alternativa në përlllogaritjen e saj.

- Referuar rregullave të prokurimit publik, neni 57 *“Njësia e prokurimit”* njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, prandaj për këtë arsye *“Njoftimi i kontratës”* si një dokument i prokurimit i hartuar nga njësia e prokurimit, pavarësisht se nënshkruhet nga Titullari i autoritetit kontraktor, duhet të nënshkruhet edhe nga njësia e prokurimit.

- Nga auditimi është evidentuar se, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, në nenin 77 *“Mbikëqyrja e kontratës”* në pikat 5 dhe 6 për *zbatimin e kontratës për furnizimin me karburant* nuk është përcaktuar se sa është ndryshimi i dukshëm (+/-) në përqindje kundrejt çmimit të kontratës dhe se cili është momenti kundrejt të cilit duhet të krahasohet çmimi i kontratës për të përlllogaritur këtë diferencë. Çmimi i kontratës kundrejt çmimit sipas Reuters në momentin e shitjes (*faturimit të mallit*), apo çmimi i kontratës kundrejt çmimit sipas Reuters në momentin e zhdoganimit të mallit sipas SAD (*Dokumenti i vetëm administrative*). Është rekomanduar ndryshimi në nenin 77.

- Nga auditimi është evidentuar fakti se përcaktimi në nenin 15 të VKM-së *“Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”*, pjesa ku shprehet për kandidatët apo ofertuesit e huaj, krijon pabarazi dhe diskriminim ndaj operatorëve ekonomikë vendas. Është rekomanduar ndryshimi në nenin 15.

- Nga auditimi është evidentuar se në nenin 66 *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”* pika 4, paragrafi I, nuk del qartë fakti se cili është kufiri i lejueshëm i gabimeve materiale, për të cilat autoritetet kontraktore e pranojnë një ofertë si të vlefshme.

- Nga auditimi është evidentuar se në nenin 18 *“Sigurimi i ofertës”*, në pikën 1, janë përjashtuar nga kërkesa për paraqitjen e sigurimit të ofertës, procedurat e prokurimit me vlera nën kufirin e lartë monetare, gjë e cila nën gjykimin e KLSH-së, ndikon në tërheqjen e ofertuesve pas klasifikimit të ofertave, duke favorizuar ofertues të caktuar e duke çuar deri në dështimin e procedurave.

Për konstatimet e mësipërme janë rekomanduar ndryshimet e mundshme ligjore në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* në nenet 18, 56, 68, 58, 59, 61, 66 dhe 77.

- Nga auditimi në **Komisionin e Prokurimit Publik** të dosjeve mbi ankimet e operatorëve ekonomikë të paraqitura pranë KPP-së, u konstatua se nuk është krijuar arkivi elektronik për të gjithë dokumentacionin për çdo ankimim, në përputhje me rregullat mbi arkivat, në zbatim të nenit 32 të VKM nr. 184, datë 17.3.2010 *“Për miratimin e për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 659, datë 3.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike”.* Është rekomanduar krijimi i arkivit elektronik të dosjeve për çdo ankimim, me qëllim sigurimin e transparencës në procesin e administrimit të dosjeve.

- Komisioni i Prokurimit Publik me vendimet përkatëse me nr.515, datë 31.7.2016, nr.516, datë 31.7.2016, nr. 43, datë 22.01.2016, nr. 302 datë 6.5.2016, nr. 112, datë 3.3.2016, nr. 531, datë 13.07.2016, nr. 84 datë 19.2.2016 që kanë të bëjnë me procedurat e tenderave të ankimuar ka skualifikuar dhe kualifikuar operatorë ekonomikë ankimes ose jo padrejtësisht me pasojë krijimin e dëmit ekonomik për buxhetin e shtetit me vlerë 248,868,263 lekë gjithsej.

Një **qasje alternative** e aplikuar përgjatë analizës së Departamentit konsiston tek Modeli i kontrollit të brendshëm COSO, i cili u përdorë për klasifikimin e gjetjeve të auditimit sipas sipas 3 shtyllave kryesore:

1. Impakti që kanë anomali të hartimit të kontrolleve të brendshme, në përdorimin e fondeve publike, të cilat ndahen në dy nënkategori: (1) impakti i mungesës së hartimit të kontrollit të brendshëm; dhe (2) mpakti kur kontrolli ekzitet nuk është hartuar siç duhet¹¹,

2. Impakti që kanë anomali të përgjatë implementimit të kontrolleve të brendshme, si edhe

3. Impakti që kanë anomali të përgjatë vlerësimit mbi fuksionimin e kontrolleve të brendshme, në gjetjet tona.

Nën këtë këndvështrim, pjesëmarrësit u prezantuan me një seri gjetjesh dhe rekomandimesh si:

¹¹duke bërë që edhe pse kontrolli funksionon sikundër është dizenuar, ai nuk mund të realizojë objektivat.

A. Gjetjet sipas anomalive të konstatuara përgjatë hartimit të kontrolleve të brendshme u grupuan përsëri spas standardeve të kontrollit të brendshëm si më poshtë:

Kuadri COSO parimi 12 – *Aktivitetet e Kontrollit*¹²– Ka munguar dizenjimi i aktiviteve të kontrollit për të rritur efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

- Nga auditimi në MZHETTS, u konstatua se në Agjencinë e Trajtit të Koncesioneve (ATRAKO), *për zbatimin e ligjshmërisë në evidentimin e koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat*, konstatohet se, deri më tani nga Këshilli i Ministrave nuk është hartuar e miratuar një dokument strategjik politikash për përcaktimin e sektorëve parësor për investime¹²;

- Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për arkëtimin e tarifës koncensionare në MZHETTS, konstatohet se, përgjatë viteve 2012 dhe 2013, referuar akt rakordimeve me Degën e Thesarit Tiranë, deri tani janë arkëtuar tarifa koncensionare në shumën 63,766,686 lekë, duke mbetur detyrime të pa shlyera nga shoqëritë koncensionare, në shumën 1,049,963,633 lekë, rekomandim i cili jo vetëm nuk është zbatuar nga ky institucion, por nuk i është përcjellë për veprime të mëtejshme ATRAKO-s, e për pasojë në kontabilitetin e Agjencisë nuk rezultojnë të regjistruara këto detyrime të mbartura të koncensionarëve ndaj saj.

- Nga auditimi në MZHETTS. konstatohet se, nga përfaqësuesit e Degëve të Shoqërive Publike në 12 Prefektura, të cilat janë pjesë e strukturës së MZHETTS nuk ka informacion të saktë për sipërfaqen e përgjithshme të dhënë me qira nga të gjitha subjektet që veprojnë në Prefekturën përkatëse (sipërfaqe nën objekt apo funksionale), si dhe vlerën kontabile të kësaj pasurie.

- Në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave u konstatua se, në asnjë rast nuk është kryer monitorimi i 26 kontratave të dhëna me qera, mbi realizimin e investimit që pretendohet të kryhej nga qiramarësi. Konstatohet se MBZHRAU nuk ka një njësi monitorimi dhe nuk disponon informacion nga monitorimi në vend i këtyre kontratave mbi realizimin e investimit që pretendohet të kryhej nga qiramarësi, përdorimi i tyre, punësimi i pretenduar, etj.

- MBZHR- Janë vendosur tregues të specifikimeve teknike, të cilët nuk mund të verifikohen brenda afateve të shtrirjes së kontratës (rasti i mëshqerrave).

¹²Referenca: OV2.16, Green Book: *Përpara se të vijohet me hartimin dhe dizenjimin e kontrolleve të brendshme, vendosja e objektivave për të realizuar misionin, planet strategjike është parakusht i domosdoshëm, për efektivitetin e kontrolleve të brendshme.*

- Vendosija e kriterëve diskriminuese në procedura prokurimi në: MEI, MZHETTS, etj.

Kuadri COSO, Komponenti 3 “Aktivitetet e Kontrollit”, Parimi 12 - Mungesa e planeve, procedura/rregullore të brendshme, të cilat duhet t’i shërbejnë përmbushjes së misionit dhe objektivave të njësisë, si pararojë në ruajtjen e aseteve të sektorit.

- Nga auditimi në MZHETTS, rezultoi se, Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT), si Autoritet Kontraktor, ka realizuar procedurën “Mbi përgatitjen e një spoti promociional me rastin e kampionatit EUROPIAN Francë 2016”, në kuadër të promovimit të turizmit shqiptar në nivel ndërkombëtar si dhe në kuadër të zhvillimit të projektit të zbatimit të brandimit të **“Albania go your own way”**; sa më sipër finalizuar me një kontratë, që do të transmentonte spotin për një vlerë prej 90 mijë Euro, për të cilën ka munguar dokumentacioni shpjegues.

- Nga auditimi në Ministrinë e Punëve të Jashtme u konstatua se, nga MPJ janë marrë të drejtat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për të kryer vetë procedurat e prokurimeve. Gjithashtu nuk janë përcaktuar rregullat që do të ndiqen nga përfaqësitë për procedurat e blerjes së automjeteve, si edhe

- Propozime për përmirësime ligjore në 10 subjekte, ndër të cilët: MEI, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, AKBN, Kuvendin e Shqipërisë, Agjencinë e Prokurimit Publik, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, MZHETTS, DPP, APP dhe Universiteti Politeknik i Tiranës.

Kuadri COSO, Parimi 13 “Përdorimi i informacionit cilësor: “Është detyrë e menaxhimit që të dizenjojë procese të tilla që përdorin objektivat e njësisë publike dhe risqet e lidhur me to, për të identifikuar kërkesat e nevojshme për informacion, me qëllim arritjen e objektivave dhe adresimin e risqeve.

- Në AKBN u konstatua se, në shumë monitorime të kontratave koncesionare, lidhur me pamundësinë e përlllogaritjes së penalteteve për vonesat në fillimin e punimeve (për vitin 2015, janë rreth 8.2 miliard lekë, për tremujorin e dytë 2016 janë rreth 1.2 miliard lekë.

B. Gjetjet sipas anomalive të konstatuara përgjatë implementimit të kontrolleve të brendshme u grupuan përsëri spas standardeve të kontrollit të brendshëm si më poshtë:

Kuadri COSO / Komponenti 5 “Monitorimi” / Parimi 17 “Vlerësimi i ngjarjeve dhe rregullimi i defincencave”: Kontrolltet e brendshme duhet të lidhen me objektivat e ndryshueshme, mjedisin, ligjet, burimet dhe risqet:

- Fee koncesionare e munguar në rastin e AKBN-së, në shumën për të cilën janë penalizuar prodhuesit për shumën 140 milion lekë;
- Sa i takon shfrytëzimit të burimeve minerare në AKBN 4 shoqëri nuk kanë deklaruar pagesë për rentën minerare ndonëse kanë realizuar dhe deklaruar të ardhura nga shitje e prodhimit, duke sjellë si pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën prej 63,600,000 lekë;
- Në MEI, në procedurën “Rehabilitimi i zonës të ish Metalurgjikut Elbasan, me fond limit 229 milion lekë, u konstatua se, ka munguar informacioni për argumentimin e punimeve që parashikohen të kryhen për këto objekte, si: nuk ka studim paraprak, detyrë projektimi apo preventiv paraprak punimesh.

Kuadri COSO, Parimi 8, Vlerësimi i Risqeve nga Mashtrimi, ku ndër të tjera renditet edhe raportimi financiar.

- Për vitin 2015 nga Ministria e Punëve të Jashtme janë lidhur kontrata punimesh, ku vlerat e mbetura pa u likuiduar, nuk janë kontabilizuar si angazhim.

Kuadri COSO, Komponenti 5 “Monitorimi”, Parimi 13 dhe 14 që ka të bëjë me efektivitetin e komunikimit së jashtmi dhe së brendshmi, të informacionit të nevojshëm, me qëllim arritjen e objektivave të njësisë:

- Nga auditimi në MZHETTS, u konstatua se nga ATRAKO është hartuar regjistri i koncesioneve, në respekt të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet/PPP”, nenit, por në këtë regjistër janë hedhur vetëm 160 kontrata koncesionare, ndërkohë që ka ende shumë kontrata të tjera koncesionare të lidhura nga MEI, që vijnë të mos jenë të përfshira në regjistër.

C. Gjetjet sipas anomalive të konstatuara përgjatë vlerësimit të funksionimit të kontrolleve të brendshme u grupuan sipas standardeve të kontrollit të brendshëm si më poshtë:

Kuadri COSO, Komponenti 4 “Aktivitetet e Kontrollit”, parimi 12, kërkon zhvillimin e politikave nëpërmjet kryerjes së procedurave periodike, si vijon:

- MZHETTS: Nga auditimi konstatohet se njësitë monitoruese nuk paraqesin raportet për monitorimin e kontratave që ato administrojnë, ose raportet janë thjesht formale, të njëanshme dhe pa dokumentacionin e duhur justifikues.
- Në MEI, u konstatua se, në praktikën e vlerësimit të vendimeve të MEI mbështetur në raportet periodike të monitorimit ka rezultuar se koncesionarët për prodhimin e

munguar të energjisë elektrike, duhet të vërtetohen, nëse mosrealizimi është shkaktuar për shkaqe madhore apo për fajin e shkeljet e shkaktuara nga vetë ai.

Kuadri COSO, Komponenti 1 “Mjedisi i Kontrollit”, parimi 4 “Demonstrim i angazhimit ndaj kompetencave” _kërkon ndër të tjera që menaxhimi të zhvillojë dhe mbajë personel kompetent për të arritur objektivat e njesisë; dhe Komponentit 4 “Aktivitetet e Kontrollit”, Parimit 10 “Hartimi i aktiviteteve të Kontrollit” që kërkon dizenjimin e llojeve të duhura të aktiviteteve të kontrollit, ku ndër të tjera përfshihet edhe menaxhimi i burimeve njerëzore:

- MZHETTS: Nga auditimi i procedurës, “Për fushatën e Integruar e Marketingun për Promovimin e Turizmit **“Albania go your own way”** me fond limit prej 51,800,000 lekë, mos monitorimi nga AKT-ja, me burime njerëzore të kualifikuara apo me personel të strukturave të turizmit në MZHETTS, nuk ka dhënë tablonë e qartë, të mënyrës së nën kontraktimeve, që operatori fitues “R&T Advertising” shpk, ka realizuar me operatorë vendas apo të huaj.

- MZHETTS: janë përfshirë në Njësitë e Prokurimit dhe në Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, burime njerëzore të pakualifikuara dhe të pa trajnuara pranë APP-së, ndonëse, në strukturën e institucionit ekziston, Sektori Prokurimeve i cili nuk është i plotësuar plotësisht me burime njerëzore.

- Në praktikën e ARRSH, në vazhdimësi, konstatohet se nisen punime për vepra, rrugë të reja, në mungesë të plotë të fondeve për realizimin/përfundimin e tyre. Në mungesë të fondeve për përfundimin e punimeve, objektet e “kolauduara”, por të papërfunduara, braktisen duke shkaktuar dëme ekonomike të parikuperueshme.

Në lidhje me alikimin e këtij modeli për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm si nga pikëpamja strategjike ashtu edhe taktike, stafi i departamentit ka përkthyer Librin Jeshil të GAO-s, (Green Book), i cili përbën një material shumë të dobishëm për vetë-trajnimin e stafit të KLSH-së për një kuptim më të detajuar të kontrollit të brendshëm të njësive publike që auditohen, por mbi të gjitha të kenë kuptim të drejtë të përgjegjësive individuale dhe të linjës drejtuese brenda institucionit suprem të auditimit.

Audituesit e Departamentit të institucioneve qendrore, si pjesë përbërëse e strukturës së KLSH ka dhënë kontributin e vetë në rritjen e transparencës së institucionit nëpërmjet pjesëmarrjes në Median e Shkruar. Nga të dhënat statistikore konstatohet se gjatë vitit 2017 trupa audituese këtij departamenti ka realizuar 26% (16 kundrejt 61) të totalit të prezencës në shtyp të audituesve të KLSH-së.

▪ KORNIZA E MATJES SË PERFORMANCËS – ASPEKTE TË PËRMIRËSIMIT TË PUNËS AUDITUESE TË DEPARTAMENTIT

Bazuar në sistemin e indikatorëve të kornizës së matjes së performancës, kryesisht të atyre që lidheshin me auditimet financiare dhe auditimet e përputhshmerisë, të aplikuara sipas pyetësorit në departament u konstatuan nivelet e zbatimit në praktikë të standardeve si dhe aspektet e përmirësimit për të ardhemn jo vetëm në nivel departamenti por në nivelin e përgjithshëm të KLSH-së. Me konkretisht pikëzimet dhe aspektet specifike sipas SAI-ve jepen në vijim:

SAI-9 Standardet e Auditimit Financiar dhe Menaxhimit të Cilësisë: Pikëzimi 3

Dimensioni (i) Standardet e Auditimit Financiar dhe Politikat 3 PIKË - Aktualisht Departamenti përdor metoda të thjeshtëzuara të përzgjedhjes së kampioneve ndërsa për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, mbështetur edhe në gjykimin profesional, audituesit mbështetën në standardet ndërkombëtare të auditimit ISSAI dhe në praktika të mira të fushës. Përgjatë vitit 2017, ka munguar qasja e orientuar ndaj hartimit të strategjisë të auditimit (pasi duhet të konsolidohen metodologjitë e zbatimit konkretë të aplikimit të këtij standardi që në fazën e hartimit të programit). Sipas kërkesave të manualit të auditimit financiar të KLSH, audituesi krijon strategjinë e përgjithshme të Planit të Auditimit, në të cilin vendosen qëllimi, koha dhe drejtimi i auditimit si edhe zhvillimin e planit të auditimit më të detajuar.

Dimensioni (ii) Menaxhimi i Grupit të Auditimit Financiar dhe Aftësitë: 3 PIKË - Në nivel politikash, KLSH ka miratuar manualin e auditimit financiar, mbështetur plotësisht mbi standardet ndërkombëtare të auditimit të SAI-eve, si dhe mbi praktikën më të mirë të fushës. Ndërsa nuk parashikohet si koncept materialiteti i performancës.

SAI-10 Procesi i Auditimit Financiar- Pikëzimi 3

Dimensioni (i) Planifikimi i Auditimit Financiar: 3 PIKË - Deri tani kemi aplikuar materialitetin për pasqyrat financiare si një e tërë. Kontrolli i brendshëm vlerësohet nga pikëpamja teorike më së shumti, pa u fokusuar shumë në vlerësimin e risqeve që mbart.

Dimensioni (ii) Implementimi i Auditimit Financiar: 3 PIKË - Nuk ka procedura të mirëfillta të dokumentimit që lidhet me këtë fazë të procesit të planifikimit. Theksojmë se aktualisht mungojnë letrat e punës për auditimin financiar

(veçanërisht për planifikimin) si hallkë e rëndësishme e procesit të auditimit (edhe pse audituesit deri më tani kanë përfshirë në dosje të gjitha ato dokumente që nën gjykimin profesional të audituesit janë vlerësuar të rëndësishme për tu dokumentuar si evidence pune). Ka munguar dokumentimi i kryerjes së procedurave të auditimit, edhe pse konstatohen raste të kryerjes së tyre.

Dimensionii (iii) Vlerësimi i evidencës së auditimit, Konkluzionet dhe Raportimi në Auditimin Financiar: 3 PIKË - Ka munguar shpesh të shkruarit qartë dhe në mënyrë koncize, pa u tejzgatur, gjë e cila është një sfidë për të gjithë ne, me qëllim përmirësimin e të shkruarit të raporteve të auditimit dhe vendosjen e kritereve unifikuese për të gjithë audituesit. Mungojnë procedura të dokumentimit të përzgjedhjes së kampioneve, prandaj kjo mbetet një nga sfidat e vitit që ka filluar.

SAI-11 Rezultateve të Auditimit Financiar 4 PIKË

Dimensionii (iii) Ndjekja nga SAI i Zbatimit të Rekomandimeve të Auditimeve Financiare 3 PIKË - Nuk ka një praktikë për vlerësim material për të përcaktuar nëse ndjekja e zbatimit të rekomandimeve kërkon investigim/auditim shtesë. Për auditimet financiare nevojitet që verifikimi mbi zbatimin e rekomandimeve të kryhet një herë në vit dhe pas muajit mars-prill, periodhe kjo e cila përkon më mbylljen e pasqyrave financiare. KLSH vepron në bazë të udhëzimeve të brendshme të Kryetarit të KLSH-së për zbatimin e rekomandimeve, si edhe procedurave të parashikuara në Rregulloren e procedurave të auditimit. Edhe pse zbatimi i rekomandimeve kryhet në mënyrë periodike (vjetore), ende duhet të përmirësohen proceset e ndjekjes së rekomandimeve.

SAI-15 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Menaxhimit të Cilësisë PIKËZIMI 3

Dimensionii (i) Politikat dhe Standardet Auditimit të Përputhshmërisë: 3 PIKË - Përlllogaritja e materialitet vijon të bëhet sipas modeleve të NAO-s. Mungojnë letrat e punës për auditimet e përputhshmërisë. Deri tani kemi vijuar të mbështetemi te dokumentet standard (së fundmi miratuar me Rregulloren e Procedurave të Auditimit), por nuk parashikohet dokumentimi për përcaktimin e risqeve, kryerjen e testeve të auditimit. Deri tani vlerësimi i kontrollit të brendshëm trajtohet si pikë e veçantë dhe më së shumti teorike. Kjo pasi nga vetë subjektet kontrolli i brendshëm vijon të shikohet i veçuar dhe jo si pjesë integrale e aktivitetit të subjektit. Në programin e auditimit, parashikohet koha dhe zgjatja e procedurave të auditimit, por jo plotësisht në kontekstin e vlerësimit të riskut. Risku i mashtrimit është

Komponent i rëndësishëm i riskut të qenësishëm, por jemi në fazë të zhvillimit të procedurave dhe proceseve që do të na shërbejnë për një qasje të strukturuar mbi identifikimin dhe vlerësimin e riskut të mashtrimit (këtu i referohemi auditimeve pilot të nisura rishtazi).

Dimensioni (ii) Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Përputhshmërisë: 3 PIKË - Edhe pse nga ana teorike ka një njohje të mirë të standardeve, përvoja praktike në këto lloje auditimi ende është në proces përmirësimi të vazhdueshëm. Pikat e tjera aktualisht zbatohen dhe ndiqen nga audituesit, veçanërisht nga ata me përvojë. Strategjia e auditimit nuk hartohet ende sipas standardeve. KLSH ofron mbështetje nëpërmjet Manualit të Auditimit të përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Standardeve të fushës ISSAI 4100 dhe ISSAI 4200, bashkëpunime me ekspertë të fushës, trajnime të vazhdueshme. Parashikuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH, nr. 107, datë 08.08.2017, ku parashikohet që në program përfshirja e grupit të kontrollit të cilësisë në procesin e auditimit.

SAI-16: Procesi i Auditimit të Përputhshmërisë PIKËZIMI 3

Dimension (i) Planifikimi i Auditimit të Përputhshmërisë: 2 PIKË- Risku i auditimit parashikohet në manual, por mungojnë modele të matjes së tij. Deri tani vlerësimi i kontrollit të brendshëm trajtohet si pikë e veçantë dhe më së shumti teorike. Kjo pasi nga vetë subjektet kontrolli i brendshëm vijon të shikohet i veçuar dhe jo si pjesë integrale e aktivitetit të subjektit.

Dimensioni (ii) Zbatimi i Auditimit të Përputhshmërisë : 3 PIKË.

Dimensioni (iii) Vlerësimi i Evidencave të Auditimit, Përfundimet dhe Raportimi në Auditimet e Përputhshmërisë 3 PIKË.

SAI-17 Rezultatet e Auditimit të Përputhshmërisë PIKËZIMI 4.

Dimensioni (i) Dorëzimi në Kohë i Rezultateve të Auditimit të Përputhshmërisë 4 PIKË.

Dimensioni (ii) Publikimi në Kohë i Rezultateve të Auditimit të Përputhshmërisë. 4 PIKË.

Dimensioni (iii) Ndjekja e Zbatimit të Rekomandimeve dhe Gjetjeve 3 PIKË- Ende nuk kemi një praktikë për vlerësimin e materialitetit me qëllimin përcaktimin se kur një procedure e ndjekjes së rekomandimeve kërkon një auditim shtesë, por sa më

sipër konsiderohet patjetër përgjatë planifikimeve vjetore që Departamenti bën. KLSH vepron në bazë të udhëzimeve të brendshëm të Kryetarit të KLSH-së për zbatimin e rekomandimeve, si edhe procedurave të parashikuara në Rregulloren e procedurave të auditimit, por sfida e së ardhmes është përmirësimi i procesit të ndjekjes së rekomandimeve.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE

Nga znj. Manjola NAÇO, Drejtori i Përgjithshëm

Në planin vjetor të auditimit për vitin 2017, të miratuar nga Kryetari për Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (këtu e në vijim NJQV) ishte programuar dhe janë realizuar **42 auditime** nga 156 auditime të realizuara në nivel institucional, **fakt që tregon se ky departament ka mbajtur një ngarkesë të madhe të punës audituese për vitin 2017. Krahasuar me vitin 2016, janë planifikuar 8% auditime më shumë (nga 39 që janë realizuar në vitin 2016).**



Auditimi i fondeve të shpenzuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore është realizuar përmes: **29 auditimeve të rregullshmërisë financiare, 5 auditime financiare, 7 auditime përputhshmërie dhe 1 auditim “Mbi zbatimin e rekomandimeve për 8 subjekte të evaduar në tremujorin e fundit të vitit 2016”.**

Në përfundim të këtyre auditimeve është konstatuar mungesë efieciencë në mbledhjen e taksave dhe të ardhurave të veta, nivel i ulët efektiviteti dhe ekonomiciteti në përdorimin e fondeve të në dispozicion dhe mungesë strategjie e vizioni në administrimin e pronës publike në dispozicion të njësive të vetëqeverisjes vendore. Konstatohet se reforma territoriale nuk ka sjellë përfitimet e synuara dhe nuk është arritur të menaxhohet me kujdes procesi i përthithjes së funksioneve, punonjësve dhe aktiveve. Për shkak të një kontabiliteti jo në përputhje me standardet e kontabilitetit është e vështirë që të vlerësohet niveli real i aftësisë paguese të njësive të vetëqeverisjes vendore por duhet të theksojmë se vështirësitë financiare me të cilat ato përballen janë të identifikueshme në njësitë e mesme dhe të vogla, ku nivelet e të ardhurave që këto njësi realizojnë janë modeste.

Ky konkluzion vjen si reflektim i shkeljeve, mangësive dhe parregullsive ligjore dhe proceduariale të gjetura dhe evidentuara në raportet e auditimeve respektive, për

të cilat KLSH ka dhënë dhe rekomandime që kanë gjetur zbatim dhe kanë dhënë impakt pozitiv në menaxhimin e NjVQV-ve. Kultura menaxheriale dhe njohja e sistemeve të kontrollit të brendshëm brenda këtyre njësive është përgjithësisht në nivele të ulta, duke reflektuar nevojën për ngritje kapacitetesh kryesisht të nivelit menaxherial.

E përkthyer në impakt financiar inefficienca dhe keqmenaxhimi përlogaritet në masën **5,430 milion lekë** (kjo për 32 bashki apo ish bashki dhe 120 ish komuna). Kjo shumë përbëhet nga **dëme ekonomike**, për të cilat është kërkuar rikuperimi në buxhetin lokal në masën **1,036 milion lekë**, vlera e **të ardhurave të munguara 2,973 milion lekë**, kryesisht nga mos administrimi i pronave dhe inefficienca në mbledhjen e të ardhurave nga tatimet dhe taksat lokale, **shpenzimet për vendime gjyqësore** kryesisht largime të padrejta nga puna **108 milion lekë** dhe vlera **1,313 milion lekë**, janë **shpenzimet e realizuara në kushte të parregullive ligjore**.



Në përfundim të auditimeve janë rekomanduar 604 masa organizative të shoqëruara me 763 masa disiplinore dhe administrative nga të cilat, 479 masa disiplinore, prej tyre (202 masa për punonjës me status nëpunësi civil dhe 277 masa për punonjës marrëdhëniet e punës rregullohen me kodin e punës) si dhe 284 masa administrative në kompetencë, IMTV dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe të APP. Po ku janë identifikua problematikat kryesore.

(1) Ineficienca në prokurimin e mallrave/shërbime apo punimeve civile

Kështu, në auditimet e realizuara për vitin 2017, për 42 subjektet nga 994 procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë 13,113 milion lekë, janë audituar **716** procedura prokurimi në vlerën **11,182 milion lekë**, ose 70% të numrit të procedurave dhe 85% e vlerës së hedhur në prokurim. Nga këto, janë konstatuar

shkelje procedurale në 672 procedura prokurimi ose në 94% të procedurave të audituara, rezultat që tregon se fondet janë shpenzuar jo në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Shkeljet e konstatuara në auditimin e procedurave të prokurimit i takojnë:

- Mos argumentim i vlerës së fondit limit në 88 procedura prokurimi,
- Mos përcaktimin e dokumenteve të tenderave në 55 procedura prokurimi
- Mos përcaktimin e drejtë dhe qartë të specifikimeve teknike në 147 procedura prokurimi
- Standarde të dyfishta në shqyrtimin e ofertave në 200 procedura prokurimi
- Mungesë monitorimi, mbikëqyrje dhe zbatim jo i saktë i kontratave në 50 procedura prokurimi
- Kualifikimin i padrejtë i operatorëve ekonomikë në 148 procedura prokurimi
- Mungesë dokumentimi të procedurave të realizuara, dosje prokurimi të pa arkivuara.

Blerje e vogla dhe shërbimet mbeten një proces me risk të lartë për abuzim edhe pse procedurat e këtyre blerjeve zhvillohen online, pasi sistemet e kontrollit të brendshëm lidhur me këto procedura janë inekzistente. Gjithashtu kemi konkluduar se shkeljet ligjore të konstatuara kanë çuar jo vetëm në deformim të konkurrencës së operatorëve në treg por njëkohësisht nuk kanë garantuar vlerë të shtuar për fondet e shpenzuara.

Vetëm për parregullsitë në fushën e prokurimeve, është kërkuar shpërblimi i dëmit në masën **430 milion lekë**, në Bashki si Sarandë, Kukës, Tepelenë, Kavajë, etj. Vlera 159,197 mijë lekë ka ardhur nga mos vlerësimi i drejtë i ofertave fituese, ndërsa vlera prej 211,743 mijë lekë përfaqëson moskryerjen e punimeve civile sipas kërkesave të procedurave të prokuruar. Konstatohet se mbikëqyrja e punimeve civile në njësitë e vetëqeverisjes është një proces formal që nuk garanton plotësinë dhe cilësinë e punimeve të prokuruar.

I klasifikuar si një sektor me risk të lartë për vetë natyrën dhe problemet e mbartura, auditimi i prokurimeve kërkon vlerësim të riskut të auditimit gjatë procesit të hartimit të programit si dhe cilësi dhe thellësi të analizës dhe testeve të kontrollit nga audituesit.

(2) Administrimi i dobët fiskal

Nga njësitë e vetëqeverisjes vendor mblidhen rreth 20 lloj taksash dhe tarifash, ku nga më kryesoret përmendim: taksa mbi pasurinë, taksa mbi kalimin e pronësisë,

taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa e regjistrimit të automjeteve, taksa për zënien e hapësirave publike, tarifa e pastrimit, taksa e truallit, taksa e tabelës dhe reklamës, tarifa e shërbimit, etj. Nga të dhënat e grumbulluara për auditimet vitit 2017, konstatohet se njësitë e vetëqeverisjes krijojnë të ardhura por që mbeten larg nivelit të shpenzimeve të tyre buxhetore duke reflektuar një pamundësi financiare për vetëadministrim.

Kështu konstatohet se vetëm 3 Bashki (Tirana, Vora dhe Pusteci) realizojnë të ardhura në nivelin 52-55% të shpenzimeve buxhetore, por këtu duhet patur parasysh se Bashkitë Vorë dhe Pustec kanë nivele shpenzimesh shumë të vogla. 16 Bashki realizojnë të ardhura në nivele nga 30 deri në 48% të shpenzimeve të tyre, 18 Bashki realizojnë të ardhura nga 20% deri në 30% të buxhetit dhe pjesa tjetër krijojnë të ardhura në nivele nën 20% 22 Bashki.

Nr.	Njësitë vendore	Të ardhurat e veta vendore 2016	Shpenzimet 2016	Të ardhura/shpenzime	Popullsia	Të ardhura/banorë
1	Bashkia Tirana	6,406,563	11,624,037	55%	786,661	8144
2	Bashkia Vorë	331,389	602,489	55%	37,869	8751
3	Bashkia Pustec	20,458	39,329	52%	5,210	3927
4	Bashkia Sarandë	247,906	487,230	51%	54,737	4529
5	Bashkia Shijak	154,967	325,150	48%	44,830	3457
6	Bashkia Shkodër	483,446	1,126,746	43%	204,124	2368
7	Bashkia Durrës	1,025,902	2,419,359	42%	310,791	3301
8	Bashkia Finiq	55,059	142,723	39%	35,429	1554
9	Bashkia Lezhë	266,789	725,756	37%	108,636	2456
10	Bashkia Malësi e Madhe	143,399	395,008	36%	54,121	2650
11	Bashkia Mallakastër	125,936	346,966	36%	42,859	2938
12	Bashkia Vlorë	421,057	1,161,174	36%	197,251	2135
13	Bashkia Dropull	49,379	140,993	35%	22,906	2156
14	Bashkia Kamzë	291,975	833,850	35%	129,998	2246
15	Bashkia Belsh	89,011	259,959	34%	32,923	2704
16	Bashkia Himarë	172,156	517,843	33%	27,290	6308
17	Bashkia Patos	102,075	322,757	32%	43,402	2352

Nr.	Njësitë vendore	Të ardhurat e veta vendore 2016	Shpenzimet 2016	Të ardhura/shpenzime	Popullsia	Të ardhura/banorë
18	Bashkia Peqin	70,099	222,540	31%	39,238	1786
19	Bashkia Krujë	196,846	652,258	30%	80,898	2433
20	Bashkia Vau-Dejës	94,994	317,852	30%	50,258	1890
21	Bashkia Lushnjë	312,358	1,060,253	29%	128,794	2425
22	Bashkia Libohovë	25,774	87,940	29%	7,095	3633
23	Bashkia Cërrik	94,217	325,113	29%	47,274	1993
24	Bashkia Pogradec	159,051	556,819	29%	91,180	1744
25	Bashkia Përrenjas	53,185	186,636	28%	33,299	1597
26	Bashkia Korçë	471,486	1,663,519	28%	130,418	3615
27	Bashkia Ura Vajgurore	91,684	331,174	28%	39,876	2299
28	Bashkia Selenicë	58,284	211,982	27%	35,532	1640
29	Bashkia Fushë-Arrëz	34,447	129,022	27%	11,652	2956
30	Bashkia Poliçan	56,237	211,211	27%	17,996	3125
31	Bashkia Kavajë	244,411	950,781	26%	81,964	2982
32	Bashkia Konispol	38,106	148,521	26%	13,684	2785
33	Bashkia Memaliaj	32,556	128,029	25%	20,946	1554
34	Bashkia Rogozhinë	83,618	335,003	25%	41,469	2016
35	Bashkia Devoll	68,903	290,032	24%	42,097	1637
36	Bashkia Kuçovë	77,008	337,727	23%	55,481	1388
37	Bashkia Berat	252,245	1,119,274	23%	99,350	2539
38	Bashkia Elbasan	434,380	1,946,832	22%	209,021	2078
39	Bashkia Delvinë	40,283	193,843	21%	18,436	2185
40	Bashkia Tropojë	79,703	392,332	20%	28,297	2817
41	Bashkia Kurbin	70,908	358,423	20%	73,996	958
42	Bashkia Fier	375,608	1,941,243	19%	199,476	1883
43	Bashkia Skrapar	77,990	448,547	17%	18,265	4270
44	Bashkia Gjirokastër	113,336	657,730	17%	52,207	2171
45	Bashkia Klos	26,029	160,690	16%	20,613	1263
46	Bashkia Këlcyrë	25,520	158,872	16%	12,441	2051
47	Bashkia Maliq	74,609	469,849	16%	63,468	1176

Nr.	Njësitë vendore	Të ardhurat e veta vendore 2016	Shpenzimet 2016	Të ardhura/shpenzime	Popullsia	Të ardhura/banorë
48	Bashkia Roskovec	71,202	466,198	15%	32,152	2215
49	Bashkia Gramsh	47,823	324,167	15%	36,063	1326
50	Bashkia Tepelenë	34,804	236,608	15%	16,334	2131
51	Bashkia Librazhd	71,697	494,041	15%	44,191	1622
52	Bashkia Pukë	34,548	240,180	14%	16,301	2119
53	Bashkia Përmet	39,267	278,515	14%	19,887	1975
54	Bashkia Kolonjë	37,615	270,715	14%	19,337	1945
55	Bashkia Divjakë	98,507	712,175	14%	54,223	1817
56	Bashkia Kukës	66,750	494,867	13%	59,195	1128
57	Bashkia Mat	47,292	377,158	13%	38,165	1239
58	Bashkia Mirditë	50,327	405,550	12%	36,994	1360
59	Bashkia Bulqizë	45,314	402,789	11%	40,289	1125
60	Bashkia Has	27,360	261,884	10%	21,481	1274
61	Bashkia Dibër	54,862	684,716	8%	78,534	699
		14,948,712	43,114,979		4,416,904	

Mungesa e të ardhurave reflekton një punë të pakujdeshme në programimin dhe mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, e shoqëruar me nivele të konsiderueshme të borxhit tatimor. Detyrimet e prapambetura përbëjnë një grupë të zezë të financave vendore.

Nga auditimi i procedurës së transferimit të të drejtave dhe detyrimeve, pas reformës territoriale janë konstatuar parregullsi në zbatimin e Ligjit nr.9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe VKM nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve...”. Në shumë auditime është konstatuar se nuk ka një transferim të saktë të listës së debitorëve gjatë procesit të transferimit të kompetencave nga komunat drejt Bashkive, proces që është shoqëruar me mungesë **procedurash për ndjekjen e debitorëve** të periudhave të mëparshme. Vetëm në auditimet e vitit 2017, detyrimet e pa arkëtuara ndër vite janë llogaritur në masën **2,575 milion lekë**, problematikë e theksuar në Bashkitë Patos, Divjakë, Shkodër, Fier, Sarandë, Krujë, Kavajë, Ura Vajgurore.

Po kështu të dhënat e auditimeve tregojnë se niveli i detyrimeve debitoare janë në shuma të konsiderueshme. Detyrimet e prapambetura ndër vite, ose borxhi ndaj biznesit është i lartë dhe pavarësisht shifrave të vëna në dispozicion për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, gjykojmë se saktësia e këtij borxhi duhet të implikojë punën e strukturave shtetërore. Nga auditimet është verifikuar vetëm saktësia e shifrës së deklaruar si detyrime të prapambetura por jo rregullshmëria e këtyre detyrimeve.

Mos vlerësim i duhur i kësaj problematike mund të çojë në një “faliment” të këtyre administratave apo krijimin e huamarrjeve në nivel lokal.

Nuk është ndërtuar një sistem i informatizuar me qëllim që të sigurojë administrim të drejtë të të ardhurave dhe të mundësojë siguri të mjaftueshëm operacionale për trajtim të njëjtë të subjekteve objekt të taksave dhe tarifave vendore. Një sistem i sigurve garanton edhe një sistem efektiv kontrolli të administrimit fiskal, duke garantuar një planifikim dhe mbledhje në mënyrë të saktë të taksave e tarifave vendore, dhe rritje të cilësisë së shërbimeve për popullatën.

(3) Pronat, mungesa e inventarëve dhe keqadministrimi i tyre

Në kuadër të reformës administrativo-territoriale, Njësive të Vetëqeverisje Vendore, ju janë transferuar pjesa më e madhe e pronave, kullotave dhe pyjeve, për të cilat ende nuk janë kryer inventarizimet dhe regjistrimet ne zyrat e regjistrimit (ZVRPP), me justifikimin e mungesës së hartave përkatëse.

Nga auditimi i procedurës së transferimit të aktiveve, pas reformës territoriale janë konstatuar parregullsi në zbatimin e procedurave për transferimin e përshkruar në VKM nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, aktiveve..”. Këto parregullsi kanë sjellë **mosevidentim të drejtë të inventarit të asetëve** të këtyre njësive.

Konstatojmë se Bashkitë nga ana praktike e kanë të pamundur **kontrollin e territorit**, dhe në disa atyre u mungon personeli i specializuar për këtë qëllim. Në pjesën më të madhe të Bashkive janë krijuar dhe funksionojnë strukturat e Inspektorateve të Mbrojtjes Territorit, (IMTV), por ajo që kemi konstatuar është se në disa Bashki këto struktura janë plotësuar me specialistë jo të fushës duke mos garantuar zbatimin me kompetencë të ligjit.

Bashkimi i ish Komunave në Bashkitë e mëdha, ka nxjerrë një problem të mprehtë në lidhje me dhënien me qera të sipërfaqeve të konsiderueshme të tokave bujqësore të pandara nga ish komunat me afate kohore shumë të gjata nga 30 deri

99 vjet, ndërkohë një pjesë e tyre i kanë **dhënë me qera pa i patur ato në pronësi** pasi nuk janë transferuar pronat. Dhëniet me qera janë bërë në mungesën e plotë të dokumentacionit ose dokumentacion i paplotësuar, problematikë që në një të ardhme jo të largët mund të krijojë një problem ligjor dhe social, për shkak të investimeve të bëra në mungesë të dokumentacionit ligjor për ti garantuar ato.

Nga ana tjetër mjaft fermerë që kanë lidhur kontrata me ish-Komunat për dhënie me qera të tokave të pandara, pas reformës, nuk kanë zbatuar detyrimet sipas kontratave të lidhura me pasojë mungesë të ardhurash, fenomen ky i shfaqur dukshëm pas shkrirjes së komunave në Bashkitë Cërrik, Roskovec, Ura Vajgurore, Delvinë, Gramsh, etj.

Nuk janë krijuar regjistrat për subjektet me leje minerale që shfrytëzojnë sipërfaqe pyjore/kollusore me të dhënat e kontratave për sipërfaqen e shfrytëzueshme duke reflektuar mungesë të ardhurash konstatuar në Bashkinë Mat, Klos, Tropojë, Dropull, Delvinë, etj.

(4) Mosnjohje të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Domosdoshmëria e ngritjes së grupit të menaxhimit strategjik (GMS)

Në auditimet e kryera gjatë vitit 2017, në lidhje me zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkludojmë se në përgjithësi në të gjitha NjVQV nuk ka një kuptim të qartë të kërkesave dhe zbatimit në praktikë të tij, nuk disponohet një program trajnimesh për punonjësit të cilin KLSH e vlerëson shumë të nevojshëm.

Ka mungesë të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, fakt që rrit risqet për miradministrim të fondeve buxhetore në përputhje me objektivat dhe misionin e njësisë. Në disa NjVQV nuk bëhet fjalë të njihen risqet e aktivitetit dhe aq më pak të ketë strategjitë të menaxhimit të riskut (përfshirë këtu raportimet formale që bëhen në kushtet e përgatitjes së formularëve të vetëvlerësimit). Mangësitë shumta të konstatuara gjatë auditiveve në lidhje me mjedisin e kontrollit dhe vlerësimin e risqeve në zbatim të Ligjit të sipër përmendur tregon se vëmendja e strukturave të Ministrisë së Financave është larg njësisë të vetëqeverisjes vendore ndërkohë që **risku operacional në këto njësi është mjaft i lartë**. Ky konkluzion mbështetet në një sërë konstatimesh për mangësi në lidhje me evidentimin dhe menaxhimin e risqeve të cilat flasin për dobësi të mëdha të mjedisit të kontrollit.

(5) Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave të Auditit të Brendshëm Publik

Objektivat e Strategjisë “Për menaxhimin e Financave Publike”, kanë përcaktuar si një shtyllë të rëndësishme forcimin e auditit të brendshëm (këtu e në vijim AB) për të ofruar garanci të arsyeshme që sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të jetë në përputhje me rregullat dhe standardet gjerësisht të pranuar. Por ajo që vihet re gjatë auditimeve të kryera në NJVQV, është **minimizimi i rolit** të strukturave përgjegjëse të AB dhe **mosfunksionimi i tyre si veprimtari e pavarur** në luftën ndaj shkeljeve ligjore dhe korrupsionit, pavarësisht se institucioni ka shumë nevojë për këtë rol, nisur nga mjedisi dhe problematikat e tij ndër vite.

Kështu në auditimet e kryera në lidhje me funksionimin e strukturave të AB të NJQV, konstatohet:

Mosplotësimi i strukturës së AB me specialist të fushës, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 17 dhe Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 3/pika 1 dhe Kreu IV neni 10 “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm”, VKM nr.212, datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet: *“Njësia e auditimit të brendshëm detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi, tre auditues, përfshirë drejtuesin e njësisë”*, i ndryshuar me VKM nr.83, date 03.02.2016 “ Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së auditit të brendshëm të sektorit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 83, datë 03.02.2016.

Mos pajisja e audituesve me certifikatë të AB, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 19, ku përmendim Bashkitë Dibër, Vorë, Librazhd, Tepelenë, Roskovec, Patos, Himarë.

Gjithashtu nga 25 NJVQV të auditura në 7 prej tyre ose 29%, nuk është ngritur struktura e AB, gjë e cila tregon rëndësinë e pakte që i jepet kësaj strukture. Si dhe në disa bashki struktura e ngritur e AB-së nuk funksionon (Bashkia Cërrik, Delvinë, Finiq, Këlcyrë, Klos, Peqin dhe Pukë).

Në total numri i audituesve të AB sipas strukturave të miratuara në Këshillat Bashkiak (KB) për 24 NJQV të audituar është 36 auditues, ku evidentohet se vetëm në 6 prej tyre ose 25% numër i audituesve është sipas VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së auditit të brendshëm të sektorit

publik”, Gjithashtu nga këto 36 auditues të miratuar në struktura e AB, janë me certifikatë auditi të brendshëm 20 auditues ose 55.5 % dhe pjesa tjetër është pa certifikatë, por që plotëson kriteret për punësim në këto struktura.

Kallëzimet penale si një instrument në luftën ndaj korrupsionit

Gjatë vitit 2017, janë dërguar në organin e prokurorisë **19 kallëzime penale** dhe **11 indicie** për kallëzim penal, për 69 persona. Të 19 praktikat e dërguara në prokurori i përkasin 11 subjekteve të audituara.

Në listën e personave të kallëzuar penalisht përfshihen drejtues të nivelit të lartë të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, drejtues të mesëm, specialist të administratës, por dhe ish të zgjedhur vendore (ish Kryetar Komunash), për të cilat është depozituar në organin e ndjekjes së akuzës kallëzim, për konsumimin e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, neni 248 dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” neni 258, Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, me efekte financiare, të shprehura në dëm ekonomik me **vlerë 137 milion lekë**.

Më konkretisht, subjektet, numri i personave të kallëzuar dhe vlera e dëmit të shkaktuar janë:

Njësia VQV	Nr.Kallëzimeve	Nr.Personave	Vlera e dëmit milion lekë
Bashkia Sarandë	2	7	27
Bashkia Himarë	3	15	22
Bashkia Tepelenë	2	2	28
Bashkia Fier, (ish komuna Dermenas)	1	3	3
Bashkia Roskovec	1	7	2
Bashkia Tropojë	1	3	2
Bashkia Delvinë	1	1	
Bashkia Ura Vajgurore	1	1	2
Bashkia Durrës	4	24	
Bashkia Divjakë	1	1	
Prefektura Lezhë	1	4	
Bashkia Kukës	1	1	51
Gjithësej	19	69	137

Gjatë vitit 2017, është arritur të jepet opinion për pasqyrat financiare në disa nga njësitë e vetëqeverisjes duke kaluar në një proces sfidues dhe mjaft impenjativ për kapacitete audituese të këtij deparamenti.

1. Bashkia Fier. Opinion i kualifikuar, pasi është arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e parregullsive individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.
2. Prefektura e Qarkut Lezhë. Opinion i pakualifikuar
3. Bashkia Durrës. Opinion i kualifikuar, pasi është arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e parregullsive individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura në periudhën nën auditim.
4. Bashkia Vlorë. Opinion i pakualifikuar
5. Bashkia Selenicë. Opinion i kualifikuar, pasi është arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e parregullsive individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura në periudhën nën auditim.

Aneks. 1

Lista e subjekteve per gjetjet me dem ekonomik ne fushen e investimeve për auditimet e vitit 2017

Nr	NË PROKURIME	Dëmi në 000/leke	Nga të cilat:		
			në procedurat prokurimit (KVO)	në zbatimin e punimeve	Në mos llogaritje penaliteti
1	Bashkia Himarë	35,501	21,851	13,650	
2	Bashkia Sarandë	88,695	32,260	45,120	11,315
3	Bashkia Teplenë	50,747	26,568	24,179	
4	Bashkia Mat	4,981		4,981	
5	Bashkia Cërrik	4,265		4,265	
6	Bashkia Gramsh	9,889	2,071	7,818	
7	Bashkia Peqin	1,031		1,031	
8	Bashkia Roskovec	5,352	2,410	2,942	
9	Bashkia Fier (9 ish Komunat)	15,660	5,724	9,591	345
10	Bashkia Ura Vajgurore	3,779		3,779	
11	Bashkia Patos	6,783		2,335	4,448
12	Prefektura Lezhë	39		39	

Kontrolli i Lartë i Shtetit

Nr	NË PROKURIME	Dëmi në 000/leke	Nga të cilat:		
			në procedurat prokurimit (KVO)	në zbatimin e punimeve	Në mos llogaritje penaliteti
13	Bashkia Kavajë	28,373	4,017	24,356	
14	Bashkia Tropojë	13,975	4,944	9,031	
15	Bashkia Pukë	6,230	1,500	4,730	
16	Bashkia Klos	5,216		4,371	845
17	Bashkia Delvinë	6,300	4,830	1,470	
18	Prefektura Berat				
19	Bashkia Finiq	36,127	28,727	7,400	
20	Bashkia Dropull	1,800		1,800	
21	Bashkia Roskovec (Auditim Tematik)	621	621		
22	Bashkia Shkodër	9,247		9,247	
23	Bashkia Divjakë	10,560	6,599	3,961	
24	Bashkia Durrës	9,655		9,655	
25	Bashkia Krujë	1,039		1,039	
26	Bashkia Durrës ish Komunat	7,077	375	6,702	
27	Bashkia Kukës ish Komunat	4,986	1,436	3,550	
28	Dr.nr. 1 e Punëtorëve, Tiranë	194		194	
29	Bashkia Tiranë ish Komunat	5,568	1,061	4,507	
30	Bashkia Kukës	57,007	42,804	14,203	
	SHUMA	430,697	159,197	211,743	16,953

**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE, TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT DHE INVESTIMEVE TË HUAJA**

Nga znj. Yllka PULASHI, Drejtor Departamenti



Në vijimësi do të gjeni një përmbledhje në lidhje me veprimtarinë audituese të dy Departamenteve të auditimit, Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Departamentit të IT-së dhe Investimeve të Huaja, të kryer përgjatë vitit 2017, në kuadër edhe të Analizës Vjetor të kryer nga departamentet, më datë 24.01.2018 me temë *“Mbi performancën dhe impaktin e veprimtarisë audituese të departamentit përgjatë vitit 2017”*.

Gjatë vitit 2017 këto dy departamente kane funksionuar te bashkuar, ku audituesit e të dy departamenteve janë angazhuar në auditime si në shoqëritë publike ashtu edhe në auditimin e projekteve me financime të huaja.

I. Sipas programit vjetor të auditimit për vitin 2017, të dy Departamentet kane pas si objektiv realizimin dhe përmbushjen e **29 auditime gjithsej**, 15 auditime në shoqëritë publike dhe 9 auditime të projekteve me financime të huaja dhe 4 auditime të teknologjisë së informacionit, ku në fund të vitit rezulton se numri i auditimeve të realizuara dhe të evaduar është **31 auditime gjithsej ose në masën 106%**.

Pra rezulton se është përmbushur numri i auditimeve te planifikuara për tu kryer gjate vitit 2017, ndonëse gjatë auditimeve disa subjekte si Albpetrol sh.a. dhe ERE kanë penguar kryerjen e auditimeve, duke krijuar pengesa artificiale dhe nxjerr pretendime antiligjore.

Auditim në shoqërinë Albpetrol sh.a., nuk përfundoi brenda afateve të përcaktuara nga KLSH në programin fillestar të auditimit, për arsyen të pengesave artificiale të krijuara nga ish administratori, por grupi i auditimit mundi të përfundonte me sukses punën audituese dhe përtej vonesave të shkaktuara nga subjekti, materiali i auditimi është evaduar brenda vitit 2017.

Auditimet e kryera gjate vitit 2017 janë kryesisht auditime përputhshmërie dhe ligjshmërie me objekt auditimi *“Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërisë financiare”*, 4 (katër) auditime financiarë, 1 (një) auditim është tematik, si dhe auditimi *“Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për auditimet e ushtruara në subjekt dhe të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2017.*

II. Gjithashtu gjatë vitit 2017 Drejtoria e Auditimit të IT-së ka mundur të realizoj gjithsej 4 auditime duke përbushur kështu numrin e auditimeve të teknologjisë së informacionit të programuara. Një nga këto auditime ka qenë auditim pilot, në bashkëpunim edhe me kolegët e SAI polak. Në lidhje me performancën e auditimeve IT Drejtori i Drejtorisë z.Kozma Kondakci do të prezantoj një përmbledhje në vijimësi të kësaj analize.

Auditimet e kryera dhe te evaduara specifikisht nga të dy departamentet janë:

- 15 (pesëmbëdhjetë) në shoqëritë dhe entet publike;
- 9 (nëntë) auditime në fushën e projekteve;
- 4 (katër) auditime në fushën e TI;
- 1 (një) auditim tematik;
- 2 (dy) zbatim i rekomandimeve.

Auditimet sipas llojit të auditimit janë:

- 20 (njëzet) auditime përputhshmërie dhe ligjshmërie;
- 4 (katër) auditime financiare, nga të cilat 3 (tre) në shoqëritë publike dhe 1 (një) në projektet me financime të huaja;
- 4 (katër) auditime TI;
- 3 (tre) auditime tematik duke përfshirë dhe zbatimin e rekomandimeve.

Aktualisht janë evaduar dhe janë raportuar për pasqyrim në evidencat e përgjithshme të institucionit 31 auditime. Të dy departamentet kanë përbushur numrin e auditimeve të planifikuar për vitin 2017, madje dhe kanë realizuar dy auditime me tepër (nga nja auditim secili departament). Të gjitha auditime kanë pasur si qëllim, që nëpërmjet gjetjeve të konstatuara dhe rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit, të ndihmojnë subjektet e audituara të shmangin në vazhdimësi parregullsitë dhe të kenë ndikim pozitiv në përmirësimin e veprimtarisë së tyre.

1. Masa e dëmit ekonomik, si dhe të ardhurat e munguara ose shpenzimet jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit janë në shumën gjithsej **18,169,910 mijë lekë**, nga të cilat shuma **6,891,003 mijë lekë** i përket dëmit ekonomik dhe **11,278,907 mijë lekë** për efektin negativ financiar ose shpenzime jo në përputhje me parimin e 3-E-ve.

2. Janë rekomanduar **529 masa organizative**;

3. Janë rekomanduar **201 masave disiplinore dhe administrative**.

Sipas fushave përkatëse konstatohet dëmi ekonomik:

- Në Shoqëritë Publike në vlerën **6,575,418 mijë/lekë**;

- Në Projektet me Financime të Huaja në vlerën **315,585 mijë lekë**.

4. Janë propozuar **2 kallëzime penale**, për 2 drejtues apo administrator të shoqërive dhe **1 indicie** për kallëzim penal, kallëzime të cilat i përkasin auditimeve të shoqërive publike.

PËR SHOQËRITË PUBLIKE

Është konstatuar **dëm ekonomik** në vlerën **6,575,418 në mijë lekë** dhe **efekt financiar negativ** në vlerën **10,861,322 mijë lekë** në 15 subjekte, kryesisht sipas fushave përkatëse:

- Në fushën e energjisë elektrike dëm ekonomik në vlerën **5,686,246 mijë lekë** dhe efekt financiar negativ në vlerën **9,341,592 mijë lekë**.

Dëmi ekonomik dhe efekti financiar negativ në fushën e energjisë elektrike ka ardhur kryesisht si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të Entit Rregullator të Energjisë, të cilat kanë krijuar një situatë konfuzë në tregun e prodhimit/blerjes/shitjes të energjisë elektrike.

- Në marrëveshjet hidrokarbure dëm ekonomik në vlerën **500,193 mijë lekë**, i konstatuar nga auditimi i zbatimit të kontratave të shitjes së naftës buto, në të cilat kostot e transportit, magazinimit, etj., duhet të ishin përcaktuar me çmimet për njësi dhe nga çmimi i kontratës duhet të ishin zbritur vetëm kostot faktike që janë kryer realisht, sipas rasteve.

- Në fushën e prokurimeve publike dëm ekonomik në vlerën **279,210 mijë lekë** dhe efekt financiar negativ në vlerën **747,619 mijë lekë**, i konstatuar kryesisht në shkeljet e ligjit të prokurimit publik në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik si dhe zbatimin e kontratave për punë, mallra e shërbime.

Kallëzime penale

Për vitin 2017 janë konstatuar 2 raste për 2 subjekte, ku përfshihen **2 persona**, drejtues dhe administrator të shoqërive, për të cilat është depozituar në organin e ndjekjes së akuzës, për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, neni 248, Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, me efekte financiare, të shprehura në dëm ekonomik me **vlerë 73,972 në mijë lekë**, si dhe në 1 rast është përcjell i gjithë Raporti i Auditimit si indicie për kallëzim penal.

1. **Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1, Tiranë**, dërguar si **indicie** për kallëzim penal;
2. **Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë**, **1 kallëzim për 1 person** – me vlerën 47,619 mijë lekë;
3. **Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë**, **1 kallëzim për 1 person** – me vlerën 26,354 mijë lekë.

Janë rekomaduar tre propozime për ndryshim ose përmirësim te bazës ligjore dhe këto për auditimin e kryer ne shoqërinë Albpetrol sh.a., propozime ndryshimesh, të cilat kanë të bëjnë me marrëveshjet hidrokarbure.

Masa organizative

Në lidhje me masat organizative për dymbëdhjetë mujorin rezultojnë se janë rekomanduar **529 masa organizative**, nga të cilat në fushat përkatëse konstatohen të rekomanduara:

- Në Shoqëritë Publike **388** masa organizative;
- Në Projekte me Financime të Huaja **141** masa organizative.

Më hollësisht natyra e masave organizative të rekomanduara janë për përmirësimin e mënyrës së drejtimit dhe korrigjimin e të metave të konstatuara në subjektet e audituara.

Masa disiplinore dhe administrative

Në lidhje me masat disiplinore dhe administrative për auditimet e evaduar, janë rekomanduar **201 masa**, nga të cilat

- 185 masa disiplinore dhe
- 16 masa administrative.

NË PROJEKTET ME FINANCIME TË HUAJA

Demi ekonomik i konstatuar dhe i rekomanduar për tu zhdëmtuar në masën 100% është në vlerën **315,585 mijë lekë** dhe efekti financiar negativ i konstatuar është **ne vlerën 417,585 mijë lekë**.

Nga auditimi i projekteve dhe investimeve me financime të huaja kanë rezultuar këto mangësi:

1. Institucionet Shtetërore dhe Entet Menaxhuese nuk kanë arritur të koordinojnë dhe harmonizojnë veprimtarinë e tyre për të realizuar disbursimet sipas parashikimeve të përcaktuara në Marrëveshjet Financiare, ku shtyrja e afateve ka sjellë shtesa në kontratat e konsulencës dhe mbikëqyrjes, duke shkaktuar efekte negative financiare në rritjen e kostos së projektit. Njësitë e Zbatimit të Projektit nuk kanë bërë një planifikim në vite për disbursimet e fondeve (huave/kredive) të akorduara, duke sjellë që në të gjitha projektet e audituara të jetë kërkuar dhe të shtyhet afati i realizimit të disbursimeve me disa vitet.

2. Njësitë e Zbatimit të Projektit nuk kanë realizuar monitorim të vazhdueshëm dhe mbikëqyrjen e kontratave të punimeve për shërbimin e konsulencës, duke sjellë për pasojë dëm ekonomik për punime të pakryera por të paguara, cilësi të dobët, shtim të volumeve të punimeve dhe vonesa të tej zgjatura dhe të pa argumentuara e justifikuara në realizimin e komponentëve të veçante dhe të projektit në tërësi.

3. Njësitë e Zbatimit të Projekteve kane ndryshime të shpeshta të stafit ose ndryshime të strukturës së tyre, duke sjellë mos organizim, mbikëqyrje dhe monitorim të dobët të projekteve. Njësitë e Zbatimit të Projekteve, nuk kanë kryer në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e projekteve.

4. Njësitë e Zbatimit të Projekteve ose Njësitë e Menaxhimit të Projekteve, kanë shfaqur parregullsi në zbatimin e afateve të përfundimit të kontratave (kryesisht për punimet e ndërtimit), si dhe nuk kanë kërkuar zbatimin e penaliteteve për kontraktorët të cilët nuk kanë mundur të plotësojmë detyrimin e realizimit të kontratës brenda afateve të përcaktuara.

Nuk është bërë një analizë e hollësishme ku të përcaktohen arsyet e vonesës, masat e marra për realizimin e projekteve, përcaktimi i afatit të ri, si dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë për vonesat e shkaktuara.

5. Njësitë e Zbatimit të Projekteve nuk e administrojnë dokumentacionin e projekteve në përputhje me legjislacionin shqiptar, kështu konstatohet se përgjithësisht dokumentacioni mbahet në gjuhë të huaj duke vështirësuar punën

audituese si dhe nuk ruhet sipas kërkesave ligjore për arkivat. Dosjet teknike kanë mangësi në korrespondencat që mbahen ndërmjet kontraktorëve, konsulentit dhe zbatuesit të projektit, ato nuk përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme, në mënyrë që të identifikohen afatet kushtet e kontratës të zbatueshme, konstatohen mangësi në dokumentacionin e dosjeve të prokurimit të dosjeve teknike dhe mosndjekja e procedurës deri në inventarizimin e tyre, etj.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna për auditimet e evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2017, Departamenti në fund të vitit 2017 ka kryer auditime në zbatim të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në subjekte. Në përfundim të auditimit, i cili është kryer për te dy departamentet ka rezultuar se:

Në 12 subjekte të audituara, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **491** masa, nga të cilat janë pranuar **478** masa ose **97%**, janë zbatuar plotësisht **123** prej tyre, ose **25%**, janë në proces zbatimi **239** masa, ose **49%**, janë zbatuar pjesërisht **27** ose **5%** dhe nuk janë zbatuar **89** masa ose **18%**.

Të analizuara sipas llojit të masave të rekomanduara, zbatimi i tyre rezulton:

a-Masa organizative, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **233** masa, nga të cilat janë pranuar **231** masa ose **99%**, janë zbatuar plotësisht **49** prej tyre, ose **21%**, janë në proces zbatimi **115** masa ose **49%**, janë zbatuar pjesërisht **12** prej tyre ose **5%** dhe nuk janë zbatuar **55** masa ose **24%**.

b-Masa për shpërblim dëmi, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **106** masa, për vlerën **16,618,059** mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **100** masa në vlerë **16,610,207** mijë lekë ose **94%**, janë zbatuar plotësisht **28** prej tyre në vlerë **98,210** mijë lekë ose në masën **26%**, janë në proces zbatimi **55** masa në vlerë **16,451,357** mijë lekë ose **52%**, janë zbatuar pjesërisht **11** masa në vlerë **26,198** mijë lekë ose **10%** dhe nuk janë zbatuar **6** masa në vlerë **34,442** mijë lekë ose në masën **6%**.

c-Masa për shpenzime/të ardhura jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **41** masa, për vlerën **5,292,394** mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **41** masa në vlerë **5,292,394** mijë lekë ose **100%**, janë zbatuar plotësisht **2** prej tyre në vlerë **3,607** mijë lekë ose në masën **5%**, janë në proces zbatimi **30** masa në vlerë **5,060,342** mijë lekë ose **73%**, është zbatuar pjesërisht **1** masë në vlerë **6,159** mijë lekë ose **2%** dhe nuk janë zbatuar **8** masa në vlerë **222,286 në mijë lekë** ose në masën **20%**.

d-Masa administrative, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **6** masa, nga të cilat janë pranuar **6** masa ose **100%**, janë zbatuar plotësisht **2** prej tyre, ose **33%**, janë në proces zbatimi **3** masa, ose **50%** dhe është zbatuar pjesërisht **1** ose **17%**.

e-Masa disiplinore, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **136** masa, nga të cilat janë pranuar **131** masa ose **96%**, janë zbatuar plotësisht **73** prej tyre, ose **54%**, është në proces zbatimi **1** masë ose **1%** dhe nuk janë zbatuar **57** masa ose **42%**.

Për rekomandimet e pazbatuara, me Vendimin nr. 218 datë 31.12.2017, të Kryetarit të KLSH, u është rikërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve 12 subjekteve dhe Ministrive të linjës për shoqëritë publike.

Në lidhje me trajnimet, audituesit e departamenteve kanë ndjekur në mënyrë sistematike dhe kanë qenë prezent në mënyrë aktive në trajnimet dhe aktivitetet e organizuara, si brenda vendit ashtu edhe jashtë.

- Çdo auditues e ka plotësuar objektivin e trajnimeve, ku në veçanti kujdes është treguar për trajnimin e audituesve të rinj. Kështu nga secili auditues i vjetër është arritur objektivi i trajnimit 20 ditë trajnimi/vit dhe për audituesit e rinj 25 ditë trajnimi/vit.
- Për sa i përket prezencës së audituesve në median e shkruar, në vitin që kaloi është rritur numri i audituesve të departamentit, të cilët kanë qenë prezent në media me shkrimet e tyre dhe këtu pozitiv është fakti që nuk kanë qenë aktiv vetëm Kryeaudituesit apo audituesit e lartë, por thuajse të gjithë audituesit.
- Gjatë vitit 2017 departamenteve u janë bashkuar disa auditues të rinj, të cilët përtej trajnimeve të ndjekura, janë angazhuar edhe në auditime nën mbikëqyrjen e auditueve më me përvojë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës por edhe përmbushjen me sa më arritje të auditimeve.
- Ne si auditues kemi qenë aktiv edhe gjatë veprimtarive të zhvilluar në kuadër të muajit të hapur të KLSH-së, ku përveç pjesëmarrjes në aktivitete e shumta që KLSH organizoi, kemi organizuar dy takime/trajnime me pjesëmarrjen edhe të kolegëve nga departamentet e tjera, gjatë të cilave kemi prezantuar disa nga auditimeve tona më të mira, kemi bërë përmbledhjen e katër librave nga kolona e botimeve të KLSH-së, si dhe kemi trajtuar në formë diskutimi një temë mbi problematikat kryesore të konstatuara në fushën e prokurimeve publike gjatë auditimit të shoqërive publike.

Kjo ishte një përmbledhje ekzekutive e veprimtarisë së auditimeve përgjatë vitit 2017, ku përtej ngarkesës dhe vështirësive të hasura, kemi mundur të realizojmë objektivin mbi numrin e auditimeve të programuara, dhe për këtë falënderoj të

gjithë audituesit për punën e berë dhe përkushtimin e treguar. Fryma e bashkëpunimit dhe gatishmëria e gjithsecilit nga ne për të punuar në grup dhe për të ndarë eksperiencën me njeri-tjetrin, *kjo edhe në kuadër të një nga motove të Kongresit të fundit të INTOSAI, të zhvilluar në Abu Dabi, nga eksperiencia e mirë përfitojmë të gjithë*, mendoj se janë pikat tonat të forta. Gjithashtu falenderojmë drejtorët e përgjithshëm, departamentin juridik dhe në veçanti Kryetarin e KLSH për mbështetjen, orientimin udhëzimet e dhëna dhe vlerësimin të punës tonë audituese.

Rezultatet e arritura deri tani nuk duhet të na bëjnë euforik, por përkundrazi duhet të na nxisin për rritur cilësinë e punës tonë audituese, për të bërë të mundur kryerjen e auditimeve në përputhje me standardet e auditimit dhe me praktikën më të mira të auditit, për të rritur integritetin profesional, për të stimuluar dhe nxitur ngritjen profesional, për të qenë sa më prezent në median shkruar dhe për të qenë të gatshëm në shkëmbimin e praktikave më të mira me kolegët e departamentit dhe jo vetëm.

Disa nga objektivat e departamentit për vitin 2018 janë:

1. Hartimi i një programi auditimi vjetor duke u bazuar në analizën e risku sipas fushave të auditimit, me qëllim përmbushjen e misionit të departamentit.
2. Përvetësimi i standardeve ISSAI dhe manualët e auditimit, në zbatim të rregullores së re të Institucionit, si dhe reflektimi i tyre në punën audituese.
3. Përvetësimi sa më i mirë i manualeve të auditimeve të përputhshmërisë dhe auditimeve financiare, si dhe vënia e tyre në praktike gjatë punës audituese, për me tepër që gjatë këtij viti auditimet tona do të jenë kryesisht të llojit *“auditim përputhshmërie”*. Gjithashtu si sfidë për secilin nga ne është aplikimi me sukses i programit të automatizimit të proceseve në KLSH, ku përfshihen proceset e auditimit dhe to ndihmëse.
3. Për përmbushjen e planit vjetor të auditimit duhet të mirëmenaxhojmë burimet njerëzore dhe kohën, duke respektuar etapat e auditimit që nga puna parapërgatitore deri në evadimit e plotë të materialeve.
4. Rritja e kapaciteteve brenda departamentit nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimit të praktikave më të mira audituese, si dhe organizimit të workshop-eve vjetore në departament, për të promovuar punën audituese.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT

Nga z. Azmi STRINGA, Drejtor Departamenti



Gjatë vitit 2017 Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit ka kryer 24 auditime duke përfshirë 8 në autoritetet doganore, 4 në organet tatimore, 8 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe strukturat në varësi të saj, një në Institucionin e Sigurimeve Shoqërore, një në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dhe një në Bankën e Shqipërisë. Për 24 auditime të evaduar në vitin 2017, është dhënë opinion në 1 auditim financiar dhe në 12 auditime përputhshmërie. Këto opinione të ndara në opinione financiare dhe përputhshmërie janë

të llojeve të pakualifikuara në 2 raste, të kualifikuara në 10 raste dhe refuzim për të dhënë opinion në 1 rast. Auditimet e kryera kanë patur në fokus vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit financiar me kuadrin rregullator në fuqi si dhe mbledhjen e evidencave të përshtatshme për të dhënë një opinion të pavarur në Kuvendin e Shqipërisë mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2016.

Në auditimet e kryera, KLSH ka rekomanduar gjithsej 405 masa për përmirësimin e gjendjes, prej të cilave nuk janë pranuar 33 rekomandime, ose 8%. Fokusi i punës së KLSH në këto auditime është drejtuar në përmirësime ligjore, si një mjet për të garantuar eliminimin e hapësirave për ripërsëritjen e problematikave të identifikuar nga auditimet, ku nga 24 auditimet e evaduar në vitin 2017 nga DABSH, në 6 prej tyre janë bërë 19 propozime për ndryshime dhe përmirësime të legjislacionit në fuqi. Përsa i përket masave të zhdëmtimit, vlera e masave të rekomanduara është në shumën 1,848,784 mijë lekë, nga të cilat nuk janë pranuar nga subjektet shuma prej 118,571 mijë lekë ose 6.4% e tyre.

KLSH nga auditimet e kryera në vitin 2017 ka identifikuar disa fenomene thelbësore për mirëmenaxhimin dhe qëndrueshmërinë e financave publike të cilat, të cilat kanë qenë pjesë e raportit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2016, në

mendimin tonë kërkojnë një vëmendje të shtuar të ekzekutivit. Ndër më kryesoret përmendim:

1. Planifikimi jorealist dhe realizimi i të ardhurave buxhetore

Ndër mesazhet kryesorë të KLSH në lidhje me zbatimin e Buxhetit të Shtetit, janë rëndësia e realizimit të ardhurave buxhetore kundrejt planifikimit, duke bërë të mundur edhe një planifikim të mirë të shpenzimeve buxhetore që do të luante një rol kyç në plotësimin e nevojave të vendit në përmirësimin e shërbimeve publike dhe njëkohësisht në rritjen e investimeve dhe nxitjen ekonomike. Në këtë mënyrë konsolidimi fiskal do të arrihej përmes rritjes së të ardhurave dhe jo me frenim të shpenzimeve publike. KLSH ka konstatuar që të ardhurat totale të programuara në 2016 janë ulur me 5.5% krahasuar me fazën e parë të PBA 2016-2018. Shpenzimet e programuara për këtë vit janë ulur me 6.3% krahasuar me fazën e parë të PBA. KLSH ka theksuar se përmbushja e synimeve strategjike kërkon një angazhim gjithëpërfshirës dhe nuk është përgjegjësi vetëm e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilët koordinojnë këtë proces. Ndryshimet me akte normative, sidomos atyre që bëhen gjatë muajit dhjetor, shkaktojnë mungesën e kredibilitetit të buxhetit dhe për rrjedhojë kërkojnë një adresim më të kujdesshëm. Për vitin 2016, të ardhurat janë realizuar në vlerë 407,103 milion lekë, nga 418,894 milion lekë të programuara me Ligjin nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, ose realizuar 97.19%. Mos realizimi i të ardhurave dhe ecuria e treguesve ekonomik kanë çuar në shkurtim të shpenzimeve, të cilat janë realizuar në shumën 433,773 milion lekë, nga 453,324 milionë lekë të planifikuara, ose janë realizuar në masën 95.7% referuar planifikimit fillestar. KLSH gjen rastin të theksojë rëndësinë që ka për financat publike ndërgjegjësimi i subjekteve dhe aktorëve të tjerë për rëndësinë e një plani buxhetor realist dhe në mbështetje të objektivave strategjik të vendosur, i cili do të kontribuonte edhe në uljen e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

2. Rritja e borxhit tatimor dhe doganor dhe përqendrimi i tij

Nga auditimi i zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ndër gjetjet kryesore të raportuara nga KLSH ishte borxhi tatimor, niveli shqetësues i të cilit u përfshi edhe në raportin e buxhetit të shtetit, prezantuar nga KLSH në Parlament. Nga auditimi u konstatua se në vlerën e borxhit prej 147,068 milion lekë, janë shtuar detyrime përgjatë vitit në shumën 76,629 milion lekë, ndërkohë që numri i subjekteve ka një rritje alarmante nga 6 408 subjekte në vitin 2015 në 63,366

subjekte në fund të vitit 2016. Në lidhje me stokun e borxhit tatimor sipas madhësisë vihet re një përqendrim i tij sipas subjekteve, ku disa nga debitorët më të mëdhenj janë edhe ente publike, ku në fund të vitit 2016 subjektet me borxh më të madh se 5,000 mijë lekë (2 067 subjekte ose 1.4% e numrit total të subjekteve) zënë 77% të stokut të borxhit ose 113,766 milion lekë në total. Referuar trajtimit në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit, borxhi Tatimor dhe Doganor, i raportuar nga administrata fiskale, është në vlerën 171,856 milion lekë, në fund të vitit 2016, nga 121,830 milionë lekë në fund të vitit 2015. Përveç rritjes së Borxhit Tatimor dhe Doganor në vlerë nominale me 41.1% në krahasim me një vit më parë, rezulton se pesha e këtij borxhi si përqindje ndaj PBB-së, nga 8.5% e PBB-së në fund të 2015 arriti në 11.7% e PBB-së në fund të 2016. Rritja e detyrimeve ndaj tatimeve dhe doganave (borxhi tatimor dhe doganor) si dhe skemës së sigurimeve shoqërore për vitin 2016 është në vlerë 51,175 milion (51.2 miliard) lekë ose 383 milion euro dhe përbën mungesë direkte të ardhurash për buxhetin e shtetit. Në vitin 2015 rritja e këtij borxhi ka qenë në vlerë 21.4 miliard lekë. KLSH në mënyrë të përsëritur në auditime ka kërkuar që organet shtetërore të ndjekin në kohë të gjitha hapat ligjorë për të bërë të mundura mbledhjen e borxheve dhe mbrojtur interesin e shtetit duke kërkuar zbatimin e hierarkisë së likuidimit të detyrimeve nga subjektet. Gjithashtu kemi kërkuar një vemëndje të shtuar të egzekutivit ndaj ndikimit që kanë amnistitë fiskale dhe politikat fiskale në lidhje sjelljen e subjekteve tatimpaguese dhe nxitjen e shmangies së detyrimeve tatimore ana e tyre. Duke kuptuar rëndësinë e kësaj çështje dhe nevojën për ta monitoruar në vijimësi, KSLH ka planifikuar për vitin 2018 një auditim të veçantë në lidhje me borxhin tatimor.

3. Pagesat e larta për largimet nga puna dhe çështje gjyqësorë nga Buxheti i Shtetit

Nga auditimet e kryera në Ministrinë e Financave rezultoi se problematika e largimeve të padrejta nga puna dhe çështjet gjyqësorë vijnë të rëndojnë Buxhetin e Shtetit. Një problematikë e tillë reflektohet edhe në mos respektimin dhe zbatimin e vendimeve të gjykatave për rikthim në vendin e punë të punonjësve të larguar padrejtësisht. Për vitin 2016 efekti total në Buxhetin e Shtetit vetëm për pagesa të kryera, pa marrë parasysh detyrimet e pashlyera dhe që vazhdojnë të akumulohen si pasojë e mosveprimit të subjekteve, është rreth 1.5 miliard lekë. Ky fenomen është me rëndësi sepse ka shtrirje në të gjithë institucionet e shtetit Shqiptarë. Nga auditimi në lidhje me ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore, u konstatua se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përgjatë vitit 2016, ka likuiduar

vlerën 213,439 mijë lekë, duke krijuar një efekt negativ në buxhetin e shtetit, nga të cilat 81 raste për ish-punonjës në vlerën 78,688 mijë lekë dhe 21 raste shoqëritë tregtare në vlerën 134,753 mijë lekë. Nga auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me këtë problematikë rezultoi për periudhën objekt auditimi (viti 2016), pagat e përfituara nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për rikthimin e ish-punonjësve të DPT në punë janë në shumën 58 milion lekë. KLSH ka konstatuar si problematik faktin që për punonjësit që pritet të rikthehen në vendin e punës nuk përlllogariten, mbahen dhe derdhen kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore çka përbën problem për punonjësit dhe qëndrueshmërinë e skemave të sigurimeve në të ardhmen. Nëse do të marrim parasysh edhe detyrimet për paga të llogaritura, por të pa paguara në vitin 2016, vetëm për DPT, ndaj ish-punonjësve për shumën 148.6 milion lekë, kontributet e pa paguara shkojnë në shumën 57.7 milion lekë. KLSH e ka monitoruar dhe raportuar këtë problematikë në vijimësi dhe ka lënë rekomandime përkatëse duke kërkuar zbatimin e vendimeve të gjykatave në mënyrë vullnetare, nxjerrjen e përgjegjësive për dëmin që i shkaktohet buxhetit të shtetit, si dhe hartimin dhe zbatimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për shlyerjen e detyrimeve të akumuluar duke u mbështetur në miradministrimin dhe mirpërdorimin e fondeve publike dhe pronës shtetërore.

4. Krijimi i detyrimeve të prapambetura nga investimet publike

Me qëllim raportimin mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2016, KLSH realizoi një auditim në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Ndër problematikat kryesore të këtij auditimi me efekte kumulative në të gjithë procesin e ekzekutimit të buxhetit të Shtetit u prezantua procesi i akumulimit të pagesave për investimet kapitale në fund të vitit, ku nga auditimi rezultoi se 34% e totalit të pagesave për investime kanë qenë në muajin dhjetor. Gjithashtu u vu re përdorimi i buxhetit të vitit 2016 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që shkojnë edhe deri në vitin 2011, duke krijuar detyrime të reja të prapambetura. Si pasojë e përdorimit të fondeve të këtij viti në shlyerjen e investimeve të periudhave të mëparshme, në fund të 2016 nga auditimi rezulton se janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në shumën 1,803,600 mijë lekë. Ndër institucionet për problematike ka rezultuar Autoriteti Rrugor Shqiptar i cili për 107 raste, në shumën 1,214,376 mijë lekë, në llogaritë e investimeve për konstruksione të rrugëve ka përfshirë shlyerjen e faturave për investime që i përkasin viteve të kaluara. Për gjatë vitit 2016, në 56 raste në Autoritetin Rrugor Shqiptar, në shumën 1,912,041 mijë lekë janë konstatuar fatura me variancë të ditëve nga data e faturës në datën e pagesës nga 32 ditë deri në 326

ditë, që reflekton mos pasqyrimin në kohë të faturave dhe mos marrjen e masave nga ana e DTPH për disiplinimin e këtij procesi. KLSH vlerëson rëndësinë e monitorimit të vijueshëm të sistemit të thesarit, duke kërkuar ndër të tjera raportimin dhe shlyerjen e detyrimeve në kohë dhe shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura, dhe si rrjedhojë e ka përfshirë për auditim edhe në planin e vitit 2018.

5. Deficiti dhe ulja e numrit të kontribuuesve në skemën e sigurimeve shoqërore të fshatit

Financimi nga buxheti i shtetit për të balancuar buxhetin e përgjithshëm të sigurimeve shoqërore vazhdon të mbetet tepër i lartë. Shuma e financimeve nga buxheti i shtetit, neto për rezultatin financiar të skemës, ka qenë 47,893 milion lekë për vitin 2016. Për vitin 2016 deficiti i degës së pensioneve të qytetit ishte në shumë 15,548.3 milion lekë, nga 16,915.9 milion lekë në 2015, ose 8.1% më pak, çka është një indikator pozitiv në lidhje me këtë skemë. Në fund të vitit 2016 të ardhurat nga dega e pensionit të qytetit mbulojnë 80.7% të shpenzimeve të kësaj dege, në krahasim me 77.7% një vit më parë. Nga ana tjetër, rezultati financiar i degës së pensionit të fshatit vazhdon të mbetet problematik. Kështu, deficiti i financiar i degës së pensioneve të fshatit ka rezultuar 11,593.2 milion lekë në 2016, nga 10,716.3 milion lekë në 2015, ose 8.2% më shumë. Në fund të vitit 2016 të ardhurat nga dega e pensionit të fshatit mbulonin vetëm 22% të shpenzimeve të kësaj dege, në krahasim me 28% një vit më parë. Për vitin 2016 rezultuan 53 168 kontribuues fizik të siguruar në fshat ndërkohë që në 2015 ky numër ka qenë 89 572 persona. Për këtë arsye, KLSH ka kërkuar nga strukturat drejtuese të ISSH që të ketë studime të mirëfillta e të veçanta për degën e pensioneve të fshatit për të minimizuar deficitin e kësaj skeme.

6. Parregullsitë në skemën e rimbursimit të ilaçeve dhe efektiviteti i përdorimit të fondeve publike për kujdesin shëndetësor

Nga auditimi i përputhshmërinë janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në organizimin dhe funksionimin e strukturave të drejtorisë qendrore kryesisht, në funksionimin dhe vendimmarrjen e Këshillit Administrativ në hartimin e miratimin e planit vjetor të punës, planeve mujore, programeve të kontrolleve dhe në evadimin e tyre. Konstatohet mungesë e bashkëpunimit të strukturave të Fondit me organet tatimore dhe me organet e tjera ligj zbatuese për parandalimin e evazionit fiskal

dhe të veprimtarive të kundraligjshme dhe abuzive në zbatimin e skemës së detyrueshme të kujdesit shëndetësor, në punësimin e panevojshëm të punonjësve të përkohshëm dhe në respektimin e dispozitave ligjore e kontraktuale për largimin e punonjësve nga puna, në dokumentimin dhe arkivimin e dokumentacionit të brendshëm, në hartimin dhe zbatimin e kontratave me dhënësit e kontraktuar të shërbimeve shëndetësore, në mungesën e analizave teknike për përfshirjen ose heqjen e barnave nga LBR-ja, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit kryesisht në llogaritjen dhe paraqitjen e gabuar të fondit rezervë në pasqyrat financiare, në shpenzimet e rimbursimit të barnave si dhe likuidimet e tyre, etj. Vlera e parregullsisve me efekte negative për buxhetin e shtetit të rezultuara nga auditimi në FSDKSH përllogaritet në mbi 1,821 milionë lekë. KLSH ka vlerësuar që FSDKSH nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm efektiv për të garantuar përdorimin me fondeve publike me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet në përputhje me aktet rregullatore në fuqi. Për këtë arsye KLSH ka berë rekomandime për përmirësime në aktet ligjore dhe nënligjore, rishikimin e kushteve të kontratave standarde dhe marrjen e masave organizative me qëllim eliminimin e hapësirave për abuzime në këtë sektor delikat për qytetarët dhe financat publike.

7. Niveli i borxhit publik dhe administrimi i risqeve nga borxhi i jashtëm

Niveli i borxhit publik (si % kundrejt PBB) nuk tenton drejt parametrave të synuar, pasi për vitin 2015 niveli i borxhit publik është rritur në nivelin 73.06%, kurse për vitin 2016 niveli i borxhit publik ka arritur në 72.4% dhe është larg trendit që të çon në përmbushjen e objektivave strategjik të vendosur. Rritja e portofolit të huasë së jashtme mban ekspozimin e lartë të monedhës ndaj kurseve të këmbimit ku për pagesat e shërbimit të borxhit, efekti nga kurset e këmbimit dhe rivlerësimet e stokut në fund të vitit sjellin diferenca të mëdha. Vetëm nga përdorimi joefektiv i instrumenteve financiare për konvertimin e flukseve të borxhit të jashtëm buxheti i shtetit ka mbajtur një kosto të konsiderueshme prej rreth 1 miliard lekë në vitin 2016. Si KLSH kemi rekomanduar që ekzekutivi duhet të angazhohet maksimalisht që të përmbushë objektivin e vendosur për ta ulur borxhin publik nën 60% të PBB-së brenda një periudhe afatmesme.

8. Problematikat ne sistemin e vlerësimit doganor dhe magazinat doganore

Në sistemin doganor, vlera totale e masave për shpërblim dëmi të identifikuar gjatë auditimeve të kryera në 2017 ishte në vlerën 1.6 miliard lekë. Në lidhje me

auditimet në dogana, disa nga problemet kryesore të identifikuar janë keqmenaxhimi i magazinave doganore, kalibrimet, dhe zbatimi i çmimeve të referencës. Vetëm në Degën e Doganës Tiranë, si dega doganore më e madhe në vend, KLSH ka rekomanduar rreth 800 milion lekë masa për shpërbllim dëmi, identifikuar si pasojë e mangësive në drejtim të plotësimit të dokumentacionit që shoqëron praktikat doganore si dhe në lidhje me qëndrimin që duhet të mbajë dogana në këto raste. Gjatë auditimit në këtë degë doganore, si rezultat i gjetjeve në lidhje me vlerësimin doganor në importin e mishit dhe nënprodukteve, kemi patur në konsideratë edhe sigurinë ushqimore, ku kjo e fundit ka një rëndësi të lartë për shkak të vetë impaktit në jetën e qytetarëve. Si në rastin në fjalë, KLSH është e angazhuar të vijojë të tregohet objektive, profesionale dhe e paanshme në gjetjet dhe rekomandimet e saj, pa u ndikuar nga grupet e interesit dhe duke patur në konsideratë vetëm interesin publik.

9. Problematikat në shitjen e pronës shtetërore dhe aksioneve të zotëruara nga shteti

Nga auditimi në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike u identifikuan disa problematika, të cilat u adresuan për rekomandime në formën e propozimeve për ndryshim në legjislacion dhe marrjen e masave nga institucioni për reduktimin e parregullsisë. Me qëllim miradministrimit të pronës publike KLSH ka kërkuar, ndër të tjera, kryerjen e një analize më të hollësishme për shitjen e pronave publike, krijimin e kartelave të veçanta, dhe zgjidhjen e problemit për kompensimin e ish pronarëve. Nga auditimi rezultoi se procesi i administrimit të pronës publike vazhdon jetë i fragmentarizuar në shumë institucione çka krijon mundësinë e shpërndarjes së përgjegjësisë dhe rrit rrezikun e keqpërdorimit të pronës publike. Gjithashtu nga auditimi ka rezultuar se mungesa e inventarizimit të pronës publike vijon prej me shume se 20 vite të jetë një nga problemet kryesore e cila krijon efekte në konfirmimet e titujve të pronësisë nga institucionet publike që kanë për detyrë dhënien e vërtetësisë mbi këto tituj. Kjo është evidentuar edhe si një nga shkaqet për ekzistencën e rreth 600 konflikteve gjyqësore në proces vetëm në Ministrinë e Financave si rrjedhojë e procedurave të privatizimit ndër vite. Vlera e shmangieve me efekte negative financiare të identifikuar nga auditimi është 337,839 mijë lekë, si pasojë e vendimmarrjeve të gabuara dhe zgjatjes së procedurës së tjetërsimit të pronës publike duke u bazuar në vlerësime të kryera vite më parë dhe që nuk reflektonin vlerën në momentin e shitjes.

10. Mos vendosja e gjobave gjatë bllokimit të aktiviteteve informale në lojrat e fatit

Nga auditimi i ligjshmërisë së bllokimit të veprimtarisë dhe sekuestrimit të pajisjeve të lojërave të fatit u konstatua se nga inspektorët e kontrollit të AMLF, nuk janë vendosur gjoba për 4761 mjete të konfiskuara në 2015 në shumën 26,583,000 mijë lekë dhe për 5,581 mjete të konfiskuara në 2016 në shumën 29,556,500 mijë lekë, në total për të dy vitet në 1,940 subjekte të palicensuara, në shumën 50,294,500 mijë lekë. KLSH ka konstatuar që informaliteti në këtë sektor vazhdon të mbetet i lartë dhe në të ardhmen ka vendosur të kryej një auditim performance për kur të vlerësohet efektet e masave dhe ndërmarra në vitet e fundit, përfshirë këtu edhe rezultat e aksionit “Fundi i Marrëzisë”.

11. Mungesa e bazës së qartë rregullative për raportimin financiar në sektorin publik

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të shtetit synojnë të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të shtetit. Konstatohet se, edhe për vitin 2016, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, nuk janë pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit. Mungesa disavjeçare e pasqyrave të konsoliduara të shtetit në gjykim tonë ndikon jo vetëm në nivelin e transparencës, por është e lidhur ngushtë me analizën e treguesve makroekonomik. Konstatohet se nuk ka një bazë të qartë rregullative mbi të cilën realizohet Raportimi Financiar, fakt që krijon hapësira për mangësi të theksuara në mbajtjen e kontabilitetit dhe në raportimin financiar nga njësitë që duhet të raportojnë mbi bazë të standardeve të kontabilitetit publik. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk disponon listën e plotë të të gjithë institucioneve buxhetore dhe jo buxhetore, bilanci i të cilave është pjesë e Pasqyrave të Konsoliduara të Shtetit. Edhe në vitin 2016, ka akoma Ministri, të cilat nuk hartojnë Pasqyra Vjetore të Konsoliduara, rasti konkret është Ministria e Transportit dhe Ministria e Mjedisit. Në kushtet kur ristrukturimi i qeverisë në fund të vitit 2017, ka prekur edhe shkrirje, ndarje apo bashkime të institucioneve shtetërore, KLSH ka kërkuar nxjerrjen e një udhëzimi që do të krijojë konsistencën me të cilin do të realizohet transferimi kontabël i aktiveve, dhe të drejtave dhe detyrimeve nga një strukturë në tjetrën. Në mungesë të një veprimi të tillë kemi vlerësuar rrezikun që procesi do të reflektojë konfuzion dhe pasaktësi të mëdha. Në janar 2018, KLSH ka filluar një auditim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me procesin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare me qëllim monitorimin e

këtij procesi në kushtet e ristrukturimit institucional dhe rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e këtij procesi nga strukturat përgjegjëse. Gjithashtu si KLSH kemi kërkuar që Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në mbështetje të strategjisë së financave publike, të publikojë menjëherë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS, si baza kryesore metodologjike mbi të cilën do të ndërtohet kontabiliteti publik në Shqipëri në të ardhmen e afërt.

12. Problematika dhe vështirësitë në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin nga institucionet publike

Ligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë publike të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, me qëllim përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë. KLSH ka konstatuar se në praktikë ka një lexim të ndryshëm nga entet publike, të fushës së zbatimi të këtij ligji duke synuar mos përfshirjen në kuadrin rregullues që sanksionon ky ligj. Tipike është sjellja e shoqërive aksionere me kapital shtetëror apo institucioneve të pavarura në krijimin e administrimit e fondeve, pavarësisht të qenit te tyre si ente publike. Për këtë kemi kërkuar që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa me qëllim zbatimin e plotë të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, duke përfshirë sipas karakteristikave specifike të tyre shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse, si dhe duhet të shprehet në kuadër ligjor për zbatimin nga institucionet e pavarura të cilat krijojnë apo shpenzojnë fonde publike. Nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2016, lidhur me ecurinë e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në disa institucione të pushteti qendror dhe atij vendor janë konstatuar problematika dhe vështirësi në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Subjektet reflektojnë një kuadër jo të plotë rregullativ të miratuar pas ndryshimeve strukturore të ndodhura, mungesa të strategjisë për menaxhimin e riskut, nuk dokumentojnë mbledhjet e GMS, nuk hartojnë gjurmët e auditimit dhe nuk ka stafe të trajnuar mjaftueshëm për zbatimin e MFK. Konstatohet se ka përpjekje për plotësim të dokumentacionit sipas kërkesave të ligjit, por në praktikë ka mangësi në implementimin e tij.

Sa më lart u paraqit një përmbledhje e shkurtër e punës së Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit në KLSH dhe disa nga çështjet kryesore më ndikim në financat publike. Në vijimësi besojmë se KLSH do të kontribuoj pozitivisht duke nxitur dhe monitoruar masat që do ndërmerren në lidhje me to.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT

Nga z. Bajram LAMAJ, Drejtor Departamenti

Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit për vitin 2018 ka realizuar planin e auditimeve 100%, si dhe ka kryer 3 auditime për vitin 2018, duke kryer dhe evaduar **19 auditime**, nga këto kemi: *1 auditim në ZVRPP, 6 auditime në ALUIZN-i, 5 auditime në Ente Mjedisore: 2 auditime në Drejtori Mjedisit dhe 3 auditime në DR Inspektoriatit të mjedisit, një auditim Zbatimi i Rekomandimeve të vitit 2016 dhe një auditim tematik për pronat bashkia Finiq (ish komuna e Mesopotamit).*



Nisur nga gjetjet, kemi rekomanduar **600**

masa gjithsej, nga të cilat 487 masa organizative, 172 masa disiplinore (nuk kemi patur adresim institucional për 84 punonjës për masa disiplinore), 35 masa zhdëmtuese me vlerë 701,643 mijë lekë, nga kjo kemi 31,122 mijë lekë mungesë të ardhura nga privatizimi, 15 kallëzime penale për 49 persona (dy nga të cilat janë indicie me numër të pacaktuar personash), nga 7 kallëzime penale që ishin në vitin 2016, si dhe 18 masa organizative zhdëmtimi, për mospërdorimin me 3E të shpenzimeve dhe krijimin e të ardhurave.

Për secilin grup subjektsh të audituar nga ky departament gjatë vitit 2017 referuar tabelës përmbledhëse rezultatet e auditimeve dhe rekomandimet adresohen:

A. Në grupin e auditimit për 7 ZVRPP-të janë 341 masa gjithsej ose 56.8% të rekomandimeve, nga të cilat: 275 masa organizative, masa disiplinore, 61 masa zhdëmtuese me vlerë 254,149 mijë lekë dhe 7 kallëzime penale për 49 persona, (pa përfshirë dëmin në natyrë për pasuritë, me njësi matëse në natyrë, etj.)

B. Në grupin e auditimit për 5 Drejtori Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, janë rekomanduar 136 masa gjithsej, ose 22.7% e totalit të rekomandimeve, nga të cilat: 2 masa për përmirësim ligjor, të cilat janë zbatuar nga Drejtoria e Përgjithshme e nxjerrë VKM përkatëse; 106 masa organizative; 25 masa

zhdëmtuese me vlerë 47,021 mijë lekë; 65 masa disiplinore, si dhe 33 masa për persona që nuk kishin adresim institucional dhe 7 kallëzime penal për 22 persona, nga 1 kallëzim me 3 persona të vitit 2016.

C. Në grupin e auditimit për 5 subjektet Mjedisore (2 DRM dhe 3 DR Inspektoriate Mjedisi) janë 123 masa gjithsej ose 20.5% e totalit të rekomandimeve ndarë: 2 përmirësime ligjore, të cilat janë iniciuar për zbatim nga Ministria e Mjedisit; 106 masa organizative; 5 masa zhdëmtuese me vlerë 17,571 mijë lekë; 68 masa disiplinore, si dhe 10 masa me vlerën 156,000 mijë lekë për mospërdorimin me 3E, lidhur me mungesën e të ardhurave nga mos aplikimi i tarifave të lejeve mjedisore, mos aplikim dhe mos arkëtim të gjobave për kundërvajtjet në mjedis, etj.

Risitë në veprimtarinë e vitit 2017

a. Nga mirë menaxhimi i Departamentit është punuar më shumë me bazë risku në auditim duke rritur eficiencën e përdorimit të burimeve njerëzore me kosto të ulët për institucionin si në afate dhe efektivitetin produktiv nga auditimi, pra kemi synuar që të bëjmë auditime me risk të lartë. Kjo ka ardhur dhe nga përfshirja në planifikim e të gjithë audituesve dhe krijimi i grupeve të auditimit bashkëpunuese dhe harmonizimi i përbërjes së tyre me specialiste juriste, ekonomiste e hartograf, duke identifikuar riskun, si dhe zgjeruar fushat e përcaktuara në regjistrin e riskut, për përfshirjen e sa më shumë risqeve në procesin e auditimit, etj.

b. Janë përmirësuar e zgjeruar programet e auditimit, duke vënë në eficiencë gjithmonë kohën e punës së audituesve në terren dhe konkretizimin e rezultateve të auditimit, nëpërmjet diskutimit mes grupit dhe Drejtorit të afatit të auditimit, shmangur qëndrimin e panevojshëm në subjektet pa risk të lartë dhe përdorimin e kapaciteteve audituese në subjekte me pritshmëri më të lartë.

c. Hartimi i planeve koncize ka sjellë përqendrim të punës audituese, kjo dhe për faktin se zbatimi i rekomandimeve ka sjellë dhe ndryshimin e metodave të subjekteve, kjo kryesisht tek ALUIZNI dhe ZVRPP-të. Sigurisht kjo është rezultat i punës së KLSH, por gjithmonë kërkohet që profesionalizmi i audituesve të jetë përpara subjektit.

d. Rritja e cilësisë së auditimit, ka qenë një ndër objektivat që kemi arritur, kryesisht në auditimet e ZVRPP-ve dhe ALUIZNI-t, ku dhe rezultatet kanë qenë të mira dhe të vlerësuara.

e. Auditimi i shpronësimeve në projektin TAP të gazsjellësit, ku grupi i auditimit të ZVRPP Skrapar bëri një punë të mirë dhe me rezultate e impakt social në vendosjen

e ligjshmërisë e rregullshmërisë së pronës, kjo për faktin se nuk ishte audituar nga KLSH.

f. Vlerësimi i ankesave të qytetarëve dhe dhënia zgjidhje në afat mbi 300 ankesave, ose adresimi në institucionet përkatëse duke i vënë ato në lëvizje, ka bërë që të rritet besimi i qytetarëve tek KLSH, ku çdo ditë Drejtori pret 4-5 qytetarë dhe i sqaron ato. Fakti që nuk kemi patur kontestime si Departament nga qytetarët, Sekretarja e Përgjithshme dhe zoti Kryetar.

Mangësitë e këtij viti dhe që duhen përmirësuar:

a. Mungesa e auditimeve rezultative në fushën e mjedisit, kjo për faktin e mos njohurive të mjaftueshme në këtë fushë të audituesve tanë dhe mungesës së eficiencës dhe produktivitetit të ekspertëve të jashtëm, të angazhuar në Departament, pasi nuk kanë afruar ekspertizë apo përvojë rezultative në dy tre auditime të angazhuara.

b. Faktor tjetër ndikues negativ ka qenë dhe organizimi i centralizuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Inspektoratin Shtetëror (këto auditohen nga Departamente të tjera të KLSH) dhe mungesa e materialitetit në subjektet që kemi audituar, pasi këto kanë patur vetëm shpenzime Paga dhe Sigurime Shoqërore e Shëndetësore dhe shpenzime operative me materialitet të ulët.

Ky shqetësim është dhe në vitin 2018. Kemi filluar auditim në Agjencinë e Zonave të Mbrojtura në Shkodër dhe dokumentacioni mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Zonave të Mbrojtura në ministri, për të gjithë agjencitë (shqetësim ky që duhet ta zgjidhim sa më parë, pasi rrezikojmë auditimet në këto agjenci).

c. Mangësi tjetër është në nivelin profesional, ku prurjet e reja nuk arrijnë të futen në problematikat audituese që kemi si departament dhe ka munguar dëshira për të bashkëpunuar apo përditsuar me legjislacionin që punojmë ne si Departament. Për të rinjtë mbetet një sfidë e hapur, përshtatja me kërkesat specifike të auditimeve në fushën e aseteve.

Gjetjet kryesore të auditimeve për çdo grup subjektsh janë si më poshtë:

A. Për grupin e auditimit në 7 ZVRPP

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, paaftësisë dhe arrogancës së administratës shtetërore, si dhe në përmbushje të detyrave të saj kushtetuese dhe të objektivave strategjike Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë procesit të regjistrimit të pronave, transaksioneve të paligjshme të kryera me to, tjetërsimit të

pronave publike, falsifikimit të dokumentacionit të pronësisë me qëllim përfitimin padrejtësisht të titujve të pronësisë në zonat turistike dhe bregdetare, shmangien e pagesave në mënyrë korruptive, si dhe mënyrës së marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve, rritjen e transparencës për publikun dhe forcimin e kulturës së përgjegjshmërisë në administratën publike.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017, KLSH ka realizuar 7 auditime në zyrat e regjistrimit, ku është konstatuar një dëm ekonomik i matshëm në vlerën **254,149 mijë lekë** dhe të ardhura të munguara në vlerën **68,958 mijë lekë** pasqyruar sipas tabelave më poshtë:

Tabela nr. 1

“Evidenca përmbledhëse e shkeljeve me dëm ekonomik të konstatuara në auditimet e ushtruara për të ardhurat dhe shpenzimet, për periudhën Janar- Dhjetor 2017”

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i subjekteve	Kamat vonesa, qera, penalitet, sipërfaqet e përbashkëta, taksa e infrastrukturës, etj.
1	ZVRPP Lezhë	19,253
2	ZVRPP Librazhd	25,492
3	ZVRPP Kolonjë	600
4	ZVRPP Korçë	39,182
5	ZVRPP Skrapar	8,962
6	ZVRPP Mat	68,010
7	ZVRPP Durrës	92,650
	TOTAL	254,149

Tabela nr. 2

“Evidenca e të ardhurave të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, për periudhën Janar- Dhjetor 2017”

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i subjekteve	Në të ardhurat nga qiratë dhe privatizimi	Të tjera si taksa, penaliteti nga legalizimi
1	ZVRPP Librazhd	31,122	
2	ZVRPP Durrës		37,836
	TOTAL	31,122	37,836

Theksojmë që krahas dëmit ekonomik të matshëm në këto institucione ekziston edhe një dëm ekonomik i fshehur dhe i pamatshëm, shumë herë më i lartë se i pari, i cili lidhet me një zinxhir të stërzgatur pasojash sociale, mjedisore, ligjore dhe njerëzore, të shkaktuara si pasojë e paligjshmërive të kryera ndër vite me pronat nga ana e punonjësve dhe drejtuesve të ZVRPP-ve të cilat së bashku me problematikën e proceseve gjyqësore, përbëjnë dhe burimin kryesor të faturave të papërbalueshme që shteti shqiptar, duhet të paguajë tashmë dhe në vijim si pasojë e vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Janë rekomanduar **46 masa disiplinore** nga të cilat **27 masa "largim nga puna", 19 masa "vërejte deri në largim nga puna", janë kallëzuar penalisht 20 punonjës** të këtyre institucioneve përfshi edhe drejtuesit e tyre, si dhe në **2 raste** është përcjellë materiali për vlerësim nga prokuroria si indicie për kallëzim penal. Theksojmë që evidentohet një mungesë e theksuar e vullnetit dhe mosveprim, nga ana e drejtuesve të institucioneve përkatëse, për zbatimin e këtyre rekomandimeve, duke e çuar në 70% nivelin e moszbatimit të rekomandimeve për masa disiplinore të KLSH-së dhe duke u mjaftuar në rastin më të mirë vetëm me dhënien e disa masave paralajmëruese, ndërkohë që masat organizative dhe zhdëmtuese kapin masën e zbatimit 72%, që është tregues pozitiv.

Nga auditimi në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme KLSH ka konstatuar një sërë shkeljesh e mangësish në pothuajse të gjitha auditimet e zhvilluara. Në mënyrë të përmbledhur, shkeljet e konstatuara në auditimet e zhvilluara nga KLSH, konsistojnë në:

- Vonesa në Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces;
- Regjistrimi i lejeve të ndërtimit mbi truall shtetëror;
- Regjistrime pasurish me ndryshime të zërave kadastral;
- Regjistrimi në bashkëpronësi të paligjshme të pasurive bujqësore;
- Mos regjistrimi i sipërfaqeve të përbashkëta në ndërtimet e reja;
- Mos evidentimin dhe mos respektimi i procedurave të regjistrimit të pronave me mbivendosje;
- Mos bërja e bilancit AMTP-LN, printim III dhe listave të trojeve sipas kryefamiljarëve;
- Tjetërsimi i pronave publike, falsifikimit të dokumentacionit të pronësisë me qëllim përfitimin padrejhtësisht të titujve të pronësisë në zonat turistike dhe bregdetare;

- Regjistrimi i lejeve të legalizimit me mangësi në dokumentacion;
- Keqmenaxhim i zonave kadastrale dhe mos pasqyrim i saktë i gjendjes së pasurive bujqësore në KPP-të dhe Zonat Kadastrale të pa menaxhuara dhe të pa përfshira në Sistemin e Regjistrimit Fillestar.

Nga një vështrimi i shkurtër mbi problematikat kryesore të sipërpërmendura konstatohet si më poshtë:

1. Administrimi i praktikave dhe kërkesave në proces

Vonesat dhe zvarritjet e praktikave në proces janë evidente në të gjitha zyrat e regjistrimit, përmendin këtu auditimet e kryera në ZVRPP Durrës **14,289** praktika dhe ZVRPP Lezhë **673** praktika apo dhe zyrat e tjera, ku janë konstatuar praktika të pa përfunduara që prej 5-10 vite, pa dhënë shërbimin e faturuar të cilat kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP-ve ndaj publikut, mos administrimin në arkiv të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata në kundërshtim e Ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 “Për arkivat”.

2. Regjistrimi i lejeve të ndërtimit mbi truall shtetëror

Nga ZVRPP-t janë pranuar e regjistruar leje ndërtimi objekteve mbi truall shtetëror, me mangësi në formë e përmbajtje të dokumentacionin përbërës, duke mos refuzuar e kthyer dokumentacionin e mangët, mos kërkuar ndaj Bashkive zgjidhjen e marrëdhënies së truallit me pasojë detyrimet e rrjedhura nga vlera e shitjes së truallit si dhe vlera e qerasë nga përdorimi dhe zënia me ndërtim pa titull pronësie, për të cilat ZVRPP-t nuk kanë vendosur as kufizim (barrë kufizuese) mbi pronën ose mbi pasuritë ndërtimore të paktën në vlerën përkatëse të qirasë së përdorimit, duke shkaktuar dëm ekonomik të konsiderueshëm për buxhetin e Bashkive.

3. Regjistrime pasurish me ndryshime të zërave kadastral

Regjistrimi i pasurive me ndryshime të zërave kadastral pa dokumentacionin përkatës pra pa kërkuar dokumentet për vlerësimin apo kompetencën nga DAMT Qarkut, veprim në tejkalim të kompetencave të regjistruarit dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin e strukturave për mbrojtjen dhe administrimin e tokës bujqësore” ndryshuar me Ligjin nr. 10 257, datë 25.3.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001. Këto veprime kanë sjellë si pasojë zhvlerësimin e paligjshëm të vlerës së aseteve, resurseve nga zbritja në kategori e zërit kadastral, veprime këto me rezultate të pritshme evazioni,

në ulje të vlerës së detyrimit nga taksa vendore e tokës, taksë e cila diferencohet sipas kategorisë së zërit kadastral.

4. Regjistrimi në bashkëpronësi të paligjshme të pasurive bujqësore

Regjistrimi në Bashkëpronësi të paligjshme i pasurive bujqësore në Kartelat Pasurive të Paluajtshme (KPP) të çelura nga NJMP dhe pranuar e marrë në dorëzim nga ZVRPP-t, për të cilat nuk janë identifikuar e hapur KPP-të përkatëse sipas sipërfaqeve përcaktuar në AMTP-të, në kundërshtim me Ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", me Ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore". Këto veprime kanë sjellë: *lindjen e bashkëpronësisë së pa ligjshme, pengesa e regjistrimit të pasurive nga pamundësia e lëshimit të certifikatave të pronësisë qytetarëve kërkuar me cenim të së drejtës së pronësisë, në mënyrë të pa nevojshme, çuarjen e zgjidhjes së problemit në gjykata, në vend të zgjidhjes në rrugë administrative nëpërmjet ZVRPP, ZQRPP dhe DAMT-ve të NJQV-ve; pra humbje e kohës dhe shpenzime për qytetarët pa shkak ligjor, rritjen e praktikave në proces, shteg për veprime të paligjshme korruptive mbi pasuritë në KPP, si dhe pamundësinë e mos konfirmimit e gjendjes juridike të pasurive të kërkuara për verifikim e vlerësim të titujve, mos shkëmbimin e informacionit nga ZVRPP për KVVTP Prefektit Qarkut.*

5. Regjistrimi i sipërfaqeve të përbashkëta në ndërtimet e reja

Në regjistrimin e pasurive të llojit "pallat" nga firmat ndërtuese, nuk është llogaritur e kërkuar dokumentacioni për arkëtim dhe shlyerje detyrimi për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta dhe tarifës së shërbimit R-11, veprime këto që kanë sjellë si pasojë shmangien e taksës së kalimit të pronësisë nga shoqëritë ndërtuese, ndërkohë që apartamentet dhe njësitë e shitura qytetarëve përfshijnë në çmim dhe vlerën e këtyre ambienteve të përbashkëta, kufizimi i veprimeve mbi pasuritë nga qytetarët për shkak të vendosjes së kufizimeve mbi to.

6. Regjistrimi i pronave me mbivendosje

Nga ZVRPP-t nuk ka një evidencë të saktë të pasurive me mbivendosje, mungon identifikimi, raportimi, vendosja e database, pasqyrimi në harta përkatëse si dhe ndjekja e procedurave ligjore të pasurive të rezultuara me mbivendosje, njoftimin e palëve të interesuara, orientimin drejt zgjidhjes gjyqësore, shpeshherë duke stimuluar përparësinë jo reale nëpërmjet kundërshtimit të paligjshëm dhe krijimit së vonësës së regjistrimit të parë. Këto veprime kanë sjellë përfitime të dyfishta titujsh të paligjshëm pronësie nga mbivendosjet, duke stimuluar përparësinë jo reale, mos ndjekur procedurat ligjore për zgjidhjen e mbivendosjeve, trajtim të

pabarabartë e favorizim të njëjës palë, duke cenuar paanësinë e ZVRPP, moszbatimin i afatit 1 muhor të Kodit të Procedurave Administrative, mos nxjerrjen e urdhrit administrativ për refuzimin e regjistrimit, të pjesëve të mbivendosura, krijimin problemeve sociale ndërmjet palëve.

7. Mos bërja e bilancit AMTP-LN, listave printim III dhe listave të trojeve sipas kryefamiljarëve

Nga ZVRPP-t nuk është bërë bilanci AMTP-Libri i Ngastrave, Listave Printim III, si dhe listave të trojeve sipas kryefamiljarëve duke mos veçuar e regjistruar "Shtet" sipërfaqen tepër mbi normë, në kundërshtim me Ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" dhe me nenin 25 të Ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978, si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", veprime këto që kanë sjellë si pasojë përfitimin e padrejtë të pasurisë shtet nga individët pa titull pronësie, kryerja e transaksioneve dhe tjetërsimi i saj duke sjellë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

8. Keqmenaxhim i zonave kadastrale dhe mospasqyrim i saktë i gjendjes së pasurive bujqësore në KPP-të dhe Zonat Kadastrale të pa menaxhuara dhe të pa përfshira në Sistemin e Regjistrimit Fillestar, që kanë sjellë si pasojë mosidentifikim të pasurive, përcaktime të pasakta të statusit juridik të pasurive në KPP dhe frenim të ritmeve të regjistrimit të tyre, në kundërshtim me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" dhe me Ligjin nr.33, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me udhëzimet përkatëse për regjistrimin fillestar të pasurive. Për këtë KLSH-it, ka rekomanduar për ZVRPP-të dhe ZQRPP Tiranë të kryejnë menaxhimin e ZK, përcaktojnë në KPP statusin juridik të pasurive të ndara sipas ligjit, tërheqin NJQV-të dhe administrojnë në arkiva dokumentacionin e munguar të AMTP-ve dhe listave të trojeve 001, si dhe të marrin masa për përcaktimin e fondeve për menaxhimin dhe futjen në sistemin e regjistrimit fillestar të pasurive për ZK e pa menaxhuara si kusht kryesor për shpejtimin e regjistrimit të pasurive bujqësore.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH

Gjatë vitit 2017 është kontrolluar zbatimi i rekomandimeve në 4 subjekte, të cilat janë audituar gjatë viti 2017, përkatësisht ZVRPP Kolonjë, ZVRPP Lezhë, ZVRPP Korçë dhe ZVRPP Librazhd. Nga verifikimi rezulton se në këto 4 subjekte janë lënë për zbatim **154 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar 112 ose 72 %, në

proces 20 dhe pa zbatuar janë 27 masa, **30 masa zhdëmtim dëmi me vlerë totale 105, 578, 903 lekë** të cilat janë pranuar të gjitha, por janë në proces arkëtimi si dhe **21 masa disiplinore** për të cilat ZQRPP nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP-të përkatëse lidhur me zbatimin e tyre, për rrjedhojë konsiderohen të porealizuara, më hollësisht trajtuar si më poshtë:

1- ZVRPP Kolonjë

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 20 rekomandime gjithsej, nga këto: 19 masa organizative dhe 1 masë zhdëmtimi me vlerën 300,000 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 19 masa organizative, të cilat, janë pranuar dhe zbatuar 2 rekomandime, janë në proces zbatimi 12 rekomandime, ndërsa 5 rekomandime nuk janë zbatuar.*
2. *Për shpërblim dëmi janë lënë 1 rekomandime për shumën 600,000 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar, por nuk është zbatuar.*
3. *Për masa disiplinore janë lënë: 1 rekomandim për "largim nga puna" për 2 punonjës. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP Kolonjë, për rrjedhojë konsiderohen të porealizuara.*

2- ZVRPP Korçë

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 45 rekomandime gjithsej, nga këto: 37 masa organizative dhe 6 masë zhdëmtimi me vlerën 39,182,344 mijë lekë, 13 masa disiplinore, nga të cilat 1 masë "vërejtje" deri në "largim nga puna", për 11 punonjës dhe 1 masë për "Zgjidhje të kontratës së punës", për 2 punonjës.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

1. *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 37 masa organizative, të cilat, janë pranuar dhe janë zbatuar 11 rekomandime dhe janë në proces zbatimi 8 rekomandime, si dhe nuk janë zbatuar 18 rekomandime.*
2. *Për shpërblim dëmi janë lënë 6 rekomandime për shumën 39,182,344 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar dhe janë të pa zbatuara, janë në proces.*
3. *Për masa disiplinore janë lënë: 1 rekomandim për "vërejtje me paralajmërim" për 9 punonjës dhe 1 rekomandim për "Zgjidhje të kontratës së punës" për 2 punonjës të*

cilat janë pranuar. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP Korçë, për rrjedhojë konsiderohen të porealizuara.

3- ZVRPP Librazhd

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 63 rekomandime gjithsej, nga këto: 49 masa organizative dhe 13 masë zhdëmtimi me vlerën 56,512,000 lekë, 1 masa disiplinore, “largim nga puna”, për 1 punonjës

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- 1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 49 masa organizative, të cilat, janë pranuar dhe janë zbatuar 49 rekomandime lidhur me vendosjen e kufizimeve.*
- 2. Për shpërblim dëmi janë lënë 13 rekomandime për shumën 56,512,000 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar dhe janë të pa zbatuara lidhur me arkëtimin e detyrimeve financiare, janë në proces.*
- 3. Për masa disiplinore janë lënë 1 rekomandim për “vërejtje me paralajmërim” për 1 punonjës. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP Librazhd, për rrjedhojë konsiderohen të porealizuara.*

4- ZVRPP Lezhë

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 54 rekomandime gjithsej, nga këto: 48 masa organizative dhe 6 masë zhdëmtimi me vlerën 12,294,559 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- 1. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 54 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe zbatuar 54 janë zbatuar 50, pa zbatuar 4.*
- 2. Për shpërblim dëmi janë lënë 10 rekomandime për shumën totale 12,294,559 lekë të arkëtueshëm, janë në proces por të pa zbatuara plotësisht.*
- 3. Për masa disiplinore janë lënë 1 rekomandim për “vërejtje me paralajmërim” dhe “deri në largim nga puna” për 7 punonjës. Lidhur me zbatimin e tyre ZQRPP nuk ka dërguar asnjë shkresë në ZVRPP Lezhë, për rrjedhojë konsiderohen të porealizuara.*

Shënim: ZVRPP e tjera nuk kanë qenë objekt i auditimit të zbatimit të rekomandimeve të vitit 2017.

B. Për grupin e auditimit në Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t

Në zbatim të programeve të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, janë planifikuar dhe audituar 5 subjekte (Drejtoria Përgjithshme ALUIZNI-t, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 2, Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Korçë, Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarku Sarandë dhe Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t Qarkut Shkodër).

Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme ALUIZNI-t dhe e Drejtorive Rajonale të ALUIZNI-t, në drejtim çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim e objekteve informale, nuk ka qenë efektive, pasi pavarësisht punës së bërë, mbi zbatimin e procedurave të legalizimit të ndërtimeve informale në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, gjithashtu janë konstatuar shkelje të ndryshme të procedurave në mos zbatim të akteve ligjore e nën ligjore si më poshtë:

Në auditimet e kryera është evidentuar **një dëm ekonomik** në vlerën **4,837 mijë lekë** kryesisht në fushën e prokurimeve, për mos pagesë TVSH-je, si dhe shkelje me efekt negativ në buxhetin e shtetit si:

- **në 277 raste** në procesin e legalizimit janë zënë sipërfaqe parcele në total prej 39690 m² dhe nga ana e Drejtorive Rajonale nuk është vepruar për shitjen e këtyre parcelave apo kthimin tyre në territore publike duke sjellë **një të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit në vlerën 70,917 mijë lekë** (nga mos veprimi me shitjen e parcelave të poseduesit referuar çmimit të tregut përcaktuar në VKM)
- **në 43 raste për 18038 m²** është ndryshuar statusi i parcelave të legalizuar nga “arrë”, “pyll”, etj., në truall veprim në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- **në 2975 raste, të ardhur të munguar në buxhetin e** Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV). **në një vlerë prej 266,647 mijë lekë**, është vepruar vetëm me njoftim për NJVQV dhe janë pajisur subjektet me leje legalizimi pa u arkëtuar më parë Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë në shkelje të Ligjit nr. 9482/2006 i ndryshuar.

Nga KLSH me Vendimin e Kryetarit nr. 42, datë 30.04.2017, për të mundësuar arkëtimin e këtyre detyrimeve dhe në vazhdim është kërkuar “Propozim për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi”, si më poshtë:

Ti kërkohet Ministrisë Zhvillimit Urban ti propozojë Këshillit të Ministrave të ndryshojë nenin 46 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, duke përfshirë nenin 27, në të drejtat që i jepen Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë përkatëse për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Gjithashtu Ministria e Zhvillimit Urban ti propozojë Këshillit të Ministrave të ndryshojë pikën 5, të VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", sipas së cilës ... "Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi", e cila bie në kundërshtim me nenin 27të Ligjit nr. 9482, datë 03.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar.

- **Në 19 raste janë kryer legalizime të objekteve të ndërtuara pa leje në; afër detit, lumenjve apo kanaleve kulluese; 3 raste në toka publike; 31 raste pa respektuar distancat nga rrugët automobilistike 3 raste janë legalizuar objekte informate të pa përfunduar në; 17 raste janë legalizuar objekte informate në zona të mbrojtura arkeologjike të kategorisë "A" dhe 1 rast në zona të mbrojtura të kategorisë "B"; 18 raste ndërtime informate në zona të mbrojtura liqenore e lagunore.**

Për të gjitha rastet është kërkuar shfuqizimi i lejeve të legalizimit dhe marrjen e masave për nëpunësit përgjegjës duke kryer kallëzim penal në dy raste për 9 persona dhe një indicie për kallëzim penal.

- Në Drejtorinë e Përgjithshme e ALUIZNI-t, është konstatuar se; në vitin 2016 në totalin e fondit të pagave prej 380,964 mijë lekë, fondi i pagave i shpenzuar për punonjësit me kontratë zë një peshë të konsiderueshme në vlerë prej 144,345 mijë lekë ose në masën 38 % dhe në totalin e fondit për sigurimet shoqërore prej 64,035 mijë lekë, fondi i shpenzuar për punonjësit me kontratë zë një peshë të konsiderueshme në vlerë prej 25,255 mijë lekë. Raportimi i këtyre shpenzimeve në vlerë 169,600 mijë lekë (144,345 mijë lekë + 25,255 mijë lekë) në Grupin 602 "Shpenzime operative" sjell një deformim të fondit të pagave deklaruar nga ky Institucion. **Ky zë përbën rritje rreth 50 % të fondit total të raportuar. Dhe rekomandimi i KLSH është:**

Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, të marrë masat që për sa kohë konstatohet nevoja për staf të eliminojë risqet e larta operationale që ka stafi i marrë me kontratë duke studiuar me kujdes nevojat për staf e fond dhe të kërkojë ndryshimin e strukturës me Vendimin e Këshillit të Ministrave të miratuar nga Kryeministri.

Për shkeljet konstatuara janë rekomanduar masa konkrete Organizative, Shpërblim dëmi dhe masa disiplinore zbatimi i tyre paraqitet si më poshtë:

- Janë rekomanduar gjithsej **104** masa, nga të cilat: janë pranuar **89** masa, ose 85.6 % e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar **15** masa, ose 14.4 %.

a- Niveli i zbatimit të rekomandimeve rezulton: zbatuar plotësisht **63** masa, ose 60.6 %, pjesërisht **26** masa ose 25 %, dhe **15** masa të pazbatuara, ose 14.4 %.

b- Niveli i realizimit të masave, sipas llojit paraqitet si më poshtë:

b. 1. Masa organizative, nga **81** të rekomanduara, janë pranuar **72**, pra 88.8%, janë zbatuar plotësisht **59** masa, ose 73 %, në proces zbatimi **13** masa, ose 16% dhe të pazbatuara 9 masa ose 11 %.

b. 2. Masa shpërblim dëmi, nga **23** masa të rekomanduara, janë pranuar **17**, ose 74 %, janë zbatuar plotësisht 4 masa, ose 17.4 %, pjesërisht 13 masa ose 56.6%, dhe 6 masa të papranuara dhe që nuk ka filluar zbatimi, ose 26%.

Zbatimi në vlerë është si vijon: **23** masa të rekomanduara **me vlerë 5,393 mijë lekë**, janë pranuar **17**, në vlerë **4,786 mijë lekë** ose 88 %, janë zbatuar plotësisht **7** masa me vlerën **1,358 mijë lekë** ose 25.2 %, janë zbatuar pjesërisht **1** masa me vlerën **332 mijë lekë**, ose 6 %, dhe janë pazbatuar (pa arkëtuar) **11** masa me vlerë **3,703 mijë lekë**, ose 68.6 %.

b. 3. Masa disiplinore, nga **40** masa të rekomanduara, janë pranuar 12 masa, ose 30%, nga të cilat janë zbatuar 12 masa ose 30%. Për 28 masa nuk ka informacion nga institucionet e prore (D.P. ALUIZNI Tiranë).

Sipas auditimeve konkrete dhe subjektet shkeljet kryesore të konstatuara janë:

1. Drejtoria e Përgjithshme

Nga gjithsej 463,196 vetëdeklarime për objekte informale, sipas të dhënave që disponon Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë, deri më 30.04.2017, rezulton se janë legalizuar gjithsej 120,409 objekte informale ose 26% e vetëdeklarimeve, megjithëse akoma nuk disponohen të dhëna të sakta mbi vet deklarimet në vite,

shumë objekte qytetarët i kanë vetëdeklaruar nga 2 herë dhe në pasqyrat e dhëna deklarohet se “mund të jenë 30 % të vetëdeklaruar me mbi dy herë”.

Nga auditimi u konstatua se nga shuma totale e vetëdeklarimeve *gjithsej 463,196 objekte, rezultojnë 17,000 objekte te kualifikuara nga Drejtoritë Rajonale*, por të pa pajisur me leje legalizimit duke u ndërprerë procedurat e legalizimit në mënyrë të pa dokumentuar dhe në kundërshtim me ligjit. Nuk ka një organizim dhe bashkërendim për ndjekjen dhe realizimin e strategjive të politikave në lidhje me procedurat e kompensimit dhe kalimit të pronës nga shteti tek pronari në përputhjen me kuadrin ligjor, për legalizimet e integrimin e zonave dhe ndërtimeve formale. Nga të dhënat e mara në Drejtorinë e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë nga viti 2006 deri më 30.06.2017, sipas informacionit për objektet e përjashtuara në drejtoritë rajonale të ALUIZNI-t në Qarqet Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë rezultojnë se janë skeduar për tu përjashtuar nga procesi i legalizimi **1,431 objekte** të ndërtuar në kundërshtim me ligjin, të dhëna të rezultuara të pa sakta pasi vetëm në 5 Drejtori Rajonale të audituara nga KLSH janë konstatuar **2,598 objekte** më shumë të skeduar për tu përjashtuar nga procesi i legalizimit por të pa deklaruar në Drejtorinë e Përgjithshme ALUIZNI-t –Tiranë, për të cilat nuk ka ndjekje të procedurave ligjore të përjashtimit nga procesi i legalizimit, pasi janë objekte të ndërtuara në zona Arkeologjike, zona historike, muzeale, rrugë, oborre shkollash, kanale vaditëse dhe kullues, troje publik, zona turistike, lumenj, liqene, vije hekurudhore, linja të tensionit të lartë, etj.

2. Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t, Qarku Korçë

*Nga auditimi i procedurave të legalizimit dhe aktivitetit financiar të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Qarku Korçë për periudhën objekt auditimi u konstatua një **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit me vlerë 763mijë lekë**, si dhe shkelje të procedurave të legalizimit konkretisht:*

- **në 23 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 8207 m² (në total), me një vlerë tarife, e cila sipas vlerës së trullit me çmim tregu referuar zonave kadastrale ka **shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve në shumën totale prej 18,468 mijë lekë**,

- **në 375 raste** në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27

*“Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç”, “vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë” me pasojë duke shkaktuar një **të ardhur të munguar në buxhetin shtetit në vlerën 38,506,651 lekë;***

- ***në 25 raste**, janë legalizuar ndërtimet pa leje në sipërfaqe tokë shtetërore dhe publike, pa respektuar distancat nga brigjet, pranë kanaleve kulluese dhe brezit mbrojtës dhe pa respektuar distancat nga rrugët nacionale; pranë linjave të tensionit të lartë dhe shtyllave së tensionit të lartë;*
- ***në 10 raste, gjithsej për 4573.3 m²**, kanë ndryshuar statusin e parcela ndërtimore nga llojit “Arë, pyll” në “truall”;*
- ***në 40 raste** nuk ka objekt të përfunduar, nuk ka dokumentacion pronësie për truallin, nuk administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit dokumentacioni që provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal dhe “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, nuk është në përputhje me Manualin;*

3. Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t, Qarku Shkodër

*Nga auditimi i procedurave të legalizimit dhe aktivitetit financiar të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Qarku Shkodër për periudhën objekt auditimi u konstatua një **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit me vlerë 2,311 mijë lekë**, si dhe shkelje të procedurave të legalizimit konkretisht:*

- ***në 8 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej 1983 m² (në total), me një vlerë tarife e cila sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale ka **shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve në shumën totale prej 9,168,147 lekë;***
- ***në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal”** ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, pika “ç” “vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë” me pasojë duke shkaktuar një **të ardhur të munguar në buxhetin shtetit në vlerën 157,528 mijë lekë;***
- ***në 15 raste**, janë legalizuar ndërtimet pa leje në sipërfaqe tokë publike, pa respektuar distancat nga brigjet dhe pa respektuar distancat nga rrugët;*

- **në 24 raste, gjithsej për 10,791 m²**, kanë ndryshuar statusin e parcela ndërtimore nga llojit “Arë” në “truall”;
- **në 23 raste** nuk ka objekt të përfunduar, nuk administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit dokumentacioni që provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal dhe “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, nuk është në përputhje me Manualin;

4. Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t, Tirana 2

Nga auditimi i procedurave të legalizimit dhe aktivitetit financiar të Drejtorisë ALUIZNI-t Tirana 2, për periudhën objekt auditimi u konstatua një **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit me vlerë 51,142 lekë**, si dhe shkelje të procedurave të legalizimit konkretisht:

- **në 1,660 raste** në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, me pasojë duke shkaktuar një **të ardhur të munguar në buxhetin shtetit në vlerën 32,386 mijë lekë**;
- **në 45 raste** në dosjen e Lejes së Legalizimit lëshuar për objektet “Shtesë kati në objektin ekzistues”, mungon akt marrëveshja me banoret e kateve të tjera, si bashkëpronarë të ndodhur vertikalisht, në kondicionet e veçanta është shënuar sipërfaqe verandë dhe “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, nuk është në përputhje me Manualin;
- janë lëshuar leja e legalizimit dhe nuk është vepruar për shpronësim parcelave ndërtimore që i përkasin **115 objekteve në vlerën 22,082 mijë lekë**;
- **në 13 raste** nuk disponohet në dosje dokumentacionin që të pasqyrojë **periudhën e ndërtimit pa leje, pjesën e shtesës pa leje, ndryshimet e sipërfaqeve të ndërtimit dhe kohën ndërtimit**.

5. Drejtoria Rajonale ALUIZNI-t, Qarku Sarandë

Nga auditimi i procedurave të legalizimit dhe aktivitetit financiar të Drejtorisë Rajonale ALUIZNI-t Sarandë, për periudhën objekt auditimi u konstatua një **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit me vlerë 1,714 mijë lekë**, si dhe shkelje të procedurave të legalizimit konkretisht:

- **në 131 raste** është evidentuar një sipërfaqe parcelë ndërtimore brenda/jashtë vijës së verdhë e pa legalizuar prej **29,500 m²** (në total), me një vlerë tarife e cila

sipas vlerës së truallit me çmim tregu referuar zonave kadastrale ka **shkaktuar mungesë të ardhurash në buxhetin të shtetit për fondin e kompensimit të ish pronarëve në shumën totale prej 21,199 mijë lekë:**

- **në 940 raste** në marrjen e vendimeve “Për kualifikimin për legalizim të objektit informal” ka vepruar në kundërshtim me ligjin, me pasojë duke shkaktuar një **të ardhur të munguar në buxhetin shtetit në vlerën 38,228,821 lekë;**
- **në 10 raste** janë mbajtur 2 akt-verifikime për dosjet në periudha të ndryshme me diferencë kohe nga 1 vit deri në 3 vjet, pa proceduar me dhënien e lejes së legalizimit që pas akt-kualifikimit të parë më mënyrë të paargumentuar,
- **në 75 raste**, u konstatua se nuk administrohet në praktikën dokumentare të legalizimit dokumentacioni që provon periudhën në të cilën është ngritur ndërtimi informal;
- **në 75 raste** “Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje”, nuk është në përputhje me Manualin;
- **në 70 raste** plani i hartuar nuk ka të përcaktuar hyrjen në parcelë por vetëm hyrjen në ndërtesë sipas shenjave konvecionale;
- **në 14 raste** ka rezultuar se ka mos përputhje të sipërfaqeve të katit përdhe me sipërfaqen për banim për sipërfaqen totale prej 138.5 m², pasi pjesa e verandës është përfshirë tek sipërfaqja e banimit dhe jo në kodicionet e veçanta të lejes, ndërkohë që për sipërfaqen 285.9 m² janë miratuar leje legalizimi me mospërputhje të sipërfaqeve të miratuara me VKM;
- **në 3 raste** janë miratuar leje legalizimi në zonën e Borshit si pjesë e vijës bregdetare që nuk lejohet legalizimi i objekteve deri në hartimin e planit të integruar sektorial për vijën bregdetare;
- **në 9 raste** janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga brigjet;
- **në 9 raste**, gjithsej për 2674 m², kanë ndryshuar statusin e parcela ndërtimore nga llojit “Arë, pyll” në “truall”;
- **në 17 raste** janë kryer legalizime të objekteve të ndërtuara brenda zonës së mbrojtjes mjedisore “A” Parku Kombëtar i Butrintit;
- **në 8 raste** është proceduar me dhënien e lejes së legalizimit për objektet mbi 4 kate, pa u administruar më parë në dosje akt-ekspertiza për ndërtimin mbi 4 kat, pa u ankimuar Vendimet e Gjykatave të Shkallës së Parë, të cila kanë marrë formë të prerë pas kalimit të afateve të ankimit, në Zonën “B” Muzeal, kur konfirmimi i statusit juridik nga ZVRPP Sarandë cilëson se parcela bie mbi rrugë.

C. Në grupin e auditimit për kryerjen e auditimeve në subjektet Mjedisore, ndahen në dy nëngrupe:

Nga auditimet në 5 subjekte janë evidentuar këto probleme:

1. DR ISHMP (Lezhë, Kukës dhe Elbasan):

- Performancë e ulët në kryerjen e i inspektimeve, shoqëruar me mungesë dokumentacioni, mosinspektim në të gjithë territorin, tolerancë në drejtim të zbatimit të masave këshilluese parandaluese, të vendosjes së sanksioneve për shkeljet, mos ndjekje të procedurave ligjore për arkëtimin e gjobave, në kundërshtim me manualin dhe Ligjin 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, Ligjin nr 111/2012, datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Janë rekomanduar gjithsej 123 masa, nga të cilat 2 propozim për përmirësim ligjor, 106 masa organizative, 71 masa disiplinore, 5 masa shpërblim dëmi me vlerë 16,705 mijë lekë dhe 5 masa për 3E me vlerë 343,598 mijë lekë.

- Nuk janë hartuar plane mujore të inspektimit për subjektet që ishin të pa pajisur me leje mjedisi, nuk ka hartuar plane inspektimi për të kontrolluar respektimin e kushteve të lejeve të mjedisit nga subjektet që disponojnë leje mjedisi qoftë ajo e Tipit A, B apo C si dhe subjektet që janë të pajisur me Leje Mjedisore apo Autorizim Mjedisor.

- DRISHMP-të nuk kanë hartuar programe mbi bazë risku dhe hartuar e miratuar plane mujore dhe vjetore nga Kryeinspektori i Inspektoratit Qendror (IQ).

- Planet mujore të punës për inspektorët nuk janë zbatuar dhe nuk janë nxjerrë në çdo rast “Autorizime Inspektimi”, si dhe nuk janë përpiluar proces verbale inspektimi për çdo objekt të kontrolluar. në Programin vjetor, nuk janë përcaktuar tematikat e inspektimit bazuar në objektivat vjetorë dhe afat mesëm, në përputhje me objektivat e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Tiranë.

- Nuk janë konstatuar prerje të paligjshme të pyjeve shtetëror dhe komunalë, dhe shpërdorim të sipërfaqeve pyjore.

- Nuk ka një informacion për fondin pyjor kullor ne rastet e dhënies me qera.

- Nuk ka patur bashkëpunim efektiv ndërmjet sektorëve të inspektimit të policisë pyjore të ISHMP, me strukturat e tjera policore e shtetërore dhe drejtoritë përkatëse të menaxhimit të pyjeve të pushtetit vendor, lidhur me shkëmbimin e informacionit, për të bërë të mundur parandalimin e kundërvajtjeve, si dhe

zbulimin e rasteve të konstatuara pa autor, për dëmet e shkaktuara në ekonomitë pyjore.

- Nuk ka kryer kontroll të vazhdueshëm dhe efektiv për mbrojtjen e mjedisit në zonat me rëndësi të veçantë, pasi nuk ka programuar inspektime më të shpeshta të zonave turistike, zonave të mbrojtura dhe zonave arkitekturore, për të bërë të mundur dhënien e përparësisë së mbrojtjes së mjedisit në këto zona.

- Nuk janë zbatuar procedura ligjore të ekzekutimit dhe arkëtimit të gjobave të vëna nga masat për dënimet administrative për kundravajtjet, në inspektimet e sektorit të mjedisit për periudhën 2015-2016. Konkretisht në 17 masa me vlerë 5,060 mijë lekë, për vitin 2015 për 14 gjoba me vlerë 3,960 mijë lekë, për vitin 2016, për 3 gjoba me vlerë 1,100 mijë lekë, pra një nivel të ulët të arkëtimit të gjobave, mungesë të evidencimit, kontabilizimit dhe manexhimit financiar dhe kontrollit, dhe ecurisë së procedurave ligjore të procesit administrativo ligjor.

Nga auditimi në **60 raste** të përzgjedhura, grupet e inspektimit në terren, kanë kryer vetëm një verifikim të thjeshtë për lëshimin e lejes mjedisore dhe pagesat vjetore lidhur me to, në këto raste proces-verbalet mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficiente, jofunksionale, të paplota.

Si institucione të krijuara prej shkurtit 2014 ka mangësi të theksuar në organizimin e tyre, në investime e pajisje kompjuterike, pajisje e mjete të tjera pune, si dhe shoqëruar me to me mungesë base të dhënash dhe mungesë të vendosjes dhe instalimit të sistemeve IT me të dhënat bazë, të cilat ndikojnë në përmbushjen e funksionimit të DRISHMP.

Në shumë institucione mjedisore për vitin 2015-2016, është kostatuar se për periudhën e audituar, nuk janë përpiluar pasqyrat financiare për vitin 2015, nuk është përgatitur bilanci kontabël për vitin 2015, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrave Financiare").

Për vitin 2015-2016 DR ISHMP-të, nuk kanë vepruar për vjeljen e gjobave për kundërvajtjet administrative, ku pas marrjes së vendimit për dënim me gjobë dhe detyrimeve të tjera, duhej që pas kalimit të afatit 30 ditor nga data e vendosjes së gjobës, ta ndjekin këtë proces në rrugë gjyqësore.

Të ardhura të munguara

- Janë konstatuar gjithsej **17 subjekte**, nga të cilat deri në fund të vitit 2016, 11 subjekte janë të pa pajisura me leje mjedisore dhe nuk janë bërë ri inspektime dhe për 6 subjekte grupet e inspektimit në terren, nuk kishin lënë afat për zbatimin e

detyrave, në moszbatim të nenit 65, të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, tjera subjekte. Këto veprime bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Për shkeljet e konstatuara, në zbatim të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet”, “pa lejen përkatëse të mjedisit të tipit C, subjektet dënohen me gjobë në vlerën nga 300 mijë deri në 500 mijë lekë”, në total me një vlerë prej 5,100 mijë lekë si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit.

Masa për shpërblim dëmi

- Janë konstatuar se në **24 raste, në vlerën 19,543 mijë lekë, e cila përbën dëm ekonomik**, prerje të pyjeve për përdorim si lëndë përpunuese dhe si lëndë dru zjarri, të cilave u mungonte dokumentacioni përkatës që vërteton marrjen e masave për bllokimin, sekuestrimin dhe dorëzimin e materialit në pikat e licencuara të grumbullimit, apo në pikat e NJQV-së, për rrjedhojë rezultoi e pa dorëzuar në pikat e grumbullimit.

1. Në DRM (Fier, Gjirokastrë)

- Performancë e ulët në kontrollin e territorit për ruajtjen e ndotjeve dhe uljen e parametrave të ndotjes në mjedis, moszbatimi i legjislacionit lidhur me miratimin e lejeve mjedisore, në kundërshtim me Ligjin “Për lejet e mjedisit”. Janë rekomanduar gjithsej **67 masa**, nga të cilat **47 masa** organizative, 13 masa disiplinore, 3 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,524 mijë lekë, 2 masa përmirësim ligjor dhe 2 masa për 3E me vlerë 151,000 mijë lekë.

2. DRM Fier

- DRM Fier periudhën 2014, 2015 dhe 2016 ka lejuar vendimmarrjen për leje të tipit C, pa miratimit e NJQV-ve, për **560 raste** (nga **782 raste**), nga të cilat në **203 raste (nga 425 dërgesa) për mos kthim** përgjigje brenda afatit 3 ditor nga NJQV-të dhe në **357 raste nga mos dërgimi i kërkesës** për mendim në NJQV.

- Gropat ekologjike të krijuara nga shoqëria “Bankers Petroleum” dhe gropat mbledhëse të naftës që krijohen nga shoqëria **Albpetrol sh.a.**, në të cilat janë depozituar mbetjet e dala nga procesi i shpimit dhe i prodhimit të naftës bruto, të cilat përbëjnë mbetje të rrezikshme, krijojnë për zonën një ndotje të madhe të tokës dhe ajrit, pasi nuk ka një impiant për trajtimin sa më të shpejtë të naftës së mbledhur në këto gropa të hapura.

- Nga ana e shoqërive të nxjerrjes dhe përpunimit të naftës me aktivitet në Qarkun Fier, nuk janë marra masa parandaluese për kufizimin dhe ndalimin e

derdhjes së mbetjeve të naftës në zonën bregdetare nga ana e shoqërive si, **Albpetrol, "Bankers Petroleum" dhe Armo.**

- Problem madhor është edhe teknologjia e përdorur nga shoqëria kanadeze **"Bankers Petroleum"** për shpimin e puseve të naftës, disa prej të cilëve kanë shpërthyer në datën 01.04.2015 duke vënë në rrezik banorët që jetojnë shumë pranë zonës ku nxirret nafta. Shpërthimi i ujërave nëntokësore në oborret e banesave dhe çlirimi i gazrave, detyroi autoritetet të evakujnë banorët nga rreziku i ndotjes së mjedisit.

Për sa më lartë, megjithë faktet e përsëritura në Raportet e Ndikimit në Mjedis për vitet 2014 dhe 2015 (2016 në proces), fakte që lidhen me dëmtimet në mjedis nga **"Bankers Petroleum."** Nga DRM Fier nuk ka informacion në lidhje me ndërmarrjen e hapave nga ana e AKM dhe DRM Fier për të bashkëpunuar me inspektoratet e ndryshme apo institucionet e tjera. Mosveprime këto të cilat kanë sjellë si pasojë mos vendosjen e sanksioneve përkatëse, për ndjekjen dhe shkeljen e kushteve të lejes mjedisore ndaj Bankers Petroleum, por mbi të gjitha mos vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në Zharrëz dhe ndotje masive në mjedis. Pavarësisht faktit që Bankers Petroleum ka leje mjedisore të tipit A. Kjo nuk përjashton DRM Fier për të informuar dhe bashkëpunuar me AKM dhe DISHMP Fier, me qëllim mbrojtjen e mjedisit në juridiksion territorial ku ajo ushtron kompetencat e veta.

DRM Fier nuk ka mbajtur Librin i Regjistrimit të vajrave të përdorur për deklarimin e destinacionit përfundimtar të mbetjeve si detyrim ligjor për subjektet që me veprimtarinë e tyre gjenerojnë mbetje të rrezikshme vajore si uzina, fabrika, pika shërbimi, ofiçina, servise makinash që merren me ndërrimin e vajrave, porte, aeroporte, hidrocentrale, hekurudha, firma transportesh, kompani të përpunimit të naftës, etj.).

MANGËSITË E PUNËS NË DEPARTAMENT, TË CILAT JANË KONSTATUAR DHE VËNË NË DUKJE GJATË VITIT 2017

A. Mangësi në procesin e hartimit të programit dhe fillimit të auditimit në drejtimet:

- Studimi dhe përgatitja e dokumentit të riskut për subjektin e auditimit, nisur nga Regjistri i Riskut dhe nga veçoritë e entitetit që do të auditohet;
- Përcaktimi i volumit të punës, zgjedhja e praktikave që do të auditohen;

- Përcaktimi dhe hartimi i dokumentit nr.5 të ndarjes së detyrave në përputhje me volumin, profesionin e anëtarëve të grupit dhe në kohën e duhur.

B. Mangësi në cilësinë dhe në rezultatet e auditimeve për grup subjektet, parë nga këndvështrimi i gjetjeve risqeve të identifikuar dhe rezultuara, si dhe nga trajtimi i pikave të programit, gjë e cila pa u zgatur del qartë nga trajtimi i punës për çdo grup auditimi.

- Evidentohen grupe që nuk e kanë dhënë cilësinë dhe efektivitetin e duhur në auditime, mangësi kjo që është vënë në dukje nga Kryetari, dhe ne e kemi riparuar.

- Diferencat, ndërmjet auditimeve në dokumentet lidhur me gjetjet, përmbushjen e pikave të programit, formulimet, etj., që tregojnë diferenca në mes audituesve të cilat nuk duhet të ekzistojnë dhe që duhet të jenë drejtimi i përmirësimit të punës për vitin 2018.

Kryerja e trajnimeve nëpërmjet përvojës së mirë brenda Departamentit, nuk ka qenë në nivelin e lartë që kërkon z. Kryetar, ndaj duhet të jepni propozime dhe të marrim masa për kryerjen e tyre si për përditësimin me legjisllacionin por dhe me kauzës të ndryshme.

- Vonesat në mbylljen e evidencave dhe mungesa e cilësisë së përgatitjes së tyre.

- Për të gjitha këto duhet të fokusohemi tek puna në grup, bashkëpunimin e cila ka vend për të rritur shkallën e bashkëpunimit deri në mbylljen dhe dorëzimin e dosjeve.

PËR VITIN 2018

Përmirësimin e punës për vitin 2018, Departamenti ynë do ta mbështesë në arritjen e këtyre objektivave:

- Të rritet puna e gjithsecilit për të përmbushur me rezultate sa më të larta sipas udhëzimeve të z. Kryetar, për të përmbushur objektivat e platformës së bërë nga z. Kryetar në fillim të mandatit të tij.

- Rritja e cilësisë së auditimeve në drejtim të përmirësimit të formulimeve, në sistemimin e gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve, me qëllim përgatitjen dhe evadimin e materialeve sa më cilësore, profesionale dhe objektive.

- Të punojmë për rritjen e kapaciteteve audituese, nëpërmjet pjesëmarrjes me përgjegjshmëri në trajnimet e kryera nga KLSH dhe nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave brenda Departamentit dhe jashtë saj grupeve të auditimit.

- Të punohet me profesionalizëm për shkurtimin e volumit të Raporteve të Auditimit, nëpërmjet përdorimit të tabelave dhe anekseve, për sistemimin e informacionit, veçanërisht në auditimet e ZVRPP-ve, sipas Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-it.
- Vazhdimi i punës për standardizimin e auditimeve, duke shmangur diferencat ndërmjet auditimeve, mbështetur në regjistrin e riskut dhe në auditimet më të mira si: ZVRPP Lezhë, Korçë, ALUIZNI Shkodër e Korçë dhe të standardizojmë auditime të tjera në entet e tjera mjedisore, ku kemi mangësi të theksuara.
- Të përgatiten dokumentet sipas standardeve dhe Rregullores së KLSH-së dhe të eliminohen mangësitë e konstatuara nga kontrolli i cilësisë në të ftohtë.
- Të rritet shkalla e bashkëpunimit në grup, duke sjellë përmirësimin e Raporteve të Auditimit, si dhe evadimin në kohë të materialeve.
- Të rritet pjesëmarrja e audituesve të Departamentit në shtypin e përditshëm.
- Të rritet kontributi i audituesve me përvojë në përcjelljen e përvojës tek audituesit pa përvojë.
- Përfshirja në sistemin e digjitalizimit të procesit të auditimit të KLSH-it, veçanërisht në auditimet pilot që do kryejmë.

Duke ju falenderuar të gjithëve për punën e kryer në vitin 2017, kam besim që me përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin tuaj, do të arrijmë të rritim cilësinë e punës audituese dhe zbatimin e etikës së KLSH në vitin 2018, për të realizuar auditime sa më objektive, profesional dhe për të rritur besimin publik ndaj institucionit të KLSH-së.

MBI AUDITIMET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Nga z. Kozma KONDAKÇIU, Drejtor Drejtorie

Drejtoria e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit ushtron aktivitetin e saj që nga dhjetori i vitit 2014, në vijim të përcaktimeve të Ligjit të ri të KLSH, nr.154, datë 27.11.2014, neni 3 dhe 14.

Gjatë viteve 2015-2017 janë hedhur hapa drejt zhvillimit Auditimit IT nëpërmjet:

- Rekrutimit të punonjësve të rinj.
- Zhvillimi i kapaciteteve audituese.
- Pajisja me metodologjinë e duhur të Auditimit IT.

Ndër rezultatet e arritura nga kjo drejtori gjatë vitin 2017 veçojmë:

- *Zhvillimi i një Auditimi TI pilot me asistencë të IPA-s.*
- *Përdorimi i manualit aktiv të auditimit në auditim.*
- *Nisja e krijimit të bazës së të dhënave për subjektet e auditimit IT(ICTS Database).*
- *Krijimi i linjës së parë të suportit me njohuri mbi auditimin IT dhe trajnimi i tyre.*

Si rezultat i përdorimit të analizës së riskut në planifikimin e auditimit nëpërmjet manualit aktiv të auditimit IT u arrit një rritje e treguesve gjatë vitit 2017 dhe ato të 6 mujorit të dytë në veçanti si më poshtë.





Treguesi	Njësia	Vlera
Fuqia maksimale Audituese e drejtorisë	Ditë/njerëz	1210
Auditime të planifikuara	numër	4
Për çdo auditim mesatarisht	Ditë/njerëz	302

Auditimet e kryera për vitin 2017

1. Drejtorinë e Ujësjellës Kanalizimeve, Tiranë (UKT). *Evaduar me vendimin Nr.119, datë 25.09.2017 (Nr.479/5 Prot.)*

Pas ushtrimit të Auditimit TI në UKT sh.a., KLSH arrin në konkluzionin se TI në UKT zhvillohet në mungesë të një Strategjie të Teknologjisë së Informacionit, duke sjellë mos pasqyrimin qartë të objektivave të sh.a., lidhur me infrastrukturën TI dhe burimet e nevojshme për ngritjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e saj.

Mungesa e Planit Strategjik mbart riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së UKT nga Teknologjia e Informacionit.

Teknologjia e Informacionit duhet të shtrihet në gjithë proceset e aktivitetit të Ujësjellës Kanalizime sh.a., Tiranë.

2. Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH). *Evaduar me vendimin Nr.65, datë 18.06.2017.*

Pas ushtrimit të Auditimit TI në ISSH, KLSH konstatoi se Instituti i Sigurimeve Shoqërore po zhvillon Teknologjinë e Informacionit duke shfrytëzuar burimet e vëna në dispozicion duke dhënë një kontribut në administrimin e sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe në zbatimin e politikave të pensioneve në veçanti.

Në saj të përdorimit të TI është përmirësuar mbulimi i popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore, është rritur numri i kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet, TI ka ndikuar në përmirësimin e eficiencës dhe transparencës në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore.

Pavarësisht arritjeve nga Auditimi u lanë rekomandime zbatimi i të cilave si dhe mbështetja e zhvillimit të TI në ISSH nga strukturat qeveritare do të rris stabilitetin dhe sigurinë e skemës së pensioneve.

3. Auditim i IT në INSTAT. *Evaduar me vendimin Nr.199 datë 28.12.2017.*

Pas ushtrimit të Auditimit TI në INSTAT, KLSH konstatoi se mungesa e Strategjisë në INSTAT ka sjellë mos pasqyrimin qartë të objektivave të institucionit lidhur me infrastrukturën TI dhe burimet e nevojshme për ngritjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e saj.

Mungesa e Planit Strategjik mbart riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së INSTAT nga Teknologjia e Informacionit.

Me gjithë përpjekjet e bëra, INSTAT nuk ka marrë masa të mjaftueshme rregullatore dhe organizative për garantimin e sistemeve të informacionit.

Në gjykimin tonë, menaxhimi i elementëve kritikë në sistemet e informacionit, është i pa pamjaftueshëm dhe i papërshtatshëm, Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe nuk kanë siguruar Rimëkëmbjen nga Katastrofat.

4. Auditim i IT në DPTTV. *Evaduar me vendimin Nr.19, datë 28.12.2017.*

Pas ushtrimit të Auditimit TI në DPTTV, KLSH konstatoi se mungesa e Strategjisë ka sjellë mos pasqyrimin qartë të objektivave të institucionit lidhur me infrastrukturën TI dhe burimet e nevojshme për ngritjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e saj.

Mungesa e Planit Strategjik mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së DPTTV nga Teknologjia e Informacionit.

Me gjithë përpjekjet e bëra, DPTTV nuk ka marrë masa të mjaftueshme rregullator dhe organizative për garantimin e sistemeve të informacionit.

Në gjykimin tonë, menaxhimi i elementëve kritikë në sistemet e informacionit, është i pa pamjaftueshëm dhe i papërshtatshëm, Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe nuk kanë siguruar Rimëkëmbjen nga Katastrofat.

Të metat e konstatuara gjatë vitit 2017

1. Hartimi i opinionit të auditimit

Grupi i auditimit duhet të tregojë kujdesit e duhur në formulimin e opinionit të auditimit i cili është një mesazh sintezë i auditimit jo vetëm për subjektin por edhe për publikun e gjerë.

2. Piramida e pyetjeve

Formulimit të piramidës së pyetjeve në përputhje me manualin e auditimit it dhe paraqitja e tyre në pjesët respektive të raportit.

3. Struktura e raporteve

Duhet të përmirësojmë strukturën e raportimit ka vend për përmirësim dhe shtim të:

- Përmbledhje e rezultateve të auditimit;
- Çfarë kemi audituar?
- Pse kjo është i rëndësishëm Auditimi?
- Çfarë gjetëm dhe përfundam në bazë të auditimit?

5. Përdorimi i linjës së parë të suportit

Gjate vitit 2017 nisi trajnimi dhe përdorimi i linjës së parë të suportit për elemente të IT në auditimet e tjera, rezultatet e përdorimit të saj janë të pakta dhe të pa konsoliduara.

Detyrat për të ardhmen, Viti 2018

- Auditues.....5;
- Drejtor.....1;
- Numri i Auditime të parashikuara për vitin 2018.....5
auditime.

Treguesi	Njësia	Llogaritja	Vlera
Fuqia maksimale audituese e drejtorisë	Ditë/njerëz	22 x 11x 5	1210
Auditime të parashikuara gjithsej	numër		6
Për çdo auditim mesatarisht	Ditë/njerëz	1210/6)	201

Për realizimin e detyrave të caktuara për vitin 2018

- Me qëllim përdorimin sa me efektiv të burimeve njerëzore në dispozicion do të shtrijmë përdorimin e manualit Aktiv të Auditimit IT në gjithë auditimet duke përdorur mjetet e ofruara nga ky manual për vlerësimin e riskut në planifikimin e auditimit.
- Me qëllim shkurtimin e kohës në planifikim do të vazhdojmë popullimin e bazës së të dhënave me informacione nga subjektet.
- Trajnimi dhe përdorimi i linjës së parë të suportit për elemente të IT në auditimet e tjera ngelet një detyrë që kërkon përmirësim për vitin 2018.

DEPARTAMENTI JURIDIK, KONTROLLIT TË ZBATIMIT TË STANDARDEVE DHE ETIKËS

Nga z. Ermal YZEIRAJ, Drejtor Departamenti



I nderuar Kryetar, të nderuar koleg,

Më lejoni që në fjalën time sot si Drejtor i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës të përqendrohem shkurtimisht në vetëm tre çështje tepër të rëndësishme të konsideruara si problematike nga ana jonë dhe për të cilat ne dëshirojmë të ndajmë me ju rekomandimet tona përkatëse për përmirësimin dhe zgjidhjen e tyre. Më konkretisht tre çështjet që do të trajtohen sot në analizën tonë si Departament janë: (1) kontrolli i cilësisë së dosjeve të auditimit (2) kallëzimet penale (3) përfaqësimi në gjykatë.

1. Kontrolli i cilësisë së dosjeve të auditimit

Për vitin 2017, nga ana jonë si Departament është kryer kontrolli i cilësisë në të nxehtë për 156 dosje auditimi, ndërsa përsa i përket kontrollit të cilësisë në të ftohtë ne sapo kemi filluar punën për shqyrtimin e 46 dosjeve të auditimit të evaduar në vitin 2017. Nga shqyrtimi i periudhave në të cilat ka iniciuar dhe përfunduar procesi i evadimit, vërehet përqendrimi i një volumi të papërbalueshëm dosjesh, të cilat vijnë njëkohësisht nga disa departamente auditimi, në fund të muajit Prill, Qershor, Shtator dhe Dhjetor.

Ky përqendrim kaq intensiv i dosjeve të auditimit që pritet të kalojnë kontrollin e sigurimit të cilësisë ndikon automatikisht në shkallën e sigurisë që ne si Departament mund të japim në lidhje me cilësinë e këtyre dosjeve pasi duhet theksuar që në rastin më të mirë ne sipas rregullores kemi në dispozicion vetëm 3 ditë kalendarike brenda të cilave presupozohet që një jurist i Departamentit duhet të kontrollojë vetëm një dosje auditimi.

Gjithsesi, nga kontrolli i cilësisë në të nxehtë të dosjeve të auditimit kanë rezultuar një sërë problematikash si më poshtë:

a) Mungesa e analizës së riskut

Kryerja e analizës së riskut për çdo subjekt auditimi është një proces i detyrueshëm sipas standardeve të auditimit. Normalisht analiza e riskut duhet të hartohet si dokument përpara hartimit të Programeve të Auditimit dhe duhet të qëndrojë më pas i hapur ndaj çdo ndryshimi që mund të sjellë procesi i auditimit në terren.

Mungesa e analizës së riskut apo kryerja e një analize risku jo cilësore, ndikon automatikisht në cilësinë e auditimeve (gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e tyre). Në momentin që gjetjet e një auditimi nuk bazohen në një analizë risku ato i përkasin rastësisë. Nëse do ti kushtohej rëndësia e duhur analizës së riskut, në Raportet Përfundimtare të Auditimit do të evidentoheshin jo vetëm më shumë gjetje, konkluzione dhe rekomandime por ato do të ishin edhe më cilësore dhe më adekuate.

Kryerja siç duhet e analizës së riskut kërkon aftësi të caktuara profesionale, eksperiencë, punë në grup dhe mbi të gjitha kohë (një element që i mungon një pjese të mirë të auditimeve tona po jo të gjithave). Koha është kosto e sakrificës që ne duhet të bëjmë në funksion të kryerjes së analizave paraprake të riskut për çdo subjekt auditimi.

Në kundërpërgjigje të këtij problemi, ne rekomandojmë që në funksion të rritjes së cilësisë së auditimeve, grupeve të auditimit ti jepet koha e mjaftueshme për të kryer analizën e riskut të subjekteve ku ata po ushtrojnë auditim, cka nënkupton reduktimin e numrit të përgjithshëm të auditimeve për çdo Departament Auditimi.

Gjithashtu, ne rekomandojmë vendosjen e analizës së riskut si pikë e veçantë në çdo Program Auditimi, praktikë kjo e ndjekur nga Departamenti i Auditimit të Performancës. Vendosja e analizës së riskut si pikë e detyrueshme në Programin e Auditimit shmang çdo neglizhim të rëndësishëm të kësaj analize nga grupet e auditimit të cilat do të jenë të detyruara që ta trajtojnë çështjen e analizës së riskut në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Nëse analiza e riskut do të futet si një pikë e veçantë në çdo Program Auditimi të KLSH-së, kjo analizë risku mund të përdoret më pas jo vetëm nga subjekti i audituar por edhe nga auditimi i brendshëm, inspektimi financiar, Kuvendi, institucione të ndryshme shtetërore, por mbi të gjitha vetë KLSH-ja e cila mund të bëjë jo vetëm

një krahasim ndër vite të analizave të riskut të një subjekti auditimi por gjithashtu mund të arrijë që të botojë çdo dy, tre apo pesë vjet një Raport të veçantë të Analizës së Riskut në nivel shtetëror të ngjashëm me Raportin që GAO i paraqet çdo dy vjet Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

b) Mungesa e bazueshmërisë ligjore

Çdo gjetje, konkluzion dhe rekomandim në Raportet e Auditimit duhet të bazohet detyrimisht në kuadrin rregullator në fuqi. Kuadri rregullator në fuqi (i cili përbëhet nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet, aktet e ndryshme nënligjore, si dhe nga rregulloret e brendshme të çdo institucioni) është kriteri, në bazë të të cilit ne gjykojmë (dhe gjykohe mi) në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve apo mosveprimeve të çdo institucioni, sektori apo nëpunësi në administratën shtetërore dhe njëkohësisht një ndër kriteret e matjes së performancës së tyre.

Sigurimi i kuadrit përkatës rregullator duhet të bëhet nga audituesit që në fillim të auditimit. Epërsia në njohjen dhe interpretimin e kuadrit rregullator është epërsi në auditim. Është e pafalshme që në fund të procesit të auditimit subjekti të arrijë të hedhë poshtë gjetjet e auditimit duke iu referuar një kuadri rregullator të panjohur dhe pa trajtuar nga grupet e auditimit.

Referimi i thjesht numrit dhe titullit të ligjit, VKM-së apo Udhëzimit nuk konsiderohet aspak si referim i kuadrit rregullator. Referimi duhet të jetë gjithnjë në nivel neni dhe madje në nivel pike apo shkronje brenda nenit.

Në referimin e kuadrit rregullator në fuqi, audituesit duhet të përdorin sa më pak interpretimin. Interpretimi i kuadrit rregullator sjell më pas interpretimin e ekzistencës ose jo të përgjegjësisë në veprimet apo mosveprimet e subjektit të audituar.

Saktësia në referimin e kuadrit rregullator bën që gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet ti rezistojnë çdo tentative të subjektit të auditimit për ti rrëzuar ato. Madje edhe zbatimi i rekomandimeve varet nga cilësia jonë në referimin e kuadrit rregullator në fuqi.

Nga ana tjetër audituesit duhet tërheqin dorë nga ripërsëritja artificiale e kuadrit rregullator në Raportet e Auditimit. Për gjetje të njëjta duhet të përdoret vetëm një bazë ligjore.

Në kundërpërgjigje të këtij problemi, ne si Departament do të fillojmë punën për përgatitjen e një Udhëzuesi për mënyrën se si audituesit duhet ti referohen kuadrit

rregullator përkatës dhe njëkohësisht do të fillojmë punën për krijimin e një databaze të kuadrit përkatës rregullator në shumë fusha të auditimit.

c) Mosrespektimi rigoroz i “Rregullores së Funksionimit Administrativ” dhe “Rregullores së Procedurave të Auditimit”

Më 1 Shtator 2017, hyri në fuqi Rregullorja e re e Procedurave të Auditimit e cila së bashku me Rregulloren e Funksionimit Administrativ përbëjnë tashmë kuadrin rregullator kryesor të procesit të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Respektimi me rigorozitet i dy rregulloreve duhet parë në dy aspekte: atë procedural dhe atë material.

Respektimi i rregulloreve në aspektin procedural nënkupton ndjekjen pikë për pikë të të gjitha procedurave, strukturave dhe afateve kohore të përcaktuara në rregullore. Në procesin e auditimit nuk duhet të ketë dhe nuk duhet të krijohen struktura paralele, struktura të shkurtra apo struktura fluide. Në procesin e auditimit duhet të ketë vetëm një strukturë, ajo e përcaktuar në rregullore.

Duke qenë në tejkalim të afateve kohore, shpesh herë Departamentet e Auditimit vendosin në presion kohor të gjithë zinxhirin hierarkik të procesit të evadimit të dosjeve të auditimit, madje në disa raste edhe duke i kapërcyer me apo pa qëllim procedurat e kontrollit të cilësisë. Nuk është aspak etike që pas nënshkrimit të Kryetarit të KLSH-së të kërkohet mendimi ynë si Departament apo mendimi i Drejtorit të Përgjithshëm. Pas vendimit të Kryetarit nuk duhet të ketë më asnjë mendim. Shkelje të tilla procedurale krijohen vetëm nga presioni i limiteve kohore që vendosen ndaj strukturave hierarkike në KLSH dhe për këtë përgjegjësia kryesore bie mbi grupet e auditimit.

Respektimi i rregulloreve në aspektin material ka të bëjë me cilësinë dhe përmbajtjen e dokumenteve të prodhuara nga secila hallkë e procesit të auditimit. Tashmë dokumentet standarde të auditimit kanë ndryshuar dhe në to parashikohen shumë më tepër elementë strukturor të detyrueshëm për tu plotësuar nga audituesit dhe instancat përkatëse të procesit të kontrollit të cilësisë dhe evadimit të dosjeve të auditimit.

Është shumë e rëndësishme që KLSH të ruajë një standard në hartimin e dokumentave të auditimit sidomos përsa i përket Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Vendimit të Kryetarit të KLSH-së. Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të ketë një standard, një format, një strukturë, një stil, dhe ç'është më e rëndësishmja një gjuhë. Tashmë çdo Raport Auditimi publikohet në faqen tonë web dhe

transparenca e punës tonë duhet të na bëjë të gjithëve që të ndihemi më të përgjegjshëm në lidhje me atë çfarë themi dhe si e themi.

Në kundërpërgjigje të këtij problemi, ne mendojmë që të kryejmë disa trajnime për stafin e KLSH-së në lidhje me mënyrën e të shkruajturit dhe hartimit të dokumenteve standarde të auditimit dhe gjithashtu mendojmë që ndoshta duhet të rishikojmë sërish modelin e dokumenteve standard të auditimit për të reflektuar në to edhe disa nga vërejtjet dhe sugjerimet që me të drejtë kanë ngritur si shqetësim disa prej audituesve më me eksperiencë në KLSH.

Përsa i përket çështjeve të aspektit procedural mendojmë që sistemi i ri informativ që pritet të implementohet në çdo hallkë të procesit të auditimit do të zgjidh çdo problematikë në lidhje me tejkalimin e afateve kohore dhe kalimin e dosjeve të auditimit në një proces normal kontrolli cilësie dhe evadimi.

d) Mospërputhjet ndërmjet Projekt Raportit të Auditimit, Raportit përfundimtar të Auditimit dhe Vendimit të Evadimit

Të paktën tre dokumentet kryesorë të dosjes së auditimit: Projekt Raporti, Raporti dhe Vendimi duhet të jenë të koordinuara ndërmjet tyre. Është normale që për një sërë arsyesh ndërmjet këtyre tre dokumenteve të ketë ndryshime por çdo ndryshim duhet të argumentohet dhe justifikohet nga ana e grupeve të auditimit. Në rast se ndryshimet nuk argumentohen krijohen dyshime të arsyeshme për shmangie të qëllimshme nga ana jonë të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve. Në kushtet kur tashmë KLSH publikon në web si Raportin Përfundimtar të Auditimit ashtu edhe Vendimin e Evadimit ne nuk duhet të lëmë asnjë shkak për lindjen e dyshimeve apo keqkuptimeve karshi punës tonë audituese, pasi kjo do të cënonte në çdo rast integritetin e gjithë institucionit. Për këtë arsye audituesit duhet të jenë të kujdesshëm që të argumentojnë arsyen e çdo ndryshimi të ndodhur ndërmjet këtyre tre dokumenteve.

Në kundërpërgjigje të këtij problemi, ne si Departament kemi rekomanduar vendosjen e një kodi specifik për çdo gjetje dhe çdo rekomandim. Në këtë mënyrë mjafton që të krahasohen kodet ndërmjet tre dokumenteve për të parë çdo mospërputhje ndërmjet tyre.

e) Cilësia në hartimin e rekomandimeve

Çdo rekomandim i paqartë, konfuz, i pa bazuar në ligj, jo adekuat, ekstrem, jo proporcional, jo i drejtpërdrejtë dhe i përgjithshëm është i destinuar që të mos zbatohet nga subjektet e auditimit. Dhënia e rekomandimeve të tilla rrit

artificialisht hendekun ndërmjet rekomandimeve të dhëna nga KLSH dhe atyre të zbatuara nga subjektet e auditimit.

Është tepër e rëndësishme që në dhënien e rekomandimeve për masa shpërblim dëmi, masa administrative dhe masa disiplinore, KLSH të ruajë të njëjtin standard në të gjitha auditimet e tij. KLSH nuk mund të trajtojë të njëjtën lloj sëmundje duke dhënë receta të ndryshme.

Shumica e rekomandimeve të dhëna për shpërblim dëmi apo masa disiplinore kalojnë shumë shpejt në procese gjyqësore. Në shumicën e këtyre proceseve gjyqësore KLSH qëllimisht nuk thirret apo nuk njoftohet si palë e tretë dhe më pas, duke u bazuar në vendimin e gjykatës, rekomandimi i KLSH-së konsiderohet nga subjektet si i zbatuar. Në fakt e gjitha kjo është një lojë që subjektet bëjnë me KLSH-në dhe rekomandimet e auditimeve tona. Mjafton të përmendim këtu një fakt që, për të gjitha proceset gjyqësore që Bashkia Sarandë ka hapur në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së të gjitha palët e paditura, kanë vetëm një avokat. Kjo tregon që gjithçka është e koordinuar. Paditësi dhe i padituri janë në të njëjtin kah dhe mbrojnë të njëjtat interesa.

Në kundërpërgjigje të këtij problemi, ne rekomandojmë hartimin e një Udhëzuesi për standardizimin e rekomandimeve, ku audituesit të instruktohen mbi rekomandimet e ndryshme që mund të japin në varësi të shkeljeve dhe dëmeve ekonomike të konstatuara. Në këtë udhëzues një vend ë rëndësishëm duhet të zë dhe trajtimi i konceptit të dëmit ekonomik sidomos në rastin e procedurave të prokurimit.

Gjithashtu ne mendojmë që ndoshta brenda strukturës së Departamentit tonë mund të krijohet një Drejtori apo Sektor i veçante në lidhje me kontrollin e zbatimeve të rekomandimeve. Kjo ide mbështetet në faktin që shumë prej rekomandimeve të KLSH-së vazhdojnë të ndiqen nga ana jonë nëpër procese të ndryshme gjyqësore.

2. Kallëzimet penale

Një ndër çështjet më të rëndësishme që lidhet me dosjet e auditimit është edhe ajo në lidhje me hartimin e kallëzimeve penale. Fillimisht më lejoni që të paraqes përpara jush disa statistika në lidhje me kallëzimet penale të kryera përgjatë vitit 2017 dhe më pas të ndaj me ju disa çështje dhe problematika që ne konstatojmë në procesin e kryerjes së këtyre kallëzimeve si Departament.

Për vitin 2017 KLSH ka depozituar pranë organeve të Prokurorive në Rrethe 47 kallëzime dhe indicie penale pa përmendur këtu edhe 4 dosje auditimi, të cilat i

janë përcjellë për vlerësim organit të Prokurorisë. Pra në total 51 çështje penale të cilat po shqyrtohen në bazë të auditimeve të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit përgjatë vitit 2017.

Shumica e kallëzimeve penale (27) janë hartuar në bazë të auditimeve të kryera nga Departamenti i Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore i ndjekur më pas nga Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit (12).

Në 47 kallëzimet dhe indiciet penale të hartuara nga KLSH, janë ngarkuar me përgjegjësi penale:

- 26 titullarë institucionesh (6 bashkie, 4 ALUIZNI, 7 ZVRP, 1 sh.a., 8 tjera);
- 41 nëpunës të nivelit drejtues;
- 43 nëpunës të tjerë;
- 5 subjekte private.

Veprat kryesore penale për të cilat akuzohen këta persona janë shpërdorimi i detyrës dhe shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike por nuk mungojnë edhe akuza për falsifikim dokumentesh.

Në procesin e hartimit të kallëzimeve penale nga ana jonë si Departament evidentohen një sërë problematikash për të cilat unë dëshiroj të flas hapur dhe pa dorashka.

KLSH duhet të ketë një standard në bërjen e kallëzimeve penale. Jo çdokush zotëron njohuritë e duhura për të kuptuar elementët e figurës së veprës penale. Kemi bërë shumë gabim që për hir të ngarkesës momentale kemi lënë në dorë hartimin e kallëzimeve penale personave të tjerë jashtë Departamentit. Prokuroria ka patur plotësisht të drejtë në disa raste që ka vendosur pushimin apo mosfillimin e çështjeve tona penale. Në shumë raste ne jemi ndjerë të turpëruar përpara prokurorëve për gafat juridike që evidentoheshin në kallëzimet tona penale.

Çështja e kallëzimeve penale është çështje serioze dhe për këtë ne si Departament kërkojmë gjithë kohën e nevojshme në funksion të hartimit të kallëzimeve dinjitoze. Cilësia e dobët e kallëzimeve tona përbën shkak për pushimin e tyre nga ana e organit të Prokurorisë dhe vendimmarrjen negative nga ana e Gjykatave.

Audituesit nuk duhet të nxitojnë që të propozojnë kallëzime penale pa mendimin tonë si Departament. Audituesit që këmbëngulin për të bërë kallëzime penale (edhe pasi ne kemi dhënë opinionin tonë kundra si Departament) duhet të jenë të gatshëm të shkojnë vetë më pas si dëshmitar në Prokurori dhe në Gjykatë, madje

dhe të përballen me kundër kallëzimet e subjektit i cili pasi merr vendimin e pushimit nga Prokuroria mund ti akuzojë ata drejtpërsëdrejti për kallëzim të rremë.

Të gjitha këto që po them kanë ndodhur dhe nuk duhet të ndodhin më. Mbi kallëzimet tona penale janë sytë më të kujdesshëm të medias, avokatëve, prokurorëve, gjyqtarëve dhe ambasadave të huaja. Secili me një qëllim të ndryshëm.

Sa më sipër, në kundërpërgjigje të këtij problemi, ne si Departament mendojmë që të përgatisim për Kryetarin e KLSH-së disa ndryshime Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe Rregulloren e Funksionimit Administrativ si dhe të shikojmë mundësinë e rifreskimit të marrëveshjes tonë me Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Përfaqësimi në Gjykatë

Gjatë vitit 2017 KLSH është angazhuar në 70 procese gjyqësore. Nga këto 21 procese gjyqësore penale me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë”, 2 procese gjyqësore me palë paditëse ish punonjës, 1 proces gjyqësor me palë paditëse subjektin e audituar dhe me objekt “pavlefshmëri e akteve të KLSH-së” dhe 50 procese gjyqësore administrative, ku KLSH ka qenë në cilësinë e personit të tretë. Proceset gjyqësore kanë pasur një shpërndarje të madhe gjeografike, ku përfshihen gjykata si Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnje, Berat, Fier, Vlorë, Përmet, Gjirokastër, Sarandë, Lezhë, Shkodër, Kukës, Dibër.

Gjatë vitit 2017 prioritet i Departamentit Juridik, ndër të tjera kanë qenë kallëzimet penale të KLSH-së dhe ecuria e tyre. Referuar numrit të vendimeve të pushimit të ardhura në KLSH evidentohet fakti se këto vendime janë ankimuar në masën 100%. 17 prej këtyre proceseve kanë qenë procese gjyqësore të iniciuara nga KLSH, me objekt “ankim kundër vendimit të pushimit/mosfillimit të prokurorisë”, ndërsa 4 prej tyre janë kërkesa të prokurorisë për pushim/mosfillim të procedimit penal (për shkak të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale).

Disa nga problematikat që shoqërojnë vazhdimisht proceset gjyqësore janë si më poshtë:

Problematikat në lidhje me hetimin e organit të prokurorisë

a) Mungesa e bashkëpunimit në lidhje me hetimet

KLSH nuk thirret nga ana e Prokurorisë për të dhënë shpjegime në lidhje me faktet e përmendura në kallëzimet penale. Edhe në ato pak raste kur thirret, kërkohen audituesit e KLSH-së për tu pyetur në cilësinë e dëshmitarëve. Ne si Departament i

kemi kërkuar në çdo rast organeve të Prokurorisë dhe Gjykatave që audituesit e KLSH-së të mos thirren si dëshmitarë por që KLSH-ja të përfaqësohet në këto organe me juristët e Departamentit Juridik.

b) Zgjatja e afateve të hetimit dhe mungesa e njoftimit në lidhje me zgjatjen e afateve

Referuar Kodit të Procedurës Penale, pas çdo zgjatje 3 mujore Prokuroria duhet të njoftoj duke dhënë arsyet e shtyrjes së afatit të hetimeve, kërkesë të cilën kallëzuesi ka të drejtë ta ankimoj në gjykatë. Në pjesën më të madhe të hetimeve konstatohet se zgjasin mesatarisht 1 vit e gjysmë.

c) Vonesa për tu njohur me dosjet hetimore

Nga korrespondenca me organin e Prokurorisë janë evidentuar vonesa në lidhje me dosjet hetimore. Këto vonesa pengojnë në shqyrtimin sa më të shpejt të ligjshmërisë së vendimit të prokurorisë.

Problematika gjatë shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të pushimit/mosfillimit

a) Numri i lartë i seancave gjyqësore

Zhvillimi i një numri të madh të seancave gjyqësore për këto procese gjyqësore. Ky numër i madh seancash vjen si pasojë shtyrjeve pa shkaqe të arsyeshme. Duke qenë se këto procese gjyqësore nuk mund të zhvillohen pa praninë e prokurorit, gjykata është e detyruara të shtyjë seancat në të gjitha rastet kur mungon prokurori. Po kështu edhe mungesa e vetë gjyqtarëve ka qenë shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore.

Po kështu referuar Vendimit Unifikues Penal nr. 2, datë 20.06.2013, gjykata në rastet e vendimeve të pushimit, duhet të njoftoj edhe personat e kallëzuar. Janë të shumta rastet kur si pasojë e mungesës së adresave të personave të kallëzuar, shtyhen seancat me qëllim njoftimin e tyre. Këto situata janë paradoksale pasi si rregull të gjitha të dhentat e personave të kallëzuar gjenden në dosjet hetimore të prokurorisë.

b) Barra e provës për KLSH-në

Vihet re tendenca e gjykatës për t'ia lënë barrën e provës në lidhje me ekzistencën e elementëve të veprës penale, organit të KLSH-së. Në fakt barra për të provuar këto element është vetëm e prokurorisë.

c) Keqinterpretim i Vendimit Unifikues Penal nr. 2, datë 20.06.2013

Gjykatat kërkojnë nga ankimuesi (kallëzuesi) përcaktimin vetëm të detyrave për organin e Prokurorisë, pa ngritur pretendime në lidhje me ligjshmërinë e hetimeve të kryera.

d) Cënimi i parimit “aksesit në gjykatë”

Është kërkuar në disa raste që për dosjen hetimore që duhet ta administrojë gjykata, është kërkuar nga ana e gjykatës që KLSH të kryej pagesën me qëllim që Prokuroria ta depozitohet në gjykatë. Në fakt kjo kërkesë është absurde pasi është detyrim i organit të Prokurorisë dorëzimi i dosjes hetimore në gjykatë. Të tilla kërkesa çenojnë rëndë parimin e “aksesit në gjykatë”, si një e drejtë kushtetuese.

e) Numër i vogël i vendimeve gjyqësore në favor të KLSH-së

Vetëm në 4 prej tyre është vendosur pranimi i ankimit dhe prishja e vendimit të pushimit të Prokurorisë. Konstatohet një mungesë e theksuar vullneti për të evidentuar paligjshmërinë. Evidentohet qartë një bashkërendim i organit të prokurorisë me gjykatën për të pushuar ndjekjet penale. Statistikisht janë magjistratët ata të cilët kanë dhen vendime në favor të KLSH-së.

Në kundërpërgjigje të këtyre problematikave, ne si Departament mendojmë që të fillojmë punën për dokumentimin e të gjitha rasteve flagrante të shkeljeve të konstatuara nga ana jonë në veprimtarinë e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve për tia përcjellë më pas këto shkelje organeve të reja KLGJ dhe KLP që pritet të krijohen nga reforma në drejtësi.

Në përfundim të trajtimit të kësaj çështje, dua të falenderoj për punën e kryer përgjatë vitit 2017 gjithë anëtarët e Departamentit, edhe ata që më parë kanë qenë pjesë e tij, por në veçanti dua të falenderoj dy juristët e KLSH-së, ata që përballen me çfarëdolloj prokurori dhe gjyqtari, dhe të cilët vazhdojnë ta mbrojnë dhe përfaqësojnë me shumë pasion KLSH-në edhe në rrethin më të largët, Z. Emiliano Doko dhe Z. Flavio Xhuveli. Faleminderit! Ju detyrohem shumë! Unë dhe KLSH-ja.

TRANSPARENCA E AKTIVITETIT TË KLSH-së SI NJË NGA TREGUESIT KRYESORË TË MODERNIZIMIT TË INSTITUCIONIT DHE TË RRRITJES SË BESIMIT TË QYTETARËVE NË PUNËN E TIJ

Nga znj. Irena ISLAMI, Drejtor Drejtorie



“Si SAI, ne do të njihemi për punën tonë vetëm nëse arrijmë të komunikojmë tek qytetarët në mënyrë të qartë atë se çfarë ne bëjmë dhe po ashtu vlerën e shtuar të gjeneruar nga auditimet tona për Shtetin dhe shoqërinë, në mënyrë që të përceptohemi si institucione strategjike të domosdoshme për interesat e qytetarëve”¹³.

Drejtorja e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë (KBMJ) ka pasqyruar këtë qasje të re të KLSH-së, e cila është në përputhje të plotë dhe bazohet në standardet profesionale të auditimit publik suprem, ISSAI-t, dhe përkatësisht në Deklaratën e Limës (ISSAI 1), në Standardin ISSAI 20 *“Parimet e Transparencës dhe të Përgjegjshmërisë”*, Parimi i 8-të, mbi komunikimin në kohë dhe gjerësisht të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-t), si dhe në ISSAI-n 12 *“Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit – Të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”*, Parimi i 6-të mbi komunikimin efektiv me palët e interesit dhe Parimi i 9-të mbi sigurimin e transparencës dhe të përgjegjshmërisë së duhur nga SAI-t.

Një dokument shumë i rëndësishëm për Drejtorinë e Komunikimit dhe për të gjithë institucionin është Strategjia e Komunikimit të KLSH-së, për vitet 2017-2019, miratuar nga Kryetari i KLSH-së në korrik të vitit 2017.

Në këtë strategji janë përcaktuar qartë Objektivat strategjike të KLSH-së në bazë të nevojave, kërkesave dhe sfidave të institucionit në komunikimin me publikun dhe palët e tjera të interesit, por edhe në bazë të burimeve aktuale njerëzore dhe financiare dhe mundësisë së kufizuar të rritjes së tyre për periudhën e realizimit të Strategjisë:

¹³ Fragment nga fjala e Dr. Josef Moser, në Simpoziumin e XXI-të OKB-INTOSAI. Dr. Moser, ish President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe ish-Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t për vitet 2004-2016.

Objektivi Nr. 1: Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni.

Objektivi Nr. 2: Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut.

Objektivi Nr. 3: Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinioni publik rezultatet dhe dobitë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit.

Objektivi Nr. 4: Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rrumbullakëta.

Objektivi Nr. 5: Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive.


Objektivi Nr. 6: Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit.

Strategjia e Komunikimit 2017-2019 synon rritjen e të kuptuarit të parimeve dhe funksioneve të KLSH nga publiku dhe qytetari, nga institucionet, organizatat jo-qeveritare dhe media. Ajo do të provojë të stimulojë debat publik rreth gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH, debat i cili çon më pas në rritjen e sensibiliteve të grupeve të ndryshme shoqërore, ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të institucionit përgjatë auditimeve të tij.

Gjatë viteve 2012-2017, institucioni në përmbushje të objektivit për rritjen e transparencës është zhvilluar në disa dimensione. Kështu, krahas rritjes së kanaleve të komunikimit me publikun, përmirësoi përmbajtjen dhe cilësinë e mesazheve në njoftimet e tij për shtyp. Njoftimet për shtyp kanë qenë dhe janë përcjellësi kryesor i mesazheve publike të institucionit. Ato janë ndërtuar me një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë, të bazuara vetëm në faktet e nxjerra nga auditimet dhe pa konsiderata hipotetike. Institucioni është përpjekur të japë në një format konciz gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga çdo auditim me rëndësi të veçantë për mirë-menaxhimin e parasë publike. Gjetjet nga auditimet, të komunikuar nëpërmjet njoftimeve për shtyp janë kthyer në këto 6 vite në lajm të ditës për televizionet, radiot dhe gazetatat kryesore të vendit.

Gjatë vitit 2017, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat tona për shtyp me një numër prej 840 artikuj, njoftime, editorialë dhe komente analitike. Në fund të vitit 2017, ne kemi qenë të pranishëm me rreth 100 kronika më shumë se vitin e kaluar (numri është rritur nga 550 në 642 kronika). Gazetarët u janë përgjigjur prononcimeve tona, problematikave të dala nga auditimet e ushtruara nga ana jonë dhe aktiviteteve të ndryshme gjatë këtij viti. Transparenca e veprimtarisë së KLSH-së po rritet nga viti në vit dhe ne jemi gjithnjë e më të hapur e bashkëpunues me median.

Institucioni ka konsideruar median e shkruar dhe audio-vizive si partnerin kryesor në realizimin e misionit të tij si “watchdog” për miradministrimin e fondeve dhe pasurisë publike si dhe për të forcuar luftën ndaj korrupsionit. Ky partneritet ka qenë real dhe që në analizën vjetore të KLSH-së të zhvilluar në janar 2012 dhe më tej rregullisht çdo vit, përfshirë analizën e fundit vjetore për vitin 2017, mediat dhe përfaqësuesit më në zë të organizatave jo-qeveritare që luftojnë korrupsionin janë ftuar të marrin pjesë dhe të diskutojnë në analizat në nivel departamenti auditimi dhe në analizën e përgjithshme të KLSH. Transparenca e aktivitetit të institucionit ka përbërë një nga treguesit kryesorë të modernizimit të institucionit dhe ka rritur besimin e publikut dhe qytetarëve ndaj tij.




Në këtë drejtim ka ndikuar dukshëm edhe prezenca e audituesve të KLSH-së në median e shkruar, shkrimet e të cilëve i janë paraqitur të përmbledhura publikut në 9 volume (periudha 2013-2017), të cilët janë botime të kolanës së KLSH-së.

Shkrimet e audituesve përmbajnë gjithnjë e më shumë shkrime konkrete për problematikat që hasen më shpesh në jetën e përditshme të qytetarit që merr shërbime publike, por dhe që janë më të mprehtat, të cilat janë evidentuar në auditimet e kryera prej tyre.


Gjatë vitit 2017, ne kemi qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetatat me 125 shkrime, të shkruara nga auditues të KLSH-së. Gjate pesë viteve, 2013-2017 audituesit e KLSH kanë botuar 521 artikuj.

Prezenca e audituesve te KLSH në shtypin e shkruar 2013-2017



Trajtimi i Letrave nga Qytetarët

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2017 ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm **letrat dhe ankesat e qytetarëve**, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit. Megjithatë, edhe në këto raste KLSH i ka orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet ti drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre. Gjatë 2017, KLSH ka trajtuar 623 letra dhe ankesa (gjatë 2016 kanë qenë 660 të tilla), nga të cilat 246 jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Nga 377 ankesa në kompetencë të KLSH, 204 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 173 janë në proces verifikimi.



Trajtimi i kërkesave për të drejtën e informimit

E drejta e informimit si një e drejtë kushtetuese dhe tanimë e parashikuar qartazi në një legjislacion të veçantë është e drejtë elementare e çdo individi në një shoqëri demokratike. Që me miratimin e Ligji të ri nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka pasur një numër në rritje kërkesash për informacion nga viti në vit. Vetëm gjatë vitit 2017 janë trajtuar dhe u është përcjellë informacioni i kërkuar, rreth 41 kërkesave dhe ankesave që kanë ardhur në adresë të koordinatorit të KLSH-së.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në dy vitet e fundit, me qëllim rritjen e transparencës ndaj publikut ka vendosur në WEB e KLSH-së pothuajse të gjitha Vendimet e Auditimit, 153 auditime nga 156 të realizuara në vitin 2017 (98%) dhe 152 auditime nga 154 të realizuara për vitin 2016 (98.7%).

Faqja e WEB-it të KLSH-së është një dritare më shumë dhe të interesuarit mund të gjejnë informacione të shumta për aktivitetin e KLSH-së dhe veçanërisht për raportet e auditimet. Gjithashtu në faqen zyrtare të KLSH gjenden të gjitha raportet që janë hartuar dhe përgatitur nga KLSH gjatë vitit 2017 si Raporti i Aktivitetit, Raporti i Buxhetit, Raportet e monitorimit, strategjitë, informacione për të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga KLSH si brenda edhe jashtë vendit, botimet e KLSH-së, etj. Botimet janë të aksesueshme nga publiku jo vetëm në opsionin read (të lexueshme) por dhe në opsion download (të shkarkueshme).

Muaji i Hapur në KLSH

Transparenca e aktivitetit të KLSH-së është një nga treguesit kryesorë të modernizimit të institucionit dhe të komunikimit të tij shumë dimensional. Qasjen e

komunikimit të pandërprerë me qytetaret, KLSH e ka parë në këto gjashtë vjet, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe me median, si dhe nëpërmjet përgjigjeve ndaj letrave të qytetarëve.

Mbështetur në sa më sipër dhe në standardin ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 12, *“Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit- të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”* dhe me qëllim njohjen më të plotë dhe të drejtpërdrejtë të veprimtarisë së Institucionit nga qytetarët, si edhe në kuadër të transparencës dhe njohjes së ndërsjellë të punës mes Departamenteve të auditimit në institucion, KLSH në zbatim të Strategjisë së Komunikimit 2017-2019 dhe të eksperiencës së javës së hapur, të organizuar në nëntor të vitit 2016, organizoi Muajin e Hapur për Qytetarët, në datat 7 Nëntor- 11 Dhjetor 2017.

Në lancimin zyrtar të muajit të hapur, Kryetari i KLSH-së, z. Bujar LESKAJ, në fjalën e tij nënvizoi se një institucion modern i auditimit më të lartë publik, një SAI, do të ishte i mangët dhe i izoluar, pa njohjen e plotë të veprimtarisë së tij nga qytetari dhe mbështetjen prej publikut dhe qytetarëve, duke cituar një shprehje të Abraham Linkoln që *«Institucionet tona nuk do të jenë kurrë të tilla (pra publike), nëse nuk krijojnë mundësitë të njihen plotësisht, madje edhe të vizitohen apo preken fizikisht nga qytetari pagues taksash»*.

Gjatë kësaj periudhe, qytetarët patën mundësinë të vizitojnë mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të njihen me historikun dhe arritjet e institucionit në 92 vitet e ekzistencës së tij nëpërmjet mini-muzeut në korridorin qendror të KLSH, të takohen me punonjës, auditues dhe ekspertë të ndryshëm të institucionit, duke marrë të gjithë informacionin që kanë kërkuar dhe duke adresuar pyetje të ndryshme me interes për ta. Stafi i përgatitur i KLSH-së ishte në dispozicion të qytetarëve gjatë gjithë kësaj periudhe.

Gjatë muajit të hapur janë zhvilluar 49 aktivitete të ndryshme si takime mes Departamenteve të ndryshme të auditimit me qëllim shkëmbimin e eksperiencave; takime me gazetarë; prezantime të botimeve të KLSH-së nga Auditues të rinj; pjesëmarrje në Panairin e librit 2017; prezantimi i Rregullores së Re të KLSH; prezantimi i kolanës së botimeve të KLSH-së në dy panaiere; takime dhe leksione me akademikë, profesorë, filozofë të fushave të ndryshme; prezantim i Draft-Strategjisë së zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018-2022; leksione nga kolegë të SAI-ve partnere, prezantimi i buxhetit faktik për vitin 2016; promovime librash që kanë interes për KLSH; aktivitete kulturore, promovimi i pjesëmarrjes së KLSH-së në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, në dy vitet e fundit me qëllim shkëmbimin e


eksperiencave; pjesëmarrje në Kongresin dhe ekspozitën rajonale “Zgjidhja e mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe të gazta”, etj.

Në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe ekspertë të jashtëm, KLSH organizoi disa aktivitete me pjesëmarrjen e: Prof. Dr. Sazan Guri, Prof.Dr.Skënder Osmani, Prof.Dr.Artan Fuga, Prof. Dr. Hysen Çela, Zv/Presidentin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë, z. Wojciech Kutyla, i cili zhvilloi një leksion të hapur me audituesit e KLSH me temë “Etika për Audituesit”, si edhe me znj. Darcie Nielsen, e cila në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe USAID për projektin “Transparenca në Sistemin Shëndetësor në Shqipëri”, zhvilloi një leksion me audituesit e KLSH-së në ambientet e Akademisë së Shkencave.

Të gjitha aktivitetet janë ndjekur me vëmendje dhe interes nga auditues, gazetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, studentë, etj.

Botimet



KLSH vjen në gjashtë vitet e fundit 2012-2017 me një kolanë botimesh prej 83 titujsh. Botimet e KLSH-së janë zbatim i detyrimeve ndërkombëtare të angazhimit të institucioneve të auditimit edhe në fushën e botimeve të dokumentacionit për t’i mundësuar qytetarëve një akses më të gjerë. Kolana e botimeve, e cila pasurohet nga viti në vit, pasqyron çdo kronikë të reformave që ka nisur KLSH dhe nëpërmjet tyre, ne rrisim transparencën dhe llogaridhënien tonë si institucion, duke rritur njëkohësisht edhe besimin e qytetarëve ndaj punës sonë.





Gjatë vitit 2017, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka vijuar me sukses punën në këtë drejtim, duke i shtuar 67 botimeve të viteve 2012-2016, 16 botimet e 2017, me titujt e mëposhtëm:


- Gjykata Europiane e audituesve, 40 vjet auditim publik;
- “Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm”, Vëllimi VII;VIII, IX;
- Revista kërkimore shkencore “Auditimi Publik” Nr.15, Nr.16 dhe Nr.17;
- “Raporti vjetor i Performancës 2016” (në shqip dhe në anglisht);
- “KLSH Analiza Vjetore 2016”;
- “ISSAI 30 – Kodi Etikës - Auditimi i etikës në organizatat e sektorit publik- Si të implementojmë ISSAI 30”;
- “Guida e planifikimit të menaxhimit dhe administrimit të aseteve në vetëqeverisjen vendore”;
- “Korniza e matjes së performancës së SAI-ve”
- “Dokumente të Këshillit Kontrollues 1925-1939”;
- “40 vjet Deklarata e Limës 1977-2017”;
- “Auditimet e performancës në KLSH 2016-2017”.











Revista Shkencore “Auditimi Publik”, arriti në numrin 17 të saj dhe është tregues i përkushtimit dhe vlerave të institucionit që vijon të botojë çdo 4 muaj një numër të kësaj Reviste. Rritja në numër e kësaj reviste, kërkimore-shkencore, është një indikator i rritjes së kapaciteteve audituese të vetë KLSH-së dhe reflekton punimet shkencore të stafit të KLSH-së, botës akademike si dhe praktikave më të mira nga SAI-et homologe dhe organizatave ndërkombëtare.

Për Kontrollin e Lartë të Shtetit, kujtesa historike është gur themeltar, një nga përbërësit me të fuqishëm në krijimin e identitetit të qëndrueshëm jo vetëm të një kombi e shteti, por edhe të një institucioni kryesor publik. Me botimin **“Dokumente të Këshillit Kontrollues 1925-1939”**, Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk i ofron lexuesit thjesht një biografi të një institucioni, por një pjesë të rëndësishme të mozaikut të historisë së shtet-ndërtimit të Shqipërisë.

Auditimi i performancës, një objektivi për t’u arritur për KLSH-në e para 2012, sot është një realitet i prekshëm dhe që funksionon normalisht nëpërmjet Departamentit të Auditimit të Performancës, në të cilin janë të përfshirë 20 auditues dhe deri në fund të vitit 2017 kanë realizuar 58 auditime performance. Kjo risi e konsoliduar tashmë dhe ky sukses është pasqyruar edhe këtë vit në botimin

“Auditimi i Performancës 2016-2017”. Me një strukturë të thjeshtë, informacion sintetik dhe klasifikim tematik, ky botim sjell një përmbledhje të punës që departamenti i auditimit të performancës ka bërë këto 2 vite.

Modernizimi i KLSH-së është një proces i vazhdueshëm e që bazohet në disa piketa, në standardet e INTOSAI-t, të cilat mbeten në qendër të linjës botuese të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Botimi **“Korniza e matjes së performancës se SAI-ve”** përben një dokument strategjik të rëndësishëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili ka treguar qartazi se ndryshimi, zhvillimi dhe përsosja është filozofia e funksionimit të tij. Ky përben një instrument jetik, i cili nëpërmjet realizimit të procesit të vlerësimit të gjithë aktivitetit të institucionit më të lartë të auditimit publik, mundëson realizimin e një ekzaminimi të detajuar të nivelit të plotësimit të standardeve të krahasuar sipas një sistemi të ndërtuar nga INTOSAI.

Me qëllim promovimin e botimeve të KLSH-së, institucioni mori pjesë për të pestin vit radhazi **në Panairin e Librit, në të cilin u paraqit me 77 botime përkundrejt 17 botimeve të vitit 2013**, kur mori pjesë për herë të parë modestisht në këtë panair.



Kontroli i Lartë i Shtetit mori pjesë në vitin 2017, për herë të dytë në **Panairin Ndërkombëtar të Klik Expo Group, që u organizua në Tiranë në datat 23-26 nëntor 2015**. Panairi i Klik Expo Group erdhi në edicionin e 24-të me një përmbajtje të re në temën Biznes-Kulturë-Bashkëjetesë. Ky panair është një nga evenimentet që e ka kthyer kryeqytetin shqiptar, Tiranën, në pikë takimi mundësisht dhe ndërveprimi.



Kontrolli i Lartë i Shtetit u paraqit në këtë panair me kolanën e plotë të botimeve të tij për periudhën 2012- 2017.

Gjithashtu KLSH mori **pjesë dhe në Kongresin Shkencor Ndërkombëtar “Menaxhimi dhe trajtimi i integruar i mbetjeve në gjendje të lëngët, të ngurtë dhe të gaztë”** në datat 24-25 nëntor.

Kryetari i KLSH z. Bujar LESKAJ në fjalën përshëndetëse në Kongres vlerësoi aktivitetin dhe bëri një pasqyrë të gjendjes në të cilën ndodhet vendi ynë lidhur me menaxhimin e pamenaxhuar dhe të patrajtuar të mbetjeve urbane. Gjithashtu në fjalën e tij Kryetari i KLSH theksoi punën e KLSH në drejtim të intensifikimit të auditimeve që lidhen me çështjet mjedisore dhe realizimin e disa auditimeve në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duke synuar që me rekomandimet e tij në këto auditime të japë zgjidhje reale dhe të qëndrueshme.

KLSH u përfaqësua në Kongres me tre materiale të përgatitura nga:

- Dr. Aulent Guri, *“Ndikimi i ujërave të zeza në ndotjen e liqeneve të Prespës”*;
- Z. Bajram Lamaj, *“Performanca mbi menaxhimin e mbetjeve urbane, Bashkia Tiranë”*;
- Z. Artur Hasanbelliu, *“Implementimi i politikave mjedisore, parë nga këndvështrimi i audituesve të KLSH”*.

Punimet u vlerësuan nga pjesëmarrësit.

Stenda e KLSH-së në të dy panairët u vizitua nga shumë studentë, studiues të fushës së auditimit, ekonomisë dhe qytetarë të interesuar për aktivitetin e KLSH-së në vite.

Në gjashtë vitet e fundit, **KLSH ka lidhur 50 marrëveshje bashkëpunimi**, nga të cilat 27 me OJF, 15 me institucione homologe dhe të tjerat me institucione shtetërore dhe Universitete Publike.

Bashkëpunime me profesoratin e Universiteteve dhe me Organizatat e Profesionistëve të fushës ka përvijuar edhe përgjatë vitit 2017, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e tyre për Revistën Shkencore të KLSH-së, Konferencat Shkencore të KLSH-së, trajnimet, rekrutimet e stafit, etj.

- Në datën 30 qershor, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Dr.Bujar LESKAJ dhe Rektori i **Kolegjit Universitar “Luarasi”**, Prof. Dr. Arben Malaj nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në ambientet e KLSH-së. Marrëveshja vjen në kuadër të interesit të përbashkët për të bashkëpunuar në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive profesionale të stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në njërën anë, si dhe në zhvillimin e kurrikulave dhe mendimit shkencore të Kolegjit Universitar “Luarasi” në anën tjetër, përmes kontributit që ofron KLSH-ja si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili ndihmon në përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike nga Qeveria dhe entet e tjera publike nëpërmjet auditimit. Kjo marrëveshje do të gjejë një zbatim tepër produktiv për të dyja palët dhe do të shtrihet në bashkëpunime në konferenca shkencore si dhe në fushën e auditimit.
- Në datën 26 korrik, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe **Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP)**. Marrëveshja ka si qëllim vendosjen e një bashkëpunimi të ndërsjellë, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit konkret dhe të frytshëm në funksion të parandalimit e luftës kundër korrupsionit e pastrimit të parave, ose aktiviteteve të lidhura me to si dhe forcimin e sistemit parandalues kundër pastrimit të parave në vend.
- Në datën 17 prill, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe **Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Europian (në vijim AAPAA)** me synim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e auditimit të fondeve të BE-së, si edhe në fusha të tjera me interes të përbashkët.
- Në datën 12 prill, midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe **Ministritë së Financave** u ri-nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi me synim rritjen e performancës, eficiencës dhe efikasitetit të punës së auditimit të jashtëm, auditimit të brendshëm si dhe veprimtarisë së inspektimit financiar publik.

Konferenca e V-të Shkencore e KLSH-së

Konferenca e V-të vjetore shkencore që organizoi KLSH vjen pas Konferencës së IV-t Shkencore “Analiza e Riskut”, në qershor të vitit 2016, e cila bëri publike hartën e risqeve në sektorin publik shqiptar, me qëllim informimin e qytetarëve për zonat nevralgjike të shërbimeve publike dhe nxitjen e ndërgjegjësimit qeveritar për marrjen e masave për reduktimin e risqeve.

Konferenca e V-të u zhvillua në datat 11 -13 tetor 2017, në Tiranë dhe u realizua si një bashkëpunim mes Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Gjykatës Turke të Llogarive dhe Fondacionit të Kontabilitetit për Bashkëpunim Akademik të Turqisë.

Konferenca e këtij viti kishte si temë kryesore *“Të Auditosh për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim”* dhe në të morën pjesë rreth 160 të ftuar. Në këtë konferencë kishte përfaqësues nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Kontrolli i Lartë i shtetit, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Unioni i Dhomave të Audituesve dhe Kontabilistëve të Licencuar të Turqisë, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve, Universiteti i Lodz-it, Këshilli i Kontabilistëve të Shqipërisë, studentë, auditues, etj.

Në këtë konferencë prezantuan punimet e tyre tre përfaqësues nga KLSH, Prof.Ass.Dr.Manjola Naço, Drejtore e Përgjithshme; Dr. Aulent Guri, Kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Performancës dhe Znj. Ina Sokoli, Audituese e Parë në Drejtorinë e Metodologjisë dhe Zhvillimit. Në punimin e saj znj. Naço u fokusua në hendekun mes nevojave në sistemin shëndetësor dhe burimeve ekonomike në dispozicion. Mungesa e burimeve publike është një problem serioz në rritje, kësajsoj, menaxhimi i kostove rrjedhëse është më urgjent sesa mbulimi i kostove të aseteve të reja.

Dr. Aulent Guri prezantoi punimin e tij për auditimin e Parkut kombëtar të Prespës me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e faktorëve që ndikojnë në ekosistemin e kësaj zone si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e situatës aktuale sociale, ekonomike dhe mjedisore.

Punimi i znj. Sokoli u fokusua në sfidat që sjellin investimet e huaja direkte për sa i takon legjislacionit shqiptar dhe përdorimit të parasë publike.

KLSH do të vijojë traditën e mirë të krijuar në këto pesë Konferencat e viteve të fundit. Gjatë viti 2018 janë parashikuar të zhvillohen dy konferenca shkencore, Konferenca e VI-të Shkencore e KLSH-së në bashkëpunim me SAI-n e Kuvajtit,

“Auditimi me Bazë Risku” në datat 9-11 prill dhe një tjetër Konferencë Shkencore në të cilën do të jemi pjesëmarrës, organizuar nga SAI Bullgar, me tematikë kryesore *“Roli i SAI-ve në mirëqeverisje”*, në datat 14-15 maj 2018, në Sofje.

Një tjetër dimension i rëndësishëm **është komunikimi me Parlamentin**. Qysh prej vitit 2012, KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë marrëdhënieve me Parlamentin duke e konturuar këtë raport në shinat e forcimit të llogaridhënies, transparencës dhe mirëqeverisjes. Vullneti për thellimin e bashkëpunimit ka qenë reciprok sepse edhe Kuvendi ka treguar një vëmendje të veçantë në raport me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Në rrafshin e komunikimit institucional dhe të detyrimeve të ndërsjella kushtetuese midis dy institucioneve, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka dërguar Kuvendit disa raporte me ndjeshmëri të lartë publike dhe vetëm gjatë vitit 2017 janë dërguar 24 të tilla.

Për të gjitha detyrat e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, Kontrolli i Lartë të Shtetit ka hartuar plane konkrete pune për zbatimin e tyre. Kontrolli i Lartë i Shtetit, si Institucioni më i lartë i kontrollit Ekonomiko-Financiar në vend, njëherazi është agjent i Kuvendit për të siguruar mirë-administrimin me efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet të fondeve publike, në bazë të Standardeve të INTOSAI-t. KLSH e zbaton këtë mision dhe detyrë madhore, duke i raportuar Kuvendit sipas përcaktimeve kushtetuese, si dhe duke zbatuar çdo rekomandim dhe orientim të Kuvendit. Janë këto arsye që institucioni i ka konsideruar në pesë vitet e fundit Rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë *“Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, si programe të qarta pune për të. Këto rekomandime janë përfshirë natyrshëm në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH.

Bashkëpunimi me SAI-et partnere dhe institucione të tjera ndërkombëtare

Një ndër ngjarjet më të rëndësishme të vitit 2017 **është dekorimi i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit**, z. LESKAJ nga Presidenti i Republikës së Polonisë me Urdhrin *“Kryqi kalorsiak i urdhrit për merita në dobi të Republikës së Polonisë”*. Për autoritetet polake, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të konsiderohet padyshim si një mik i Polonisë dhe promovues i kulturës polake. Zoti LESKAJ që në fillim të mandatit të tij si Kryetar i KLSH-së ka mbështetur dhe ka qenë promotor i bashkëpunimit mes dy institucioneve supreme të Auditimit. Ky bashkëpunim ka qenë i frytshëm në drejtim të forcimit të kapaciteteve të audituesve dhe veçanërisht në drejtim të mbështetjes që institucionet i kanë dhënë njëri-tjetrit në komunitetin e INTOSAI-t dhe të EUROSAI-t.

Ceremonia e dekorimit u zhvillua në datën 19 prill 2017 në Varshavë, në ambientet e Institucionit Suprem të Auditimit të Republikës së Polonisë (NIK). Në ceremoninë e dekorimit morën pjesë Përfaqësuesit më të lartë të shtetit polak si dhe ambasadorja e Shqipërisë në Poloni. Dekorata akorduar nga Presidenti i Republikës, z. Andrzej Duda iu dorëzua z.LESKAJ nga Sekretari i Shtetit, pranë Presidentit z.Andrzej Duda.

Kryetari i KLSH, Z. Bujar LESKAJ është dekoruar gjithashtu gjatë vitit 2017 edhe nga Presidenti i Republikës, SH.T.Z. Nishani me urdhrin **“Gjergj Kastriot Skënderbeu”** me dekretin nr. 10445, dt.12.06.2017 për kontributin e pamohueshëm në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës si dhe ka mundësuar me drejtimin e tij të pagabuar rritjen cilësore të KLSH-së për të qenë një nga institucionet model të shtetit shqiptar.

Në zbatim të orientimeve dhe realizimit të objektivave të dhëna nga Kryetari i KLSH, janë ndjekur të gjitha procedurat për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përcaktuara jashtë vendit dhe konstatojmë me kënaqësi që gjatë vitit 2017 kanë marrë pjesë në aktivitetet jashtë vendit 146 auditues ose 675 ditë/njerëz në total, thënë ndryshe pothuajse të gjithë audituesit e KLSH-së kanë qenë të paktën një herë jashtë vendit. Viti 2017 ka ruajtur trendin e suksesshëm të pjesëmarrjes së audituesve në aktivitete të ndryshme trajnuese të ofruara nga SAI-t homologe dhe institucione të tjera ndërkombëtare.

Në tabelën më poshtë gjenden të dhënat për vitet 2015, 2016 2017:

Numri i punonjësve	Ditë/njerëz	Viti
135	775 ditë	2015
153	765 ditë	2016
146	675 ditë	2017

Pjesëmarrja e Kryetarit në aktivitetet e rëndësishme jashtë vendit

Përgjatë vitit 2017 janë zhvilluar 57 aktivitete, të tilla si Kongrese, Konferenca, Takime, seminare, trajnime, (këto të fundit edhe në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-et homologe) dhe Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve e Jashtë ka qenë e përfshirë edhe në organizimin e 2 aktiviteteve të kryera në bashkëpunim me Institucionet Homologe dhe institucione të tjera të huaja.

Ndër këto aktivitete, veçojmë vizitat dhe pjesëmarrjen e Kryetarit të KLSH në aktivitetet e mëposhtme, të cilat kanë pasur rëndësi të veçantë në vendosjen e partneriteteve strategjike të bashkëpunimit të KLSH-së:

- Pjesëmarrja në Ceremoninë e 40 vjetorit të Deklaratës së Limës;
- Kongresi i X-të i EUROSAT-t në Stamboll;
- Pjesëmarrja e Kryetarit në Mëngjesin e Lutjeve;
- Vizita në SAI-n e Qipros;
- Vizita në SAI e Polonisë;
- Pjesëmarrja në Konferencën e 9-të Vjetore të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës;
- Pjesëmarrja në Simpoziumin e INTOSAI-t në Vjenë;
- Pjesëmarrja në 40 vjetorin e krijimit të Gjykatës Europiane të Auditimit dhe në takimin e Komitetit të Kontaktit në Luksemburg;
- Pjesëmarrja në 10 vjetorin e krijimit të SAI-t të Serbisë.

Në kuadër të pjesëmarrjes së Mëngjesin e Lutjeve, në datën 30 janar 2017, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar LESKAJ takoi në Uashington D.C. drejtues të lartë të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO), përkatësisht z. James-Christian Blockwood, Drejtor i Planifikimit Strategjik dhe i Marrëdhënieve me Jashtë dhe zj. Janet St.Laurent, Drejtoreshë e Qendrës së Ekselencës në Auditim. Zoti LESKAJ dhe dy përfaqësuesit e lartë të GAO-s diskutuan fushat e bashkëpunimit me Qendrën e Ekselencës në trajnime afatgjata e afatshkurtra të audituesve shqiptarë, veçanërisht për Auditimin e Performancës dhe të IT, si edhe në sferën e Planifikimit Strategjik 2018-2022.

Një nga ngjarjet më të rëndësishme në komunitetin e INTOSAI-t në vitin 2017 ishte kremtimi i 40 vjetorit të Deklaratës së Limës në datat 5-7 dhjetor 2017. Kjo Deklaratë, ISSAI 1, është guri i themelit në punën e audituesit të jashtëm dhe, jo vetëm i ka qëndruar testit të kohës, por frymëzon zhvillime të vazhdueshme për të rritur impaktin dhe rëndësinë e SAI-eve. Pjesë e aktiviteteve të prezantuara në takim ishte dhe prezantimi i Peer Review (vlerësimit mes kolegëve), që SAI austriak në bashkëpunim me *Austrian Development Cooperation* kishte realizuar në 7 SAI-e të ndryshme, proces i kryer edhe në KLSH. Disa nga SAI-t e vlerësuara, përfshirë

edhe Shqipërinë, bënë një prezantim të detajuar të punës dhe rezultateve të procesit të Peer Review.

Në vijim, Kryetari i KLSH-së, z. LESKAJ, realizoi një takim bilateral me një nga hartuesit kryesorë të Deklaratës së Limës dhe firmosësit e saj, Dr. Hubert Weber. Përgjatë gjithë vizitës 3-ditore, përfaqësuesit e KLSH-së vendosën ura bashkëpunimi me kolegët e tyre nga mbarë bota. Kryetari i KLSH-së zhvilloi takime të shumta bilaterale me Presidentin e INTOSAI-t, z. Harib Saeed al Amimi, Presidentët e SAI-t polak z. Krzysztof Kwiatkowski, atë bullgar z. Tzvetan Tzvetkov, Çek z. Miloslav Kala, peruan z. Nelson Shack, delegacionin austriak që organizoi këtë event me SAI-n peruan dhe që mban rezidencën e përhershme të Sekretariatit të INTOSAI-t, si edhe drejtues të SAI-eve të vendeve të rajonit, Maqedoni, Bosnje-Hercegovinë, Mal i Zi, etj.

Një ndër aktivitetet më të rëndësishme të komunitetit të SAI-eve të vendeve të BE ishte zhvillimi i **Kongresit të X të EUROSAT-t**. Ky Kongres, që njohu pjesëmarrjen e 50 delegacioneve të vendeve të kontinentit europian, u mbajt në një kohë kur institucionet supreme të auditimit (SAI-t) në mbarë botën po kalojnë nëpër ndryshime të jashtëzakonshme, për të luajtur një rol aktiv në auditimin e sektorit publik. Kjo sfidë kërkon që SAI-t të pajisen me auditim të avancuar, analizë, raportim dhe me aftësi të spikatura të komunikimit, të cilat nuk mund të përmbushen vetëm duke u mbështetur në metodat tradicionale të auditimit.

Pjesë e aktiviteteve të kongresit ishte dhe zhvillimi i seminarit *“Implementimi i ISSAI-ve: Sfida dhe zgjidhje për zhvillim të mëtejshëm” dhe miratimi i Planit Strategjik 2017-2023*. Ky plan është shumë i rëndësishëm për komunitetin e 50 SAI-ve të kontinentit, sepse synon realizimin e objektivave tejet ambicioze të SAI-ve europiane drejt modernizimit të tyre të mëtejshëm dhe përballimit të sfidave të ekonomive publike të kontinentit. Gjatë zhvillimeve të këtij Kongresit, delegacioni i KLSH i kryesuar nga Kryetari i KLSH, z. Bujar LESKAJ, zhvilloi takime të shumta me përfaqësuesit e SAI-ve pjesëmarrëse.

Në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit me institucionet homologe në datën 27 mars 2017, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Bujar LESKAJ, zhvilloi një vizitë zyrtare **në Zyrën e Auditimit të Qipros**, ku nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me homologun e tij, z. Odysseas Michaelides.

Kryetari i KLSH-së evidentoi frymën e bashkëpunimit mes KLSH-së dhe SAI-t të Qipros, e cila motivohet dhe gjen shumë gjëra të përbashkëta edhe nga të qenit vende të Mesdheut. Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj marrëdhënie premtan rezultate

pozitive për zhvillimin reciprok të të dy SAI-ve, bazuar në moton e INTOSAI “*Experientia mutua omnibus prodest*”.

Diskutime midis Kryetarit të KLSH-së dhe Audituesit të Përgjithshëm të Qipros u fokusuan në institucionalizimin dhe konkretizimin e bashkëpunimit në fushën e auditimeve të performancës dhe në veçanti në temat mbi mbrojtjen e mjedisit.

Marrëveshja e nënshkruar është me shumë vlera për KLSH-në dhe vjen pas nënshkrimit të disa marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-et Europiane e më gjerë, të tilla si NIK-u Polak, Gjykata Austriake e Auditimit, Gjykata Turke e Llogarive, SAI-et e Kroacisë dhe Sllovenisë dhe në nivel rajonal, me SAI-et e Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë dhe Bullgarisë. Zbatimi i këtyre marrëveshjeve, ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së.

Në frymën e shkëmbimit të eksperiencës midis institucioneve dhe midis kolegëve auditues, në datën 18 deri në 20 Korrik 2017, **pranë Zyrës Rajonale të NIK-ut të Polonisë** në Wrocław, Kryetari i KLSH-së z. Bujar LESKAJ dhe një grup audituesish të KLSH-së, morën pjesë në një vizitë studimore.

Kjo vizitë u realizua në një nga zyrat rajonale më të mëdha të NIK-ut, e cila kryen auditime shumë të rëndësishme për shkak të investimeve të mëdha të realizuara në këtë qytet, si qytet i tretë nga madhësia në Poloni. Ajo ishte konceptuar kryesisht si një format bashkëpunimi mbi bazat e shkëmbimit të eksperiencës dhe kishte si qëllim kryesor pasurimin me informacione dhe praktika të tjera ndërkombëtare në fushën e auditimit.

Me ftesë të Audituesit të Përgjithshëm të **Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKA)**, Kryetari i KLSH-së, z. Bujar LESKAJ dhe një grup audituesish të KLSH-së morën pjesë në Konferencën e 9-të Vjetore të ZKA, zhvilluar në 13 korrik në Prishtinë. Tema e Konferencës ishte “*Fuqizimi i llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të institucioneve të sektorit publik, përmes zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm*”.

Në fjalën përshëndetëse, kreu i KLSH vlerësoi partneritetin solid dhe ndëraktiv mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ZKA, duke çelur një horizont të ri bashkëpunimi përmes kryerjes së auditimeve të përbashkëta, në fusha me interes për të dyja palët.

Në 31 Maj deri në 2 Qershor 2017 u zhvillua në selinë e Kombeve të Bashkuara në Vjenë **simpoziumi i INTOSAI-t në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB)**. Në këtë Simpozium mori pjesë edhe Kryetari i KLSH, z. LESKAJ si dhe përfaqësues të lartë të institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve) nga 76 vende të botës. Simpoziumi organizohet çdo dy vjet nga Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t në Vjenë, me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i këtij simpoziumi është zhvillimi i kapaciteteve institucionale të SAI-ve duke trajtuar çështje aktuale në fushën e auditimit publik dhe kontribuar në zhvillimin e metodologjive në këtë fushë. Simpoziumi u fokusua në dy tema:

- Digjitalizimi, të dhënat e hapura dhe përpunimi i tyre: rëndësia dhe implikimet në auditimet e SAI-t;
- Kontributi i SAI-ve në përmbushjen e Axfordës 2030 të OKB duke ndjekur dhe vlerësuar përmbushjen e Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ), në përputhje me angazhimin e marrë në Kongresin e XXII të INTOSAI-t.

Në datat 12-13 tetor një delegacion i kryesuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar LESKAJ mori pjesë në takimin e drejtuesve të **SAI-eve anëtarë të Komitetit të Kontaktit** të vendeve të Bashkimit Europian, të organizuar nga Gjykata Europiane e Audituesve në Luksemburg dhe aktivitetet e zhvilluara me rastin e 40 vjetorit të krijimit të kësaj Gjykate.

Tema kryesore e takimit të drejtuesve të SAI-eve anëtare të Komitetit të Kontaktit të vendeve të Bashkimit Europian dhe vendeve kandidatë të BE ishte *“Kontributi i SAI-ve për rikthimin e besimit të qytetarëve europianë”*. Ceremonia zyrtare për 40 vjetorin e krijimit të Gjykatës Europiane të Audituesve u përshëndet nga Presidenti i Parlamentit Europian, z. Antonio Tajani dhe Presidenti i Komisionit Europian, z. Jean-Claude Juncker, të cilët në fjalën e tyre theksuan rëndësinë dhe rolin e pazëvendësueshëm të Gjykatës si mbikëqyrëse të menaxhimit të parasë publike, duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes.

Gjatë ditëve të zhvillimit të takimit të Komitetit të Kontaktit, Kryetari i KLSH, z. LESKAJ zhvilloi një takim me Presidentin e Gjykatës Gjermane të Auditimit, z. Kay Scheller, me të cilin diskutoi rreth thellimit të bashkëpunimit konkret midis dy institucioneve, nëpërmjet përfitimit të shkëmbimit të eksperiencës gjermane, si një nga SAI-et më moderne në Europë. Ky bashkëpunim shpresojmë të konkretizohet gjatë vizitës së pritshme të z. Scheller gjatë vitit 2018 në Tiranë.

Z. LESKAJ gjithashtu zhvilloi takime pune me Presidentin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë, z. Krzysztof Kwiatkowski, Presidentin e SAI-t të Republikës Çeke, z. Miloslav Kala, Presidentin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Bullgarisë, z.Tzvetan Tzvetkov, Audituesin e Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Kroacisë, z.Ivan Klešić, Audituesin e Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Bosnjë-Hercegovinës, z. Dragan Vrankić, Audituesin e Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Kosovës, z. Besnik Osmani dhe përfaqësues të SIGMA-s. Në këto takime z. LESKAJ diskutoi eksperiencat dhe hapat konkrete të bashkëpunimit me këto institucione, të cilat përbëjnë një vlerë të shtuar në konsolidimin shumë dimensional të KLSH-së.

Në kuadër të bashkëpunimit me SAI-et e vendeve të rajonit, në **datën 7 qershor 2017 Kryetari i KLSH mori pjesë në ceremoninë e 10 vjetorit të themelimit të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Serbisë**. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga 18 Institucione Supreme të Auditimit të EUROSAT-t, përfshirë përfaqësues të Gjykatës Europiane të Audituesve, të Programit SIGMA dhe përfaqësues të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare si dhe zyrtarë të Parlamentit dhe qeverisë serbe. Presidenti i SAI-t Serb, z. Radoslav Sretenoviç ka marrë pjesë në ceremoninë e 90 vjetorit të krijimit të KLSH-së dhe të tilla evente janë tepër produktive për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira, në shembullin e motos së INTOSAI-t *“Experientia Mutua Omnibus Prodest”*.

Vizitat e Drejtuesve të SAI-eve Homologe në Tiranë dhe personaliteteve të tjera të huaja

KLSH i ka dhënë një rënësi të veçantë thellimit të bashkëpunimit me SAI-et homologe.

Kështu gjatë vitit 2017 KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me SAI-n e Qipros, Kuvajtit dhe SAI-n e Hungarisë, marrëveshje që synojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencave me të mira në Auditim (në total, KLSH ka nënshkruar 15 marrëveshje gjatë 6 viteve të fundit me Institucionet Homologe).

Aktivitete të rëndësishme gjatë vitit 2017 kanë qenë:

- vizita e Presidentit të SAI-t të Kuvajtit z. Adel Abdulaziz Al-Saraawi në datat 6-7 mars 2017 në Tiranë;
- vizita e Presidentit të SAI-t të Çekisë z. Kala;
- vizita e Presidentit të SAI të Bullgarisë, z.Tzvetan Tzvetkov;

- Drejtues të NIK-ut Polak, zv/Presidenti Wojciech Kutyla, ish-Presidenti z.Jacek Jezierski dhe Drejtues të Zyrove Rajonale.

Në të gjitha takimet e zhvilluara me homologët e tij, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit shprehu gatishmërinë për bashkëpunimin me institucionet supreme të auditimit të sipërcituara me synim ngritjen dhe përsosjen e kapaciteteve audituese.

Gjatë vitit 2017, Kryetari i KLSH, z. LESKAJ ka pritur në takime të veçanta profesorin e shquar amerikan të Universitetit të Nebraskës, z. Sang M. Lee dhe Drejtoreshën e Qendrës së Ekselencës në Auditim të GAO-s, znj. Janet St.Laurent. Të dy këta përfaqësues të shquar kanë mbajtur leksione të hapura për audituesit e KLSH.

Aktivitetet e organizuara nga KLSH në bashkëpunim me SAI-e homologe dhe institucione te tjera:

KLSH gjatë vitit 2017 ka vërtetuar se ka kapacitete për të organizuar edhe aktivitete ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim tryezën e rrumbullakët mbi "**Rolin e SAI-ve në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit**". Kjo tryezë e rrumbullakët e zhvilluar në datat 14-16 qershor 2017 u bashkë organizua me SIGMA-n. Aktiviteti, në të cilin morën pjesë përfaqësues nga Gjykata Europiane e Audituesve (ECA), nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) të Suedisë dhe Çekisë, nga SAI-t e rajonit, Kosova, Bosnje-Hercegovina, Turqia, Mali i Zi dhe Serbia, përcolli mesazhin e rëndësishëm se Institucionet Supreme të Auditimit janë një ndër veprimtarët kryesorë në luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit. Me mbikëqyrjen e financave publike dhe rolin e tyre në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik, ata japin një kontribut të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për mirëqeverisjen. Megjithatë, SAI-t kanë mandate të ndryshme në luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit dhe përballen me sfida domethënëse në përmbushjen e pritshmërive të palëve të interesuara, kur është fjala për parandalimin, zbulimin dhe raportimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Aktiviteti tjetër mjaft i rëndësishëm i organizuar nga KLSH dhe SAI i Estonisë ishte takimi i 15 i Grupit të punës të EUROSAI-t për Auditimet e Mjedisit

Në takimin e zhvilluar në datat 17-20 tetor 2017 morën pjesë 70 përfaqësues të 26 SAI-ëve të BE. Temat kryesore të aktivitetit ishin "*Auditimi i përdorimit të tokës dhe zhvillimi*" dhe "*Si mund të përdoren të dhënat në auditimet e mjedisit?*".

Në këtë aktivitet u paraqitën rreth 25 punime, në të cilat u theksua që përdorimi i tokës përfshin menaxhimin dhe modifikimin e ambientit natyror, çka ndikon në jetën e njerëzve por edhe të faunës.

Auditimi i politikave mjedisore nëpërmjet njohjes së thelluar të çështjeve që lidhen me përdorimin e tokës, pasojat që sjellin politikat e gabuara të hartuara nga qeveritë, i vendos SAI-et para sfidave për të qenë koherente dhe *avant-garde* në rekomandimet që dalin nga auditimet e kryera në këtë fushë.

Pjesëmarrja e KLSH në aktivitete të ndryshme jashtë vendit

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka qenë tepër aktiv dhe ka marrë pjesë edhe në një sërë takimesh të zhvilluara nga grupet e punës së EUROSAI-t dhe INTOSAI- t ku mund të përmenden:

- Pjesëmarrja në takimin e WGEA për kryerjen në bashkëpunim të auditimit për cilësinë e ajrit zhvilluar në Krakovë të Polonisë, në datat 26-27 shkurt 2017;
- Pjesëmarrja në takimin e TFA&E, në datat 2-3 shkurt 2017 në Londër;
- Pjesëmarrja në takimin e Grupit të punës për Auditimet IT, të zhvilluar në datat 20-21 mars në Gjenevë, Zvicër;
- Pjesëmarrja në takimin e Grupit të Punës EUROSAI-t për auditimin e fondeve për katastrofat natyrore të zhvilluar në Romë në datat 30-31 mars 2017;
- Pjesëmarrja në Kick off-in për grupin e punës për auditimin e bashkive, zhvilluar në Vilnius në datat 11-12 prill 2017;
- Pjesëmarrja në seminarin për çështjet e integritetit të zhvilluar në Budapest në datat 24-28 prill 2017;
- Pjesëmarrja në takimin e Task forcës për Banking Union të zhvilluar në Hagë në datat 4-5 shtator 2017;
- Pjesëmarrja në Young EUROSAI zhvilluar në Talin;
- Pjesëmarrja në seminarin e 4-t të taskforcës së EUROSAI-t për auditimin e bashkive zhvilluar në Riga në datat 5-6 tetor 2017;
- Pjesëmarrja në takimin e WGEA për kryerjen në bashkëpunim të auditimit për cilësinë e ajrit zhvilluar në Luksemburg në datat 8-9 nëntor 2017;

- Pjesëmarrja në takimin për *Strategic Goal 1* zhvilluar në Potzdam të Gjermanisë në datat 29-30 nëntor 2017.

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO ka shtuar në aktivitetet e Kontrollit të Lartë një takim të rëndësishëm siç është mbledhja e Njësive Audituese Kombëtare CNABN, ku me 8-9 maj 2017 u diskutua rreth Raportit vjetor të aktivitetit të Bordit Ndërkombëtar të Audituesve (IBAN) për NATO-n. Tashmë prej disa vitesh, Kontrolli i Lartë i Shtetit merr pjesë aktive në këtë aktivitetet të përvitshëm, si Institucioni Suprem i Auditimit të Shtetit Shqiptar, anëtar i NATO-s.

Qendra për Ekselencë në Financë në Ljubjanë, CEF, vazhdon të jetë një nga institucionet kryesore të trajnimeve të audituesve të KLSH-së. Me lektorë, nga më të mirët të fushës së financave, në CEF audituesit e KLSH-së janë njohur me teknikat më bashkëkohore të auditimit në fushën e auditimit financiar, ku mund të përmendim workshop-in për pasqyrat financiare.

Me rëndësi për t'u shquar është Seminari me temë *Prokurimi Publik dhe Koncesionet e BE-së* nga Institutit Europian për Administratën Publike, zhvilluar në Dubrovnik në datat 25-26 prill 2017. Ky institut është një nga qendrat më prestigjioze mbi integrimin europian dhe sfidat e reja të menaxhimit publik, e cila ofron aktivitete trajnuese, hulumtime shkencore dhe shërbime konsulence në fushën e vendimmarrjes së BE, ligjeve dhe politikave të saj si dhe çështjeve rajonale.

Workshop-et mbi Auditimin Paralel të Performancës (PPAII) përbëjnë një tjetër aktivitet me rëndësi për vitin 2017. Pas Malit të Zi, Kosovës, Suedisë dhe Shqipërisë në 2016, PPA II u zhvillua në Shkup në datat 7-9 mars 2017 dhe në Beograd në datat 5-9 qershor 2017. Pjesëmarrja e KLSH-së në këtë format është një tjetër dëshmi e konsolidimit të auditimit të performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Internshipi i ECA-s dhe fellowship i GAO-s

Në modernizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë dhënë një kontribut të çmuar Gjykata Europiane e Audituesve (ECA), nëpërmjet intershipeve dhe Zyra e Auditimit Qeveritar të SHBA-së GAO, përmes fellowship-eve. Falë kësaj asistence, në KLSH po krijohet një gjenerate e re audituesish me parametrat e kolegëve të tyre euro-atlantikë.

Në vitin 2017, dy auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë qenë pjesë e strukturave të ECA-s për një periudhë 5 mujore, duke përfituar nga programet e internshipit të këtij institucioni, për të kontribuar pranë departamenteve dhe

drejtorive të ndryshme të ECA-s. Internshipi është konsideruar një mjet shumë i rëndësishëm për të ofruar njohuri mbi auditimin e fondeve të BE-së, për audituesit e SAI-ve të vendeve që aspirojnë të bëhen anëtare të BE-së. Në total janë 12 auditues të KLSH-së që kanë fituar internship-et tek ECA, përfshirë dy audituese që do të fillojnë internshipin në mars 2018.

Po aq produktive për KLSH-në ka rezultuar edhe bashkëpunimi me GAO-n e SHBA-së ku gjatë vitit 2017 dy auditues të KLSH-së morën pjesë në një fellowship 4 mujor pranë kësaj zyre ndërsa gjatë 2018 dy auditues do të ndjekin këtë felloëship. Fellowshipi është hartuar për të forcuar kapacitetet e SAI-ve e për të rritur llogaridhënien dhe mirëqeverisjen. Pjesëmarrësit kanë mundësi të njihen me përvojën amerikane të auditimit, me qëllim zhvillimin e strategjive për të sjellë ndryshim dhe për ta përcjellë dijen e përfituar në SAI-et e tyre respektive.

Implementimi i projektit të binjakëzimit gjatë vitit 2017

Projekti i binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve të auditimit te jashtëm”, i cili nisi të implementohej në KLSH në mars të vitit 2016 ka vijuar të zbatohet në mënyrë të suksesshme edhe gjatë vitit 2017. Projekti është i ndarë në tre komponentë:

- Përmirësimi i kornizës ligjore për auditimin;
- Zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve të raportimit;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i impaktit të rezultateve të auditimit.

Gjatë këtij viti janë kryer 37 misione, nga të cilat 2 i përkasin komponenti të parë, 24 misione i përkasin komponentit të dytë dhe 11 misione që i përkasin implementimit të komponentit të tretë.

Misionet e kryera përgjatë vitit 2017 ishin të fokusuara në:

- Marrëdhëniet e SAI-t me Parlamentin;
- Analizën e kornizës ligjore dhe praktikat e KLSH për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve;
- Trajnimet për zhvillimin e metodologjisë dhe kapacitetet e raportimit;
- Kryerjen e tre auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë me mbështetjen e ekspertëve polakë;

- Kryerjen e auditimeve pilot të performancës, ku mund të përmendet bashkëpunimi me kolegët holandezë për kryerjen e auditimit në departamentin e administratës publike dhe kryerja e auditimit të performances për strategjinë e turizmit në bashkëpunim me kolegët kroatë;
- Zhvillimi i manualit IT;
- Modulet e auditimit IT në trajnimet standard për audituesit e KLSH;
- Krijimi i Helpdesk-ut;
- Kryerja e auditimit IT pilot në Drejtorinë e Tatim Taksave në Bashkinë e Tiranës;
- Zhvillimi i metodologjive për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë;
- Vlerësimi i riskut në rishikimin e strukturës së brendshme të KLSH dhe i përgjegjësisë funksionale për çdo njësi;
- Hartimi i politikave të burimeve njerëzore dhe udhëzuesve përkatës;
- Implementimi i politikave të burimeve njerëzore;
- Implementimi i skemës për menaxhimin dhe dokumentimin e kohës së punës audituese;
- Shqyrtimi i procedurave dhe praktikave për zhvillimin profesional të audituesve në KLSH;
- Përcaktimi i kompetencave dhe komponentëve të dëshiruar për procedure e certifikimit të audituesve;
- Zhvillimi i procedurave për trajnimin e vazhdueshëm;
- Përcaktimi i hapave dhe masave për rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së opinionit publik.

Pas zhvillimit të suksesshëm të misioneve, në të cilat ekspertët polakë, kroatë dhe holandezë kanë bashkëpunuar ngushtë me drejtues dhe auditues të KLSH-së, dokumentet e dorëzuara nga ekspertet janë:

- Vlerësimi për seminarin e marrëdhënies së SAI-t me Parlamentin;
- Analiza e kornizës ligjore dhe praktikave të KLSH për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve;

- Draftimi i manualit për ndjekjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve të auditimit;
- Dokumenti i udhëzuesit për rishikimin e Manualit të Auditimit të Përformancës;
- Korniza e Manualit të Auditimit IT;
- Manuali i auditimit dhe udhëzuesit e tjerë për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë;
- Raporti i analizës së risqeve për strukturën e brendshme;
- Draft-template për përshkrimin e punës;
- Drafti i politikës së burimeve njerëzore ;
- Draft-skema e menaxhimit të zhvillimit të audituesve të rinj;
- Draft-koncepti i procedurave/rregullave për trajnimet e përhershme;
- Draft-plani për përmirësimin e transparencës së KLSH;
- Draft-udhëzuesi për komunikimin e jashtëm;
- Strategjia e Komunikimit dhe dokumentet e planifikimit.

Në përfundim të 37 misioneve ekspertët kanë dhënë mbi 80 rekomandime.

Lidhur me rekomandimet e dhëna nga ekspertët polakë, kroatë dhe holandezë me Vendimin e Kryetarit nr. 83, dt. 30.06.2017 është miratuar template i rekomandimeve të projektit IPA për periudhën mars 2016-shkurt 2017, personat përgjegjës dhe afatet për implementimin e rekomandimeve. Nga Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, përgjegjëse për ndjekjen e projektit është hartuar edhe template i dytë për rekomandimet e lëna nga ekspertët për rekomandimet e periudhës mars- tetor 2017.

Në zbatim të rekomandimeve të projektit mund të theksohet se është miratuar strategjia e komunikimit, dokumenti i politikave të burimeve njerëzore dhe po punohet për dokumentet për udhëzuesit për marrëdhëniet me parlamentin.

Në kuadër të projektit janë zhvilluar 6 misione trajnuese me një total prej 21 ditësh trajnim, të cilat lidhen me të gjitha etapat në të cilat kalojnë auditimet financiare dhe të përputhshmërisë, trajnime për krijimin e hepldesk-ut, të moduleve të auditimit IT për audituesit dhe çështjet e komunikimit.

Gjithashtu gjate këtij viti janë zhvilluar dhe 2 vizita studimore, në të cilat audituesit e KLSH kishin mundësi të përfitonin eksperiencë nga koleget polakë dhe kroatë për çështjet e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, në vizita studimore 5 ditore, në të cilat kanë marrë pjesë 31 drejtues dhe auditues të KLSH-së.

Në misionet e zhvilluara në periudhën janar-dhjetor 2017 kanë marrë pjesë 98 drejtues dhe auditues të KLSH-së me përkatësisht 893 ditë/njerëz ose mesatarisht me një përfshirje individuale prej 9 ditësh.

Fondi i përdorur nga financimi i projektit IPA për vitet 2016-2017 është 1.579.227 euro. Nga fondi i qeverisë shqiptare, akorduar KLSH si pjesë e bashkëfinancimit është përdorur për zërat e financimit të biletave të udhëtimit për vizitat studimore dhe aktivitetet trajnuese (marrje ambientesh me qera) 2.984.140 lekë nga 5.700.000 lekë parashikuar për vitin 2017.

Projekti i binjakëzimit është monitoruar nga strukturat e Komisionit Europian. Në vizitën e monitorimit të kryer nga këto struktura në datat 6-15 shtator 2017 u intervistuan struktura përgjegjëse për implementimin e projektit në KLSH, këshilltarja rezidente e projektit, përfaqësues të CFCU dhe përfaqësues të delegacionit të Bashkimit Europian, të cilët mbikëqrin mbarëvajtjen e projektit të binjakëzimit që implementohet në KLSH. Kriteret e vlerësimit ishin:

- Relevanca;
- Efektiviteti;
- Eficienca;
- Qëndrueshmëria.

Në të gjitha pikat e sipërcituara projekti u vlerësua pozitivisht, duke vlerësuar largpamësinë në planifikimin e planit të projektit dhe relevancën e produkteve që do të prodhojë projekti, me synim ngritjen e kapaciteteve institucionale të KLSH dhe forcimin e auditimit të jashtëm publik në Shqipëri. Në përfundim të monitorimit janë lënë vetëm 3 rekomandime të cilat janë:

- I. Pas përfundimit të projektit, KLSH duhet të evidentojë produktet nga projekti i binjakëzimit dhe të theksojë impaktin e këtij projekti në sektorin e auditimit të jashtëm.

- II. KLSH dhe SAI i Polonisë të hartojnë një plan të vazhdimësisë, në të cilin në mënyrë specifike të përfshihen rekomandimet që dalin nga projekti i binjakëzimit, veprimet e kërkuara dhe afati kohor për implementimin e tyre.
- III. KLSH në konsultim me palët e interesit të rishikojë Strategjinë e Zhvillimit Institucional për vitet 2018-2022 për të përfshirë në të një strategji zhvillimi afatmesme që përcakton qartë rolin e saj të ardhshëm dhe identifikon një sërë objektivash të orientuara drejt rezultateve për të udhëhequr rrugën e zhvillimit në të ardhmen. Institucioni duhet të identifikojë nevojat e mëtejshme të zhvillimit, të kombinuara me mbështetjen potenciale të donatorëve.

Referuar planit të implementimit të projektit të binjakëzimit, për vitin 2018 planifikohet kryerja e 15 misioneve të cilat lidhen **me**:

- Analizën e kornizës ligjore dhe praktikat aktuale të KLSH për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve. Hartimin e një manuali për ndjekjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve të auditimit. Hartimin e një regjistri për rekomandimet e auditimeve të KLSH;
- Kryerjen me mbështetjen e ekspertëve të tre auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë;
- Propozimin për përditësimin/rishikimin e Manualit të Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë së KLSH-së;
- Asistimin e KLSH-së në zhvillimin e metodologjisë për vendosjen e lidhjeve procedurale midis auditimit vjetor të pasqyrave financiare të ministrive dhe shqyrtimit të raportit vjetor të ekzekutimit të buxhetit;
- Kryerjen e auditimeve pilot të performancës.

Projekti me USAID-in “Transparenca në Sistemin Shëndetësor në Shqipëri”


Projekti që KLSH ka me USAID-in “*Transparenca në Sistemin Shëndetësor në Shqipëri*” (projekt dy-vjeçar), i cili ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët shqiptarë me fokus luftën ndaj korrupsionit, përmirësimin e transparencës dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të pavarura, organizatave të shoqërisë civile dhe media-s për të kërkuar një qeverisje më të përgjegjshme në sektorin shëndetësor. Projekti synon të përmirësojë koordinimin ndër-institucional dhe të rrisë bashkëpunimin me

shoqërinë civile dhe media-n për të rritur ndërgjegjësimin rreth shkallës së korrupsionit në sistemin shëndetësor dhe trysinë për reforma për rritjen e transparencës.

Sfidat 2018

KLSH do të vijojë të pasurojë kolanën e botimeve të tij edhe për vitin 2018, gjatë të cilit janë parashikuar të botohen 17 tituj, midis të cilëve mund të përmendim:

- Audituesit e KLSH-së në Shtypin e përditshëm, Volumi X dhe XI;
- Analiza vjetore, 2017;
- Revista "Auditimi publik" nr. 18,19 dhe 20 në shqip dhe në anglisht;
- Raporti Vjetor i Performances, KLSH 2017, në shqip dhe në anglisht;
- Libri Jeshil i GAO, "Standardet e Kontrollit të Brendshëm", etj.



- Përmbyllja e Projektit IPA
- Projekti me USAID-in
- Konferenca Shkencore, etj.

MBI AUDITIMET E PERFORMANCËS TË REALIZUARA GJATË VITIT 2017
PUNA AUDITUESE E DEPARTAMENTIT TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
Nga z. Rinald MUÇA, Drejtor Departamenti



Auditimi i performancës njohu rritje në cilësi dhe sasi përgjatë 2017-s.

Nga pikëpamja sasiore, në total u evaduan 15 auditime, në 110 subjekte, me një numër gjetjesh, konkluzionesh e rekomandimesh, respektivisht 528, 424 dhe 396. Mesatarisht për çdo auditim u realizuan 41 gjetje, 33 konkluzione dhe 31 rekomandime, shifra këto të rritura respektivisht me 52, 108 dhe 54% krahasuar me një vit më parë.

Nga pikëpamja e 3E-ve, gjetje, konkluzione e rekomandime që adresonin ekonomikitetin ishin 172, eficiencën 477 dhe efektivitetin 683.

Për çdo auditues efektiv performance apo që ka realizuar auditime performance (konvertuar audituesit part-time të dept. të tjera në raportin 2 me 1), gjetjet mesatare për auditues janë 31, konkluzionet 25 dhe rekomandimet 23.

Lidhur me raportin klasik të eficiencës së punës audituese, atë që krahason paratë e kursyera nga puna audituese, me paratë e shpenzuara për këtë punë, departamenti, për shkak të pamundësisë për të monetarizuar në çdo rast dhe aktualisht 3E-të e munguara, nuk e ka llogaritur si parametër.

Nga pikëpamja e lëvrimin kohor, 7 nga 15 auditime u evaduan gjatë 6-mujorit të parë të vitit, ndërsa pjesa tjetër në gjysmën e dytë të tij.

Për sa i përket cilësisë së auditimeve, konstatohet se:

- a) Departamenti po konvergon gjithnjë e më tepër drejt strukturës raportuese të unifikuar në manual;

- b) Temat e përzgjedhura priren të reflektojnë problematikën qytetare dhe kritere të tjera të qenësishme, si materialitetin, auditueshmërinë, testimin e teknikave të reja, auditimet rajonale e europiane, etj.
- c) Njohja dhe respektimi i standardeve ISSAI të performancës po rritet në nivelin e duhur, ndonëse ka ende raste ku evidenca audituese merret e gatshme nga subjekti dhe, pa u testuar nga audituesit, futet e gatshme në projekt-raport e më tej në raport.
- d) Analiza e riskut është bërë pjesë standarde e auditimeve. Tashmë pothuajse të gjitha grupet audituese kryejnë analizën SWOT, madje në një apo dy raste bëhen përpjekje për realizuar edhe analizën PESTLE. Rol kyç në këtë drejtim luan edhe dept. i metodologjisë, që duhet të intensifikojë punën e tij trajnuese e testuese.
- e) Një pjesë e mirë e grupeve të auditimit janë shkathtësuar në ndërtimin e piramidës së çështjeve që duhen audituar, kjo edhe si pasojë e vlerësimit më të mirë të risqeve. Sikurse është theksuar edhe në vlerësimet e dosjeve audituese, kjo piramidë ende nuk markohet me teknikat e vjeljes, përpunimit dhe analizimit të informacionit për pyetjet e nivelit më të ulët, kalendarin kohor të realizimit të punës apo alokimit të burimeve të tjera për kthimin e përgjigjes dhe audituesin që mban përgjegjësi për cilësinë e punës me atë çështje. Të gjitha këto, jo vetëm që orientojnë më mirë punën, por kursejnë kohën dhe rrisin produktivitetin.
- f) Nga pikëpamja e kritereve, çdo grup auditimi ka referenca me bollëk në auditimet që kryhen, duke vendosur jo thjesht kriteret ligjore, por edhe kritere të tjera të BE-së apo praktika të mira.
- g) Përgjithësisht observacionet e subjekteve vlerësohen dhe reflektohen me kujdesin dhe seriozitetin e duhur dhe në këtë drejtim stimulohen audituesit të bëjnë më tepër takime ballafaqese me subjektet dhe të mos mjaftohen vetëm me anën shkresore.
- h) Garantimi i cilësisë së punës audituese, pavarësisht filtrave formalë që ekzistojnë, çalon.
- i) Së fundmi, gjuha dhe stili i të shkruarit në hartimin e programeve, projekt-raporteve dhe raporteve është përmirësuar ndjeshëm, por gjithsesi aksesimi i përmbajtjes së raporteve nga një lexues mesatar mund të bëhet edhe më mirë, fragmentimi i raportit në shumë çështje humbet interesin e

audiencës dhe mungesa e një strukture të specializuar në KLSH për redaktim gjuhësor, përkthim në anglisht dhe formatim, ia zbeh në shumë raste vlerën disa raporteve që në të kundërt do të kishin impakt në opinion dhe SAI të tjera partnere.

Të gjitha auditimet e performancës të vitit të kaluar tjerin problematika të mprehta, ku spikat auditimi mbi Matura 2016, Siguria Ushqimore, Zhvillimi Strategjik i Turizmit, Prokurimi Publik, Cilësia e Ajrit, Unifikimi i pikave doganore me Kosovën, Performanca e borxhit publik, Performanca e MASR në zhvillimin e sportit, etj.

1. Ngritja e kapaciteteve departamentale

Në 2017-n departamenti. përjetoi ndryshime të pakta në staf.

Nga pikëpamja e trajnimeve, përgjithësisht është respektuar numri minimal i ditëve të trajnimit (25 në vit), por mungon publikimi i kalendarit të trajnimeve që në fillim të vitit, gjë që i jep mundësi drejtuesve të grupeve të planifikojnë kohën për auditim, nuk ka kurrikula koherente trajnuese dhe departamenti i metodologjisë planifikon, ekzekuton dhe kontrollon me pak persona. Konkretisht janë zhvilluar trajnime në Poloni, Suedi, Luksemburg, Çeki, SHBA, etj., sikurse kanë ardhur dhe plot kolegë të huaj për të na trajnuar në mjediset e KLSH-së.

Lidhur me rekrutimet, formimi i anëtarëve të dept. vazhdon të mbetet i larmishëm, sikurse e kërkon edhe auditimi i performancës. Mbizotërojnë ekonomistët dhe juristët, por kemi gjithashtu edhe inxhinierë mjedisi, marrëdhënie ndërkombëtare, etj. Mosha mesatare e departamentit aktualisht është 41 vjeç, gjë që konsiderohet frytdhënëse në aspektin e kombinimit të eksperiencës, profesionalizmit e seriozitetit me novatorizmin, përkushtimin dhe ambicien personale për të avancuar, veçanërisht e vërtetë kjo në auditim, ku kërkohet maturi, objektivitet e integritet.

Mundësia më e mirë për trajnim dhe rritje profesionale është bashkëpunimi me njëri-tjetrin, inisiativa për të marrë përsipër përgjegjësi, kurajo për të evidentuar dhe publikuar probleme dhe frymëzimi nga ata që i japin emër të mirë departamentit.

2. Komunikimi

Në aspektin e komunikimit, departamenti ka publikuar në faqen zyrtare të KLSH-së të gjitha auditimet e vitit 2017, në formën e ekstraktit të vendimit të Kryetarit. Sikurse edhe nga Peer Review e zhvilluar nga kolegët austriakë, sugjerohet që në

faqen tonë zyrtare të publikohet raporti i plotë, së bashku me observacionet e subjekteve, gjë që gjithsesi në e bëjmë në faqen tonë të FB, por të shtrirë në një hark kohor më të gjatë.

Lidhur me prezencën në Facebook, viti 2017 shënoi rritje të audiencës. Aktualisht kemi 3,000 ndjekës, por në rastin e publikimeve të auditimeve të mira, arrijmë një audiencë prej 20,000-21,000 personash përmes sponsorizimit të postimit. Përgjithësisht bëhen pak komente për raportet, por në rastin e publikimit të pyetësorëve, pjesëmarrja është e madhe. Sikurse është theksuar, raportet e gjata vështirësojnë leximin deri në fund dhe me vëmendje nga publiku i gjerë, ndoshta numri optimal do të ishte 60-70 faqe.

Në median e shkruar kemi qenë të pranishëm vitin e shkruar me 20 artikuj si departament, ndërsa në revistën tonë të KLSH-së me rreth 1-2 të tilla. Mediatizimi i punës sonë është edhe direktivë e Kryetarit për nivelet: auditues i lartë, kryeauditues dhe drejtor, por çdo auditues, në fund të punës audituese, mund të shkruajë një artikull informues për publikun. Mbeten për t'u formalizuar edhe më tej filtrat nëpër të cilat kalon një artikull përpara se të shkojë për botim.

Komunikimi me subjektet ka qenë i kënaqshëm, pavarësisht se një pjesë prej tyre vazhdojnë të vonojnë dhënien e informacionit të kërkuar. Një e metë e punës sonë nga viti 2017, që duhet ndryshuar për 2018-n është faza e ndjekjes së rekomandimeve tona. Grupet audituese përgjithësisht janë neglizhente kur bëhet fjalë për implementimin dhe masën e zbatimit të rekomandimeve, që në fakt është një aspekt kyç i auditimit.

Lidhur me partnerët e huaj, komunikimi ka qenë shumë i mirë. Në kuadrin e projektit IPA u zhvilluan 3 auditime pilot dhe është në proces një i katërt. Mungesa e një strukture të specializuar për përkthim brenda KLSH-së, ul profilin e punës sonë tek të huajt, jo vetëm tek ata që bashkëpunojnë me ne, por edhe organizma të tjerë që monitorojnë apo asistojnë administratën në përgjithësi.

E ardhmja departamentale

Për 2018-n kemi në plan të evadojmë 18 auditime të reja dhe 2 të mbartur nga 2017. Në terma institucionale, puna në dept. do të zerë 14% të numrit të auditimeve në KLSH. Sfida më e madhe vazhdojnë të mbeten raportet me impakt në Kuvend dhe publik, që në fakt është një sfidë shumë-dimensionale.

1. Mbi auditimin me temë: CILËSIA E AJRIT


Aulent GURI, Artur HASANBELLI dhe Xhuljeta ÇELAJ



Mesazhi i auditimit

Masat e marra nga qeverisja qendrore dhe lokale për përmirësimin e cilësisë së ajrit në vendin tonë nuk kanë qenë efektive dhe eficiente. Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit (SKCA) e miratuar në vitin 2014, ende nuk është zbatuar. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka raportuar asnjëherë mbi zbatimin e SKCA-së. Plani Kombëtar i Veprimit për Cilësinë e Ajrit nuk është miratuar dhe si rrjedhojë asnjë Bashki në Shqipëri nuk ka miratuar Planet Vendore të Veprimit të Cilësisë së Ajrit. Monitorimi i cilësisë së ajrit nuk i përmbush plotësisht standardet e vendosura nga direktivat përkatëse të BE-së. Vlerat e publikuara për Tiranën, ashtu si edhe për qytetet e tjera të Shqipërisë nga stacioni i lëvizshëm i AKM-së nuk janë përfaqësuese si vlera mesatare të tyre. Numri i stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të dhëna përfaqësuese dhe të besueshme për qytetet përkatëse. ISHMP nuk kryen inspektime sa i përket tejkalimit të normave të shkarkimeve të elementëve ndotës të ajrit sepse nuk zotëron asnjë mjet/laborator për matjen e këtyre shkarkimeve në terren. ISHP nuk ka kryer asnjë studim epidemiologjik që të vlerësojë lidhjen shkak pasojë mbi ndikimin e cilësisë së ajrit në shëndetin e popullatës.

Piramida e pyetjeve



A kanë qenë efektive politikat dhe legjislacioni i miratuar për zgjidhjen e problemeve të cilësisë së ajrit?

Gjetje

- SKCA miratuar në vitin 2014 nuk është vënë në zbatim dhe nuk është e shoqëruar me Planin e Veprimit.
- MTM nuk ka raportuar asnjëherë mbi zbatimin e SKCA.
- Sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit vazhdon të jetë i pa akredituar i pa kalibruar.
- Në Shqipëri numri total i stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit është 7.
- **ISHP** nuk ka kryer asnjë studim për të vlerësuar impaktin dhe përfitimet shëndetësore nga zbatimi i politikave të cilësisë së ajrit. ISHP nuk ka asnjë të dhënë mbi treguesit cilësisë ajrit - shëndet të miratuar nga OBSH si për shembull “Vitet e humbura të jetës *Years of Live Lost*”, “Vitet e jetuara me paaftësi *-Year lived with disability*”.

- **Treguesit** e vetëm që përdor MTM lidhur me efektivitetin e politikave të cilësisë së ajrit janë vlerat mesatare vjetore të elementëve kryesorë të ndotjes së ajrit, numri vjetor i ditëve me tejkalim të normës së lejuar.
- Në Raportet e Gjendjes së Mjedisit AKM nuk pasqyrohet sa përqind e popullatës ekspozohet ndaj ndotjes së ajrit. **AKM** nuk ka kryer asnjë vlerësim lidhur me përlogaritjen në terma monetarë të përfitimeve nga politikat e cilësisë së ajrit.

Konkluzione

- SKCA ka objektiva të përgjithshëm, nuk është “SMART” dhe nuk parashikon masa konkrete për zbatimin e këtyre objektivave.
- Ndëshkimi ndaj ndotësve të ajrit është i papërfillshëm dhe jo proporcional sipas nivelit të dëmit në mjedis.
- Kuadri ligjor mbi inspektimin dhe kontrollin e cilësisë së ajrit, për sa i takon kundravajtjeve administrative nuk përcakton dhe nuk diferencon ndotësit e ajrit sipas nivelit të tejkalimit të pragut të lejuar.

Rekomandime

- MTM të marrë masa për të vendosur në zbatim Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit.
- MTM të hartojë dhe të propozojë pranë Këshillit të Ministrave Planin e Veprimit të SKCA.
- Me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit, MTM të parashikojë dhe të vendosë si objektiv afat-shkurtër akreditimin/kalibrimin e stacioneve ekzistuese fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit si dhe shtimin e numrit të tyre.
- MTM të propozojë ndryshime në kuadrin ligjor për diferencimin e ndëshkimit ndaj ndotësve bazuar në nivelin e tejkalimit të pragut të lejuar.
- MTM të marrë masa për të propozuar ndryshime në kuadrin ligjor me qëllim kryerjen e analizës kosto-përfitim për çdo politikë dhe legjislacion mjedisor para miratimit të tyre.
- **ISHP të realizojë një studim pilot (duke përfshirë MTM dhe AKM, si dhe Ministrinë e Shëndetësisë)** mbi vlerësimin e impaktit që ka ndotja e cilësisë së ajrit në shëndetin e popullatës duke përdorur treguesit “cilësi e ajrit –

shëndet” të miratuara nga OBSH si për shembull “Vitet e humbura të jetës – *Years of Live Lost*”, “Vitet e jetuara me paaftësi -*Year lived with disability*” etj.

- AKM të të pasurojë Raportin e Gjendjes në Mjedis me të dhëna mbi përqindjen e ekspozuar të popullatës ndaj ndotjes së ajrit.
- AKM të përfitojë njohuri mbi analizën kosto – përfitim të politikave të cilësisë së ajrit përmes konsolidimit të bashkëpunimeve ndërinstitucionale brenda dhe jashtë vendit me institucione monitoruese homologe.

A kanë qenë eficiente politikat e ndërmarra për cilësinë e ajrit dhe çfarë dihet mbi kostot dhe përfitimet e tyre?

Gjetje

- Shqipëria ka numrin më të vogël të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit në raport me sipërfaqen e saj.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk i ka të përcaktuara shpenzimet buxhetore në lidhje me monitorimin e cilësisë së ajrit.
- Fondi i mjedisit ende nuk është krijuar. MTM nuk ka parashikuar fonde buxhetore për akreditimin dhe kalibrimin jashtë vendit të stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit në vitet 2014 - 2016. Ligj nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 67.
- Në Shqipëri nuk ka asnjë subjekt të licensuar për të bërë kalibrimin e laboratorëve të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Nr	Vendi	Nr. i Stacioneve Fikse	Sipërfaqja	Rap. 1 St./Sip.
1	Shqipëria	7	28.748 km ²	4.107 km ²
2	Slllovakia	38	49.035 km ²	1.290 km ²
3	Kosova	12	10.908 km ²	909 km ²
4	Maqedonia	17	25.713 km ²	1.513 km ²

Konkluzione

- Procesi i monitorimit të cilësisë së ajrit që kryhet në Shqipëri nuk është eficient. Paratë e shpenzuara në këtë proces shkojnë vetëm për pagat/dietat e punonjësve të përfshirë në monitorim, ndërkohë që për kalibrimin e laboratorëve të stacioneve të monitorimit nuk shkon asgjë.

Rekomandime

- MTM të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim eliminimin e inefficiencës dhe inefektivitetit të procesit të monitorimit të cilësisë së ajrit.

A është monitoruar, inspektuar dhe raportuar në mënyrë efektive niveli i cilësisë së ajrit?

Gjetje

- Ka mospërputhje midis programeve vjetore të monitorimit të mjedisit (për kapitullin e ajrit), me Raportet e Gjendjes së Mjedisit (për kapitullin e ajrit). Në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (RGJM) 2015, rezultatet e matjeve të kryera nuk përcaktojnë qartë llojin e stacionit (nëse është stacion automatik fiks apo i lëvizshëm, si për shembull stacionet e Korçës, Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Durrësit) që ka kryer këto matje.
- Në RGJM, 2015 nuk specifikohet nëse është zbatuar kriteri i Programit të Monitorimit të Mjedisit 2015 për PM10 dhe PM2.5 sa i përket mbulimit të kohës së monitorimit në masën 90 % dhe përfutimit të të dhënave në masën 90%.
- Për sistemin e monitorimit të cilësisë së ajrit nuk kryhet kontrolli dhe sigurimi i cilësisë.
- Aktualisht në të gjithë Shqipërinë ka vetëm 7 stacione automatike statike të cilët monitorojnë 365 ditë/vit. Stacionet e tjera janë stacione të lëvizshme të cilat monitorojnë në periudha 2 - 3 javore në sezone të ndryshme.
- Në qytetin e Tiranës, AKM nuk ka stacion automatik fiks të monitorimit të ajrit.
- ISHMP për periudhën 2014 - 2016 nuk ka kryer inspektime të subjekteve apo operatorëve që ushtrojnë veprimtari me ndikim në mjedis për cilësinë e ajrit.

- ISHMP nuk mund të verifikojë tejkalimin e normave pasi mungojnë pajisjet matëse laboratorike për të vlerësuar tejkalimin e shkarkimeve mbi normat e lejuara.
- Në kundërshtim me Ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Neni 24, pika 3, për vitet 2014 dhe 2016 nuk ka hartuar Programin Vjetor të Inspektimeve, nuk e ka dërguar atë për mendim në Inspektoratin Qendror dhe nuk ka marrë miratimin përkatës nga Ministri i Mjedisit. Ndërsa për vitin 2015 Programi Vjetor i inspektimeve është hartuar dhe është marrë mendimi nga Inspektorati Qendror, por ky program nuk është miratuar nga Ministri i Mjedisit.
- ISHMP nuk respekton normat metodologjike të vendosura nga Inspektorati Qendror.
- ISHMP nuk përdor portalin e inspektime “on line” (e-inspection) pavarësisht faktit se është trajnuar për përdorimin e tij nga Inspektorati Qendror. Inspektorati Qendror ka shpërndarë 62 paketa portabël për kryerjen e inspektimeve on line të cilat nuk janë përdorur asnjëherë nga ISHMP.
- ISHMP gjatë kryerjes së inspektimeve nuk përdor “badget” identifikues i cili është lëshuar posaçërisht nga Inspektorati Qendror.
- Inspektorët e ISHMP-së jo gjithmonë pajisen me autorizimin përkatës në kundërshtim me metodologjinë e aprovuar nga Inspektorati Qendror.
- ISHMP nuk ka kërkuar dhe as nuk i janë akorduar fonde për blerjen e pajisjeve matëse laboratorike.
- Në planet vjetore të punës së ISHMP-së nuk parashikohet inspektimi i cilësisë së ajrit ISHMP jo gjithmonë administron dosjet e inspektimit në përputhje me ligjin për arkivat
- ISHMP nuk ka krijuar një “data base” të inspektimeve për cilësinë e ajrit.
- MTM nuk ka transpozuar ende Direktivën Europiane të ligjit të kimit mjedisor.

Konkluzione

- Sistemi i monitorimit nuk është gjithëpërfshirës dhe prezantues për të gjetur mesataren e një qyteti të caktuar.

- Raportet e Gjendjes së Mjedisit nuk janë në koherencë me Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit, lidhur me monitorimin e cilësisë së ajrit.
- Në mungesë të akreditimit të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit nuk kryhet kontrolli dhe sigurimi i cilësisë.
- Në Tiranë si qyteti metropol i Shqipërisë për vitet 2014 dhe 2015 ka munguar monitorimi i vazhdueshëm (365 ditë/vit) i cilësisë së ajrit sepse dy stacionet fikse automatike të ISHP-së kanë qenë jashtë funksionit. Vlerat e publikuara nga stacioni I lëvizshëm i AKM-së nuk janë përfaqësuese si vlera mesatare të qytetit të Tiranës. Matjet treguese të kryera nga stacioni mobile nuk mund të prezantohen si vlera mesatare të qyteteve ku kryhen këto matje.
- Funkcioni i inspektimit, jo vetëm që ka qenë infektiv, por ai ka qenë totalisht inekzistent. ISHMP nuk disponon logjistikën e nevojshme për të bërë të mundur vërtetimin e kapërcimit të normave të emetimeve në ajër.
- ISHMP nuk ka respektuar udhëzimet e vazhdueshme nga Inspektorati Qendror lidhur me metodologjinë e inspektimit, përdorimin e portalit “e-inspection”, përdorimin e “badge” identifikues, etj.
- Edhe pse ISHMP ka qenë e ndërgjegjshme për mungesën e pajisjeve logjistike si laboratorë matës të treguesve të ajrit, etj., asnjëherë gjatë viteve 2014 - 2016 nuk ka kërkuar fonde në Ministri për plotësimin e këtyre mangësive.
- Mos respektimi i kriterëve ligjore për administrimin e dosjeve të inspektimeve, ka sjellë mos arkivimit dhe mos dokumentimit të punës së institucionit ndër vite.
- Transpozimi i Direktivës Europiane të ligjit të krimin mjedisor do të ndihmojë institucionet përkatëse në luftën kundër ndotësve të mjedisit.

Rekomandime

- AKM të hartojë Raportet e Gjendjes së Mjedisit në përputhje të plotë me Programet Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit.
- Sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit të shoqërohet me kryerjen e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë.

- MTM të marrë të gjitha masat e nevojshme për shtimin e numrit të stacioneve fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit në shkallë vendi dhe veçanërisht në qytetin e Tiranës.
- ISHMP të miratojnë Programin Vjetor të Inspektimeve për vitin e ardhshëm.
- ISHMP të ndjekë udhëzimet e vazhdueshme nga Inspektorati Qendror lidhur me metodologjinë e inspektimit, përdorimin e portalit “e-inspection”, përdorimin e “badge” identifikues, etj.
- Inspektorët e ISHMP-së, gjatë inspektimeve në terren, të pajisen gjithmonë me autorizimin përkatës në përputhje me metodologjinë e aprovuar nga Inspektorati Qendror.
- Në planet vjetore të punës, ISHMP të parashikojë inspektimin e cilësisë së ajrit.
- ISHMP të marrë masa dhe të kërkojnë fonde nga MTM për të plotësuar mangësitë që ka në pajisje logjistike si: laboratorë, matës të treguesve të ajrit, etj.
- ISHMP të respektojnë kriteret ligjore për administrimin e dosjeve të inspektimeve në përputhje me ligjin për arkivat.



2. Mbi auditimin me temë: EFEKTIVITETI I POLITIKAVE PËR ZHVILLIMIN STRATEGJIK TË TURIZMIT

Miranda BERDO dhe Klejvis KULE

Nisur nga rëndësia ekonomike dhe sociale e sektorit të turizmit, KLSH, në zbatim të politikave të saj të sanksionuara në Planin Strategjik, Ligjin “Për funksionimin dhe organizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka marrë indicie dhe e ka konsideruar të rëndësishëm auditimin e kushteve dhe politikave për zhvillimin strategjik të turizmit. Ky auditim u zhvillua në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Agjencinë Kombëtare të Turizmit, Këshillin e Qarkut Berat, Këshillin e Qarkut Kukës dhe Këshillin e Qarkut Vlorë.

Një vlerë e shtuar e këtij auditimi është bashkëpunimi me Zyrën Supreme të Auditimit të Kroacisë, në kuadër të projektit IPA për “Forcimin e Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm në Shqipëri”. Në auditim u përfshinë auditues kroatë, të cilët ofruan ekspertizën dhe përvojën e tyre për formulimin e rekomandimeve integrale dhe të orientuara drejt praktikave më të mira në rajon.

Në nivelin kombëtar në sektorin e turizmit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si institucioni kryesor përgjegjës për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, ka në varësi të saj dy agjenci:

- Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, e cila ka si mision të saj mbrojtjen dhe zhvillimin e zonës bregdetare;
- Agjencinë Kombëtare të Turizmit, e cila ka si mision promovimin dhe krijimin e identitetit të turizmit shqiptar brenda dhe jashtë vendit;
- Në nivelin rajonal zbatimi dhe koordinimi i politikave për turizmin realizohet nga njësitë e qeverisjes vendore, ku për nga lloji i turizmit që ofrojnë dhe numri i turistëve që i vizitojnë, grupi i auditimit përzgjedhi: Këshillin e Qarkut Berat, Këshillin e Qarkut Kukës dhe Këshillin e Qarkut Vlorë.

Efektiviteti i politikave për zhvillimin e turizmit në të gjitha nivelet e tij kërkon përmirësimin e disa komponentëve.

Së pari, duhet të hartohet dhe miratohet Strategjia e Zhvillimit Kombëtar të Turizmit, si kusht paraprak për realizimin e objektivave;

Së dyti, me miratimin e akteve normative që rregullojnë funksionimin e këtij sektori;

Së treti, krijimin e institucioneve me fushë zbatimi sektorin e turizmit, me qëllim zhvillimin e tij;

Së katërti, krijimin e data-bazës me të dhënat statistikore reale, për përcatimin dhe orientimin e saktë të objektivave;

Së pesti, duhet të hartohen dhe miratohen zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Së gjashti, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të alokohen fonde për nivelin rajonal, kombëtar dhe lokal, sipas prioritetit të zbatimit të politikave në turizëm;

Së shtati, kategorizimin dhe standardizimin e strukturave akomoduese sipas kushteve të legjislacionit në fuqi.

Ky sektor vuan nga një mungesë efieiene dhe efektiviteti, sepse më parë dhe aktualisht kanë munguar dhe vazhdojnë të mungojnë politikat e orientuara kah krijimit të produkteve turistike, strategjitë e bazuara në studime dhe plane veprimi të mirë detajuara, objektiva të qartë dhe të arritshëm për të siguruar zhvillimin ekonomik të pritshëm, marrë në konsideratë faktin se këto janë shoqëruar nga mosrealizimi i tyre në kohë dhe me cilësi. Pavarësisht përpjekjeve pozitive me projekte të ideuara nga AKB, sektori i turizmit ka një mungesë bashkëpunimi dhe komunikimi midis subjekteve në funksion të të cilave është përmirësimi i treguesve të turizmit, si dhe historiku të zhvillimit në vite të shërbimit publik për turizmin.

Sektori i turizmit, së bashku me institucionet e varësisë përgjegjëse për turizmin, drejtohen në aktivitetin e tyre sipas Ligjit nr. 93, datë 27.07.2015 “Për turizmin”. Ky sektor është një ndër furnizuesit kryesorë të ekonomisë me të ardhura të shprehur në termat e prurjeve valutore, rritjen e zërit të konsumit, përmirësimin e normave të punësimit, si dhe nxitje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha, tërësia e të cilave ofron më shumë mirëqenie për popullsinë. Nëse i referohemi turizmit si koncept ekonomik, mund të ndikojë tek konsumatori në disa drejtime. Fillimisht në kostot e drejtpërdrejta që paguan në këmbim të shërbimit që merr, së dyti në kostot e tërthorta nga shpenzimet e buxhetit të shtetit për këtë sektor, si dhe në mënyrën e ofrimit të këtij shërbimi me sa më shumë cilësi dhe standarde.

Në sfidat afatmesme dhe afatgjata të ekonomisë shqiptare, turizmi vlerësohet një sektor me potencial për të arritur një rritje ekonomike më të lartë me efekte pozitive në rritjen e punësimit dhe të të ardhurave reale, rritjen e mirëqenies sociale, krijimin e një mjedisi mundësues për sipërmarrje të vogla dhe të mesme,

nxitjen e interesit nga investitorët e huaj, i tillë që të ofrojë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Duke parë ndikimin që ky sektor ka në zhvillimin ekonomik dhe të qëndrueshëm është mjaft e rëndësishme që shërbimi i turizmit të orientohet përgjatë një strategjie të analizuar, hartuar dhe detajuar me objektiva të arritshëm. Kjo strategji duhet të reflektojë dhe të orientohet kah zgjidhjes së problematikave në këtë sektor, të tillë që të përmirësojë të gjitha mangësitë e mëparshme dhe të krijojë baza për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, me qëllim përdorimin optimal të burimeve, minimizimin e ndikimeve negative ekologjike, kulturore dhe sociale si dhe maksimizimin e përfitimeve që vinë prej turizmit.

Deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të ri Nr.93/2015 “Për Turizmin”, Ligji i mëparshëm Nr.9734 datë 14.05.2007 “Për Turizmin” vendosi rregullat mbi menaxhimin e sektorit të turizmit, zhvillimin e standardeve për shërbimet dhe produktet turistike. Që prej vitit 2007 e deri në vitin 2015, Ligji në fuqi për Turizmin nuk arriti të gjeneronte efekte të prekshme.

Ligji i ri Nr.93/2015 “Për Turizmin” nuk u plotësua me nxjerrjen në kohë të akteve ligjore dhe nënligjore, duke u shoqëruar kështu edhe me mos krijimin e disa Institucioneve kyçe që parashikohen në Ligj. Këto mangësi kanë zvogëluar kështu efektivitetin e institucioneve përgjegjëse për turizmin, duke vënë në dyshim funksionimin e tyre të plotë si dhe duke ndikuar negativisht në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

Megjithëse kanë kaluar 3 vjet nga hartimi i Draft-Strategjisë Kombëtare për Turizmin 2014-2020, sektori i turizmit nuk ka akoma një Strategji të Miratuar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të tij, por vetëm një draft-strategji për vitet 2017-2022, e cila është një studim i GIZ dhe jo një dokument i hartuar nga Ministria përgjegjëse për turizmin.

Aktualisht ka drejtime të rëndësishme që mbeten ende të porealizuara, të cilat lidhen me:

- Zhvillimin e qëndrueshëm të produktit dhe zbatimin e parimit të qëndrueshmërisë në të gjitha nivelet;
- forcimin e strukturave institucionale në nivel qendror dhe lokal, të cilat garantojnë zbatimin e planeve dhe objektivave strategjikë;
- hartimin apo rishikimin e planeve urbanistike të zonave me prioritet turizmin mbështetur në analiza të plota ekonomike, sociale-kulturore, mjedisore;

- krijimi i një sistemi sipas standardeve ndërkombëtare për grumbullimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore mbi zhvillimin e kërkesës dhe ofertës;
- kategorizimin dhe standardizimin e strukturave akomoduese;
- zhvillimi i elementëve infrastrukturorë;
- arsimimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore në shërbim të turizmit;
- rritja e financimeve për mbrojtjen dhe rruajtjen e vendeve me rëndësi natyrore dhe kulturore;
- angazhimi i sektorit publik/privat;
- marketingu dhe promovimi i turizmit brenda dhe jashtë vendit;
- promovimi i praktikave më të mira;
- telekomunikacioni dhe interneti janë një komponent i rëndësishëm dhe domosdoshmërisht në rritje për promovimin e sektorit të turizmit dhe komunikimin.

Në lidhje me pyetjen kryesore të këtij auditimi:

“A sigurojnë institucionet përgjegjëse publike kushtet paraprake për zhvillimin strategjik të turizmit në vendin tonë?” grupi i auditimit arriti në këtë mesazh auditimi :

Masat e marra nga qeveria dhe institucionet përgjegjëse për turizmin, mund të sigurojnë kushtet paraprake për zhvillimin e sektorit të turizmit në situatën në të cilën ndodhet, por nga ana tjetër ato janë të pamjaftueshme për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të tij në periudhën afatgjatë. Sektori i turizmit, së bashku me institucionet përgjegjëse për turizmin, vuajnë nga një mungesë efience dhe efektiviteti. Mungesa e strategjive të bazuara në studime dhe plane veprimi, mungesa e nxjerrjes së akteve ligjore dhe nënligjore në kohë, si dhe mungesa e krijimit të disa institucioneve të rëndësishme që parashikohen në Ligj, jo vetëm që e zvogëlojnë efektivitetin e institucioneve, por vënë në dyshim funksionimin e tyre të plotë si dhe ndikojnë negativisht në zhvillimin e turizmit. “Turizmi prioritet”, do të ishte më frytdhënës me legjislacion të kompletuar, punë konkrete, komunikim dhe bashkëpunim të ngushtë me sektorin publik dhe privat, me qëllim zhvillimin e këtij komponenti të rëndësishëm të ekonomisë sonë.

3. EFEKTIVITETI I GRANTEVE NË AGJENCINË E ZHVILLIMIT BUJQËSOR DHE RURAL

Gjovalin PREÇI dhe Klejvis KULE

Në datë 03.06.2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas shkresës për njoftim të fillimit të auditimit, nisi auditimin e performancës mbi efektivitetin e granteve në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, i cili përfundoi në Dhjetor të vitit 2017.

Ky auditim përfshiu vetëm një subjekt, AZHBR dhe strukturat rajonale të saj. Periudha e cila u përfshi nën auditim ishte Janar 2013 – Shtator 2017. Objektivi i këtij auditimi ishte: “Veprimtaria e AZHBR-së gjatë gjithë procesit të aplikimit (informimi, pranimi, kontrolli administrativ i aplikimeve, kontrolli në terren para dhe pas financimit, monitorimit të ecurisë së financimit përgjatë një periudhe kohore të caktuar) si institucioni kryesor në miradministrimin e fondeve të buxhetit të shtetit për zhvillimin rural dhe të bujqësisë. Gjithashtu, struktura organizative e AZHBR, kapacitetet e burimeve njerëzore, formimin profesional të tyre, infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave institucional”. Për të arritur këtë objektivi, grupi i auditimit u fokusua në këto çështje:

1. Menaxhimin e stafit dhe specialistëve të AZHBR në funksion të zbatimit të procedurave të granteve.
2. Efektiviteti i granteve nga performanca e AZHBR në zbatimin procedurës së dhënies së granteve.
3. Arritja e objektivave në administrimin e skemave dhe fondeve për mbështetjen e zhvillimit të bujqësisë.
4. Efektiviteti i fondeve për publicitet për skemat kombëtare.
5. Efektivitetin financimet buxhetore për mbrojtjen e ullirit në vendin tonë.
6. Ekonomiciteti i mbështetjes financiare të investimeve në bujqësi.
7. Monitorimi i granteve zhvillimit të bujqësisë.

*Pas kryerjes së këtij auditimi, në përgjigje të pyetjes kryesore: **Sa ka kontribuar performanca e AZHBR në efektivitetin e granteve në zhvillimin bujqësor dhe rural?***

Grupi i auditimit të KLSH-së ka arritur në këtë mesazh kryesor:

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural nuk ka arritur efektivitetin e synuar nga menaxhimi dhe administrimi i fondeve buxhetore për skemat kombëtare, për shkak se:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore ka shfaqur mangësi;
- Kanë shfaqur mangësi vetë procedurat e subvencionimit për skemat kombëtare;
- Fondet e dhëna për informim kanë rezultuar jo efektive;
- Financimet për mbrojtjen e ullirit nuk rezultojnë efektive, pasi nuk janë zbatuar siç duhet procedurat e prokurimit;
- Fondet e investimeve të përfituara nuk janë shfrytëzuar si duhet në aspektin ekonomik;
- Ka munguar sektori i monitorimit për një periudhë 4-vjeçare, e si pasojë edhe monitorimi i skemave kombëtare të vogla dhe investimeve.

Gjetjet, Konkluzionet dhe Rekomandimet më të rëndësishme të këtij auditimi sipas çështjeve përkatëse janë:

1. Në lidhje me çështjen se si ka ndikuar menaxhimi i stafit dhe specialistëve të AZHBR në funksion të zbatimit të procedurave të granteve?

Gjetje dhe Konkluzione:

- Largimet nga puna jashtë çdo kriteri ligjor, për 2013-2017 janë larguar 94 punonjës, 30 prej të cilëve me 3-6 vite eksperienc dhe formimin profesional në profilin bujqësor dhe rural;
- Mbizotërimi i profesioneve që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet kryesore të AZHBR, rekrutimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga AZHBR ka ndikuar negativisht në realizimin me sukses të objektivave të institucionit;
- Trajnimet nuk kanë rezultuar eficiente dhe efektive.

Rekomandime:

- AZHBR të marri masat e nevojshme për krijimin e sektorit që shërben për informimin dhe këshillimin e fermerëve;

- AZHBR të kryejë trajnime jo në numër të përqendruar punonjësish, por të jenë gjithë përfshirëse;
- AZHBR të analizojë dhe të evidentojë përgjegjësinë për largimet nga puna pa shkaqe ligjore.

2. Në lidhje me çështjen se a është ndikuar efektiviteti i granteve nga performanca e AZHBR në zbatimin procedurës së dhënies së granteve?

Gjetje dhe Konkluzione:

- Viti 2017, konsiderohet një vit i mos-realizimit të objektivave, për shkak se:
 - është ndikuar nga lëvizja e stafit në nivelet e larta drejtuese të AZHBR;
 - Keq planifikimi, keq administrimi si dhe rialokimet e shpeshta të fondeve për skemat kombëtare brenda vitit, si pasojë e mungesës së kriterëve për planifikimin e tyre, si dhe paaftësia e AZHBR për të përthithur të gjitha fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit për skemat kombëtare, e ka shndërruar atë në një “debitore” të rregullt ndaj përfituesve të këtyre skemave.
- Studimet e MBZHRAU janë të vjetra në kohë dhe të pa përditësuara me ndryshimet e faktorëve (klimaterik, mjedisor).
- Numri i dokumenteve për tu plotësuar ka ardhur në rritje nga viti në vit, duke rritur kostot financiare dhe kohore për fermerin.

Rekomandime:

- AZHBR të kryejë një planifikim dhe administrim më të mirë dhe më të saktë të buxhetit për skemat kombëtare;
- Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të marrin masat e nevojshme që të përditësojnë studimet mbi të cilat ndërtohen hartat e rajonizimit;
- Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave të marrin masat e nevojshme që një pjesë të dokumenteve (kryesisht vërtetimet, OSHEE, sigurimet shoqërore) që i kërkohen aplikantit për tu plotësuar, të verifikohen prej AZHBR vetë.

3. Në lidhje me çështjen se a kanë ndikuar fondet për publicitet në efektivitetin e granteve të dhëna?

Gjetje dhe Konkluzione:

- Nuk ka pasur një përdorim me efektivitet të fondeve për informimin mediatik të publikut për skemat kombëtare të zhvillimit të bujqësisë dhe rural;
- Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR nuk kanë hartuar dhe zbatuar një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për skemat e përfitimit.

Rekomandime:

- AZHBR të hartojë një relacion të veçantë mbi mënyrën e përdorimit të fondit për informimin e publikut;
- Ministria e Bujqësisë dhe AZHBR të hartojnë dhe të zbatojnë planin e informimit dhe ndërgjegjësimit të grupeve të interesit për skemat, kriteret dhe kushtet e përfitimit.

4. Në lidhje me çështjen se sa efektive kanë qenë financimet buxhetore për mbrojtjen e ullirit në vendin tonë?

Gjetje dhe Konkluzione:

- Ka patur mungesë qëndrueshmërie në treguesit e përfitimit të skemës së mbrojtjes ullishteve nga dëmtimi i mizës.
- Në përcaktimin e fondit limit, komisioni nuk ka marrë në konsideratë numrin e rrënjëve për ha, i cili është përcaktues në vendosjen e pesticidit që lufton mizën e ullirit.
- Sipas dokumentacionit të sjellë nga DB konstatohet se nënshkrimet e fermerëve pothuajse janë të njëjta, d.m.th fiktive.

Rekomandim:

- AZHBR të studioj dhe të analizojë me hollësi aplikimin dhe rezultatet e kësaj skeme, të evidentojë mangësitë dhe dobësitë e saj, duke parë mundësinë e kalimit në subvencionimin e eco-trapeve drejtpërdrejtë të fermerëve aplikues.

5. Në lidhje me çështjen se a është përdorur me ekonomicitet mbështetja financiare e investimeve në bujqësi?

Gjetje dhe Konkluzione:

- Brenda një periudhe 5 vjeçare ka pasur ndryshime të mëdha të nivelit të financimit, vlerës dhe aq më tepër të drejtimeve të investimit, që tregon se nuk

ka një strategji me objektiva të qarta dhe të matshme për të orientuar zhvillimin e bujqësisë në përputhje me strategjinë ndërsektoriale 2014-2020.

- Dokumentacioni dhe procedura e dhënies së kredisë pa interes është shoqëruar me mangësi të shumta të cilat kanë sjellë pasoja në efektivitetin e ulët deri dhe të munguar të kësaj skeme.

Rekomandime:

- AZHBR të marrë masat e nevojshme për sigurimin e qëndrueshmërisë së kësaj skeme, si dhe të sigurojë shpërndarje territoriale dhe drejtimet e projektit të investimeve në favor të zhvillimit të bujqësisë dhe atij rural.

6. Në lidhje me çështjen se sa i ka shërbyer monitorimi i granteve zhvillimit të bujqësisë?

Gjetje dhe Konkluzione:

- Mungesa e sektorit të monitorimit për periudhën 2013-2015 si dhe fillimi i aktivitetit të kësaj strukture rreth 10 muaj me vonesa nga momenti i krijimit, ka sjell ulje të eficiencës dhe efektivitetit të AZHBR.
- Mungesa e monitorimit të objektivave të AZHBR, nga sektori i raportimit për periudhën 2013-2017, ka ndikuar negativisht në eficiencën dhe efektivitetin e këtij institucioni.

Rekomandime:

- Sektori i monitorimit gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, të monitoroj disa indikatorë të rëndësishëm, si rritja e fuqisë punëtore për biznesin, ecuria e të ardhurave, ecuria e prodhimit të aktivitetit, si dhe të rrisë numrin e monitorimeve gjatë 1 viti.
- Sektori i raportimit AZHBR, të monitoroj zbatimin dhe ecurin e objektivave të AZHBR.

Rezultatet e këtij auditimi, pas Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr.209, datë 29.12.2017, prot. 635/5, ja kemi përcjellë AZHBR, Ministrisë së Bujqësisë për zbatimin e rekomandimeve si dhe kemi vënë në dijeni për situatën Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

4. Mbi auditimin me temë: PERFORMANCA E MINISTRISË SË ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË NË ZHVILLIMIN E SPORTIT

Dorel BALLIU dhe Kris ANASATASI



Metodologjia: Qasje pragmatike e orientuar kah rezultatit.

- Qasje cilësore duke analizuar kriteret e shpërndarjes së fondeve dhe eficiencën e përdorimit të tyre;
- Shqyrtim i të dhënave sasiore;
- Qasje kah rezultatit, për të gjykuar arritjen e objektivave për zhvillimin e sportit.

Subjektet nën auditim: Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Federata e Basketbollit, Federata e Volejbollit, Federata e Mundjes, Federata e Atletikës, Klubi Sportiv Partizani, Klubi Sportiv Studenti.

Piramida e pyetjeve:

1. A janë vjelë dhe shpenzuar siç duhet nga ana e MASR fondet për ushtrimin dhe zhvillimin e sportit?

1.1 A kanë mundur rritjen e performancës në fushën e sportit grantet e shpërndarë për organizatat sportive të marra në shqyrtim? 1.2 A janë

respektuar kriteret ligjore për mbledhjen e të ardhurave për Fondin Kombëtar të Zhvillimit të Sportit? 1.3 A janë garantuar kushtet për ushtrimin e aktiviteteve sportive të sportistëve, nxënësve dhe studentëve?

1.1.1 A janë respektuar kriteret e vendosura në ligj për alokimin e granteve në favor të këtyre organizatave? 1.1.2 A ka qenë efektiv monitorimi i MASR për përdorimin e granteve nga ana e organizatave sportive?

2.2.1 A është vjelë në tërësinë e tij Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit?

1.3.1 A ofron infrastruktura sportive aktuale mundësi të përshtatshme për ushtrimin e sporteve? 1.3.2 A ka kontribuar Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit në përmirësimin e këtyre mundësive?

Gjetje dhe rekomandime

A) MASR të hartojë një dokument strategjik afatgjatë për zhvillimin e sportit në vend

B) MASR të propozojë pranë KM një akt ligjor ku të përcaktojë qartë kriteret e alokimit të granteve

C) MASR të krijojë marrëdhënie të standardizuar bashkëpunimi me të gjitha federatat

01- MASR nuk ka strategji/plan ushtrimi për civilitetin e sportit

02- Gruntat e alokuara 20-40% të kërkesave të fider.

03- Federatat kanë gjeneruar pak ose aspak të ardhura

04- Asnjë ardhurë e MASR për rezultatet e federatave

05- Klubeu Partizani dhe Studenti marrin fonde shtesë

Federatat e tjera

GJETJE DHE REKOMANDIME (FEDERATAT)

Jo më shumë se dy punonjës në staf

MASR të propozojë ndryshimin e Udhëzimit nr. 4/2014 në pjesën ku thuhet se financimi bëhet vetëm për dy punonjës.

Mangësi në personel teknik dhe bazë materiale

MASR të paraqesë në KM një projekt zhvillimi afatmesëm për rikonstruktimin e objekteve sportive ekzistuese sipas standardeve më të mira dhe krijimin e atyre të reja.


Klubeu nuk funksionojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare

MASR të marrë masat e nevojshme që klubeu Partizani dhe Studenti të shndërrohen në shoqëri tregtare. (Neni 21, L. 79/2017 "Për Sportin")

Financim me fonde buxhetore për klubeu Studenti dhe Partizani

MASR të gjejë zgjidhje të qëndrueshme me pushtetin vendor sa i përket klubeve sportive Partizani e Studenti.

Të ardhurat e munguara në Fondin Kombëtar të zhvillimit të Sportit pranë MASR



Gjetje dhe konkluzione:

- DPT dhe AMLF institucionet përgjegjëse për mostransferimin e shumës së 20mësipërme për llogari të zhvillimit të sportit;
- Drejtorja e Sportit dhe e Financës në MASR nuk kanë njoftuar strukturat përkatëse duke mos zbatuar detyrat;
- MASR të rakordojë me DPT dhe AMLF shumën prej 30,941,281 lekësh për vitet 2013-2017 me qëllim vjeljen e këtyre të ardhurave të munguara nga kompanitë e licencuara të basteve;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, të auditojë DPT dhe AMLF dhe të evidentojë personat përgjegjës, të cilët kishin për detyrë të garantonin vjeljen e plotë të FKZHS dhe mbikëqyrjen e këtij procesi, duke marrë masa disiplinore ndaj tyre;
- Sektori i Politikave të Sportit të njoftojë me shkrim DPT dhe AMLF çdo muaj që konstaton se të ardhurat nga kompanitë e basteve nuk janë vjelë sipas legjislacionit në fuqi;
- Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit nuk është përdorur efektivisht për financimin e aktiviteteve të pambuluara nga buxheti i federatave, për shkak se të ardhurat e tij nuk janë vjelë plotësisht. (Neni 40, Ligji nr. 79/2017 “Për Sportin”);
- Vjelja e FKZHS ka filluar të bëhet vetëm në vitin 2015, pavarësisht se fondi ka qenë i parashikuar që në ligjin e mëparshëm për sportin;
- Gjatë viteve 2013–2017 nuk është vjelë/transferuar 63% e fondit, shumë që mund të përdorej në dobi të sportit apo infrastrukturës sportive.

Rekomandime:

- Federatat e marra në shqyrtim nuk kanë kontrata sponsorizimi me sponsorët;
- MASR, në bashkëpunim me aktorë të tjerë të përfshirë në çështjen e sponsorizimeve, si federatat apo MFE, të kryejë një analizë ekonomike me qëllim përcaktimin e një formule të re sponsorizimi dhe krijimin e lehtësirave fiskale për kompanitë sponsorizuese në fushën e sportit;
- MASR të kërkojë pranë KM dhe Kuvendit ndryshimin e ligjit të sponsorizimit, për të kthyer interesin e kompanive private për sponsorizimin e sporteve të ndryshme;
- MASR të nxisë KM për të hartuar një vendim me qëllim përcaktimin e kritereve të shpërndarjes dhe përdorimit të Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit.

5. Mbi auditimin me temë: UNIFIKIMI I PIKAVE DOGANORE TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

Sali AGAJ dhe Redi AHMETLLARI

Në mbyllje të vitit 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit përfundoi auditimin e performancës me temë “Unifikimi i pikave doganore të Shqipërisë me Kosovës”, miratuar me Vendimin e Kryetarit Nr.202, datë 29.12.2017. Auditimi kishte si risi bashkëpunimin e frytshëm me institucione të rëndësishme të Kosovës si, Zyra Kombëtare e Auditimit, Ministria e Financave, Doganat dhe Odën Ekonomike të Kosovës. Raporti përfundimtar i auditimit iu përcoll Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Kuvendit, Kryeministrit, Ministrisë së Diasporës dhe Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Ambasadës së Kosovës.

Natyrshëm, pritshmëria dhe ndjeshmëria e publikut dhe biznesit ndaj këtij procesi janë të larta. Në aspektin politik të integriteteve, e si financuese e pikës së përbashkët doganore në Morinë-Vermicë, Bashkimi Europian është një tjetër aktor që ka një pritshmëri të lartë për të parë tek Shqipëria një ekonomi të fortë, me protagonizëm rajonal, si dhe institucionalisht të pjekur për t’u bashkuar në familjen europiane. Për shkak të valencave të shumta që mbart tema, u trajtuan studime ekonomike nga Universiteti i Harvardit, hulumtime nga ekspertë të makroekonomisë dhe anketa për biznesin, të hartuara nga grupi i auditimit, veçanërisht me Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë së Shqipërisë dhe Odën Ekonomike të Kosovës, për të zbërthyer në një masë të gjerë komponentët që përbënin këtë auditim.

Nëpërmjet këtij auditimi, KLSH ka arritur në mesazhin se: *“Me gjithë përparimin e arritur në fushën e shkëmbimit tregtar dhe bashkëpunimit doganor, marrëveshjet e nënshkruara nuk përbëjnë një bazë të plotë rregullatore për unifikimin doganor me Kosovën. Marrëveshjet e nënshkruara karakterizohen nga një formë e shprehjes së vullnetit të mirë, por nuk janë pasqyruar në politika të mirëfillta qeveritare, të cilat do ta realizonin me përgjegjshmëri dhe me sukses bashkimin doganor me Kosovën. Konstatohet se nuk ka një angazhim të vazhdueshëm institucional, bazuar në një strategji të posaçme për unifikimin doganor me Kosovën, gjë e cila ka dëmtuar dukshëm besimin e bizneseve në dy anët kufirit. Veprimtaria e Ministrisë së Financave e Ekonomisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave në unifikimin e pikave doganore është e mangët dhe nuk ka krijuar premisat për një bashkim*

doganor të shpejtë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Nuk është hedhur hapi vendimtar, unifikimi i politikave fiskale, si parakusht për sigurimin e bashkimit doganor, i cili përbën një potencial për rritjen e shkëmbimit të mallrave, rritjen e ekonomisë për dy vendet, si dhe një parapërgatitje e proces maturimi për institucionet shqiptare për t'u bërë ballë sfidave që parashtron integrimi në tregun europian”.

Pozicioni i Shqipërisë dhe Kosovës në CEFTA: Shqipëria me Kosovën kanë lidhur një marrëveshje të tregtisë së lirë (MTL), por bashkimi doganor është një shkallë më e lartë, jo vetëm si ndërveprim ekonomik, por edhe si një sinkronizim ekonomiko-fiskal dhe kërkon vendosjen e tarifave të përbashkëta karshi vendeve të treta. Në rastin e MTL-së, siç është CEFTA, shtetet anëtare tregtojnë pa tarifa doganore me njëri tjetrin, por ruajnë sovranitetin e politikave tregtare me shtetet e tjera jashtë CEFTA-s. Pra, tarifatat e vendosura karshi atyre vendeve jo anëtare ndryshojnë nga një shtet në tjetër. Kjo mund të çojë në fenomenin që në teorinë ekonomike quhet “diversion tregtar” (Viner 1950) – një situatë ku të mirat nga jashtë MTL importohen në një vend anëtar me tarifë të ulët, nga ku mund të dërgohen pa tarifë në një vend brenda MTL-së që aplikon një tarifë të lartë për palët e treta. Bazuar në të dhënat e INSTAT, në periudhën 2012-2016 eksportet me vendet e BE kanë zënë mesatarisht 76,6 % të totalit; ndërsa eksportet me CEFTA-n zënë 12,4 % të totalit. Në CEFTA, me gjithë barrierat e shumta burokratike që ngrihen nga vendet anëtare karshi mallrave shqiptare, Shqipëria ka raportuar vetëm 3 raste (numrin më të vogël krahasuar me shtetet e tjera) në Komitetin e Përbashkët gjatë periudhës 2009-2016. Kjo tregon një nivel të dobët të komunikimit dhe aksesit që ka biznesi shqiptar tek instancat shtetërore për të adresuar problematikat që ndesh në kufijtë ballkanikë.

Tarfia e përbashkët: Ekonomisti i shquar, David Ricardo, në veprën e tij “Parimet e Politikave Ekonomike dhe Taksimit” (v. 1817) thekson se “*Eliminimi i tarifave do të sillte një përfitim neto në dobi të mirëqenies së përgjithshme – nga ku përftimet e konsumatorëve janë më të mëdha se humbjet e prodhuesve*”. Vendosja e tarifave të përbashkëta është një proces i shtrirë në kohë, p.sh BE-së iu deshën 11 vjet dhe me efekte zinxhir në hallkat ekonomike dhe administrativ. Sipas një skenari 1, vendosja e një tarifë të përbashkët sjell një tarifë të lartë për shembull për Kosovën. Kjo nënkupton që konsumatorët në Kosovë do të paguajnë çmime më të larta për importet nga jashtë unionit doganor ose do të furnizohet nga furnitorë më pak eficient nga Shqipëria. Pavarësisht tarifave të larta të importit, qeveria e Kosovës do të përfitojë më pak të ardhura për shkak të alternimit të burimit të importit, nga

vendet me jashtë, me furnitorë nga Shqipëria. Sipas një Skenari 2, vendosja e një tarife më të ulët, për shembull në Shqipëri, do të ulte riskun e diversionit tregtar dhe do të sillte dy efekte pozitive. Së pari do të rriste importet e Shqipërisë nga vendet e tjera duke sjellë efektin pozitiv të “krijimit të tregtisë. Së dyti, do të rriste të ardhurat ne importet. Prodhuesit vendas, megjithëse do të ndeshen me një konkurrencë të lartë, kjo do të kompensohej nga përfitimet që do të vijnë për konsumatorët, të cilët do të blejnë mallra me çmime më të ulëta. Rregullimet ligjore: Cili shtet do t’i mbledhë detyrimet doganore? Si do të mblidhen këto detyrime dhe si do të bëhet ndarja e të ardhurave?

Barrierat burokratike: Për periudhën, 2012-2016 eksportet me Italinë zinin mesatarisht 51,0% të eksporteve gjithsejt të Shqipërisë, ndjekur nga Kosova me 7.5%, Spanja me 6.8%, Greqia me 3.9%. Eliminimi i barrierave jotarifore përbën qëllimin kryesor të Marrëveshjes për Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë mes Shqipërisë dhe Kosovës. Në këtë kuadër janë ngritur edhe grupe pune, por biznesi vazhdon të ndeshet me tilla pengesa. Sipas një ankete të kryer nga Oda Ekonomike e Kosovës, theksohet se “Ekzistimi i barrierave jo-tarifore, në të vërtetë paraqet një neglizhencë të qeverive respektive. Andaj duhen siguruar kushte që incidentet e shpeshta që paraqiten në sektorë të ndryshëm të mos ndodhin, duke krijuar kështu kushte për fuqizimin e marrëdhënieve tregtare”. Tre janë format kryesore të barrierave të hasura nga biznesi i Kosovës: Burokracia e tepruar; Certifikata e origjinës; Dokumenti fitosanitar dhe më konkretisht: Në pikën kufitare shqiptare kërkojnë noterizimin e analizave të kualitetit të lëshuara nga IKSHP ose Instituti Bujqësor dhe nuk e njohin dokumentin fitosanitar dhe sipas bizneseve kosovare të anketuar, Shqipëria është i vetmi vend që kërkon dokumente të ndryshme, madje edhe krahasuar me të gjitha shtetet e BE-së, etj.

Operimi i Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit: Në Portin e Durrësit, 90% e tranzitit dhe 30% e mallrave që përpunohen kanë si destinacion Kosovën. Deklaratat publike në këtë rrafsh, të cilat shërbyen edhe si informacion për grupin e auditimit, nuk përputheshin me gjendjen reale të konstatuar nga grupi auditues në fushën e ekzistencës së bazës ligjore, përgatitjeve administrative nga Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si dhe kapaciteteve infrastrukturore të Portit të Durrësit. Nga operimi i plotë i doganës kosovare në Portin e Durrësit, bizneset do të përfitonin një ulje të kostos aktuale me rreth 2 milion euro në vit. Braktisja e projektit për vënien e Portit të Shëngjinit në shërbim të Doganës së Kosovës, pa u kryer një studim i mirëfilltë për potencialet dhe përfitimet ekonomike që do të sillte për të dy vendet, ka shkaktuar një mungesë

përgatitjeje institucionale e cila është reflektuar edhe në shtyrjen e operimit të doganës së Kosovës në Portin e Durrësit.

Nga informacionet e marra nga grupi i auditimit operimi i doganës së Kosovës në Portin e Durrësit do të fillonte në dhjetor 2017, për të cilën u përgatit edhe një projektvendim i Këshillit të Ministrave *“Për lejimin e kryerjes së kontrolleve fizike nga zyrtarët e zyrës doganore të Kosovës në Portin e Durrësit dhe Porto Romano dhe njohjen e licencave të agjencive të përfaqësimit Doganor të Kosovës”*, por qeveria shqiptare hoqi dorë nga miratimi i këtij projektvendimi, për një afat të pacaktuar. Kjo tërheqje konstatohet edhe nga fakti se zyra doganore e Kosovës nuk u hap në muajin dhjetor, sikurse qe parashikuar, për arsye se nga pala shqiptare nuk është marrë asnjë masë për të plotësuar kriteret bazë të operimit, siç vëren Dogana e Kosovës në *“Raportin për Parakushtet e vendosjes së Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit”* dërguar në datën 23.10.2017 Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Çfarë nuk shkon? Për bashkimin doganor Shqipëri-Kosovë nuk ekziston një kuadër rregullator i posaçëm që të rregullojë marrëdhëniet mes dy vendeve, por vihet re një kuadër i shpërndarë në dispozitat e morive të marrëveshjeve të nënshkruara. Këto marrëveshje e cekin në mënyrë tangjente unifikimin e pikave doganore me Kosovën por nuk përfaqësojnë në thelb, në formë dhe përmbajtje, një bazë ligjore të posaçme. Konkretisht, Marrëveshja për Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë nuk parashikon strategjinë e implementimit të punës, organet dhe ministritë përgjegjëse për të ndjekur procesin dhe nuk kanë arritur të eliminojë barrierat burokratike. Harmonizimi fiskal, si gur-themeli i unionit doganor, nuk është konturuar si politikë qeveritare, bazuar në një marrëveshje ndër qeveritare, por është shtruar në formë aspirate.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, ndonëse përmendet në mënyrë tangjenciale bashkëpunimi me Kosovën dhe megjithë rëndësinë që ka për vendin tonë, ky bashkëpunim nuk parashikohet në një kapitull të veçantë.

Mungesë efektiviteti: Strukturat institucionale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Shqiptare nuk janë angazhuar në mënyrë të vazhdueshme e në koordinim me institucionet e Kosovës në këtë drejtim, për shkak të mungesës së një strategjie të posaçme. Paradoksi që është krijuar është se në optikën e performancës, procesi është invers, nga inputet po shkohet tek një objektiv i vagullt e retorik, që ndryshon trajtë pas çdo deklaratë

publike, e jo nga një objektiv i qartë e strategjik tek inputet. Kjo ka shkaktuar një situatë ku Dogana shqiptare por edhe Ministria e Financave po e gjejnë veten të papërgatitura dhe shumë prapa përballë deklaratave politike në këtë rrafsh.

Çfarë kemi rekomanduar? KLSH ka dhënë 24 rekomandime në këtë auditim, ndër kryesore të këtij auditimi vlen të përmendim:

- Hartimi i një strategji kombëtare të posaçme për bashkimin doganor me Kosovën, për ta veçuar Kosovën nga bashkëpunimi ekonomik me vendet e CEFTA-s.
- Në grupet e përbashkëta të punës midis Shqipërisë dhe Kosovës, të përfshihen edhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë e Industrisë të Shqipërisë dhe Oda Ekonomike e Kosovës, si organizata që përfaqësojnë bizneset e të dy vendeve
- Hartimi i një studimi mbi vendosjen e Portit të Shëngjinit në shërbim të Doganës së Kosovës. (*“Porti i Shëngjinit – Porti i integritimeve shqiptare” Fjala e deputetit Bujar LESKAJ në Kuvendin e Shqipërisë, 2009*).
- MFE të marrë masa që në administratën doganore të instalohet një platformë Single Window (sikurse do të implementohet nga pala kosovare në vitin 2018) dhe të shqyrtojë rekomandimin 36 të UN/CEFCAT për të krijuar një Single Window (Dritare të Vetme) Shqipëri – Kosovë.
- MFE dhe DPD të ndërmarrin hapat e nevojshëm administrativë për krijimin e një regjistri elektronik të përbashkët për bizneset që operojnë në Shqipëri dhe në Kosovë.

Këto rekomandime kanë si qëllim ndërmarrjen e hapave konkretë, për të realizuar një zhvendosje nga retorika aktuale në një angazhim shtetëror efektiv dhe gjithëpërfshirës, duke thirrur në tryezat e përbashkëta edhe organizatave të bizneseve të të dyjave vendeve. Po ashtu, duke marrë parasysh të metat e strukturës së eksporteve shqiptare, të cila përbëhen nga produkte me vlerë të ulët e të papërpunuara, është me rëndësi që bashkimi doganor të zhvishet nga ambalazhi politik e të parashtrohet si domosdoshmëri e realitetit të zhvillimeve ekonomike.

FOKUSI STRATEGJIK I KLSH-së – QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT

PËR PERIUDHËN 2018 – 2022

Nga z. Bujar LESKAJ, Kryetar i KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vendosur fokusin strategjik të zhvillimit i udhëhequr nga konceptet dhe parimet e adresuara në dy Rezolutat e rëndësishme të Asamblesë së Përgjithshme, të cilat kanë pranuar dhe theksuar *“...rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në promovimin e një administrate publike efektive dhe të përgjegjshme, të favorshme për realizimin e prioriteteve të zhvillimit. Ato luajnë një rol kritik në luftën kundër mashtrimeve financiare dhe praktikave të korruptuara”*. Gjithashtu, moto e Kongresit të XXI – të INCOSAI-t: *“Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes së Mirë Kombëtare”¹⁴*, përbën thelbin e qëllimeve strategjike dhe objektivave të zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018-2022.

KLSH, si partner aktiv i rrjetit ndërkombëtar të institucioneve supreme të auditimit, ka integruar në kornizën e zhvillimit strategjik mesazhet e përcjella nga Kongresi i XXII i INCOSAI-t *“Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-et) në shërbim të qytetarëve”* dhe *“Të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri”*.

“Qytetari meriton të vërtetën” është motoja e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018-2022.

Kjo moto është shprehje e eksperiencës së akumuluar përgjatë implementimit të Planit Strategjik të pesë viteve të kaluara dhe nxitje për të konsoliduar aktivitetin në të gjitha dimensionet për vitet 2018-2022, duke informuar publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me përgjegjshmërinë e qeverisë qendrore e vendore, si dhe të njësive të tjera publike për përdorimin e parave publike me ekonomicitet, efektivitet dhe efizienzë, në përputhje me praktikën me të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mire, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Monitorimi i implementimit të Strategjisë së Zhvillimit të periudhës së mëparshme identifikoi eksperiencat e rëndësishme në këto vitet e fundit. Ky monitorim konfirmoi gjithashtu se KLSH ka treguar profesionalizëm si në parashikimet për

¹⁴Deklarata e Kongresit të XXI të INCOSAI-t, Pekin, Tetor 2013
KLSH 2018

zhvillimet e saj strategjike, ashtu dhe në vënien në jetë dhe zbatimin e suksesshëm të tyre. Monitorimi vlerësoi progresin e bërë kundrejt objektivave të planifikuara po ashtu dhe efektivitetin e politikave të vendosura në arritjen e vizionit dhe misionit për të përmbushur rolin dhe mandatin kushtetues të KLSH-së në pesë vite. Raporti i Monitorimit të Planit e Zhvillimit Strategjik të KLSH 2013-2017 vlerësoi se në tërësi indikatorët e performancës të vendosur në Planin e Veprimit u arritën si në aspekte të përmbajtjes, ashtu dhe kohës së realizimit të tyre në rreth 85% të objektivave të synuara.

Mbi të gjitha, analiza e progresit konfirmoi ndryshimin institucional që reforma dhe implementimi i Strategjisë për vitet 2013-2017 solli në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ndryshim që sot mund të matet me shifra dhe fakte të publikuara dhe të vlerësuara nga mbikëqyrësit si Kuvendi i Shqipërisë, strukturat vlerësuese të Komisionit të BE-së, SIGMA, qytetarët dhe nga komuniteti i INTOSAI-t, EUROSAI-t, homologët e vendeve të tjera apo shoqatat profesionale.

Ka një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet konkluzioneve të nxjerra nga analiza e zhvillimit dhe arritjet gjatë implementimit të Planit Strategjik 2013-2017 dhe projektimit të fokusit të strategjisë së zhvillimit për pesë vitet në vijim. KLSH ka vendosur tashmë një bazë solide mbi të cilën po ndërtohet strategjia e së ardhmes, që përfaqëson mënyrën se si do të menaxhohet ndryshimi nga arritjet aktuale drejt pritshmërive. Zhvillimet për periudhën e ardhshme janë përcaktuar mbështetur në vlerësime dhe analiza, në referencë të asaj se çfarë është bërë dhe çfarë synohet të arrihet nga KLSH, gjithnjë drejt përmbushjes së misionit dhe vizionit e duke ruajtur e zhvilluar vlerat e parimet tona.

Objektivi i tretë i ISSAI-t 12, sipas të cilit *“SAI duhet të jetë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit”*, përbën boshtin mbi të cilin është hartuar Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së dhe që synon të sigurojë: transparencën dhe përgjegjshmërinë e duhur; qeverisjen e mirë; pajtueshmërinë me Kodin e Etikës; ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet promovimit të të mësuarit dhe shpërndarjes së njohurive.

Ky vizion konkretizohet në tri qëllime strategjike, në të cilat KLSH do të fokusojë veprimtarinë e saj për vitet 2018-2022 dhe që konsistojnë në:

QËLLIMI 1: RRIJTJA E IMPAKTIT TË PUNËS AUDITUESE ME FOKUS NË 6E-të;

QËLLIMI 2: OPTIMIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE, AFTËSIVE AUDITUESE, PROCEDURAVE TË PUNËS, LOGJISTIKËS DHE FUNKSIONEVE TË TJERA MBËSHTETËSE;

QËLLIMI 3: PËRMIRËSIMI I KANALEVE TË KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT

1. QËLLIMI 1: RITJIA E IMPAKTIT TË PUNËS AUDITUESE ME FOKUS NË 6E-të

Puna audituese dhe produktet e saj janë “shtylla kurrizore” e aktivitetit institucional. Përveçse e fokusuar në auditimet tradicionale të përputhshmërisë dhe ato financiare, KLSH do të vijojë zgjerimin e fokusit të saj në auditimet e performancës dhe IT, duke përfshirë në secilin prej tyre konsiderata për ekonomikitetin, eficiencën, efektivitetin, etikën, mjedisin (environment) dhe energjinë.

1.1. THELLIMI NË AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Sfidat që lidhen me auditimin e TI-së, dhe prezantimi gjithnjë e më shumë i projekteve të qeverisjes elektronike (e-qeverisjes) shtron nevojën për zhvillimet të mëtejshme, shtrirje dhe thellim të këtij lloji auditimi, së cilës KLSH i përgjigjet duke e vendosur kryerjen dhe zhvillimin e auditimeve të TI si një ndër nën-objektivat e saj strategjike edhe për periudhat e ardhshme.

Bazuar në rekomandimet e Kongresit të X-të të EUROSAT-t, të cilat konsistojnë në: shkëmbimin, shpërndarjen dhe ndjekjen e praktikave të mira të auditimit të TI-së; identifikimin e të gjitha pengesave që zvogëlojnë mundësinë e kryerjes së auditimeve të TI-së; përfshirjen e auditimit të TI-së në Strategjinë e SAT-t; krijimin dhe mbajtjen të përditësuar të informacionit në fushën e TI-së të të gjithë të audituarve dhe të të gjitha projekteve të rëndësishme të qeverisjes elektronike (e-Government); dhe, sigurimin e programeve të trajnimit në stafin e auditimit të TI-së.¹⁵, KLSH vendos nevojën për zhvillime të mëtejshme të Auditimit të TI-së në krye të nën-objektivave që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e performancës institucionale. Përhapja e shpejtë e teknologjisë kompjuterike dhe përdorimi i “Big Data” në auditim, kërkojnë investime në mjete vizualizuese e analizuese, auditues të TI të aftë, të mirëtrajnuar dhe që zotërojnë dijet e duhura për të dhënë siguri nëse kontrollet dhe proceset e përshtatshme janë vendosur, funksionojnë efektivisht për të menaxhuar riskun dhe vulnerabilitetin e sistemeve TI.

Objektivi i KLSH për periudhat e ardhme konsideron kalimin në një fazë të mëtejshme që synon konsolidimin e Auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimin e elementeve të Auditimeve TI-së në auditimet e përputhshmërisë, financiare dhe të performancës.

Për zhvillimin e mëtejshëm të kapacitete të auditimit të sistemeve TI që përdoren për raportim financiar në sektorin publik dhe në proceset audituese në përgjithësi, strategjia fokuson këto aspekte:

¹⁵Kongresi X-të të EUROSAT-t, Turqi, 2017
KLSH 2018

- ✓ Zhvillimin e mëtejshëm të kapacitete të auditimit të sistemeve TI për dhënie e sigurisë të arsyeshme (për çdo lloj auditimi: financiar, të performancës dhe të përputhshmërisë) mbi të dhënat që ruajnë këto sisteme;
- ✓ Zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve audituese me teknikat CAAT dhe njohuri të teknologjisë së informacionit;
- ✓ Pajisjen e audituesve IT të KLSH me çertifikata të njohura ndërkombëtarisht mbi auditimin IT, duke marrë në konsideratë burimet e nevojshme sipas angazhimeve financiare.

Ngritja në një nivel më të lartë si Departament i Auditimit të TI do të synojë të krijojë kushtet e nevojshme për kryerjen e këtij lloj auditimi dhe t'i hapë rrugën zhvillimeve të mëtejshme të punës audituese të KLSH-së. Elemente të auditimit TI do të vazhdojnë të shtrihen në Departamentet e Auditimit, duke vazhduar praktikën e ngritur nga projekti i binjakëzimit për ngritjen e një linje të parë mbështetëse me njohuri TI në çdo departament dhe mbështetjes së saj nga trupa TI.

KLSH po përfundon programin për “Menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve” në KLSH dhe ato të auditimit në veçanti, me synimin që me anë të teknologjisë bashkëkohore moderne të automatizojë proceset e punës të KLSH, duke përmirësuar dhe njëkohësisht lehtësuar menaxhimin e të gjithë llojeve të auditimit. Baza e të dhënave të këtij programi do përmbajë informacione mbi subjektet që përdorin fonde publike dhe gjetjet e auditimit, shfrytëzimi i saj për analizën e rasteve përbën sfidën e KLSH për vitet në vijim për t'iu përgjigjur me efektivitet e profesionalizëm taksapaguesve se si përdoren lekët e tyre¹⁶. Për vitet në vazhdim mbetet prioritet implementimi i programit (ngritur mbi platformën REV Zone) dhe zhvillimi i tij në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe zhvillimet institucionale.

1.2. FOKUSI NË RITJE DREJT AUDITIMIT TE PERFORMANCËS

KLSH është në linjë me konkluzionet dhe rekomandimet e rezolutave dhe kongreseve të INTOSAI-t “*për një qasje gjithëpërfshirëse drejt auditimeve të performancës dhe inkurajim për auditime të përbashkëta dhe për një shkëmbim më intensiv të njohurive mes SAI-ve*”.¹⁷

Auditimi i Performancës është konceptuar në strategjinë e kaluar si një nga shtyllat moderne të zhvillimit të KLSH-së, sipas eksperiencave botërore. Performanca është

¹⁶Eksperiencia e SAI-t Cek dhe eksperiencia SAI-ve te tjerë qe kanë implementuar sisteme të tilla

¹⁷Kongresi i XXII në Abu d’Habi

rritur shëndetshëm gjatë 5-vjeçarit të kaluar, me rrënjë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin e ri 154/2014, trung të ushqyer nga puna e kolegëve auditues, bashkëpunëtorëve vendas dhe të huaj dhe degë të shtrira në të gjithë sektorët që ushtrojnë aktivitet ekonomiko-social publik.

Në strategjinë 2018-2022, puna audituese në departamentit të performancës duhet të:

- ✓ Fokusetohet në çështje *makro-ekonomike*, krahas atyre *mikro-ekonomike*;
- ✓ Vijoje të fokusohet në *auditime procesi* më shumë sesa *auditime institucioni*;
- ✓ Riklasifikojë fushat audituese duke marrë në konsideratë edhe kritere të tjera, si: prioritetet qeverisëse, peshën sektoriale në buxhet, *e-government*, etj.;
- ✓ Klasifikojë dhe monetarizojë gjetjet, konkluzionet e rekomandimet sipas 3E-ve dhe jo thjesht në: *organizative* e *ligjore*, sikurse është tradita e KLSH-së në auditimet e ligjshmërisë dhe ato financiare;
- ✓ Ruajë dhe promovojë profilizimin dhe specializimin e audituesve, duke krijuar një bërthamë apo lokomotivë profesionale që të menaxhojë ndryshimin dhe rrisë peshën e raporteve të performancës brenda e jashtë institucionit;
- ✓ Shtojë filtrat garantues të cilësisë brenda Departamentit, duke rritur komunikimin mes kolegëve dhe ngritur grupe që vlerësojnë punën e njëri-tjetrit;
- ✓ Gjenerojë një numër më të madh auditimesh performace, me një rritje mesatare vjetore prej 4 auditime në vit. Kjo rritje duhet “financuar” ose duke shtuar nr. e audituesve të dept. të performancës (rekrutime të reja, qarkullim nga dept. të tjera tek performanca) ose duke krijuar një *drejtori të përgjithshme të performancës* që të ketë në përbërje dy apo tre dept. të cilat të kryejnë auditime “të pastra” performance dhe “të përziera” ku të dominojë elementi i performancës. Aktualisht në KLSH kryen mjaft auditime ligjshmërie ku në fakt trajtohen gjerësisht elementë të performancës.

Në mënyrë specifike fusha e auditimit të performancës përballet me risqe mjaft domethënëse si: ndryshimi i filozofisë dhe vizionit të hierarkisë drejtuese për rolin që duhet të mbartë auditimi i performancës brenda e jashtë institucionit, pasivitet i audituesve për të aplikuar metoda auditimi që klasifikojnë dhe monetarizojnë punën audituese sipas 3 apo më shumë E-ve, fokusimi në mikro-çështje audituese, duke gjeneruar auditime të segmentuara dhe me impakt pjesor e të tjera.

Objektivat për auditimin e përfomancës shkojnë përtej nxitjes së ndryshimit, duke synuar në rritjen e impaktit që këto auditime duhet të sjellin në interes të palëve të përfshira. Për këtë qëllim gjatë periudhës së ardhshme strategjike Departamenti i Auditimit të Performancës synon të:

- ✓ Përcjellë në Kuvend çdo raport auditimi performance, duke kërkuar edhe të dëgjohet në seanca të posaçme për çështje kritike;
- ✓ Shtojë peshën e vet të raportimit në dy raportet që KLSH përcjell çdo vit si dokumente integrale në Kuvend (Raporti për Zbatimin e Buxhetit Faktik dhe Raporti për Performancën Institucionale);
- ✓ Rrisë pjesëmarrjen aktive në konferenca, *workshop*-e e takime jashtë vendit, duke prezantuar dhe promovuar punën audituese;
- ✓ Organizojë mbi baza periodike takime me gazetarët, akademinë dhe shoqërinë civile për të rritur impaktin dhe marrë *feedback*;
- ✓ Ruajë dhe rrisë prezencën në median e shkruar, duke synuar kalimin edhe në median vizive;
- ✓ Shtojë numrin e ndjekësve në kanalet sociale, duke targetuar moshën e re, për të ndërgjegjësuar brezin e ri për problemet e vendit dhe joshur ata drejt pjesëmarrjes në zgjidhjen e problemeve;
- ✓ Nxisë dhe mbështesë botimet institucionale lidhur me performancën.

Auditimi i Performancës në KLSH, në momentin e hartimit të Strategjisë 2018-2022, ndodhet në një moment vendimtar. Të rritet duke u bërë promotor i zhvillimit institucional dhe konsoliduar në një auditim analitik, këshillues, bashkëpunues e vlerështues, apo të mbetet “krahu liberal” i një KLSH-je që perceptohet si penalizuese, e ngurtë, fanatike e ligjit dhe letrës dhe jo performancës e realitetit. Vizioni i hierarkisë drejtuese, Kryetarit, Drejtorit të Departamentit është për të parën dhe në këtë aspekt janë vendosur objektivat SMART për të ardhmen 5-vjeçare të Departamentit të cilat synojnë që numri i auditimeve të performancës të shkojë në 30-35% të punës audituese institucionale.

1.3. KRYERJA E AUDITIMIT FINANCIAR NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT

Auditimi financiar përbën një nga aktivitetet audituese më tradicionale nga pikëpamja e historisë, por që përsoset në mënyrë dinamike nga zhvillimet në fushën e raportimit financiar, përfshi rolin gjithnjë e më të madh të teknologjisë së

informacionit në këtë fushë, si dhe ndryshimet e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Plani strategjik i KLSH merr në konsideratë dhe zhvillimet e ndodhura dhe të pritshme në fushën e raportimit financiar në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë, të cilat rrisin përgjegjësinë e KLSH për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve në zhvillimin e auditimit mbi raportimin financiar në këtë sektor. KLSH, në përmbushje të detyrimeve ligjore, ka për kompetencë auditimin e pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe vendore, si dhe dhënien e opinionit mbi to. Kontrolli i Lartë i Shtetit, çdo vit jep opinion në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të konsoliduar të shtetit.

Aktualisht raportimi financiar nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme në Shqipëri realizohet mbi bazën e mjeteve monetare, por me elementë të administrimit të aktiveve, të angazhimeve, debitorëve dhe kreditorëve. Raportimi financiar në sektorin publik është i orientuar drejt mënyrës së buxhetimit dhe kontrollit të zbatimit të buxhetit të shtetit. Si rrjedhojë, opinionin e KLSH mbi raportimin financiar në sektorin publik gjatë këtyre viteve ka qenë i fokusuar vetëm në këto aspekte, duke rekomanduar në mënyrë të përsëritur nevojën që raportimi financiar në sektorin publik të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS). Ekzekutimi i auditimit, përfshi garantimin e procedurave të testimit, të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme mbi prezantimin e drejtë të raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të konsoliduar të shtetit në çdo aspekt material, është një detyrë komplekse dhe kërkon një metodologji gjithëpërfshirëse dhe instruksione standarde të zbatueshme në nivel institucional.

Në Kongresin XXII të INCOSAI-t, në Abu D'habi u përforcua ideja se SAI-t, përmes auditimit të llogarive dhe operacioneve qeveritare, luajnë një rol të madh në promovimin e financave të shëndetshme publike dhe llogaridhënies së përgjithshme në qeveritë e tyre.

Është detyrë themelore e SAI-ve të shqyrtojnë nëse fondet publike shpenzohen me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret ekzistuese. Ndërsa SAI-t shqyrtojnë mobilizimin e burimeve (të hyrave) dhe menaxhimin e shpenzimeve (Shpenzimet), ato ndihmojnë në përmirësimin e proceseve kyçe të MFP-së. Në këtë mënyrë, SAI kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit, duke rishikuar auditimin e brendshëm dhe duke i bërë risqet të

dukshme, duke botuar gjetjet dhe rekomandimet e tyre në faqet zyrtare të internetit (media, etj.)¹⁸.

Në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Shtylla 4 - Raportim qeveritar transparent, Kontabiliteti, Qeveria e Republikës së Shqipërisë është angazhuar që kontabiliteti dhe raportimi financiar në sektorin publik të kryhen në përputhje me Standardet Europiane të Kontabilitetit Publik¹⁹ (SEKP). Ky zhvillim e bën të domosdoshme që KLSH të garantojë kapacitete institucionale të përshtatshme për të kryer auditime financiare në përputhje me standardet ndërkombëtarë të auditimit (SNA) mbi pasqyrat financiare të sektorit publik të përgatitura në përputhje me IPSAS.

Për më tepër, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë. Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor përfshin, ndër të tjera, dhe pasqyrat financiare vjetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kërkesat e Ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kërkojnë që KLSH, duke filluar nga viti 2018, të angazhohet në kryerjen e auditimeve financiare në përputhje me SNA mbi veprimtarinë financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Për realizimin e kësaj sfide, KLSH planifikon që të shtojë kapacitetet veta të burimeve njerëzore ose do të kontraktojë ekspertë të jashtëm të auditimit, në mënyrë që të përmbushë misionin e tij auditues edhe në përgjigje të dimensionit të ri të përcaktuar nga Ligji nr. 68/2017.

Në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020, qeveria synon përdorimin gjithnjë e më të gjerë të sistemit SIQF në raportimin financiar të njësisë publike. Integrimi i përditshëm i të dhënave të kontabilitetit nëpërmjet Ndërfaqes/Lidhjes midis sistemit të SIFQ-it dhe sistemit tatimor digjital është një nga objektivat e qeverisë, sikundër dhe dhënia e aksesit të drejtpërdrejtë për institucionet e qeverisjes së përgjithshme në SIFQ me qëllim ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe kryerjen e raportimin financiar. Përdormi gjithnjë e më i gjerë i sistemeve IT në fushën e raportimit financiar në sektorin publik, kërkon që KLSH të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet në auditimin e këtyre sistemeve në funksion të efektivitetit të auditiveve financiare.

¹⁸Deklarata Kongresit XXII të INCOSAI-t, Dhjetor 2016

¹⁹Komisioni European ka vendosur të përgatisë SEKP bazuar në IPSAS, të cilat mund të bëhen të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të BE-së duke filluar nga viti 2021.

Në strategjinë 2018-2022, bazuar mbi zhvillimet e parashtruara më lart, në lidhje me auditimet financiare, KLSH ka si objektiva:

- ✓ Përgatitjen e metodologjisë standarde dhe të detajuar të auditimit financiar që të jetë sa më lehtësisht e zbatueshme nga audituesit;
- ✓ Përgatitjen e formateve standarde të letrave të punës apo instruksioneve të detajuara në lidhje me kryerjen e procedurave të detyrueshme të testimit dhe dokumentimin e punës audituese në përputhje me metodologjinë standarde të auditimit financiar dhe SNA;
- ✓ Përgatitjen dhe rishikimin vjetor të instruksioneve standarde dhe procedurave të detajuara të auditimit financiar, të cilat duhet të kryen nga çdo grup që auditon njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe vendore, të cilat shërbejnë për dhënien e opinionit nga KLSH mbi paraqitjen e drejtë, në çdo aspekt material, të raporteve financiare të konsoliduara të shtetit që paraqiten për miratim në Kuvend;
- ✓ Hartimin e planit vjetor të auditimeve të KLSH që garanton, ndër të tjera, mbulimin e përshtatshëm, në çdo aspekt material, për dhënien e opinionit mbi raportet financiare të konsoliduara të shtetit që paraqiten për miratim në Kuvend. Në këtë plan të përfshihen dhe auditimet mbi sistemet IT që janë relevante për raportimin financiar të konsoliduar të shtetit;
- ✓ Alokimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për të rritur në vijimësi numrin dhe mbulimin nga auditimet financiare të kryera nga KLSH. Përveç planit vjetor për auditimet financiare, do të hartohet dhe plani afatmesëm për këto auditime me qëllim përmbushjen në kohë të përgjegjësive ligjore të KLSH-së, në harmoni me zhvillimet e raportimit financiar në sektorin publik që drejtohen nga Qeveria e Shqipërisë;
- ✓ Shtimin e burimeve njerëzore përgjegjëse për auditimet financiare, për t'iu përgjigjur përgjegjësive të shtuara të KLSH-së si rrjedhojë e zhvillimeve në raportimin financiar në sektorin publik që drejtohen nga Qeveria e Shqipërisë;
- ✓ Certifikimin e audituesve të KLSH si Ekspertë Kontabël të Regjistruar dhe pjesëmarrjen e tyre në seksionet e edukimit të vazhdueshëm të organizuara nga IEKA;
- ✓ Organizimin dhe pjesëmarrjen e audituesve në trajnime të vazhdueshme mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik. Zhvillimin e moduleve të brendshme të trajnimit në lidhje me to;

- ✓ Organizimin dhe pjesëmarrjen e audituesve në trajnime të vazhdueshme mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Zhvillimin e moduleve të brendshme të trajnimit mbi SNA-të dhe metodologjinë standarde të auditimit financiar të KLSH;
- ✓ Zhvillimin e kapaciteteve të strukturës përkatëse teknike për rishikimin periodik të metodologjisë dhe formateve standarde të auditimit që garantojnë përputhshmërinë në çdo kohë me SNA, si dhe për ofrimin e asistencës së specializuar teknike për audituesit në lidhje me interpretimin në raste komplekse të SNA dhe IPSAS. Konsulenca nga kjo njësi mund të kërkohet si e detyrueshme për rastet e dhënies së një opinionit të modifikuar me qëllim garantimin që ky opinion është i mbështetur në evidenca të përshtatshme auditimi.

1.4 KONSOLIDIMI I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË VLERËSUAR, SIPAS KËRKESAVE TË ISSAI-VE

Eksperienca e deritanishme e KLSH-së ka treguar se auditimet e përputhshmërisë janë lloji më i përhapur i auditimeve të kryera. Vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare kanë shprehur pozitivitet përse i përket aftësive të audituesve në kryerjen e këtij lloji auditimi si dhe rezultateve të tyre.

Megjithatë, KLSH njih nevojën që ndërsa do të punohet në drejtim të rritjes së numrit të auditimeve financiare dhe të performancës, nuk mund të mbetet mënjanë cilësia dhe konteksti i auditimeve të përputhshmërisë.

Në këtë drejtim KLSH synon të arrijë nivelin më të lartë të pajtueshmërisë me kërkesat ISSAI 400 të detajuara më pas në ISSAI e nivelit 4, ISSAI 4100. Realizimi i këtij objekti kërkon:

- ✓ Finalizimin e procesit të rishikimit të Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë mbi bazën e rezultateve të vlerësimeve të auditimeve pilot të përputhshmërisë;
- ✓ Hartimi i udhëzuesit të posaçëm për qasjen në përzgjedhjen e subjekteve për t'u audituar, të bazuar në një vlerësim sistematik dhe të dokumentuar të riskut dhe materialitetit si dhe që të sigurojë që të gjitha subjektet brenda mandatit të KLSH të auditohen gjatë një periudhe të arsyeshme kohore;
- ✓ Përfshirja në modulet e trajnimit të stafit të kuadrit të rishikuar të manualeve dhe të procedurave të lidhur me auditimin e përputhshmërisë;

1.5 CILËSIA SI PRIORITET I KLSH-PËRMIRËSIMI I CILËSISË DHE PËRFITIMI NGA AUDITIMET E KLSH-së

Një nga mënyrat që KLSH do të vijojë të aplikojë për të shtuar vlerë dhe gjeneruar përfitime në forcimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit të qeverisjes në tërësi dhe të njësive të sektorit publik është duke ofruar vlerë dhe cilësi në vetë auditimet e kryera prej tij. Në Deklaratën e Abu D'habi-t²⁰ në Dhjetor 2016 u theksua se *“Është detyrë e SAI-t të kryejë auditime të cilësisë së lartë dhe t’u japë qytetarëve raporte që mbështesin transparencën, përgjegjshmërinë e mirë dhe besimin në qeverisje.”*

Ofrimi i rezultateve të auditimit, të cilat demonstrojnë integritet, neutralitet politik dhe angazhim për të sjellë ndryshim dhe impakt pozitiv të bazuara në auditime cilësore është një objektivi që KLSH synon ta shndërrojë në tipar të punës audituese. Duke njohur dhe duke qenë të ndërgjegjshëm që cilësia është thelbësore për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit në shërbim të Kuvendit dhe të qytetarëve shqiptarë, KLSH do të:

- ✓ Adoptojë Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë i cili përfshin të dy anët kontrollin e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë. **Kontrolli i cilësisë** do të konsolidohet nëpërmjet zbatimit të përpiktë të Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH. Kjo procedurë mbështetet edhe nga **Sigurimi i Cilësisë**, i cili kryhet nga individët të pavarur (d.m.th. nuk kanë marrë pjesë në procesin e auditimit që po rishikojnë);
- ✓ Miratojë Manualin për Sigurimin e Cilësisë²¹ sipas ISSAI 40, i cili do të jetë udhërrëfyesi kryesor për efektivitetin e menaxhimit total të cilësisë në auditim;
- ✓ Konsolidojë dhe forcojë strukturat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë duke e konsideruar këtë si pjesë e procesit të vazhdueshëm të përmirësimit, po ashtu dhe rritjes së impaktit të rezultateve të punës së saj;
- ✓ Shtrijë sigurimin e **cilësisë së auditimeve me burime të jashtme** duke adoptuar si pjesë të procedurave për sigurimin e cilësisë edhe procedura që lejojnë vlerësimin e rregullt dhe monitorimin me përgjegjësi të përcaktuara qartë për punën e ekspertëve të jashtëm;
- ✓ Përfshijë në politikat dhe procedurat e Burimeve Njerëzore, të nëntë elementët e përmendur në zbatimin e udhërrëfyesit brenda Kontrollit të

²⁰ Kongresi **XXII INCOSAI**

²¹ produkt i Projektit IPA 2013 “Forcimi i Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm KLSH 2018

Cilësisë për SAI-t, ISSAI 40, duke i dhënë rëndësinë e duhur cilësisë dhe angazhimit të KLSH ndaj parimeve etike²².

1.6 FORCIMI I NDJEKJES SË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE, RRRITJA E NIVELIT TË REKOMANDIMEVE TË PRANUARA DHE TË ZBATUARA.

Efekti real i aktivitetit auditues së KLSH-së matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet publike të audituara, institucionet ligj-zbatuese dhe politikë-bërësit. Për këtë arsye, në vitet e fundit, institucioni suprem i auditimit publik ka treguar angazhim dhe këmbëngulje në identifikimin dhe aplikimin e instrumentave të duhur për të rritur ndjeshmërinë e të gjithë palëve të interesit të produkteve të KLSH-së në drejtim të pranimit dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna gjatë aktivitetit auditues.

Instrumentet kryesor që përdorë KLSH-ja për realizimin e këtij objektiv janë:

- ✓ Ndërtimi dhe implementimi i sistemit të procedurave dhe infrastrukturën e duhur brenda institucionit, për të siguruar gjurmimin sistematik dhe periodik të zbatimit të rekomandimeve²³;
- ✓ Krijimi i një baze të dhënash për identifikimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit si dhe përdorimin e mjeteve të TI-së në funksion të këtij qëllimi;
- ✓ Përdorimi i marrëveshjet e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe aktorë të tjerë për zhvillimin e instrumenteve të duhur me përfitim të përbashkët për zbatimin e rekomandimeve të auditimit publik (përfshirë auditimin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm);
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit me Kuvendin dhe veçanërisht me Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, dhe
- ✓ Sinergjizimi me faktorë të tjerë për t'i kërkuar qeverisë të nxjerrë urdhra e udhëzime për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

²² Këto politika dhe procedura lidhur me burimet njerëzore përfshijnë: - rekrutimin (dhe kualifikimin e stafit të rekrutuar), - vlerësimin e performancës, - zhvillimin profesional, - promovimin, - kompensimin, dhe - vlerësimin e nevojave të personelit, Dokumenti Politikave të Burimeve Njerëzore

²³ Infrastruktura ligjore përbëhet nga kërkesat e Ligjit 154/2014 të mbështetura nga procedurat e përcaktuara në Rregulloret e Brendshme dhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit, si dhe të detajuara në Urdhër specifik të Kryetarit të KLSH për këtë qëllim

1.7. FORCIMI I PAVARËSISË DHE MANDATIT TË KLSH/ALSAI-t

Pavarësia dhe mandati i Kontrollit të Lartë të Shtetit është e sanksionuar në Kushtetutë dhe në Ligjin e tij Organik, duke u konsideruar si kusht i domosdoshëm për përmbushjen e misionit dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave strategjike përgjatë zhvillimit ndër vite. Në një nga dokumentet bazë të SAI-ve, Deklarata e Limës, kërkohet që *“Krijimi i Institucioneve Supreme të Auditimit dhe shkalla e nevojshme e pavarësisë së tyre, përcaktohet nga Kushtetuta; detajet mund të përcaktohen në legjislacionin përkatës. Pavarësia nga çdo ndërhyrje dhe mandati i auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit, garantohen nga Gjykata e Lartë.”*²⁴

Niveli aktual i pavarësisë së institucionit suprem të auditimit publik është vlerësuar dhe përshkruar në pjesën e dytë të këtij dokumenti, por ka aspekte të cilat duhet të konsolidohen dhe të përmirësohen më tej përgjatë 5 viteve të ardhshme. Në këtë kontekst, duke iu referuar rekomandimeve të adresuara në “Peer Review”, nga kolegët e Gjykatës së Auditimit të Austrisë, KLSH do të propozojë ndryshimet e nevojshme në kornizën ligjore përkatëse që të gjitha parakushtet që konsiderohen të domosdoshme për pavarësinë e institucionit, që konsistojnë në:

- ✓ Qartësimin dhe adresimin e fushave të pambuluar me auditim nga KLSH, për një qasje të pakufizuar dhe të pavarur në auditimin e institucioneve, organizatave dhe kompanive që janë përdorues të fondeve publike, pavarësisht statusit të tyre, përfshirë edhe përdoruesit e fondeve të asistencës së Bashkimit Europian. Në këtë mënyrë jepet siguri e arsyeshme dhe e pavarur për palët e interesit të nivelit kombëtar, Kuvendin, dhe ndërkombëtar, Komisionin Europian në mbrojtje të interesave financiare të tyre. Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga BE e krijuar me statusin si Agjenci Autonome në vartësinë e Kryeministrit nuk siguron pavarësinë nga ekzekutivi dhe si e tillë duhet të përfshihet apo të jetë në vartësinë e KLSH që gëzon mandatin kushtetues si institucion i pavarur i auditimit të jashtëm në vend.

Përdorimin e instrumenteve si një garanci shtesë që do të japë siguri të mëtejshme se KLSH duhet të ketë në dispozicion burimet njerëzore, materiale dhe monetare të nevojshme dhe të arsyeshme për kryerjen e plotë të auditimeve. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duhet të jetë *“de facto”* autoriteti që duhet të vendosi mbi disponibilitetin e burimeve të institucionit të auditimit të jashtëm publik.

²⁴ISSAI 1. Deklarata e Limës, Seksioni 5, paragrafi 3.
KLSH 2018

2. QËLLIMI 2. OPTIMIZIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE, AFTËSIVE AUDITUESE, PROCEDURAVE TË PUNËS, LOGJISTIKËS DHE FUNKSIONEVE TË TJERA MBËSHTETËSE

INCOSAI XXII përcaktoi profesionalizimin *si proces i vazhdueshëm i fitimit me autoritet të cilësisë dhe statusit të ekspertit dhe të etikës, duke demonstruar një nivel të lartë të kompetencës ose aftësisë*, dhe si tillë ai është adresuar me rëndësi të veçantë nga KLSH, duke e vendosur si një nga qëllimet strategjike zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe rritjen e aftësive audituese të stafit. KLSH e konsideron nivelin e ekspertizës dhe profesionalizimit të audituesve, element kyç në pavarësisë reale të institucionit që kontribuon *“duke forcuar pavarësinë me një armë që askush s’do të guxonte t’ua merrte: diturinë mbi auditimin, e cila i pajis me ide ose mendime dhe analizë të pavarur”*²⁵

2.1. KORNIZA MATJES PERFORMANCËS - SI MJET VLERËSIMI DHE FAKTOR ZHVILLIMI TË VEPRIMTARISË SË KLSH-SË

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka adoptuar zbatimin e Kornizës së Matjes së Performancës së SAI-t^{26,27}, në mënyrë vullnetare si një mjet i rëndësishëm për të zhvilluar kapacitetet. Nëpërmjet aplikimit të kësaj kornize KLSH synon të masë performancën kundrejt standardeve të INTOSAI-t, po ashtu dhe praktikave të mira. KLSH është e angazhuar të zhvillohet si një institucion që udhëheq nëpërmjet shembullit. Rishikimi sistematik i performancës do t’i mundësojë KLSH-së të ndjekë progresin në aspektet kryesore dhe të sigurojë informacion të rëndësishëm mbi të cilin mund të bazohen vendimet menaxheriale dhe organizative. KMP mundëson vlerësimin e performancës në mënyrë tërësore: korniza mbulon si punën audituese, qeverisjen e brendshme dhe etikën, marrëdhëniet me aktorët e jashtëm, si dhe pavarësinë dhe kornizën ligjore. Kjo njeh faktin që SAI-t janë institucione komplekse, dhe se performancat në aspekte të ndryshme janë të ndërlydhura me njëra-tjetrën.

Vlerësimi i nevojave nëpërmjet KMP do të jetë baza mbi të cilën KLSH do të parashikojë zhvillimet strategjike, duke u mbështetur në informacione dhe të dhëna konkrete, të cilat identifikojnë aspektet dhe veprimet që duhet të ndërmerren për të siguruar përputhshmëri të plotë me standardet e pranuar, menaxhimin e

²⁵Z. Terence Nombelle, “INTOSAI Journal” Nentor 2011, fq.15.

²⁶ Kongresi XXII INCOSAI-t miratoi Kornizën e Matjes së Performancës së SAI-t (PMF) nëpërmjet së cilës KLSH ashtu si SAI-et anëtare të INTOSAI-t u angazhua të krijojë një kuadër global të vlerësimit të performancës së SAI-ve, që mund të tregojë se si SAI-të në të gjithë globin po kryejnë punën dhe misionin e tyre, si dhe se si kjo performancë po përmirësohet.

²⁷ Botuar dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit: http://www.klsh.org.al/ëeb/libri_pmf_3366.pdf

performancës, përcaktimin e mundësive për t'u përmirësuar dhe monitoruar punën e KLSH, si dhe për të rritur transparencën e llogaridhënien.

KLSH synon të përdorë KMP-në për:

- ✓ Ndërtimin e matricës së pikëzuar sipas gjashtë fushave të parashikuara në këtë dokument. Ky proces do të jetë i përshkallëzuar për tre vitet e para të zbatimit të strategjisë;
- ✓ Ngritjen e grupeve të punës, që do të aplikojnë KMP për ekzaminimin dhe vlerësimin e fushave sipas treguesve dhe dimensioneve respektive. Rezultatet sipas pikëzimeve do të raportohen duke ndjekur udhëzuesin e KMP për hartimin e raportit dhe publikimin e tij;
- ✓ Përgatitjen e raporteve të performancës vjetore institucionale të mbështetur në evidencën dhe kuptimin e drejtë të ndërlidhjes midis fushave të performancës, duke treguar vlerat dhe përfitimet, se si KLSH kontribuon për rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit në vend;
- ✓ Përcaktimin e masave afatshkurtra dhe afatgjata, që të adresojnë problematikat e identifikuar dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e aktivitetit të KLSH-së me qëllim që të sigurohet përmirësimi i vazhdueshëm i performancës institucionale.

2.2. AUDITIMI MBI BAZË RISKU

Auditimi mbi Bazë Risku (ABR) - si një metodë e rëndësishme e auditimit ka si qëllim të përmirësojë cilësinë dhe të rrisë efektivitetin e punës audituese. Aplikimi i saj kërkon ndryshim rrënjësor të qasjes audituese në praktikë. Deri tani aplikimi i qasjes së bazuar në risk është shtrirë mbi fazën planifikimit vjetor të KLSH. E aplikuar për herë të parë me asistencën e ekspertizës së Projektit "Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm" për hartimin e Planit Vjetor të Auditimit të KLSH për vitin 2017, kjo qasje do të shtrihet dhe zgjerohet më tej në çdo fazë të angazhimeve të auditimit.

KLSH synon të konsolidojë auditimin mbi bazë risku si qasje të përshtatshme dhe shumë të rëndësishme për të gjitha llojet e auditimit që aplikon. Kjo kërkon krijimin e një strukture të veçantë (të përherëshme ose rast pas rasti), e cila do të zhvillojë Udhëzues të veçantë për Vlerësimin e Riskut në Auditim, trajnojnë stafin për këtë çështje, sa të rëndësishme aq dhe të vështirë e komplekse, si dhe të ndjekë në vijimësi implementimin e duhur të ABR në praktikë. Qasja nga poshtë-lart e analizës

së riskut në KLSH duhet të balancohet me rritjen e strukturës lart - poshtë të analizës së riskut.

Objektivat strategjikë të aplikimit të qasjes së auditimit mbi bazë risku për KLSH-në përfshijnë:

- ✓ Analiza e riskut dhe përdorimi i regjistrimit të riskut qendror si pjesë kryesore e procesit të planifikimit vjetor, nëpërmjet hartimit të një tablele të dhënash, e cila do të dokumentojë dhe përmbledhë të dhënat dhe rezultatet e analizës së riskut;
- ✓ Mbështetja e gjyqimit profesional mbi të dhënat sasiore për procesin e përzgjedhjes së subjektit të auditimit;
- ✓ Ruajtja e koherencës ndërmjet zhvillimeve institucionale, regjistrimit qendror të riskut të KLSH-së dhe analizës së zhvilluar nga njësitë publike – subjekt i auditimit.

Sfida kryesore dhe objektivi strategjik i institucionit është hartimi i hartës së riskut në vend, i cili kërkon bashkëpunim të gjerë jo vetëm midis institucioneve, por mbi të gjitha me studiuesit e profesoratin e universiteteve dhe akademikët.

2.3 NXITJA DHE PROMOVIMI I VLERAVE TË LARTA PROFESIONALE TË AUDITUESVE NËPËRMJET KULTIVIMIT TË KULTURËS TË TË MËSUARIT GJATË GJITHË JETËS.

Kapitali human, audituesit, mbeten aset më i rëndësishëm dhe më i vlefshëm për KLSH-në duke konsideruar që sukcesi në përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave të saj varet në mënyrë të ndjeshme nga të krijuarit të një trupe auditimi kompetente dhe të mirëtrajnuar.

Nëpërmjet politikës së edukimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional KLSH synon të:

- ✓ Sigurojë që stafi auditues të zotërojë aftësitë dhe dijet e kërkuara për të realizuar me profesionalizëm çdo aspekt me të cilin mund të përballen gjatë punës audituese.
- ✓ Aplikojë sistemin e trajnimit të vazhdueshëm të hartuar në përputhje me nevojat individuale të audituesit në mënyrë që të reflektojë nga njëra anë nevojat specifike të individit për njohuri specifike gjatë gjithë jetës.
- ✓ Hartojë dhe ndjekë planin e zhvillimit profesional të gjithsecilit sipas kërkesave të sintetizuara në objektivat specifike të Programit Vjetor të Trajnimit.

- ✓ Realizojë mesatarisht i 25 ditë trajnimi ne vit për çdo punonjës së institucionit suprem të auditimit, duke matur njëkohësisht impaktin e këtij sistemi në përfomancën e punës audituese.
- ✓ Ngrehë një sistemi motivimi që do të kishte për qëllim krijimin e një lidhjeje të ngushtë ndërmjet punonjësve dhe institucionit nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit intensiv të parashikuara dhe që zhvillohen në KLSH. Për këtë qëllim implementimi i dokumentit të Politikave të Burimeve Njerëzore të KLSH-së përbën instrumentin kryesor për promovimin e vlerave profesionale të audituesve nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm, pasi bazohet në ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të vlerave.

2.4. FORCIMI I SISTEMIT TË STRUKTURUAR TË EDUKIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET CERTIFIKIMIT TË AUDITUESVE PUBLIK DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUESHËM.

Mbështetur në ISSAI 200 – “Standardet e Përgjithshme të Auditimit’ sipas të cilit “... SAI duhet të adoptojnë për të zhvilluar dhe trajnuar punonjësit e tyre për t’i aftësuar ata të kryejnë detyrën e tyre efektivisht dhe për të përcaktuar bazat për avancimin profesional të audituesve dhe të stafit tjetër...”, KLSH e konsideron trajnimin dhe zhvillimin profesional të audituesve si një standard auditimi.

Audituesit e jashtëm të sektorit publik duhet të jenë të aftë t’i përgjigjen ndryshimeve të mjedisit ekonomik, social, teknologjik dhe të ballafaqohen me standardet në rritje, jo vetëm të aktivitetit auditues, por edhe të përballen me presione politike e publike apo sfida të tjera që lidhen me vetë profesionin e auditimit. Për të mbështetur dhe ndihmuar audituesit të përballen në mënyrë efektive me këto sfida, KLSH synon të :

- ✓ Realizojë rregullime ligjore për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme dhe burimet e duhura për të përmbushur objektivin në mënyrë cilësore dhe me qëndrueshmëri afatgjatë;
- ✓ Vendosë një Sistem të Certifikimit të Audituesve Publikë, duke përmirësuar kuadrin ligjor mbështetës për këtë qëllim. Sistemi i certifikimit do të ndërtohet duke marrë në konsideratë eksperiencën e GAO-s, si dhe eksperiencat e tjera të ngjashme të vendeve të BE-së, siç është eksperiencat e SAI-t Kroat;
- ✓ Zhvillojë një Program për Certifikimin e Audituesve në formën e moduleve të strukturuar dhe duke aplikuar kurse praktike të dedikuara brenda KLSH-së si

dhe në bashkëpunim me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit apo me organizma të tjerë të profesionit.

Objektivi i referohet ndryshimit të idesë kryesore në të cilën bazohet sistemi i trajnimit në KLSH: nga metoda e ‘mbushjes së boshllëqeve’ në ofrimin e mundësive punonjësve më të mirë për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese të cilësisë së lartë.

2.5. IMPLEMENTIMI DHE MONITORIMI I VAZHDUESHËM I STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN E BURIMEVE NJERËZORË TË KLSH-SË.

Monitorimi i vazhdueshëm, vlerësimi i implementimit të Dokumentit të Politikave të Burimeve Njerëzore do të jetë një nga mjetet me të cilat KLSH do të masë efektivitetin e këtyre politikave, dhe do të mbajë të përditësuar sistemin e menaxhimit të këtyre burimeve për të siguruar që KLSH shpërndarjen dhe përdorimin me më efektivitet të këtyre burimeve.

Implementimi i plotë i kësaj politike kërkon përmbushjen e aktiviteteve të reflektuara në Planin e Veprimit dhe burimet e infrastrukturën e cila parashikon masat që do të ndërmerren në periudhën afatshkurtër dhe në atë afatgjatë.

Objektivat më të rëndësishëm të Politikës së Burimeve Njerëzore të KLSH-së përfshijnë:

- ✓ Të komunikojë vlera dhe pritshmëri në lidhje me mënyrën si funksion KLSH-ja;
- ✓ Të ruajë pajtueshmërinë ligjore të KLSH-së dhe të ofrojë mbrojtje ndaj pretendimeve në punësim;
- ✓ Të dokumentojë dhe zbatojë praktikrat më të mira të përshtatshme për KLSH-në;
- ✓ Të mbështesë trajtimin e njëtrajtshëm të personelit, drejtësisë dhe transparencës;
- ✓ Të ndihmojë drejtuesit të marrin vendime që janë të qëndrueshme, të njëtrajtshme dhe të parashikueshme;
- ✓ Të mbrojë individët dhe organizatën nga presionet për t’u përshtatur.

Objektivi për Zhvillimin Strategjik 2018-2022 kërkon që burimet njerëzore të:

- ✓ Rekrutohen, kultivohen, monitorohen dhe promovohen vetëm në përputhje me dijet e tyre dhe kontributin profesional në punën audituese;

- ✓ Trajnohen dhe testohen sipas një kalendari dhe kurrikule të planifikuar në terma vjetorë, të specializuar në përputhje me eksperiencën dhe fushën audituese, të harmonizuar me trajnimet e tjera brenda e jashtë vendit;
- ✓ Motivohen financiarisht sipas një plani të mbështetur në performancë;
- ✓ Ndryshojnë qasjen e tyre nga reaktive në proaktive;
- ✓ Shfrytëzojnë ekspertizën vendase dhe të huaj në dobi të auditimit dhe jo anasjelltas.

2.6. ZBATIMI I STANDARDEVE PROFESIONALE NËPËRMJET ZHVILLIMIT TË METODOLOGJIVE DHE STANDARDEVE TË APLIKUESHME, NË PËRPUTHJE ME PRAKTIKAT MË TË MIRA TË PROFESIONIT

Motoja e Kongresit të X-te të EUROSAT-t në Maj 2017, cilësoi “Zbatimin e ISSAI-ve: Sfidat dhe zgjidhjet për zhvillim të mëtejshëm”. Zbatimi i standardeve profesionale konsiderohet prej KLSH-së si një prej prej sfidave të vazhdueshme me të cilat përballen të gjithë SAT-t në nivel global.

Implementimi i Standardeve ISSAI është një proces dinamik dhe një prej sfidave të zhvillimit institucional të KLSH-së. Në përmbushje të këtij objekti strategjik, institucioni është angazhuar rishqyrtime dhe riformulime të metodologjive të auditimit të KLSH-së, proceseve dhe procedurave, për të siguruar përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me standardet profesionale dhe vlerat.

Në një linjë me objektivat strategjike të INTOSAI²⁸-t dhe EUROSAT²⁹-t **Vizioni i KLSH-së** për implementimin të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit konsideron se njohja, implementimi i ISSAI-ve përbëjnë një objektivi parësor në funksion të rritjes dhe forcimit të profesionalizmit performancës dhe kredibilitetit institucional.

Në përmbushje të këtij vizioni, KLSH do të vijojë me procesin e implementimit të ISSAI-ve³⁰, duke:

²⁸ INTOSAI-t për periudhën 2017-2022 përcakton si objektivi parësor zhvillimin e Standardeve Profesionale dhe konkretisht: “INTOSAI do të vijojë të promovojë Institucione të pavarura, të zhvilluara, multidisiplinore dhe do të inkurajojë mirëqeverisjen nëpërmjet: Mbështetjes për gjenerimin dhe ruajtjen e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI si dhe kontribuimin për zhvillimin dhe miratimin e standardeve profesionale efektive.

²⁹ Kongresin e X i EUROSAT-t, Maj 2017 theksohet që: “EUROSAT rekomandon përmirësimin e zbatimit të ISSAI-ve dhe nëse është e mundur reflektimin e ISSAI-ve në progresin e SAT-ve”.

³⁰ Marrëveshja me Iniciativën e Zhvillimit të INTOSAI-t (IDI), INTOSAI Development Initiative, Mars 2013.

- ✓ Avancuar me implementimin e kërkesave të niveleve 3³¹ dhe 4 të ISSAI-ve në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë audituese;
- ✓ Analizuar kuadrin rregullator ekzistues referuar mundësisë së hartimit të Standardeve të Auditimit të Jashtëm Publik (SAJP) për Kontrollin e Lartë të Shtetit. Hartimi dhe miratimi i Standardeve të KLSH-së do të mundësojë që standardet dhe normat ndërkombëtare të profesionit të kthehen në parime dhe rregulla të zbatueshme në kontekstin shqiptar të zhvillimit. Baza e këtij zhvillimi do të jenë rekomandimet e adresuara nga Kongresi i X i EUROSAT sipas të cilit: *“Duke marrë parasysh se mandatet e auditimit janë të ndryshme, EUROSAT konkludon se ISSAI-të ofrojnë një kornizë të përbashkët veçanërisht për auditimin financiar dhe rekomandon që ISSAI-të të harmonizohen me kornizat ligjore kombëtare të SAI-ve”*³²;
- ✓ Përmirësuar Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Auditimit Financiar, mbështetur në rekomandimet e vlerësimeve nga SIGMA, duke reflektuar kërkesat e Standardeve të nivelit 3, ISSAI 200 dhe 400 dhe duke i pasuruar me udhërrëfyesit specifik të fushës së auditimit sipas dhe kërkesave të ISSAI-ve të nivelit 4^{33, 34}.

Hartuar manuale specifike të detajuara për fusha dhe drejtime të caktuara për Auditimin Financiar, të Përputhshmërisë, dhe të Performancës bazuar në Udhërrëfyesit e Përgjithshëm të Auditimit të INTOSAI-t dhe për mirëqeverisjen INTOSAI GOV.

2.7. INTEGRITETI SI VLERË THEMELORE DHE ROLI I KLSH-SË NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Duke synuar jo vetëm profesionalizmin por dhe një shkallë të lartë përgjegjshmërie në kryerjen dhe cilësinë e auditimit, KLSH nëpërmjet aplikimit të INTOSAI-t nxit dhe promovon integritetin dhe sjelljen etike si pjesë të rëndësishme të

31Niveli 3, përmban parimet fundamentale të auditimit dhe japin një platformë konceptuale për Auditimin Financiar, Auditimin e Performancës dhe Auditimin e Përputhshmërisë duke siguruar dhe konsistencën me kuadrin e ISSAI-ve.

32Konkluzione dhe rekomandime. Kongresi i X i EUROSAT-t 23-25 Maj 2017. Stamboll, Turqi.

33 Niveli 4 i standardeve përfaqëson nivelin kryesor në referim të praktikës auditimit bazuar në ISSAI dhe përmban kërkesat për udhëzimin e auditimit në praktikë në trajtën e udhëzimeve operacionale që mund të përdoren gjatë veprimtarisë audituese. ISSAI (1000-4999) përfshin setin e kërkesave të rekomanduara që duhet të përmbushin audituesit gjatë kryerjes së auditimit financiar, të performancës dhe të përputhshmërisë

34 www.ISSAI.org & www.IDI.org ISSAI Implementation handbook Financial, Compliance, Performance Audit.

përgjegjshmërisë individuale dhe institucionale. Instrumenti i vetëvlerësimit të integritetit në KLSH është zhvilluar dhe do të vazhdojë të konsolidohet në zbatim të udhëzimeve dhe parimeve të INTOSAINIT si metodologji, si dhe në përputhje me kërkesat e standardit ISSAI 41 *“Instrumenti për analizën e boshllëqeve”*.

Synimet e KLSH-së për dimensionin e integritetit dhe të parandalimit të korrupsionit shkojnë përtej institucionit, duke e shtrirë atë në të gjithë organet shtetërore. Objektivi kryesor në Strategjinë e 2018-2022 do të jetë miratimi nga Kuvendi i **ligjit për “Përgjegjësinë materiale”**, i cili konsiderohet si një mjet mjaft i rëndësishëm për të luftuar *“në rrënjë”* korrupsionin i cili injektohet *“... në arteriet e funksionimit të shtetit”* nga *“Kultura e pandëshkueshmërisë” dhe mungesa e vënies përpara përgjegjësisë të nëpunësve të lartë të Shtetit, abuzues me interesin publik”*.

Arritja e këtij objektivi kërkon që KLSH të :

- ✓ Bashkëpunojë me faktorët kyç vendimmarrës në mënyrë të vazhdueshme, pasi kjo iniciativë do të sillte impakt pozitiv të dyanshëm, jo vetëm si një hap cilësor në luftën kundër korrupsionit, por do të shërbejë si një instrument mjaft konstruktiv për optimizimin e rezultateve të veprimtarisë audituese të KLSH-së, duke sjellë vlerë të shtuar në vetë institucionet që auditohen;
- ✓ Evidentojë mekanizmat konkretë të bashkëpunimit, mbi baza vjetore, rezultatet e të cilit duhet të bëhen publike dhe ti dërgohen Kuvendit në formën e një Raporti të Posaçëm apo si pjesë e Raporteve Vjetore të Veprimtarisë së çdo institucioni pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit, që KLSH ka nënshkruar me institucionet e tjera shtetërore, veçanërisht me organet e zbatimit të ligjit;
- ✓ Krijojë grupe të përbashkëta institucionale me detyra konkrete për monitorimin e evidentimin e problematikave dhe rasteve të lidhura me korrupsionin dhe keqpërdorimin e fondeve publike nëpërmjet bashkëpunimit, si dhe përgatitjen e Raportit të përbashkët për informimin e ndërsjellët për titullarët e institucioneve;
- ✓ Kryejë Auditimet e Integritetit të nëpunësve publikë, bazuar në eksperiencat më të mirat të ndërkombëtare si ajo e SAI-t Holandez dhe Hungarez, të cilat kanë zhvilluar vlerësimin e integritetit të të gjitha institucioneve publike të vendeve respektive;

- ✓ Përfshirja në programet e auditimit, kryerjen e auditimit të integritetit dhe etikës gjatë veprimtarisë audituese duke kontribuar kështu në forcimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik³⁵.

Duke marrë në konsideratë mprehtësinë e këtij problemi të evidentuar qartazi edhe nga aktivitetet audituese, KLSH do të insistojë ndërtimin e një njësie apo komiteti ndërinstucional apo kombëtar për të krijuar frontin e përbashkët të luftës ndaj korrupsionit duke marrë masat për parandalimin e tij.

2.8 FORCIMI I SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

KLSH synon të mbajë dhe të përditësojë kuadrin e ngritur ligjor e rregullator në shërbim të qeverisjes së brendshme, duke implementuar politika dhe procedura kontrolli efektive për të mbajtur një ambient kontrolli të shëndetshëm.

Në mbështetje të sistemit të kontrollit të brendshëm të krijuar dhe në përgjigje të nivelit të maturisë institucionale të arritur, KLSH do të vendosë fokusin në :

- ✓ Nxitjen e zbatimit dhe funksionimit efektiv të kuadrit të kontrollit duke theksuar njëkohësisht rolin parandalues po aq sa dhe zbulues e korrigjues të veprimtarive të kontrollit;
- ✓ Kryerjen e analizave sistematike për të identifikuar fuqitë dhe dobësitë si dhe shqyrtuar alternativat e zhvillimit;
- ✓ Rishikimet funksionale me qëllim që të identifikohen në kohë nëse ka mangësi apo dhe dublikime të funksioneve, nëse njësitë organizative (Departamente, Drejtori e Sektorë) kanë detyra të ndara dhe të përshkruara qartë, nëse procedurat dhe linjat e raportimit sigurojnë që problemet të identifikohen shpejt dhe veprimet korrigjuese janë ndërmarrë në kohë;
- ✓ Forcimin e strukturave dhe kapaciteteve që sigurojnë kryerjen dhe funksionimin e kontrolleve;
- ✓ Marrjen e veprimeve dhe masave korrigjuese në kohë dhe ndjekjen e zbatimit të tyre për të korrigjuar impaktin negativ të rasteve të shkeljeve, në mënyrë të veçantë të çështjeve lidhur me etikën dhe integritetin;

³⁵INTOSAI GOV 9100 – 9600

- ✓ Monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontrolleve dhe veprimtarive në këndvështrimin e përmirësimit të vazhdueshëm;
- ✓ Adoptimin i politikës së “whistle-blower”, si dhe përdorimin e instrumenteve efektivë për të siguruar transparencën, përgjegjshmërinë e veprimtarisë së tij.

Thelbin e objektivit për forcimin e kontrollit të brendshëm do ta përbëjë ruajtja e vlerave , integritetit dhe etikës në kryerjen e detyrave audituese nga çdo individ të çdo niveli ekzekutiv dhe drejtues në KLSH.

KLSH synon të ruajë një sistem efektiv të menaxhimit të riskut duke e integruar atë në planet dhe veprimtaritë e vjetore të punës. Menaxhimi i riskut nuk shikohet si një program i shkëputur, por duhet të bëhet përgjegjësi e çdo punonjësi në KLSH, të çdo niveli deri në hierarkinë më të lartë drejtuese. Për këtë qëllim KLSH do të:

- ✓ Përditësojë Strategjinë e Menaxhimit të Riskut nëpërmjet së cilës të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative;
- ✓ Administrojë Regjistrin e Riskut, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun risqet e identifikuar, mënyrën se si ato kanë ndryshuar gjatë periudhës, po ashtu dhe të pasqyrohen elementet e rinj të riskut të perceptuar;
- ✓ Konsolidojë strukturën e Auditimit të Brendshëm e krijuar në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të IIA-së dhe Ligjit 114/2015 “Për organizimin e auditimit të Brendshëm në sektorin publik në Shqipëri” duke siguruar në vijimësi që personeli i ngarkuar me këtë përgjegjësi të ketë mandatin e duhur, aftësitë, përvojën dhe burimet e nevojshme për realizimin e këtij funksioni;

3. QËLLIMI 3. FORCIMI I KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT

KLSH do të vijojë angazhimin për të kontribuar në zhvillimet e profesionit nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në aktivitete bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar dhe rajonal dhe në mënyrë të veçantë në pjesëmarrjen e tij në grupet e punës dhe “task forcës” të krijuar për çështje specifike.

3.1 KONSOLIDIMI I MARRËDHËNIEVE TË KLSH-SË ME PARLAMENTIN

Mbështetur në praktikat më të mira dhe konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga dokumente vlerësuese të SIGMA- s dhe Bankës Botërore/ PEFA-s, KLSH do të theksojë dhe më tej kërkesën për organizimin e dëgjësive publike dhe në mënyrë të veçantë të Komisioneve përkatëse Parlamentare me njësitë e audituara, me qëllim ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe rritjen e impaktit të raporteve të KLSH. Ndërgjegjësimi i anëtarëve të Kuvendit për vlerën që i sjell shtetit dhe shoqërisë një auditim efektiv publik dhe rolin e ndërsjellë të legjislativit në rritjen e impaktit dhe shtimin e vlerës së auditimeve të KLSH duhet të qëndrojë në themel të përpjekjeve të KLSH për të siguruar një ambient të jashtëm mbështetës dhe të dobishëm.

Aktivitet dhe objektivat e synuara të KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë konsistojnë në:

- ✓ Paraqitja dhe diskutimi i platformave potenciale të politikave të bashkëpunimit dhe komunikimit midis KLSH-së dhe Parlamentit:
 - a. Vendosja e strukturës në nivel komisioni apo nën komisioni që do të angazhohet me aktivitetin auditues të KLSH-së;
 - b. Komisionet sektoriale të trajtojnë në mënyrë specifike raportet e auditiveve të performancës;
 - c. Përcaktimi i një axhende të veçantë për paraqitjen e raporteve të KLSH-së;
 - d. Përcaktimi i personave respektivë të kontaktit si dhe autoritetin e tyre.
- ✓ Dakortësimi mbi Memorandumin e Bashkëpunimit me Parlamentin mbi procedurat e bashkëpunimit dhe finalizimi i tij:
 - a. Organizimi i takimeve të rregullta me Parlamentin, të cilat do të përgatiten nga takimet në nivelet teknike;
 - b. Përfshirja e komisioneve të tjera parlamentare;
 - c. Sigurimi që të gjitha raportet e KLSH-së zotërohen nga të gjithë anëtarët respektiv të parlamentit;
 - d. Organizimi i trajnimeve/informime mbi misionin dhe aktivitetin e KLSH-së për anëtarët e rinj të parlamentit;

- e. Organizimi i trajnimeve/informime mbi misionin dhe aktivitetin e KLSH-së për këshilltarët e komisioneve;
 - f. Organizimi i konferencave të përbashkëta, tryeza të rrumbullakëta apo workshope;
 - g. Informimi i përgjithshëm nëpërmjet doracakëve dhe buletineve përmbledhës katër mujor.
- ✓ Ngritja e procedurave standarde për një bashkëpunim efektiv por pa cenuar pavarësinë e KLSH-së
- a. Dakortësimi mbi një procedure konsultimi para se të kërkohet një auditim specifik nga Parlamenti.
 - b. Ndjekja e diskutimeve dhe e shqetësimeve relevante të anëtarëve të parlamentit për identifikimin e auditimeve potenciale në të ardhmen.
- ✓ Llogaridhënia/përgjegjshmëria dhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve duke përfshirë:
- a. Raportimi i mënyrë të veçantë mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së nga entitet publike;
 - b. Organizimi nga komisionet parlamentare përkatëse seanca dëgjimore me entet publike të audituara.
 - c. Komisionet parlamentare të kërkojnë në mënyrë specifike planin e veprimit nga qeveria apo institucione të veçanta për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.
 - d. Në rastet serioze të mos zbatimit të rekomandimeve, Parlamenti të vendosë sanksione (politike, financiare apo disiplinore).

3.2 THELLIMI DHE SHTRIRJA E BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET E TJERA

Moto e INTOSAI-t "Nga eksperiencia e përbashkët, përfitojnë të gjithë" (*Experientia mutua Omnibus prodest*) përbën thelbin mbi të cilin është hartuar dhe zhvilluar Strategjia për Zhvillim e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Bashkëpunimi me partnerët qeveritarë, në angazhime të përbashkëta dhe pse rolet janë të ndryshme, konsiderohen nga KLSH si një mjet për rritjen e efektivitetit të punës, pasi veprimtaritë e ndjekura bashkërisht sigurojnë impakt më të madh të auditimeve të tij. KLSH vlerëson se koordinimi dhe bashkëveprimi me palët e interesit dhe subjektet e audituara e bëjnë më efektiv dhe më eficient vetë

institucionin dhe për më tepër shërbimin e tij ndaj publikun dhe Kuvendin “Angazhimi me qytetarët dhe aktorët e tjerë të jashtëm mund të forcojë kapacitetet dhe efektivitetin e SAI-ve në bërjen e qeverive të përgjegjshme”³⁶

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, vendos si shtyllën e 6 të saj rolin e KLSH në mbikëqyrjen efektive të financave publike, dhe implementimi i kësaj Strategjie mbështetet në mënyrë thelbësore nga bashkëpunimi efektiv midis KLSH dhe Sistemit të KBFP, e cila theksohet dhe më tepër në përcaktimet e Kapitullit 32 të *Acquis communautaire*.

Për këtë qëllim, objektivat strategjikë në fushën e bashkëpunimit reciprok që KLSH vendos për në vitet në vijim synojnë:

- ✓ Të mbajnë dhe të forcojnë marrëdhënie profesionale efektive me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ministritë e linjës dhe institucione të tjera shtetërore nëpërmjet:
 - a. Realizimit të plotë në vitet që vijojnë i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë që mbulon kooperimin e përbashkët në fushë e auditimit publik dhe inspektimit financiar;
 - b. Mbështetjes për auditimin e brendshëm në sektorin publik, po ashtu dhe të mbështetet në punën e audituesve të brendshëm duke rritur efektivitetin e mbikëqyrjes së financave publike në përgjithësi dhe me përfitime dyanëshe në një perspektivë më të gjerë të krijimit të një kulture të përbashkët auditimi në sektorin publik;
 - c. Bashkëpunimit në fushën e standardeve të kontabilitetit publik që do të mundësojë një kuptim më të mirë të vendosjes dhe zhvillimit të këtij sistemi për të dy palët, audituesit dhe ekzekutivin;
 - d. Bashkëveprimit me strukturat qeveritare dhe organizatat profesionale në fushën e kontabilitetit publik, për të garantuar kapacitete institucionale të përshtatshme dhe të afta për të kryer auditime financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) mbi pasqyrat financiare të sektorit publik të përgatitura në përputhje IPSAS³⁷;
 - e. Shtrirjes dhe forcimin e marrëdhënieve bashkëpunuese dhe me përfitim të ndërsjellët me ministri të tjera dhe institucione shtetërore për rritjen e

³⁶ SAI dhe Praktikat e angazhimit të palëve të interesit, Raport OECD, 2014.

³⁷Qëllimi Strategjik 1, Objektivi 1.6 : Auditimi Financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

efektivitetit të proceseve audituese si dhe të zbatimit të rekomandimeve të tyre;

- f. Shkëmbimit të informacionit me njësitë e sektorit publik, për rritjen e efektivitetit të auditimit, cilësisë së të dhënave dhe shmangies së mbivendosjes së veprimtarive.
- ✓ Të bashkëpunojë me Institucionin e Prokurorisë dhe Strukturën e Inspektimit Financiar si një nga prekuizitat për të qenë i suksesshëm në luftën kundër rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit në sektorin publik dhe për të vënë para përgjegjësisë ligjore nëpunësit dhe drejtuesit që papërgjegjshmërinë në përdorimin e fondeve publike;
 - ✓ Si pjesë e Strategjisë Antikorrupsion të bashkëpunojë me strukturat përkatëse për realizimin e veprimtarive dhe arritjen e objektivave të kësaj Strategjie duke përdorur qasje shumë palëshe të agjencive shtetërore me mbështetjen e shoqërisë civile.
 - ✓ Bërjen efektive të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurive, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit Pastrimit të Parave, Autoritetit të Konkurrencës do të mundësojnë që informacioni i dyanshëm të rrjedhë midis palëve duke siguruar rritjen e efektivitetit të secilës prej tyre.

Përdorimi i instrumenteve të përshtatshëm në vendosjen e ambientit bashkëpunues me të gjitha palët dhe ruajtja e cenimit të pavarësisë së auditimit janë parashkushtet për krijimin e marrëdhënieve korrekte dhe profesionale bashkëveprimi.

3.3. Roli i KLSH në Axhendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm³⁸

Kongresi XXII i INTOSAI-t në Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe vendosi angazhimin për rritjen e kontributit të INTOSAI-t dhe SAI-ve në Axhendën e vitit

³⁸**Axhenda e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm:** Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), për të cilat u angazhuan së bashku Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në Shtator 2015, ofrojnë një "plan ambicioz dhe afatgjatë veprimesh për njerëzit, planetin dhe mirëqenien", për të gjitha kombet. Deklarata mbi OZHQ / SDG-të, "Shndërrimi i botës sonë: Axhenda e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm", vuri në dukje se "Qeveritë tona kanë përgjegjësinë kryesore në ndjekjen dhe shqyrtimin në nivel kombëtar, rajonal dhe global, të progresit të bërë për zbatimin e objektivave dhe synimeve për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme. Përmes auditimeve të tyre dhe në përputhje me mandatet dhe prioritetet e tyre, SAI-t mund të japin kontribute të vlefshme për përpjekjet kombëtare për progres, monitorim të zbatimit dhe identifikim të mundësive për përmirësim përgjatë gjithë grupit të OZHQ / SDG-ve dhe përpjekjeve të vendeve përkatëse për zhvillim të qëndrueshëm."

2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke përfshirë mirëqeverisjen në mënyrë që të forcojë luftën kundër korrupsionit.

Duke konsideruar rolin kritik që SAI-t kanë për të garantuar hartimin dhe zbatimin e strategjive kombëtare në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm si dhe integritetin, besueshmërinë, dhe krahasueshmërinë e statistikave kombëtare që i paraqiten OKB-së nga vendet e ndryshme për të vlerësuar progresin kundrejt Axhendës 2030, Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018 – 2022 është e ndërtuar e orientuar në përbushje të këtyre angazhimeve që i përkasin sferës ndërkombëtare. Kjo Strategji Zhvillimi vendos si një nga dimensionet strategjike të zhvillimit, dhënien e kontributit për ndjekjen dhe vlerësimin e përbushjes së objektivave të Axhendës 2030, nëpërmjet:

- ✓ Angazhimi në krah të anëtarëve të tjerë të INTOSAI-t për të punuar së bashku me qëllim zhvillimin e kapaciteteve të përshtatshme për kryerjen e auditimeve të performancës në lidhje me OZHQ-të;
- ✓ Vlerësimin e aftësisë së qeverisjes qendrore për të raportuar në lidhje me progresin dhe përbushjen e OZHQ-ve, si dhe auditimin e veprimtarisë së saj dhe besueshmërinë e dhënave që gjenerohen;
- ✓ Kryerjen e auditimeve të performancës në lidhje me ekonomicitetin, efektshmërinë dhe eficiencën e programeve kryesore qeveritare që kontribuojnë për OZHQ-të;
- ✓ Vlerësimin dhe mbështetjen e zbatimit të Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm Nr. 16 që lidhet me institucione transparente, eficiente dhe llogaridhënese;
- ✓ Të qënit shembull i transparencës dhe llogaridhënies gjatë veprimtarisë së tij.

INCOSAI XXII deklaroi se është thelbësore të sigurohet që referenca dhe konsiderimi i OZHQ-ve të inkorporohet në të gjitha fazat e procesit të auditimit, duke përfshirë: zgjedhjen e temave të auditimit; si dhe, duke marrë parasysh OZHQ-të si një prioritet horizontal në planet strategjike të SAI-ve.

Planifikimi i auditimeve përfundimisht duhet të rezultojë në një mbulim më të mirë të OZHQ-ve në raportet e auditimit³⁹. Këto deklarata konsiderohen nga KLSH si objektiva të rëndësishëm për t'u arritur gjatë zbatimit të Strategjisë afatmesme të Zhvillimit .

³⁹Deklarata e Kongresit të XXII, INCOSAI, Abu D'habi, Dhjetor 2016

3.4. Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i Strategjisë për Komunikim të KLSH-së

Politika e komunikimit është konsideruar jetike për rolin dhe përmbushjen e misionit të KLSH-së, po ashtu dhe dobishmëria e saj në funksion të maksimizimit të vlerës së produkteve, raporteve të auditimit si dhe zbatimit të rekomandimeve. Strategjia e zhvillimit 2018-2022 do të përmbushi kërkesat e Strategjisë së Komunikimit 2017-2019 dhe synon:

- ✓ Perceptimin e drejtë të parimeve dhe funksioneve të KLSH nga publiku dhe qytetari, nga institucionet, organizatat joqeveritare dhe media;
- ✓ Stimulimin e një debati publik rreth gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH, debat i cili çon më pas në rritjen e sensibiliteve të grupeve të ndryshme shoqërore, ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të institucionit përgjatë auditimeve të tij;
- ✓ Realizimi i komunikimit të KLSH me grupe të ndryshme shoqërore, duke vendosur në qendër qytetarin, do të sjellë rritjen e kontrollit qytetar dhe shoqëror në përdorimin e Buxhetit të Shtetit.

Objektivat strategjikë të KLSH në komunikimin me publikun dhe palët e tjera të interesit janë përcaktuar në bazë të nevojave, kërkesave dhe sfidave të institucionit dhe përfshijnë:

Objektivi Nr. 1: Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni.

Objektivi Nr. 2: Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut.

Objektivi Nr. 3: Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinionin publik rezultatet dhe dob të institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit.

Objektivi Nr. 4: Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rumbullakëta.

Objektivi Nr. 5: Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive.

Objektivi Nr. 6: Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit.

Për këtë qëllim implementimi në të gjitha dimensionet e Strategjisë së Komunikimit 2017-2019, do të përbëjë instrumentin më efikas jo vetëm për të rritur impaktin e aktivitetit auditues së KLSH-së, por edhe për forcuar partneritetin me palët e interesit duke i bërë ata aleatët më besnik të tij për të rritur presionin ndaj qeverisë për zbatimin sa më të plotë të rekomandimeve të institucionit të auditimit të jashtëm publik.

3.5. Rritja e impaktit të raportimeve nëpërmjet rritjes së përdoruesve të produkteve të KLSH-së

KLSH është e angazhuar që në mënyrë të vazhdueshme të performojë sa më mirë, të jetë bashkëveprues dhe gjithëpërfshirës për të maksimizuar vlerën që ofron, nëpërmjet zhvillimit të ekspertizës, për t'iu përgjigjur problemeve dhe sfidave që dalin dhe për të qenë e aftë të demonstrojë autoritetin e duhur për të gjeneruar impakt pozitiv për çështjet që auditohen.

Në kuptimin tradicional, marrëdhënia e KLSH me grupet e interesit është konceptuar si një rrjedhje informacioni e njëanshme: kundrejt Kuvendit, publiku, subjektet e audituara dhe grupe të tjera të interesit. Media, organizatat e shoqërisë civile dhe në veçanti qytetarët i përdorin raportet e KLSH si burim informimi të sigurt rreth performancës qeverisëse, e cila nga ana tjetër mund të përdoret si kërkesë për ndryshim në sisteme e procedura. Kjo kërkon që KLSH t'i paraprijë sfidave dhe problemeve të sektorit publik në Shqipëri në të ardhmen me qëllim që t'i integrojë ato në punën audituese duke u siguruar se rekomandimet e KLSH janë kuptuar drejt, dhe implementimi i tyre të sjellë ndryshime pozitive.

KLSH synon të rrisë influencën dhe impaktin e auditimeve të saj duke zgjeruar bazën e përdoruesve të produkteve të saj, gjetjeve, opinioneve dhe rekomandimeve të auditimeve, për t'i shërbyer qoftë përdoruesve direkt ashtu dhe indirekt, duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit për të mbërritur deri tek përdoruesi më i fundit, qytetari i thjeshtë. Ky objektivi strategjik realizohet nëpërmjet:

- ✓ Përmirësimin të qasjeve dhe cilësinë e raporteve si produkt i punës audituese, duke e konsideruar raportimin jo më si fazë përmbyllëse të auditimit, por si një pjesë të një procesi të gjerë për arritjen e ndryshimeve përfituese.
- ✓ Rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të sistemit të raportimit në formë dhe përmbajtje në mënyrë që rezultatet e auditimit të jenë të lexueshme, më të përshtatshme dhe më të aksesueshme. Këto rishikime dhe përmirësime do të synojnë që auditimet të influencojnë në mënyrën se si administrohen dhe menaxhohen vendimet e qeverisë dhe mënyrën se si shërbimet publike parashikohen dhe u ofrohen qytetarëve.
- ✓ Mundësimin e një komunikimi interaktiv me qytetarin, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit si mjet i depozitimeve të ankesave dhe ku publikohen vendimet e plota të auditimeve.
- ✓ Rritjes së profesionalizimit në trajtimin e problemeve me të cilat ballafaqohen subjektet që auditohen me qëllim të promovojë besimin e publikut.
- ✓ Ndryshimin në qasje të informacionit, duke theksuar rëndësinë e një marrëdhënie më të sofistikuar që siguron fluksin e dyanshëm të informacionit, që përfshin si konsultimin ashtu dhe bashkëpunimin.
- ✓ Modernizimin e kanaleve të komunikimit për të forcuar mesazhet kyç në qasje të çdo pale të interesit duke aplikuar metoda dhe rrugë inovative, duke theksuar rëndësinë e komunikimit efektiv midis KLSH dhe publikut në ruajtje dhe rritjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë brenda Qeverisë.

Identifikimi i perceptimit të veprimtarisë së KLSH-së nga qytetari dhe palët e tjera të interesit nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile të specializuar për të realizuar këto lloj matjesh, do të përbëjë instrumentin bazë të përmirësimit të vazhdueshëm të instrumenteve që do të rrisin impaktin dhe përdoruesit e produkteve të KLSH-së.

LEKSIONE TË HAPURA TË ZHVILLUARA ME STUDENTËT E UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

VEPRIMTARIA E AUDITIMIT TË JASHTËM NË SEKTORIN PUBLIK, KONTROLLI I LARTË I SHTETIT, KUADRI KUSHTETUES DHE LIGJOR

Nga znj. Luljeta NANO, Sekretar i Përgjithshëm

Administrimi i fondeve publike **çështje besimi**. Auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por **synon**:

- Të **zbulojë** shmangjet nga standardet e pranuar;
- Shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, eficiencës, efektivitetit, të ekonomicitetit dhe administrimit efektiv të burimeve;
- Marrjen e masave për parandalimin e gjendjes **dhe rekomandimet** për përmirësim.

Me synim arritjen e objektivave është e nevojshme që çdo shtet demokratik funksionin **e auditimit publik** mbi të gjitha institucionet e shtetit, tja **ngarkojë një institucioni tjetër të jashtëm, të veçantë**, që është Institucioni Supreme i Auditimit (SAI), i pavarura, i cili garantohet nga Kushtetuta.

Në Shqipëri, këtë funksion e kryen institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Modelet e organizimit të SAI-ve janë standardizuar në tre forma:

1. **Modeli Latin**, i njohur ndryshe si Gjykata Llogarive apo Gjykata e Kontrollit dhe me drejtim kolegjal (Greqia, Italia, Portugalia, Austria, Franca, etj.)
2. **Modeli Anglo-sakson**, që janë Institucione Supreme të Auditimit të tipit dikasterial, nën drejtimin monokratik, si Anglia, Vendet e Komonuelthit, etj.

KLSH është organizuar sipas këtij modeli.

3. **Modeli me bord drejtues**, i shfaqur në disa vende të lindjes, si Kinë, Kore, etj.

Institucionet Supreme të Auditimit aderojnë në shoqatën e tyre ndërkombetare me baza vullnetarizimi duke ruajtur pavarësinë administrative dhe funksionale (INTOSAI).

Organizatat e modelit anglosaksion janë vetëm institucione që nuk përfaqësojnë asnjë lloj pushteti dhe kanë të drejtë të auditojnë në menyrë të pakufizuar pasuritë publike.

Nuk **kanë të drejtë vendimmarrje** pas përfundimit të kontrolleve, por vetëm i **rekomandojnë subjekteve** që auditojnë masa me karakter legjislativ, administrativ, ngrejnë padi civile dhe penale përpara gjykatave administrative dhe organeve të hetimit shtetëror .

SAI-t e modeleve Latine, Gjykatat e Llogarive kryejnë **auditim parafaktit** (Auditimi paraprak konsiderohet efektiv për administrimin e mire te fondeve publike). Gjykatat e llogarive kanë nga një përfaqësues në çdo institucion qendror që administron fonde publike. Por ky model ka disavantazh se krijon sasi të madhe pune dhe **marrje përgjegjësie, si ortak** me organet ekzekutive të qeverisë dhe masat kanë karakter ekzekutiv.

Ndërsa SAI-t sipas modelit latin auditojnë **pas faktit** dhe detyra e tyre është të auditojnë ligjshmërinë rregullshmërinë financiare, pasqyrat financiare, si dhe të kryejnë auditime të performancës dhe të japin rekomandime për përmirësimin e gjendjes.

Institucionet supreme të **auditimit janë të pavarura nga qeveria**, por drejtuesit e tyre zgjidhen nga Legjislativi dhe i raportojnë Kuvendit sipas procedurave të përcaktuara në Kushtetutë dhe në Ligjet e tyre organike.



Faktorët e suksesit për sigurimin e një llogaridhenie efektive, janë:

- ✓ Sigurimi i Pavarësisë së SAI-t, duke e mandataruar atë;
- ✓ Raportimi me cilësi dhe profesionalizëm nga SAI;
- ✓ Mirëfunksionimi midis SAI dhe Parlamentit;
- ✓ Kapacitete të mjaftueshme dhe vullnet politik për shqyrtimin dhe ndjekjen e mëtejshme të raporteve të SAI-t nga Parlamenti.

Institucionet supreme të auditimit zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI-të).

Roli dhe misioni i auditimit të jashtëm (KLSH) në sektorin publik.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i Kontrollit Ekonomik e Financiar në vendin tonë, dhe i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ai përfaqëson një instrument të fuqishëm për rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe llogaridhënien në sektorin publik, si dhe ndihmon në nxitjen e administrimit dhe vendimmarrjen më të mirë, me impakt përdorimin efektiv të parave të taksapaguesve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përcaktuar Misionin dhe Vizionin e Zhvillimit Institucional.

Misioni: KLSH është institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që ti shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Vizioni: KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të pasurisë publike, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve.

Misioni dhe vizioni bazohen në parimet e KLSH, të cilat mbështeten në Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit (SNA), në parimet e ISSAI 12, “Vlera dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit - Një ndryshim në jetën e qytetarëve” që janë:

- *Pavarësia*
- *Profesionalizmi*
- *Bashkëpunimi*
- *Përgjegjshmëria*
- *Integriteti*
- *Objektiviteti*
- *Interesi Publik*
- *Transparenca*

Mesazhet e përcjella nga Kongreset të XXI dhe XXII të INCOSAI-t: “Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes së Mirë Kombëtare”⁴⁰, “Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-et) në shërbim të qytetarëve” dhe “Të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri”⁴¹, **përbëjnë thelbin e objektivave të zhvillimit të KLSH-së në nivel institucional.**

KLSH gjithashtu ka për mision të sigurojë Kuvendin dhe taksapaguesit nëse burimet e sektorit publik janë përdorur në mënyrë të ligjshme dhe efektive.

Institucioni i KLSH e ushtron veprimtarinë në përputhje me rekomandimet mbi funksionimin e Institucioneve Supreme të Auditimit në Kuadrin e Integritetit Europian.

Baza ligjore, organizimi, funksionet dhe pavarësia

KLSH ka një bazë ligjore të plotë të qëndrueshme dhe të zbatueshme, që parashikohet në Kushtetutë, në Ligjin Organik 154/2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e KLSH-se” dhe të plotësuar me udhëzime rregulla dhe procedura të miratuara nga Kryetari.

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon:

- a) Autoritetin dhe funksionin e KLSH-së;
- b) Objektivitetin e veprimtarisë;
- c) Mënyrën e raportimit;
- d) Marrëdhëniet me Kuvendin;
- e) Marrëdhënien e KLSH-së me Qeverinë;

⁴⁰Deklarata e Kongresit të XXI të INCOSAI-t, Pekin, Tetor 2013, “40 – Vjet Deklarata e Limës(1977 – 2017)”, Seria Botime KLSH- 16 2017/83, fq 219.

⁴¹ Kongresi XXII, INCOSAI-t , Abu Dhabi, Dhjetor 2016, “40 – Vjet Deklarata e Limës (1977 – 2017)”, Seria Botime KLSH- 16 2017/83, fq. 237.

f) Zgjedhjen dhe statusin e Kryetarit të KLSH-së.

Në përmbajtje kuadri kushtetues plotëson këto kërkesa bazë:

- *Autoritetin dhe funksionin* e KLSH-së, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Shqipërisë, i cili në veprimtarinë e tij i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.
- *Mënyrën e zgjedhjes së Kryetarit të KLSH-së*, i cili zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës dhe qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
- *Objektin e veprimtarisë* audituese, i cili ka në themel veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridik shtetërore; përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor; veprimtarinë ekonomike të personave juridik, në të cilët shteti ka më shumë së gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tjera garantohen nga shteti
- *Mënyrën e raportimit dhe marrëdhëniet me Kuvendin*, sipas të cilës Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe mendimin e tij për raportin e Këshillit të Ministrave, për shpenzimet e vitit të kaluar financiar, para se ky të miratohet nga Kuvendi. Kuvendit i dërgohen edhe informacione për rezultatet e kontrolleve sa herë që kërkohen nga Kuvendi. Gjithashtu, Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij.
- *Marrëdhëniet me Qeverinë* gjejnë shprehje në të drejtën që i jepet Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shqyrtohen çështje që lidhen me funksionet e tij .
- *Mbrojtja ligjore e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit* garantohet nga Kushtetuta, imuniteti i të cilit barazohet me imunitetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

2. Ligji Organik i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Objektivat, detyrat organizimi dhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit trajtohen në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Në përmbajtje, ky ligj krahas përcaktimeve kushtetuese sanksionon gjithashtu, *Postulatin bazë të Kontrollit të Lartë të Shtetit*

si: Institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Shqipërisë, i cili në ushtrimin e kompetencave të tij i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Statusi, Autoriteti, Marrëdhënia me Kuvendin, Mënyra e Raportimit Mandati, të drejtat gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Marrëdhënia me Qeverinë, Marrëdhënia me Institucionet Homologe, Aksesit në dokumentet zyrtare janë trajtuar në Ligjin Organik të KLSH-së.

Mandati Kontrollit të Lartë të Shtetit përfshin të gjitha njësitë e qeverisjes shtetërore, lidhur me:

- Zbatimin e buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, llogaritë dhe pasqyrat financiare vjetore dhe dhënien e opinionit për to;
- Mbledhjen e të ardhurave publike;
- Përdorimin, administrimin dhe mbrojtjen e fondeve dhe pronës publike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
- Përdorimin e fondeve të ofruara nga Bashkimi Evropian ose organizata të tjera ndërkombëtare (me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe me ligj të veçantë);
- Përdorimin, administrimin e fondeve dhe pronës publike dhe mbrojtjen e interesave ekonomike dhe financiare të Shtetit për personat juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e aksioneve ose kur huatë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti;
- Mbrojtjen e interesave publikë, në veprimtaritë apo sektorët e rregulluar me kontrata koncesionare;
- Sistemet e auditimit të brendshëm të sektorit publik;
- Partitë politike apo shoqatat për fondet që u janë akorduar nga Buxheti i Shtetit;
- Subjekte të tjera të përcaktuara në ligje të veçanta.

Të drejtat gjatë ushtrimit të veprimtarisë

KLSH, në bazë të nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ka të drejtë:

- të informojë drejtuesit e njësive të audituara apo institucioneve më të larta për shkeljet e akteve normative, me pasojë dëme materiale dhe t'u rekomandojë atyre korrigjimin, rregullimin, ndryshimin e akteve ligjore;

- të informojë drejtuesit e njësive të audituara apo organet e kompetencës mbi parregullsitë dhe dëmet financiare gjatë administrimit të fondeve publike dhe t'u rekomandojë atyre që çdo shumë e përdorur në shkelje të ligjeve apo akteve nënligjore të kompensohet dhe të dëmshpërblehet në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji;
- t'u rekomandojë drejtuesve të njësive të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative;
- t'u përcjellë organeve të posaçme të shqyrtimit administrativ, sipas fushave përkatëse të kompetencës, gjetjet mbi shkeljet që janë objekt shqyrtimi, së bashku me dokumentet përkatëse të auditimit;
- t'i sigurohen nga subjektet e audituara kushtet, vendi i punës dhe mjetet e nevojshme logjistike për kryerjen e veprimtarisë audituese në rastet kur misionet e auditimit zhvillohen në mjediset e tyre;
- të pyesë dhe të marrë përgjigje, me shkrim ose me gojë, nga subjektet e audituara ose punonjësit e tyre, brenda 1 jave nga data e paraqitjes së një kërkesë paraprake;
- në përputhje me nenin 26 të ligjit organik, t'u kërkojë subjekteve të audituara që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej tij;
- në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, t'u kërkojë personave juridikë, ku shteti disponon me shumë se 50 për qind të aksioneve ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti, të cilët posedojnë dokumente shkresore apo elektronike që konsiderohen të nevojshme për kryerjen e procesit të auditimit, që t'i paraqesin ato, sipas kërkesës, tek audituesit përgjegjës;
- t'u kërkojë autoriteteve publike, të cilat kanë kompetenca në fushën e kontrollit financiar, kontrollit fiskal, si dhe kontrollit apo mbikëqyrjes në fusha të tjera, që t'i japin përparësi dhënies nga ana e tyre të ndihmës në kryerjen e proceseve të auditimeve të veçanta të ndërmarrja nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili në këto raste u drejtohet atyre me një kërkesë të veçantë.
- të kërkojë nga Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë t'i vihen në dispozicion, brenda një afati të arsyeshëm, të dhënat në lidhje me llogaritë e

institucioneve të qeverisjes qendrore, organeve të pushtetit vendor, institucioneve të tjera qendrore dhe vendore, që kryejnë funksione publike, institucioneve të pavarura, si dhe të shoqërive tregtare apo të çdo forme tjetër organizimi shoqërisht, përfshirë ato financiare, ku kapitali shtetëror është mbi 50% për qind ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantojnë nga shteti;

- t'u drejtohet organeve të ndjekjes penale në rastet kur ndjekja e mëtejshme e zbulimeve nga auditimi është kompetencë e tyre;
- t'i drejtohet gjykatës me padi;
- t'i propozojë inspektimit financiar dhe njërive të auditimit të brendshëm publik të kryejnë inspektime dhe auditime brenda kompetencave të tyre;
- të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës si dhe pas 6 muajve të kërkojë dhe/ose verifikojë zbatimin e tyre;
- t'u drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës në rast të moszbatimeve të rekomandimeve të dhëna nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- t'i propozojë Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat ose ndonjë komisioni tjetër përkatës të Kuvendit që të marrin në shqyrtim raporte të veçanta të auditimit.

Autoritetet shtetërore detyrohen të venë në dispozicion të KLSH të gjitha dokumentet që kërkohen, përfshirë edhe ato sekrete, të cilat administrohen me rregulla të veçanta, duke respektuar dispozitat përkatëse ligjore. Kontrolli i Lartë i Shtetit është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacioneve të siguruar për shkak të detyrës, të cilat mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Marrëdhënia me Qeverinë

Marrëdhënia me Qeverinë gjen shprehje në të drejtën që i jepet Kryetarit të KLSH, i cili mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shqyrtohen çështje që lidhen me funksionet e tij dhe veprimtarinë e KLSH-së.

Për çështje që kanë të bëjnë me hartimin e një projektligji që lidhet me funksionin, veprimtarinë, detyrat dhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit, organet shtetërore konsultohen paraprakisht me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit jep opinionet e tij, si dhe bën propozime për sa i përket përmirësimit të legjislacionit në fushat brenda kompetencave të tij.

Krahas raporteve që u dërgohen ministrave/titullarëve të institucioneve qendrore për rezultatet e auditimeve të ushtruara për ministritë/institucionet që ata drejtojnë, atyre mund t'u dërgohen edhe raportet e auditimeve të ushtruara në njësitë e varësisë nën juridiksionin e këtyre ministrive/institucioneve.

Nëpërmjet buletineve të auditimeve të botuara në mënyrë periodike, KLSH e njeh në vijimësi Qeverinë me veprimtarinë audituese, gjetjet e auditimeve, zbulimet dhe shkeljet e konstatuara, rekomandimet e dhëna si dhe nivelin e zbatimit të këtyre rekomandimeve nga subjektet publike të audituara.

KLSH komunikon dhe u drejtohet organeve ekzekutive edhe për probleme që çmohen të kenë rëndësi të veçantë dhe vlerë për zhvillimet ekonomiko-financiare, sociale, kulturore etj të vendit.

Bashkëpunimi me organet e prokurorisë

Kontrolli i Lartë i Shtetit si një nga institucionet publike që luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, bashkëpunon me Prokurorinë e Shtetit, veçanërisht në luftën kundër mashtrimit financiar. Ky bashkëpunim sanksionohet në marrëveshje dypalëshe ku përcaktohen përgjegjësitë dhe të drejtat e palëve lidhur me realizimin dhe ndjekjen e procedurave për rastet e kallëzimeve për vepra penale të shpërdorimit të detyrës nga nëpunës publikë apo të tjera sipas përcaktimeve të Kodit Penal të identifikuar gjatë kryerjes së auditimeve nga KLSH. Bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit shtrihet dhe në fushën e shkëmbimit të informacionit, mbi ndjekjen dhe gjendjen e ecurisë së çështjeve dhe procedimeve penale me qëllim rritjen e efektivitetit të luftës kundër korrupsionit në të gjitha nivelet e administratës publike.

Marrëdhënia me institucionet homologe dhe organizatat ndërkombëtare të auditimit

Në marrëdhëniet me institucionet homologe të auditimit dhe organizatat ndërkombëtare të auditimit, KLSH udhëhiqet nga motoja "Experientia mutua omnibus prodest". KLSH bashkëpunon dhe bashkëvepron me institucionet homologe të auditimit jashtë vendit dhe me organizatat profesionale

ndërkombëtare dhe rajonale në mënyrat e parashikuara në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI) dhe praktikat e mira të bashkëpunimit. KLSH aderon dhe është anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Organizatën Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI); KLSH merr pjesë në Konferenca e Kongrese si dhe kontribuon aktivisht në Grupet e Punës, Task Force dhe Komitete që funksionojnë pranë EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, e në trajnimet dhe auditimet e drejtuara nga këto organizata dhe organizata të tjera ndërkombëtare profesionale si dhe institucione homologe të auditimit.

Akresi në dokumentet zyrtare dhe kufizimet

Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 26 të Ligjit nr.154/2014, ka të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të dhënave, si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të, parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore. Të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara t'i sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm. Në rast të hasjes së pengesave, veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me të drejtat e mësipërme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i drejtohet, sipas rastit, organit më të lartë administrativ ose organeve të pushtetit gjyqësor. Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk mund t'u kërkojë dokumente apo informacione dhe as të shkojë fizikisht te subjekte, të cilat nuk janë subjekte të audituara në kuptim të neneve 3 dhe 10 të përcaktuara në ligjin organik. Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk mund të ndërhyjë në vetë deklarin e subjekteve tatimore, por jep rekomandime për sa i përket vlerësimit dhe rivlerësimit të tyre.

Ruajtja e konfidencialitetit dhe e sekretit shtetëror

KLSH ruan konfidencialitetin, kur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, përballet me dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike dhe çdo informacion tjetër që përbën sekret shtetëror, sipas përcaktimeve të legjislacionit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror. Në këto raste KLSH vë në dijeni autoritetet e interesuara kompetente. Kontrolli i Lartë i Shtetit është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacioneve të siguruara për shkak të detyrës, të cilat mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Paraqitja e raporteve të auditimit, botimet dhe transparenca

KLSH ia paraqet raportet përkatëse të auditimit subjektit të audituar dhe sipas rastit, autoriteteve që përgjigjen ligjërisht për të, duke përfshirë edhe rastet kur ato i paraqiten Kuvendit. Kryetari vendos nëse është e nevojshme t'i paraqiten këto raporte edhe Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, kryetarëve të grupeve parlamentare apo Ministrit të Financave. KLSH i paraqet Këshillit të Ministrave, autoriteteve të tjera shtetërore, organizatave jofitimprurëse (me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi), publikut dhe palëve të tjera të interesuara, kur ai e gjykon të nevojshme dhe në interes të shtetit dhe të publikut, raporte auditimi, studime, materiale apo raporte të tjera auditimi që kanë të bëjnë me Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucione të tjera qendrore. . Në funksion të detyrave të tij informuese dhe qëllimit për shkëmbimin e përvojës, KLSH boton rregullisht një buletin, i cili përmban:

- a) raportet përfundimtare të auditimit;
- b) konkluzionet dhe rekomandimet e auditimeve me rëndësi të veçantë;
- c) llogaritë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke përfshirë edhe opinionin e audituesve për to.

KLSH në varësi të qëllimit dhe detyrave të mësipërme, si dhe në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, universitare dhe të shoqërisë civile, mund të angazhohet në organizimin e analizave të hapura vjetore të punës, konferencave shkencore në fushën e auditimit publik dhe menaxhimit financiar. KLSH angazhohet në botimin e revistave shkencore dhe profesionale, përkthime, botime, shpërndarje të publikimeve të organizatave ndërkombëtare të auditimit (të jashtëm), të institucioneve të tjera homologe që konsiderohen me interes.

KLSH në respekt të detyrimit të tij ligjor për informimin e publikut, siguron natyrën publike të punës së tij nëpërmjet: a) publikimit të raporteve të paraqitura nga KLSH në Kuvendin e Shqipërisë; b) publikimit të raporteve të auditimit në mënyrë elektronike; c) serisë së botimeve të KLSH-së; ç) konferencave për shtyp dhe metodave të tjera të informimit në media; d) publikimit të njoftimeve për shtyp dhe çdo informacioni tjetër që përcaktohet nga Kryetari i KLSH-së; me përjashtim të informacioneve dhe materialeve, të cilat sipas dispozitave ligjore përkatëse, përbëjnë sekret shtetëror, tregtar apo konsiderohen si konfidenciale.

AUDITIMI KOMBËTAR DHE RESPEKTIMI I TIJ NË KUADËR TË STANDARDIZIMIT TË NJË KONCEPTI EUROPIAN MIRËQEVERISJEJE DHE TË MIRADMINISTRIMIT TË ASETVE NË INTERES TË PUBLIKUT

Nga z. Bajram LAMAJ, Drejtor Departamenti

Auditimi kombëtar në shërbim të mirëqeverisjes kombëtare na bën të vetëdijshëm se, proceset audituese priren të sigurojnë përjasje e përputhshmëri tërësore me standardet ndërkombëtare, kjo vetëm duhet të ndikojë pozitivisht në përforcimin e bindjes se veprimtaria audituese është e standardizuar, por njëkohësisht i paraprin edhe detyrimeve të vendit tonë për integrimin Europian.

Pikërisht për të qënë në lartësinë e standardeve më të mira të një shteti ligjor ku interesi publik është prevalent ndër parimet e së drejtës, e me qëllim përmbushjen me sukses të sfidave në të ardhmen, realiteti po tregon çdo ditë domosdoshmërinë e shtuar për prezencë të KLSH me auditimet e saj të pakushtëzuara, të pacunguara dhe aksesplota, duke ***shmangur çdo keqkuptim apo keqinterpretim që mund të ndodhë në praktikë në lidhje me të drejtën e KLSH-së për të audituar administrimin e pronës publike apo shtetërore dhe asetëve***, pra nga ku shteti synon të përfitojë të ardhura të cilat kanë destinacion rritjen e të mirave publike.

Gjithashtu të gjithë ne e dimë se prona publike jo vetëm nuk mund të tjetërsohet, por duhet të mbrohet, të përmirësohet, t'i shërbejë publikut dhe nuk mund t'i ndryshohet destinacioni në emër të interesit privat. Lind pyetja. Po si përkon të jetë realiteti?

Një nga shembujt që mund t'i referohemi për vet impaktin negativ në drejtim të pronës publike është dëmtimi urban i saj, ALUIZNI; një tjetër shembull është ai i keqadministrimit nga segmentet shtetërore të autorizuar, si p.sh. Drejtoritë e shërbimit pyjor, Drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës, ZVRPP, njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat në kuadër të një menaxhimi jo të mirë tjetërsojnë statusin e saj, zërin kadastral, shkallën e mbrojtjes dhe në fund destinacionin dhe regjimin juridik. Kjo është shumë e rrezikshme dhe me pasoja të rënda në ekonominë e vendit dhe interesin publik, impaktin negativ të së cilës do ta mbartin edhe brezat.

Edhe po të priremi të bëjmë një analizë shkencore ligjore referuar jurisprudencës e doktrinës të vet aseteve, **vullneti për t'i konsideruar shtyllë klasike të auditimit tonë vetëm do të rritej e përforcohej.**

*Termi **Aset**, bazuar në origjinën e tij anglo-franceze asset (lexo: aset) ka kuptimin e pronës ose tiparit të dobishëm, ndërsa në fjalorin ekonomik merr kuptimin e mjetit.*

*Gjithashtu **Aset** (kapital) do të thotë çdo send me vlerë, qoftë ai i prekshëm ose i paprekshëm, dhe që përfshin :**Pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, pronën e paprekshme dhe intelektuale, paratë, letrat me vlerë, koncesione ose licensa kërkesat ose të drejtën në para, fitimin e akumuluar, mallra, shërbime dhe përmbushjen e kontratës.***

E gjithë kjo e sa sipër si iniciativë këmbëngulëse sigurisht që përligjet nga vet pozitat kushtetuese që ka KLSH-it, për të garantuar përputhshmëri, ligjshmëri, rregullshmëri, mirmenaxhim financiar dhe ekonomicitet, efektivitet si dhe efikasitet në administrim të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, por nevojitet që e gjithë kjo të ketë suport të gjithanshëm administrativo ligjor. Pra, të ketë bashkëpunim dhe sens pozitiv ndaj çdo zbulimi e rekomandimi duke i vlerësuar në mënyrë moderne, të hapur, largpamëse e pakomplekse të drejtat dhe detyrat e KLSH.

Në mbështetjen edhe të normave ndërkombëtare do të citonim **ISSAI 200 "Pavarësia"** i cili shpreh qartë se, **KLSH mund të ketë marrëdhënie bashkëpunimi me qëllim që tu tregojmë subjekteve që auditojmë se cili është funksioni ynë, citoj: "SAI (KLSH) duhet të mbetet i pavarur nga njësitë publike të audituara. Megjithatë (KLSH) duhet të kërkojë, të mësojë njësitë publike të audituara për kuptimin e rolit dhe funksionit të tij, me qëllim ruajtjen e marrëdhënieve miqësore me to. Marrëdhëniet e mira e ndihmojnë SAI (KLSH) për të marrë informacione të lira e të singerta dhe për të zhvilluar diskutime në një atmosferë respekti dhe mirëkuptimi reciprok..."**

Pra, përveç sa më sipër, r të gjithë duhet të kuptojnë se në funksion të auditimit të jashtëm ku çdo rekomandim i shërben vetëm përmirësimit dhe rregullimit vijues, nevojitet që çdo përfitues të respektojë pozitivisht atë ç'ka synohet përmes akteve tona, pasi në të kundërt efekti për të qenë përmbushës të një misioni fisnik do të humbiste sens.

Një nga subjektet, ku mund të konkretizojmë më mirë veprimtarinë, kontributin tonë në denoncim të paligjshmërive, abuzimeve dhe parregullsive dhe kontributin tonë në përmbushje të qëllimit e mirë për rritje të eficiencës në mirëqeverisje dhe

ndikim të mirë në respektim të interesit publik, janë njësitë e qeverisjes vendore. Këto njësi duhet të instalojnë një sistem efikas të menaxhimit financiar e kontrollit të brendshëm, (veçanërisht për Asetet), pasi sipas vlerësimeve tona nga auditimet e kryera, ka rënë ndjeshëm përgjegjësia menaxheriale në drejtim të administrimit të pronës publike dhe është kërkesë imediate që të rikthehet kujdesi i duhur e të krijohet një mjedis i besueshëm për komunitetin se këto pasuri sjellin të mira publike dhe për të realizuar misionin, qëllimin dhe objektivat, si në mbrojtjen e pronave, por dhe zbulimin e gabimeve dhe mashtrimeve apo veprime të tjera korruptive me këto prona.

Përgjegjshmëria menaxheriale është themeli mbi të cilin ngrihet dhe funksionon efektivisht sistemi i kontrollit të brendshëm në njësitë publike qofshin qendrore, lokale apo niveleve të tjera.

Mbështetur në konstatimet e bëra nga KLSH në auditimet e kryera në disa bashki gjatë vitit 2016-2017, rezultatet e pritura nuk janë arritur, por përkundrazi në ato njësi të vetëqeverisjes vendore ku titullarët e tyre u ka munguar vizioni dhe përgjegjësia ligjore në ushtrimin e kompetencave, janë kthyer në “pronarë” të këtyre aseteve/pronave.

Në kuadrin e decentralizimit nga qeveria, janë transferuar të gjitha pronat dhe asetet e qëndrueshme që kanë në territoret e bashkive dhe komunave, trajtimi i këtyre resurseve jo në mënyre ligjore dhe si një burim i rritjes së të ardhurave të bashkisë/komunës dhe mos administrimi i tyre sipas akteve ligjore në fuqi, na ka vënë përpara fakteve tepër shqetësuese, ku asetet janë “përvetësuar” nga persona që nuk kanë plotësuar kriteret për tjetërsim dhe posedim, pra duke arritur nga disa drejtues/administrator vendor që të veprohet në kapërcim të kompetencave e tagrave të autorizuar nga ligji, duke i transferuar ato në administrim të personave fizik të cilët i kanë kthyer në objekte përfitimi, duke kryer madje veprime haptazi të kundraligjshme për transferimin tek të tretët, pa patur kompetencë ligjore për administrim e për më tej për tjetërsim pronësie.

Për ti paraprirë e sensibilizuar të gjithë administratorët e personat përgjegjës për administrim të këtyre pronave, KLSH, ka kryer trajnim me audituesit e tij, duke evidentuar auditimet cilësore brenda KLSH, por dhe duke bashkëpunuar me Ministrinë e Turizmit e Mjedisit, duke thirrur si lektorë specialistë të fushave përkatëse për asetet (pyje, kullota, pasuri të tjera natyrore dhe vepra ujore, etj.) dhe ekspert të jashtëm, gjë e cila ka ndihmuar audituesit në rritjen e aftësive

profesionale të auditimit në këtë fushë. kjo nisur dhe nga motoja që KLSH udhëhiqet “Përvoja e mirë u shërben të gjithëve”.

Nga auditimet e KLSH, janë konstatuar shumë shkelje ligjore dhe ka evidentuar përgjegjësi ligjore individuale nominative, duke kallëzuar edhe penalisht personat përgjegjës e duke informuar mbarë publikun për shkeljet e shkelësit. Sigurisht që në përmbushje të misionit tonë kemi rekomanduar masa të spikatura për përmirësimin e gjendjes për vlerësimin e aseteve dhe pasqyrimin me saktësi të vlerave reale të tyre duke bërë dhe sistemimin në kontabilitet, dhe jo mbetjen e tyre në dokumente extra jashtë bilancit. Siç e dimë prona vlerësohet sipas tregut dhe kjo ndjesi për rritje vlere të çdo aseti në administrim, duhet të jetë detyrë për çdo person që ligji e ka ngarkuar me këtë detyrë.

Kjo, në dukje por, deficencat në këto subjekte vijnë që në thelb. Ato administrojnë asetet pa ditur se ç’vlerë kontabël paraqesin, cila është pritshmëria për rritje të kësaj vlere apo paksim të saj, cili është inventari real de facto dhe ç’raport ka ai me atë de jure, e më pas nga kjo të dalin konkluzione për plan veprime të mundshme e marrje masash. Kjo vjen nga mungesa e seriozitetit dhe papërgjegjshmëria për të respektuar siç duhet interesin publik dhe përmbushjen e detyrës si administrator në funksion të zgjedhësve e komunitetit.

Në këtë pikëpamje Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Bashkitë) në kuadrin e decentralizimit dhe autonomisë, kanë të drejtë që pas fuqizimit të tyre, të hyjnë në marrëveshje me bankat e nivelit të dytë për marrje kredi apo investime të përbashkëta, por siç dihet Bankat nuk pranojnë të kryejnë marrëdhënie me njësi vendore, kur nuk ekziston një bilanc i konsoliduar i saktë, e që i përputhet tregut.

Po cilat janë konstatimet si shkelje flagrante në këtë drejtim dhe çfarë ka rekomanduar KLSH për këto probleme?

1. Në shumë Njësi të Vetëqeverisjes Vendore, ka munguar inventarizimi, administrimi, menaxhimi dhe vënia në eficiencë e aseteve që u janë transferuar nga Qeveria, pra nuk është kryer inventarizimi ligjor e fizik lidhur si me gjendjen fizike, funksionale dhe administrimin, për shkak të mos përmbushjes së procedurave të transferimit të titujve të pronësisë e përdorimit sipas urdhërimeve të VKM, duke krijuar hapësira për tjetërsime flagrante të pasurive shtetërore e publike në kapërcim të kompetencave ligjore, apo duke kaluar deri në tjetërsim të zërave kadastralë me qëllim ndryshimin e statusit dhe krijimin e mundësive subjektive për përfitime nga tjetërsime të mundshme. Në këto raste KLSH, ka propozuar jo vetëm

ndjekjen penale nga organi i autorizuar, por edhe rekomandime që shkojnë deri në përmirësime të akteve që kanë të bëjnë me këtë pjesë.

2. Në këto njësi, nuk janë krijuar regjistrat e Aseteve ose “database”, të cilat janë një mënyrë e dokumentimit të tyre, ku duhet të evidentohen të gjithë treguesit e nevojshëm të tyre dhe pastaj mbi to mund të kryhen studime apo vlerësime për vënien në eficiencë sipas statusit juridik që kanë dhe hapësirat që lejon ligji për të vepruar mbi këto prona. Nga KLSH në këto raste, është rekomanduar të kryhet inventarizimi fizik dhe të përfshihen në inventarin kontabël dhe librin e AQT-ve, me vlerën që kanë ose që mund të vlerësohen sipas rregullave të caktuara, por zbatimi i këtij rekomandimi nuk është kryer plotësisht, megjithëse ai ndikon dukshëm në përmirësimin e punës tyre dhe shmangien e rrjedhjes së pronave “pa zot”. Ato duhet të evidentojnë e raportojnë gjendjen aktuale fizike dhe të vënë në eficiencë pronat e paluajtshme (Asetet) asetet e llojit ndërtesa, trojet dhe veprat ujore me aksesorët përkatës, këto në rakordim me listën e transferuar nga Këshilli i Ministrave me vendim të veçantë për çdo bashki/komunë. Këto kërkesa duhet të bëhen në përmbushje të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (MFK), pjesa e **“Përgjegjësisë menaxheriale e nënpunësve zbatues”**, pika 2, Germa “ë, e, f”, ku citohet: *“...mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit...ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar...”*. Përgjegjshmëria e dokumentimit dhe ruajtjes së aktiveve rrjedh dhe si detyrim i zbatimit të kërkesave të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr.10110, datë 02.04.2009, neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, ku citohet: *“Njësitë ekonomike ...duhet të kontrollojnë , të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe evidencës së tyre mbështetëse..”*

3. Në NJVQV, funksionojnë Zyrat e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokave (ZAMT), por në shumë raste kanë funksionuar jo në përputhje me detyrimet ligjore gjë që ka sjellë që këto zyra të kryejnë deri veprime abuzive në ndryshimin e zërave kadastral dhe transformimin e gjendjeve kadastrale. Si rrjedhojë duke shkuar edhe më tej duke plotësuar evidenca formale për gjendjen në natyrë dhe atë juridike të pronave në administrim të NJVQV.

4. Një tjetër evidencë negative del në administrimin e pyjeve dhe sipërfaqeve pyjore e kullimore në posedim apo në pronësi të NJVQV, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 106, datë 3.2.2008, ku planet e menaxhimit nuk

përfshihen në buxhet me treguesit e tij, si tek të ardhurat dhe tek shpenzimet, të cilat do të mundësonin dhe ndjekjen e kryerjes së këtyre shpenzimeve dhe analizën e të ardhurave që krijohen. Për këto, jo vetëm mungon inventarizimi fizik, kadastral por nuk ka asnjë përditësim të gjendjes së tyre për ndryshimet që ndodhin, pra nuk ka administrim dhe nuk zbatohet VKM nr. 22, datë 9.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të Administrimit të Pyllit Komunal”. Evidentimi i dëmeve është tejet jo profesional dhe shoqëruar me gjokat që vihen, për të cilat nuk ndiqen procedurat administrative dhe ligjore për ekzekutimin e tyre por mbeten të pa ekzekutuara si të kishin qëllim formal në aplikimin e tyre.

Jo vetëm kaq por ajo që është më e papranueshme e në këndvështrimin ligjor është përfitimi pa shkak i të ardhurave në konceptin bashkiak. Pyjet mund të kenë qenë në administrim e përdorim komunal (kullotje bagëtie apo përfitim nga të mirat e pyjeve e kullotave) që në vitin 1923 bazuar në ligjin për pyjet e kullosat, por kjo e drejtë nuk mund të trashëgohet a-priori pa titull pronësie të deklaruar ligjërisht nga organet aktuale të autorizuar nga ligji. Kjo e drejtë si masë përfitimi nuk mund të jetë absolutisht tagër subjektiv dhe as i autorizuar nga një pushtetari vendor, pasi në rastin më të paktë do të përkonte me shpërdorim detyre haptazi. Ky risk ndodh sidomos në zonat verilindore të vendit.

5. Në administrimin e aseteve, në shumë raste kemi abuzime dhe nuk janë zbatuar kërkesat ligjore “Për tokat bujqësore të pandara”, dhe ato nënligjore “Për procedurat e dhënies me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore dhe tokave bujqësore të pandara”. Nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit është nxjerre një Urdhër në vitin 2012 “Për ri inventarizimin e tokave bujqësore të pandara dhe të refuzuara të ish kooperativave bujqësore”, por aktualisht këto sipërfaqe janë kthyer në objekte abuzimi nga drejtuesit vendor, pasi jo vetëm nuk zbatohen procedurat e caktuara, por mbi to veprohet sikur të ishin “pronarë”, duke i dhënë me qira nga 35 deri 99 vjet me një copë letër për një shumë qesharake parash dhe njëkohësisht duke shkelur rëndë edhe vet dispozitat e Kodit Civil.

6. Po kështu dhe në administrimin e aseteve, në qendrat e urbanizuara dhe jashtë tyre, për asetet e llojit troje apo objekte, është konstatuar se mungon dokumentacioni inventarial, si për ndërtesat, objektet kulturore e sportive, por në shumë raste është lejuar përdorimi i paligjshëm e shfrytëzimi i tyre për ndërtime shtëpi e objekte shërbimi (lokale), dhe trualli është përdorur dhe për kultivime bujqësore pa ndërtuar më parë marrëdhënie ligjore (pronësie a qiraje), duke sjellë si pasojë përfitime të paligjshme nga persona të paautorizuar ligjërisht.

7. Janë evidentuar probleme e shkelje dhe në administrimin dhe vënien në efikasitet të aseteve të llojit vepra ujore, me aksesoret përkatës, pasi për to nuk ka akt marrje në dorëzim të rezervuarve me aksesoret përkatës, sisteme ujitëse, stacione pompimi, skema ujitëse e trojet e tyre, të dhënat teknike të skemave ujitëse, dhe nuk ka asnjë përcaktim të gjendjes aktuale teknike, pasi ato nuk janë përfshirë në kontabilitet në inventarin e AQT-ve dhe nuk janë vënë në efikasitet objektive ligjore.

8. Nga NJVQV ka paaftësi të drejtuesve vendorë në lidhje me arkëtimin dhe përdorimin e taksës së tokës bujqësore? Megjithatë NJVQV ngarkohen nga ligji që të konfirmojnë në rrugë zyrtare nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, klasifikimin e kategorive të tokës bujqësore, shumë bashki e nënvleftësojnë këtë.

Të shumta janë shkeljet jo vetëm në NJVQV por edhe në segmente të tjera si ZVRPP, të cilat keqadministrojnë (magazinojnë) në mënyrë abuzive aktet dhe kryejnë procedura formale pa u ndalur përgjegjshmërisht në ligj e akte nënligjore. Abuzimet nuk reshtin as në Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, të cilat përligjin me neglizhencën e tyre veprime të subjekteve privatë në pyjet apo zonat e mbrojtura, duke shkuar deri edhe në tjetërsime të statusit të atyre pasurive nga të paprekshme e monumente natyrore në të prekshme e mjet përfitimi. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe ALUIZNI-t ,të cilët me veprimet e mosveprimet e tyre kanë shkelur rëndë qëllimet publike të shumë trojeve e pronave, duke legalizuar në kundërshtim me ligjin dhe duke bërë përfitues individë jashtë çdo kondicioni. Pa lënë mënjanë koston e madhe financiare të shkaktuar nga zvarritja e këtij procesi kaq të rëndësishëm për dinamizmin e një ekonomie. Po aq të ndikueshme në ekonominë dhe financat e vendit janë edhe veprimet te AKKP, jo vetëm në tjetërsimet abuzive të pronave shtetërore, por edhe në paaftësinë për të bërë vetëm rolin e një organi administrativ e jo të një gjykate, ku njohja e së drejtës për kompensim konsiderohet si jo abuzive. Ndërkohë që të gjithë e dimë që çdo vendim i tillë përkthehet në faturë financiare në dëm të interesit publik me pasoja të ndikueshme të disa brezave. Në fakt këto çështje meritojnë vëmendjen e teknikienëve dhe të politikëbërësve për të ndërhyrë pasi veprimet tona janë evidente dhe dëshmojnë qartë vullnet maksimal për të evidentuar, evidencuar dhe bërë transparent çdo abuzim duke rekomanduar zgjidhje optimale për përmirësimin e gjendjes, jo vetëm në subjektin konkret por edhe në autoritetet që kanë përgjegjësinë e përshkallëzuar.

AUDITIMI I SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Nga znj. Yllka PULASHI, Drejtor Departamenti

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet auditimeve, synon përdorimin me efektivitet, fiçencë dhe ekonomikitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij.

Në germën “e” të nenit 10 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” ndër kompetencat e tij ka edhe auditimin e përdorimit, administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore, si dhe mbrojtjen e interesave ekonomikë dhe financiarë të Shtetit në personat juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Ne përgjithësi format kryesore të personave juridike në të cilët shteti ka kapitalin në masën 100% ose më shumë se gjysmën e aksioneve, për fondet publike, i gjejmë të organizuara në formën e shoqërive aksionare.

Format e shoqërive tregtare, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Në neni 20 të këtij ligji janë përcaktuar të gjitha format e këtyre shoqërive të cilat janë: 1) Shoqëri publike tregtare, sipas formës, pa dallim nëse kryen veprimtari tregtare ose tjetër; 2) shoqëria komanditore; 3) shoqëria me përgjegjësi të kufizuar; 4) shoqëria aksionare; dhe 5) shoqëria komanditore me aksione.

Shoqëritë Aksionare janë forma më komplekse e shoqërive tregtare. Ashtu si Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar, ato janë shoqëri kapitali. Kjo do të thotë që anëtarët e kësaj shoqërie përgjigjen për detyrimet e shoqërisë vetëm në masën e kontributit që ata kanë në shoqëri.

Në varësi të organizimit të shoqërisë, Shoqëritë Aksionare mund të jenë me ofertë publike, ose me ofertë private. Shoqëri Aksionare me ofertë publike janë ato shoqëri të cilat i drejtojnë ofertën për të blerë aksione një numri të përcaktuar personash. Me ofertë private janë ato Shoqëri Aksionare, të cilat ia drejtojnë ofertën për të blerë aksione disa institucioneve, aksionarëve, punonjësve dhe/ose

jo më shumë se 100 investitorëve të jashtëm. Shoqëria Aksionare me ofertë publike nuk mund të ketë një kapital më të vogël se dhjetë milion lekë. Shoqëria Aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se dy milion lekë.

Organi më i rëndësishëm i Shoqërive Aksionare është Asambleja e Përgjithshme e ortakëve. Sipas përcaktimeve në statut dhe në aktin e themelimit, Shoqëritë Aksionare mund të kenë një **Këshill Administrimi, Këshillin Mbikëqyrës, dhe/ose një ose më shumë administratorë.**

Objektivat e Departamenti të Auditimit të Shoqërive Publike janë:

1. Auditimi i zbatimit dhe vlerësimit të shoqërive publike
2. Në këtë kuadër, vlerësimi i ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve të këtyre financimeve. Auditimi i ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësimi i veprimtarisë ekonomiko financiare në personat juridik publik: shoqëritë anonime me kapital shtetëror dhe në shoqëritë e përbashkëta, ku shteti zotëron paketën kontrolluese të aksioneve, si dhe në personat juridik publik.
3. Auditimi dhe vlerësimi i shoqërive publike sipas planit të auditimit dhe ndarjes së detyrave në subjektet e audituara.
4. Në këtë kuadër, vlerësimi i ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shoqëritë publike.

Në vijimësi jepet në mënyrë të skeletuar se cilat janë etapat e auditimit të një shoqërie publike, duke nisur që nga faza e planifikimit e deri në përfundim.

I. Planifikimi dhe përfshirja në planin e auditimit të shoqërive publike:

- Auditimet e mëparshme;
- Lista e shoqërive publike me kapital shtetëror (50% plus);
- Shoqëri publike të cilat kanë interes publik/kërkesës nga komuniteti.

II. Rëndësia e auditimit të shoqërive publike:

- Janë shoqëri që menaxhojnë të ardhura publike;
- Ofrojnë shërbime/produkte të cilat lidhen direkt ose indirekt për publikun;
- Menaxhojnë resurse të cilat janë pasuri kombëtare, etj.

III. Njohja me shoqërinë që do të auditohet:

- Auditimet e mëparshme;

- Rregulloret e brendshme, statutet e shoqërive;
- Ligjet e veçanta që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë;
- Publikime të ndryshme.

Këtu duhet të kushtojmë vëmendje fazës së para hartimit të programit të auditimit, pasi në këtë fazë shikojmë zonat më me rrisht, drejtimit e auditimit, përcaktimin e afatit të auditimit, periudhës së auditimit, përbërjen e grupit të auditimit, si dhe nevojën për ekspert të jashtëm ose jo.

IV. Hartimi i programit të auditimit

Çështjet kryesore që duhet të përfshihen në programin e auditimit, si dhe tu kushtohet vëmendje e veçantë gjatë procesit të auditimit.

1. Organizimi dhe funksionimi i organeve drejtuese të shoqërisë:

- Këshillat Mbikëqyrës/Bordet Drejtuese;
- Drejtoria/Divizionet/Departamentet.

2. Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Planit të biznesit/planit ekonomik:

- Si është organizuar planifikimi?
- Renditja e prioritetëve për investimet që planifikohen të kryhen;
- Ndryshimet dhe arsyt e ndryshimeve;
- Miratimi i ndryshimeve;
- Tejkalmi i zërave si për të ardhurat dhe për shpenzimet;
- Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, në veçanti i investimeve;
- Analiza për mosrealizimin e planit të biznesit.

3. Bilanci kontabël i shoqërisë, regjistrimi i veprimeve kontabël, gjendja e debitorëve:

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit;
- Ekspertiza nga eksperti kontabël;
- Hartimi i bilancit financiar dhe fazat e miratimit;
- Evidentimi, marrja e masave për detyrimet debitorë.

4. Struktura organizative e Shoqërisë:

- Miratimi i strukturës, ndryshimi i strukturës organizative;
- Mënyra e rekrutimit të stafit;
- Rregulloret e brendshme, përshkrimi i postit të punës;
- Krijimi i sigurisë juridike për punonjësit.

5. Funksionimi i auditit të brendshëm:

- Mënyra e organizimit të AB;
- Vartësia/ hierarkia vertikale;
- Marrja si reference ose mbështetja e gjetjeve mbi materialet e AB.

6. Funksionimi dhe zbatimi I MFK:

- Strategjia e shoqërisë;
- Plan biznesi afatmesëm dhe afatgjatë;
- Funksionimi i sistemeve të kontrollit.

7. Prokurimet Publike:

- Regjistri i parashikimeve të prokurimit;
- Përzgjedhja e metodës së prokurimit;
- Krijimi strukturës së posaçme për organizimin e prokurimeve;
- Trajnimet e stafit në lidhje me përvetësimin e ligjit të PP;
- Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës;
- Ngritja e grupeve të punës;
- Procesi i prokurimit nga shpallja e procedurës deri tek lidhja e kontratës;
- Zbatimi i kontratave;
- Marrëveshja kuadër.

HYRJE NË AUDITIM

Nga znj. Aulona JANI, Kryeaudituese

KLSH zhvillon veprimtarinë audituese mbështetur në këto parime bazë të auditimit:

1. Auditimet ushtrohen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI-t).
2. KLSH përcakton standarde të aplikueshme për punë të cilat sigurojnë në vijimësi cilësi të lartë të auditimit.
3. Zbatimi i saktë i standardeve të pranueshme të kontabilitetit publik për paraqitjen e drejtë, të saktë e të vërtet të pozicionit financiar , të transaksioneve dhe rezultateve.
4. Aktivitetet e auditimit kryhen brenda mandatit të auditimit të KLSH-së dhe brenda programit të punës të çdo grupi auditimi. Çdo veprim auditimi pa miratim, përbën shkelje të parashikimeve të kësaj rregulloreje.
5. KLSH-ja punon në zbatim të teknikave më të përparuara të auditimit duke përmirësuar efektivitetin, eficiencën dhe ekonomikitetin e procesit auditues.
6. KLSH-ja shmang konfliktin e interesave midis audituesit dhe njësisë publike që auditon

Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvillon llojet e auditimeve të mëposhtme:

1) Auditime të Përputhshmërisë (pajtueshmërisë), të cilat duhet të përcaktojnë:

- a. nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me Ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- b. nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

2) Auditime të rregullshmërisë, që përfshijnë:

- a. verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare, si dhe shprehjen e

opinioneve për pasqyrat financiare, verifikimin e përgjegjësisë financiare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme;

- b. auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
- c. auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe të funksionimit të auditimit të brendshëm;
- d. auditimin e integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar.

3) Auditime financiare, në të cilat duhet:

- a. të japin siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi dhe gabimet dhe i mundësojnë audituesit;
- b. të japin një opinion nëse pasqyrat janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar;
- c. të japin opinion mbi pasqyrat financiare raportohe dhe komunikohet sipas kërkesave të SNA-ve dhe bazuar në gjetjet e auditimit. Dhënia e opinionit shprehet nëpërmjet njërit prej 4 (katër) opinioneve të auditimit: 1) të pakualifikuar, 2) të kualifikuar, 3) të kundërt dhe 4) refuzim të dhënies së opinionit.

4) Auditimi i performancës, i cili përfshin:

- a. auditimin e ekonomicitetit të aktiviteteve administrative nëpërputhje me parimet dhe praktikat e shëndetshme administrative dhe politikave menaxheriale;
- b. auditimin e eficiencës së përdorimit të burimeve njerëzore, financiare, etj., duke përfshirë shqyrtimin e sistemeve të informacionit , treguesve të performancës dhe mënyrave të monitorimit dhe procedurave që aplikojnë nga subjektet e audituara për të reflektuar problemet e identifikuara;
- c. auditimin e efektivitetit të performancës referuar arritjes së objektivave të subjektit/ve të audituara dhe ndikimeve të tyre krahasuar me ato të synuara.

5) Auditim i Sistemeve të TI-së, i cili përfshin ekzaminimin e implementimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit për të marrë siguri nëse sistemi

kompjuterik mbron asetet, ruan integritetin e të dhënave, lejon që synimet e subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive dhe përdor burimet në mënyrë eficiente.

Planifikimi në secilin lloj auditimi është i rëndësishëm për gjatë procesit të auditimit, pasi qysh aty fillon puna për:

- a. Mbledhjen e informacionit paraprak;
- b. Njohjen me subjektin;
- c. Vlerësimin e Kontrollit të Brendshëm;
- d. Vlerësimin e riskut;
- e. Përcaktimin e objektivave të auditimit dhe fushëveprimit;
- f. Përcaktimin e burimeve;
- g. Hartimin dhe miratimin e Programit të Auditimit.

Koncepti i materialitetit merr rëndësi të vecantë gjatë planifikimit, sa më sipër gjithashtu diktuar nga ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450 ku specifikohet se, objektivi i audituesit është të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Materialiteti është një koncept bazë në auditimi. Ai vendos nivelin e devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar në vendimmarrjen e përdoruesve të informacionit. Një shifër ose grup shifrash mund të jenë materiale për shkak të vlerës, natyrës ose kontekstit ku devijimi ndodh. Përcaktimi i materialitetit ndihmon audituesin të planifikojë auditimin në mënyrë të tillë që të sigurojë se shmangiet materiale janë zbuluar nga testet e auditimit dhe se burimet e KLSH-së janë angazhuar me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet.

Koncepti mund të tingëllojë abstrakt për këdo jashtë fushës së auditimit, por është esencial për tu zhvilluar dhe konsideruar përgjatë gjithë auditimit. Është pikërisht materialiteti, i cili duke përcaktuar “rëndësinë e çështjes” përqendron punën (kohën dhe energjitë) e audituesit drejt auditimit të atyre elementëve thelbësorë që lidhen me/dhe ndikojnë në aktivitetin ekonomik-financiar të njësive publike.

Tjetër element që duhet mbajtur parasysh gjatë auditimit është risku. Nuk është praktike dhe as kosto-efektive për audituesit, që të mbledhin evidencë me qëllim që të marrin siguri absolute 100% apo siguri se kanë zbuluar të gjitha gabimet materiale. Audituesit në fakt, duhet të synojnë arritjen e sigurisë së arsyeshme në opinionet e tyre. Risku i auditimit është e kundërta e sigurisë së auditimit. Risku i

auditimit është risku që audituesi dëshiron ta tolerojë për të dalë në përfundim të gabuar. Në praktikë, risku i auditimit normalisht është 5%, me qëllim marrjen e sigurisë së arsyeshme, shkalla e sigurisë është 95 % (100-5). Risku i Auditimit sa i takon besueshmërisë së pasqyrave financiare është risku që KLSH mund të jap një opinion jo të saktë, në rastet se pasqyrat financiare janë materialisht gabim. Shembuj të kushteve dhe/ose ngjarjeve që mund të paraqesin një risk të gabimit material mund të jenë:

1. Struktura e subjektit : Ndryshimet në strukturë si riorganizimi ose ngjarje jo të zakonshme; bashkime komplekse ose shkrirje njësisish, etj.;
2. Transaksionet: Transaksione të rëndësishme me palë të treta; Vlera të rëndësishme të transaksioneve jo rutinë ose jo sistematike në periudhën e fund vitit;
3. Kontabilizimi: Aplikimi i rregullave të reja kontabël (p.sh. prezantimi me kontabilitetin rritës); masa kontabël që përfshijnë procese komplekse, etj.;
4. Personeli: Mungesa e personelit me aftësitë e nevojshme kontabël dhe të raportimit financiar; ndryshimet në personel, që përfshijnë largimet e drejtuesve kyç ose rotacioni i stafit;
5. Teknologjia e Informacionit (IT): Ndryshime në mjedisin IT; instalimi i sistemeve të reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, etj.;
6. Probleme aktuale ose të shkuara: Historiku i gabimeve materiale ose sistemime të rëndësishme në fundin e vitit; dobësi në sistemet e kontrollit të brendshëm, etj.

Meqenëse është e pamundur praktikisht të auditosh të gjitha transaksionet e aktivitetit të një subjekti, audituesi duhet të ndërmarrë procedurat e vlerësimit të riskut (analiza, inspektime, hetim), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion i vlefshëm mund të merret edhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut. Në të gjitha rastet audituesi duhet të ushtrojë skepticizmin profesional sa i takon vlerësimit të riskut të kryer nga vetë subjekti.

Ka shumë teknika auditimi, një pjesë e të cilave KLSH i implementon tashmë, ndërsa vijojmë të testojmë teknika të tjera të diktuara nga praktikat më të mira si dhe nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik, por ajo çfarë është themelore në punën tonë, si auditues publik është integriteti, të cilit i mësohet që në shtyllat e auditimit publik siç është Deklarata e Limës, ku parashikohet që audituesit e SAI-eve

duhen të kenë kualifikimet dhe integritetin e duhur për të përmbushur detyrat e tyre. Nën këtë këndvështrim “kultura e integritetit” është një faktor mbi të cilin në mënyrë të vazhdueshme investohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Në terma të kësaj kulture, investimi në “tone at the top” ka qenë dhe do të vijojë të mbetet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm në KLSH.

ISSAI 12 – Vlerat dhe përfitimet e SAI-se – të bësh diferencën në jetën e qytetarëve, ndër të tjera ka si objektivi rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe **integritetit të** qeverisë dhe njësive publike. E në këtë kontekst ne si SAI, duhet të udhëheqim përmes shembullit, duke qenë një organizatë model e duke synuar vazhdimisht drejt përmbushjes së rolit tonë primar si “mbrojtës” të parasë publike.

KONTRIBUTET E AUDITUESVE TË KLSH-së, TË CILËT KANË MBYLLUR KARRIERËN E TYRE PROFESIONALE GJATË VITIT 2017

Në Konferencën e Parë Vjetore Shkencore të KLSH-së, në dhjetor të vitit 2012 *“100 vjet Shtet shqiptar dhe 87 vjet KLSH”*, u theksua që kujtesa historike është një nga përbërësit më të fuqishëm në krijimin e identitetit të qëndrueshëm jo vetëm të një kombi por edhe të një institucioni shtetëror.

Nën këtë prizëm dhe në vijim të traditës së krijuar që në vitet e para të mandatit të Kryetarit LESKAJ, në mbyllje të Analizës Vjetore për vitin 2017, z.LESKAJ iu referua kontributit dhe vlerave të veçanta të punonjësve që gjatë vitit 2017 mbyllën karrierën e tyre profesionale në KLSH, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit.

Zoti LESKAJ theksoi se *“vlerat dhe kontributi i çdo audituesi në vite është i padiskutueshëm dhe unë kam vlerësimin tim maksimal për secilin prej punonjësve që kanë dalë në pension, të cilët me punën e tyre të ndershme, korrekte dhe profesionale i kanë shërbyer KLSH në periudha kohore të ndryshme, duke kontribuar në kulturën e vlerave dhe të ngritjes së institucioneve publike në vend”*.

Livan HOXHA



Lindur më 02 Mars 1952 në Gjonme të Elbasanit,

Në vitet 1970-1975 është diplomuar në Fakultetin Ekonomisë Agrare.

Ka punuar fillimisht si ekonomist, me pas Përgjegjës Sektori dhe Kryetar i Degës së Planit në Kooperativën Bujqësore Lunik, të rrethit Librazhd, gjatë viteve 1974-1985.

Nga Prilli 1985 deri në Gusht 1991 ka qenë Drejtor në Ndërmarrjen Tregtare të Shitblerjes, të Librazhdit.

Për 19 vite që nga qershori 1999 ka qenë Auditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Vasillaq PEÇI



Lindur më -1 Janar 1953 në qytetin e Korçës.

U diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik në vitet 1971-1976.

Në vitet 1975-1987 ka punuar fillimisht si ekonomist e më pas si Kryetar i Degës së Planit, në Uzinën Nr. 12, në Kombinatin Metalurgjik Elbasan

Në vitet 1987-1993 ka qenë Inspektor Komisioni i Kontrollit të Shtetit, ndërsa në vitet 1993-1996- Inspektor i Kontroll-revizionit dhe Përgjegjës i Sektorit të Kontroll- Revizionit, në Ministrinë e Kulturës Rinisë e Sporteve.

Nga viti 1997e në vazhdim ka dhënë kontributin e tij për 21 vite, si përgjegjës sektori, Drejtor Departamenti, Auditues i parë në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Pullumb BEQIRAJ



Lindur më 4 Prill 1951 në qytetin e Vlorës.

Është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, në vitet 1968-1974.

Në vitet 1974-1981 ka punuar si Kryetar i Degës së Planit në Parkun Automobilistik të Mallrave, në Mirditë.

Në vitet 1981-1986 punoi si Kryetar i Degës së Planit në Parkun Automobilistik të Mallrave të qytetit të Vlorës dhe revizor në Komitetin Ekzekutiv të këtij qyteti.

Për 4 vite, nga 1986 deri më 1990, punoi si Kryedispecer e për dy vite të tjera, deri më 1992 si në Drejtor i Rajonit Hekurudhor Vlorë.

Për 19 vite që nga viti 1999 ka dhënë kontribut me vlerë si Auditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Saveta JANI



Lindur më 8 shtator 1956, në qytetin e Gjirokastrës.

Pas mbarimit të shkollës së mesme, në vitin 1975, ka punuar me përkushtim në qytetin e saj të lindjes deri në vitin 2008, si specialiste sekretari arkive në Komitetin Ekzekutiv, Qendrën Ekonomike Arsimore dhe Drejtorinë Rajonale Arsimore.

Që nga viti 2008, për 10 vite punoi me po atë përkushtim si psecialiste e Protokoll Arkisës në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Aqif KLOSI



Lindur më 10 Nëntor 1952, qytetin e në Laçit.

U diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, në vitet 1971-1978.

Gjatë viteve 1973-1981 ka punuar si Kryetar i Degës së Financës, në Kooperativnën Bujqësore Rremull, Laç.

Në vitet 1981-1983 punoi specialist finance në Bankën Bujqësore të Burrelit.

Në vitet 1983-1999 punoi si përgjegjës i sektorit të kontrollit në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit Matit, më pas deri më 1992, Drejtor i Ndërmarrjes së

Grumbullim-Përpunimit, Kryetar i Degës së Financës në SMT, Drejtor i Rezervave të Shtetit dhe Kryetar i Degës Tatimeve në rretin e Matit

Gjatë viteve 2002-2005 ka punuar si Inspektor Kontkollit në Zyrën Qendrore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Që nga viti 2005 për 13 vite punoi si Auditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Ymer STAFA



Lindur më 17 gusht 1952, në Tiranë.

Ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik në vitet 1971-1975.

Në vitet 1974-1979 punoi si Ekonomist-Ndërmarrja Rruga-Ura, në Elbasan.

Për 10 vjet, nga 1979 deri më 1989 punoi si Revizor në Ministrinë e Ndërtimit.

Në vitet 1989-1992 punoi Inspektor Komisioni i Kontrollit të Shtetit, ndërsa për vitet 1992-1995-ka punuar Drejtor Departamenti në Ministrinë e Turizimit.

Që nga viti 1995, për 23 vite kontriboi si Auditues, Përgjegjës seksioni, Kryeinspektor, Drejtor Departamenti, Auditues i Lartë në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Fadil DEKOVI



Lindur më 20 gusht 1951, në Shkodër.

Diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, në vitet 1970-1975.

Në vitet 1974-1988 ka punuar si mësues në Shkollën e Mesme Ekonomiko-Bujqësore, Lezhë.

Më pas në vitet 1988-1992, ka punuar ekonomist i Statistikës, pranë Komitetit Ekzekutiv të Lezhës, dhe në vitet 1992-1998 ka qenë Specialist në Zyrën e Punës së qytetit të Lezhës.

Që nga viti 1998 ka dhënë e kontributin e tij, për 22 vite si Auditues në Departamentet e KLSH-së.

Gëzim ZILJA



Lindur më 06 shtator 1951 në qytetin e Vlorës.

U diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dega Matematikë në vitet 1969-1974.

Në vitet 1974-1996 punoi në qytetin e Vlorës si mësues matematike, në shkollën e mesme “Jani Minga”, Pedagog në Shkollën e Lartë të Marinës dhe 6 vite si Drejtor në Shkollën e Mesme të përgjithsme “Ali DEMI”.

Në vitet 1996-1997 zgjidhet Deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe me pas Kryetar i Bashkisë Vlorë.

Gjatë viteve 1997-2002 ushtroi me përkushtim gazetarin.

Në vitet 2003-2007 punoi si shef i administratës së Presidencë së Republikës së Shqipërisë.

Për 7 vite që nga 2011 punoi në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së IT dhe Logjistikës.

Raimond KOÇI



Lindur më 12 mars 1953, në qytetin e Tiranës.

U diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, dega Financë Kontabilitet, në vitet 1972-1976.

Në vitet 1976-1984 punoi si ekonomist në Ndërmarrjen e Riparim Shërbimeve në Pukë.

Nga viti 1984 deri në vitin 2000 punoi në ndërmarrje dhe drejtori të ndryshme të qytetit të Tiranës, si Kryetar i Degës së Financës dhe drejtues.

Që nga viti 2000, për 17 vite punoi si Auditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Bashkim SHEHU



Lindur më 09 shkurt 1953 në Belsh të Elbasanit.

Është diplomuar në Institutin e Lartë Bujqësor, Kamëz, në Fakultetin Ekonomi Agrare, në vitet 1972-1976.

Punoi si llogaritar në Kooperativën Bujqësore Belsh, Elbasan, në vitet 1974-1976 dhe deri më 1981 si Kryetar i Deges së Financës në këtë kooperativë.

Nga viti 1981 deri më 1995 punoi në qytetin e Elbasanit, fillimisht si ekonomist në Komitetin Ekzekutiv, inspektor në Degën e Policisë Financiare, inspektor në Bankën Tregtare Agrare, Kryetar i Deges së Financës dhe më pas Kryetar i Deges së Kontroll-Revizionit në Rajonin e Sigurimeve Shoqërore Elbasan.

Që nga viti 2005, për 13 vite punoi si Auditues në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

**PASQYRIMI NË MEDIAN VIZIVE, TË SHKRUAR DHE ELEKTRONIKE
I ANALIZËS VJETORE TË KLSH-së PËR VITIN 2017, 15 SHKURT 2018.**

Analiza Vjetore e KLSH-së për vitin 2017, u transmetua më datë 15 shkurt 2018, drejtpërdrejt dhe me kronika të zgjeruara nga televizionet kombëtare: Ora News, News 24, TV Klan, ABC News, Top Channel, Top News, Vizion Plus, TVSH, Scan Tv, A1 TV, UTV, NTV, si dhe televizionet lokale të qyteteve të Durrësit, Vlorës, etj.





Analiza vjetore e KLSH, Leskaj: Gjysma e tenderave në 2017 u fituan nga vetëm 57 kompani

Më datë 16 -17 shkurt 2018 në median elektronike dhe në shtypin e përditshëm u pasqyruan mesazhet e dhëna nga të ftuarit në Analizën Vjetore të KLSH-së, për vitin 2017, si dhe pjesë nga Raporti i paraqitur nga Kryetari i KLSH-së, z. Bujar LESKAJ.

- **Gazeta “Panorama”,** faqe 9:
 - KLSH: Dëmi ekonomik nga administrata ne 2017 arrin 826 milion euro. Nga Dorina AZO.
 - Presidenti META: Duhet të rikthehet besimi tek institucionet publike.
- **Gazeta “Telegraf”,** faqe 4 dhe 5:
 - Presidenti META: KLSH nëpërmjet vlerësimit të performancës duhet të kontribuojë drejtpërdrejtë në evidentimin dhe jetësimin e praktikave më të mira.
 - Miliona euro, kreu i KLSH, LESKAJ: Janë rritur dëmet ekonomike nga ana e institucioneve shtetërore.
- **Gazeta “SOT”,** faqe 11:
 - Bujar LESKAJ, akuzua për prokurimet publike: Gjysma e tenderave në 2017 u fituan nga vetëm 57 kompani, kemi bere 47 kallëzime penale Kryeprokurori: Falë punës se KLSH u arrestua Spiro Ksera, askush nuk është i paprekshëm.
 - LESKAJ, këshillë qeverisë: Kujdes me buxhetet jorealiste.
- **“Gazeta Shqiptare”,** faqe 7:
 - Shteti 825,6 milion euro dëm buxhetit.



Publike Aktualiteti Ekonomia Bota Raport Opinion/Editorial Intervista Qesq


Bujar Leskaj, akuza për prokurimet publike: Gjysma e tenderave në 2017 u fituan nga vetëm 57 kompani, kemi bërë 47 kallëzime penale






Postuar: 16/02/2018 - 08:10

Korupsioni i tallë me pronat dhe legalizimet, problemet me tenderat publike, rishfryga e detyrimeve të propambetura dhe heqja e uljes së borxhit publik. Këto janë disa prej problemeve kryesore të evidencuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në adresë të administratës publike. Në analizën vjetore të punës së kësaj institucioni, kryetar i KLSH, Bujar Leskaj tha se gjysma e vlerës totale të tenderave, janë fituar nga vetëm 57 subjekte



Miliona euro, kreu i KLSH, Leskaj: Janë rritur dëmet ekonomike nga ana e institucioneve shtetërore

 15.02.2018



Nga shprehje të kryetarit të KLSH të 2017 për situatën ekonomike nga ana e institucioneve shtetërore

Nga Leskaj gjat vitit 2017 KLSH ka rritur të treguar të kontrollit dhe përfundimit të punës së administratës së shtetit, të cilin në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për të siguruar që të gjithë subjektet të punës së shtetit të punojnë në kushte të barabarta.

NEWS 365

Analiza vjetore e KLSH

Sipas kështjës të Kontrollit të Lartë të Shtetit janë ribur dëmet ekonomike nga ana e institucioneve shtetërore. Sipas bujar tësaktë gjatë vitit 2017 KLSH ka vijuar të trajtojë profesionalizimin letrar dhe amksat e qytetarëve, të cilët në çkë rast kanë qështjës e ngjitur prej tyre ka qështë jashtë kompetencave të institucioneve.

Shprehjet: edhe në këtë rast... (text partially obscured)

almakos

Meta: Arsimi i lartë ndeshet ende me sfida mjaft të vështira dhe me rështirësi për zbatimin e ligjit të arsimit të lartë

SMART KËSHTJËS

Presidenti i Republikës, Vllasë Duka, ka qështë të shprehë shprehjet e tij për të ardhurën e arsimit të lartë në Kosovë. Në një shprehjet të dhënë gjatë konferencës së shtetërore për ligjin e arsimit të lartë të Kosovës, Duka ka qështë të shprehë shprehjet e tij për të ardhurën e arsimit të lartë në Kosovë. Në një shprehjet të dhënë gjatë konferencës së shtetërore për ligjin e arsimit të lartë të Kosovës, Duka ka qështë të shprehë shprehjet e tij për të ardhurën e arsimit të lartë në Kosovë.



The screenshot shows the homepage of DRONI.al, a website focused on news and analysis. The header features the site's logo and a navigation menu with categories: HOME, POLITIKA, KRONIKA, EKONOMI, OPINION, RAJONI, KULTURE, and SI. Below the navigation, there are social media icons for Facebook, Twitter, and YouTube. The main headline reads: "VITI 2017/ Analiza e KLSH, ja sa llogaritet dëmi ekonomik dhe sa kallëzime penale për drejtues të nivelit të mesëm e të lartë". Below the headline is a photograph of a man in a suit speaking at a podium in a conference room. The text below the photo states: "Në analizën vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit, kreu i këtij institucioni Bujar Leskaj bëri me dije se për gjatë vitit 2017 janë kryer plotë 256 auditime, ndërsa dëmi ekonomik për llogaritet 11.3 miliardë lekë. Të kishte bërë një pasqyrë të vitit që kaloi, Leskaj thotë se janë bërë 47 kallëzime penale për drejtues të nivelit të mesëm e të lartë."

3 pranimë të analizave të institucioneve publike të kontrollit të nivelit të mesëm e të lartë.



The screenshot shows the homepage of 55 ONLINE, a website focused on news and analysis. The header features the site's logo and a navigation menu with categories: NEWS, POLITICS, ACTUALITIES, EDITORIAL, OPINIONS, CULTURE, and BLOG. Below the navigation, there are social media icons for Facebook, Twitter, and YouTube. The main headline reads: "Presidenti Meta: KLSH, me performancë të qëndrueshme vitet e fundit". Below the headline is a photograph of a man in a suit speaking at a podium in a conference room. The text below the photo states: "Presidenti i Republikës, Dr. Meta ka bërë gjatë vitit 2017 një vizitë të rëndësishme në institucionin e kontrollit të nivelit të mesëm e të lartë të Shtetit. Në vizitën e tij, Meta ka bërë një analizë të performancës së institucioneve të kontrollit të nivelit të mesëm e të lartë të Shtetit dhe ka bërë një pasqyrë të vitit që kaloi. Meta ka bërë një pasqyrë të vitit që kaloi, Leskaj thotë se janë bërë 47 kallëzime penale për drejtues të nivelit të mesëm e të lartë."



Istandard File të testit >

NEWSBORE - POLITIKË - ACTUALITET - KOMENT - EKONOMI - BOTA - SHOK

KLSH: Dëmi ekonomik nga administrata në 2017 arrin 826 milionë euro

11 shkurt 2018

Facebook Twitter YouTube Instagram LinkedIn

Shkëlqej dhe abuzimet e institucioneve shtrënore i kanë shkakuar buxhetit të shtetit për periudhën janar-dhjetor 2017, dëm ekonomik me vlerë 826 milionë euro.

Dëmi ekonomik u deklarua dhe nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Sllaz Lleskaq, gjatë analizës vjetore të Institucit të Lartë të Shtetit, Lleskaq, tha se për 2017 d

Kreu i KLSH-së u shpreh se dëmet më të shtrëna... the.bardha.net. File:shkëlqej.d

Albanian Daily News
THE MOST AUTHENTICATIVE ALBANIAN SOURCE IS ONLINE

Home Politics Economy Current Events Social Sport Go to World News Contact Us

SSA Integrity Preservation, Important Challenge - Says Meta

President of the Republic, Ilir Meta defines the State Supreme Audit (SSA) integrity preservation an important challenge. The Head of State, Meta underscored this fact during SSA annual analysis on Thursday.

"Citizens' confidence on the institutions and their decision-making restoration is an absolute necessity. Major support should be given to an important institution like SSA while preserving the integrity," said President Meta.

Referring to the SSA activity President Meta declared that the work done so far by this institution has

Del shifra/ KLSH: Dëmi ekonomik nga administrata në 2017 arrin 826 milionë euro

Feb 17, 2018

SHPËRNDAJE



Facebook



Twitter



Like 10



Tweet

DORINA AZO/ Shkeljet dhe abuzimet e institucioneve shtetërore i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit për periudhën janar-dhjetor 2017, dëm ekonomik me vlerë 826 milionë euro.



Dëmi ekonomik u deklarua dje nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bujar Leskaj, gjatë analizës vjetore të institucionit për 2017-n. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Leskaj, tha se për 2017-n janë kryer 156 auditime.

Kreu i KLSH-së u shpreh se dëmet më të larta janë në administrimin e pronës shtetërore dhe tenderat. Për shkeljet me dëm ekonomik, KLSH në 2017 kallzoi në Prokurori për ndjekje penale 130 zyrtarë. Kryetari i

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

RSH. Kontrolli i Lartë i Shtetit

Analiza Vjetore e KLSH 2017 / redaktoi Armanda Begaj;

RSH. Kontrolli i Lartë i Shtetit. - Tiranë: KLSH, 2018

296 f. : me foto ; 23.5 cm.

ISBN 978-9928-159-69-4



Seria: botime KLSH - 04/2018/88

Shtypur në Shtypshkronjën
MORAVA



Kontrolli i Lartë i Shtetit
Rruga "Abdi Toptani", Nr. 1
Tiranë Tel/Fax 04/228485, Tel.04/251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail klsh@klsh.org.al